

DIBLIOTEKA
SHTEHT

214.09

550

DILAVER
DILAVERI

meditime
letrare

meditim
letrar

meditim
letrare



Dilaver Dilaveri ka lindur më 1936. Studimet e larta, në Universitetin Shtetëror të Tiranës, i ka kryer më 1958. Prej disa vjetësh është marrë me shkrime kritike dhe ka botuar një sërë artikujsh e studimesh letrare. «Meditime letrare» është vëllimi i tij i parë, ku janë përmbledhur disa nga shkrimet e tij më të mira.



814.09
8 50

S

DILAVER DILAVERI

R

MEDITIME LETRARE

(Artikuj kritikë)

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

31213

SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

JETA E SOTME REVOLUCIONARE NË ROMANIN TONË

Mozaiku kaq i larmë, i pasur dhe i gjerë i jetës sonë, vrulli revolucionar, heroizmi masiv dhe, mbi të gjitha, lufta e përditshme këmbëngulëse për formimin e ndërgjegjes së re, apo më mirë, për krijimin e njeriut të ri, që është rrjedhim i drejtpërdrejtë i thellimit të revolucionit ideologjik, përbëjnë një material shumë të pasur ku krijimtaria jonë letrare, e sidomos romani ynë ka gjetur mundësinë e zhvillimit të vet të suksesshëm.

Pasqyrimi i realitetit nuk nënkupton një soditje apo konstatim simplist të asaj që shtjellohet rreth nesh dhe jashtë nesh, por një zbërthim të fenomeneve të realitetit, një thellim të shkrimtarit në ato apo këto fenomene, që e interesojnë atë dhe që e kanë nxitur frymëzimin e tij.

S'ka pasqyrim të realitetit jashtë marrëdhënjeve ekonomiko-shoqërore, jashtë raporteve të përditshme sociale, në të cilat zhvillohet dhe evoluon jeta. Ky realitet, përfshin, madje si një element me rëndësi të parë, edhe vetë njeriun, që është në fund të fundit jo vetëm mbartës e shprehës i këtyre raporteve ekonomiko-shoqërore, por njëherazi edhe një objekt i ndërlikuar, që me botën e vet të brendshme, me faktin se gjer në ç'masë e ka të zhvilluar e të pasur atë botë, përfaqëson edhe stadin e zhvi-

llimit të shoqërisë, konkretisht të shoqërisë sonë të sotme.

Pasqyrimi dhe njohja e një realiteti të caktuar përfytyron në të njëjtën kohë edhe një paraqitje reale e bindëse të konflikteve të rëndësishme, që vlojnë brenda gjirit të shoqërisë. Romani ynë si një gjini që po merr çdo ditë prioritetin mbi gjinitë e tjera dhe që po evoluon mbi një terren të shëndetshëm e revolucionar letrar, siç është letërsia e realizmit socialist, në mënyrë të pashmangshme do të trajtojë pikërisht konfliktet më të mprehta, konflikte të natyrshme e të pranueshme për shoqërinë tonë, që shtjellohen nëpër kontradiktat antagonistike e sidomos jo antagonistike, në mënyrë që të mund të japë pa e shtrembëruar tablonë e gjerë të jetës te ne.

Nëse do të ndodhte e kundërta, pra nuk do të zbërtheheshin në vepra këto konflikte, nëse autorët nuk do ta merrnin spuntin e tyre krijuese në jetën e gjallë, atëherë s'do të kishim këtë letërsi, që kemi sot, por një letërsi të zbetë, anemike e vanitoze, një krijimtari më tepër pjellë të fantazisë së autorëve që, sado e begatshme, do të shteronte dikur e do të na jepte vepra bastardhe, pa freskinë e njomësinë e jetës.

Edhe sikur të marrim për të vështruar mënyrën se si ka zënë vend dhe është pasqyruar në letërsinë tonë qoftë vetëm tema e klasës punëtore, do të kemi të qartë se ç'ecje përpara ka shënuar apo ka realizuar proza jonë në gjininë e romanit, si ka evoluar pasqyrimi i realitetit jetësor në prozën tonë të gjatë.

Gani Guri i romanit «Çlirimtarët» na dha një përfaqësues të klasës punëtore shqiptare, i cili, sikurse klasa e vet, në vitet e luftës, pati për mision të përhapte idetë e reja komuniste dhe personazhi e arrin këtë mision në vepër. Por me gjithë këtë figurë e ndonjë tjetër episodike, ne s'e kemi të gdhendur në vepër si klasë me botën shpirtërore të profilizuar proletariatin shqiptar të mirëfilltë. Në tërësi ata që bashkohen dhe drejtojnë punëtorët në vepër janë të futur vonë në radhët e kësaj klase dhe këta vijjnë o nga fshati, o nga vegjëlia e varfër e qytetit. Kjo mungesë objektivisht e shpjegueshme, se edhe në jetën

tonë asi kohe proletariati, apo punëtorja, qe një shtresë shumë e pakët në numër, doemos do të reflektohej edhe në vepra artistike, që morën si detyrë mbi vete të na përshkruanin tablonë e fuqishme reale të kohës.

Pak vjet më vonë «Këneta», roman mbi veprat e para, që u ndërmorën nga partia për ndërtimin e jetës së re, i kushton më tepër vend klasës punëtore, paraqitjes së saj dhe të rolit të saj. Është karakteristike për këtë roman se pjesa dërmuese e personazheve që përfaqësojnë klasën, janë fshatarët, që edhe këtu në kantierin e bonifikimit të Maliqit, ruajnë më tepër botën shpirtërore të fshatarit, janë me trup aty, në kantier, e me zemër në fshatrat e tyre. Elementet e ndërgjegjes së klasës këtu janë shumë të pakët, madje ato vetëm sapo nisnin të duker te ndonjëri prej personazheve pa mundur të arrijnë që të na demonstron në masën e gjerë. Kjo veçori e romanit, veç të tjerave, shpreh objektivisht gjendjen apo stadin e zhvillimit e të rolit real, që kishte nisur të luante klasa jonë punëtore në vitet e para të çlirimit.

Krejtësisht i ndryshëm është roli dhe vendi që zë klasa punëtore në romanet «Dasma» dhe «Përsëri në këmbë». Tashmë kemi një klasë punëtore, që ndihet shumë në jetë e, si rrjedhim, edhe në vepër, kemi një klasë punëtore që jo vetëm s'është me rol të pakët në fatin e ngjarjeve, që zhvillohen në realitet, por që ndikon fuqimisht e në mënyrë vendimtare mbi heronjtë e tjerë, mbi ngjarjet dhe mbi krejt shoqërinë.

Klasa punëtore e veprave të fundit është përfaqësuese e denjë dhe e ndërgjegjshme e moralit dhe e ideologjisë sonë komuniste, ajo është vendosmërisht luftëtare e pakompromis, që mbron dhe përkrah të renë në jetë e në shoqëri.

Në këto vitet e fundit të krijimtarisë sonë, lulëzimi letrar që u arrit, sukcesi që shënoi romani, shpjegohet edhe me faktin se shkrimtarët u thelluan më tepër në njohjen e jetës, në kapjen e konfliktit thelbësor, në pasqyrimin e guximshëm të konflikteve dhe të realitetit. Kështu romani «Dasma» i Ismail Kadaresë, pavarësisht

nga ndonjë e metë dhe mungesë e tij, që një hap i rëndësishëm i autorit në trajtimin e temës së revolucionarizimit të ndërgjegjes. Ai dëshmoi për një përpjekje serioze të shkrimtarit për të na dhënë, nëpërmjet paraqitjes së kontradiktave joantagoniste, apo duke vendosur në qendër të veprës një konflikt të madh shoqëror, realitetin shqiptar të atyre viteve kur, mbas Letrës së hapur dhe sidomos fjalimit të gjashtë shkurtit, nisi në gjirin e shoqërisë sonë lufta e ashpër kundër botëkuptimit patriarkal dhe paragjykimeve fetare, lufta për çlirimin e gruas, për ngritjen e personalitetit të saj. Meritë e veprës është, veç të tjerave, fakti që autori në tërë subjektin e saj ka futur jetën e gjallë, që ka rrjedhur rreth tij. Çdo lexuesi, sado i pakualifikuar qoftë ai, s'mund të mos i lërë mbresë krejt ajo mori tipash që, ndonëse janë dhënë me pak radhë, ndonjëherë edhe vetëm me një frazë apo batutë, prapë janë aq të vërtetë dhe aq të pranueshëm për ne, që nga Rudi e deri te «Soda kaustike» me shokë, apo ajo atmosferë e gjallë, plot kolorit e ngrohtësi e kësaj dasme punëtore, që me gëzimin e vet të zhurmshëm e ndërpret, e superon derisa e mposht me gjithësej frymën e zymtë e të errët të jetës patriarkale, intrigat dhe kurthet e mblesit e të priftit, pjella dhe mbrojtës të kanunit e të ungjillit.

Po në këtë aspekt të njohjes e të dhënjes besnike dhe emocionale të realitetit, gjejmë edhe disa romane të tjera të këtyre viteve të fundit. Romani «Përsëri në këmbë» i Dhimitër Xhuvanit ndonëse trajton temën e klasës punëtore, merret me një anë tjetër të rëndësishme të realitetit, me pasqyrimin e botës shpirtërore të njeriut të ri të klasës, me rritjen e ndërgjegjes dhe formimin botëkuptimor revolucionar të individit në shoqërinë tonë. Një fatkeqësi aksidentale e një njeriu nga më zakonshmit dhe rruga e tij plot përpjekje të vetëdijshme për t'u kthyer në jetë, përbëjnë boshtin e subjektit të romanit. Duke përshkruar një rrugë disavjeçare të heroit, autori ka mundur të japë, jo vetëm nëpërmjet heroit të veprës, por edhe nëpërmjet paraqitjes së realitetit përreth heroit,

rritjen e klasës punëtore, rritjen e rolit të saj të ndërgjegjshëm në zgjidhjen e problemeve të rëndësishme e delikate, që kishin të bënin me fatin e atdheut, në ato çaste kur atë e kërcënonte blokada revizioniste. Ky aspekt i dytë jetësor i jep sfond synimit kryesor të autorit, që lidhet me veprimtarinë, përpjekjet dhe luftën që bën hero i romanit për të mos dalë nga radhët.

Autori ka kapur një rast nga jeta, nga realiteti dhe e ka vendosur në subjekt të veprës, por në saje të forcës përgjithësuese, që arrin romani, rasti jetësor e humb vlerën e mëvetshme dhe shtrihet në dhjetëra, qindra apo mijëra raste të tjera të ngjashme edhe të ndryshme, që janë shfaqje dhe njëkohësisht tipare të njeriut tonë të sotëm. Pa e idealizuar jetën tonë, duke e pasqyruar atë me realizëm, Dh. Xhuvanit i kanë tërhequr vëmendjen edhe fenomene të tilla, që dëshmojnë për elemente morale negative aty-këtu te njerëzit tanë, si mund të vërejmë dyshimin e skepticizmin e ndonjë personazhi, mosbesimin për mundësinë e arritjes së suksesit të heroit edhe për faktin se edhe në «botën e zhvilluar» individi nuk ja ka arritur, përkundër më tepër ka dështuar në raste tentativash të tilla të pashpresa. Vështrimi realist e ka çuar autorin në dhënjen disa herë në roman të ambienteve letargjike në lagjen ku banon Dini, apo në dhënjen e çregullimit e të frymës së dizinteresimit, që zotëronte në oficinë, sidomos për materialet gjysmë të konsumuara që flakeshin në rikupero. Për këtë cilësi të veprës flasin edhe skenat e jetës në bilardo e gjetkë, por, sidoqoftë, këto skena, ashtu sikurse në jetë, në veprë janë kënde të vogla në tablonë e madhe plot pathos revolucionar e vetëmohim, plot këmbëngulje dhe besim në triumfin mbi vështirësitë, mbi mungesat dhe fatkeqësitë e çdollojshme. Në këtë plan, duke na dhënë jetën tonë revolucionare në roman, autori ndikon thellë në edukimin me ndjenja e moral të shëndoshë te lexuesit tonë. Ndofta vepra do të qe më tipike dhe më aktuale sikur të na e jepte Dinin të rrethuar nga atmosfera e ngrohtë e vëllazërore e shoqërisë edhe në pjesën e parë të romanit, edhe gjatë viteve

të përpjekjeve të tij për t'u ngritur në këmbë, ashtu siç ndodh sot realisht ndër ne, ku shoqëria s'është e huaj për fatin e individit, përkundrazi. Por edhe kështu si është konceptuar, për shkak të momenteve të jetës e karakterit real të njeriut, që e ka frymëzuar autorin, vepra ndikon pozitivisht, se e ka dhënë jetën tonë revolucionare në një aspekt të saj.

Gjithmonë në këtë tragë tematike, megjithëse jo më ngushtësisht në terrenin punëtor, realiteti ynë heroik, heroizmi masiv i popullit, ka gjetur vend në romanin «Dhjetor i shqetësuar» të Fatos Arapit. Këtë radhë s'kemi të bëjmë më vetëm me elemente të veçuara, as me raste të shkëputura, por me krejt një lëvizje popullore. Kjo që thamë i përket realitetit, asaj që ndodhi te ne, se me të vërtetë qe emocionuese dhe të mbushte me krenari ajo që ndodhi pas tërmetit të Dibrës, në atë dhjetor të akullt, kur mijëra e mijëra nga bashkatdhetarët tanë braktisën çdo gjë dhe u sulën për t'u vajtur në ndihmë të dëmtuarve nga tërmeti, pa përfillur dëborën, tufanin dhe ngriecat. *Atje, në fshatrat e Dibrës të mbuluara me dëborë e rënoja, çdo ditë, çdo çast, njeriu takonte e njihte heroizma, luftë të ndërgjegjshme e vetëmohuese. Pikërisht ky realitet e ka frymëzuar autorin dhe ka vërshuar në faqet e romanit të tij. I nisur nga dëshira për të na dhënë sa më të plotë tablonë e kësaj ngjarjeje revolucionare, F. Arapi ka futur aspekte të ndryshme jete, që në vetëvete flasin dhe e realizojnë qëllimin e tij, por që autori nuk ka arritur t'i shkrijë e t'i unifikojë në mënyrë organike në një tërësi subjekti e, si rrjedhim, ato ruajnë një farë mvetësie, që i ka shkaktuar një natyrë pak fragmentare veprës.*

Po kështu, nga materiali që të ofron romani, të krijohet përshtypja se në shumë momente të subjektit mungon thellimi dhe motivimi logjik e emocional, që do të na jepte më mirë atë që ndodhi realisht në dhjetorin e vitit 1967. Shumë episode apo aspekte reale jete vetëm sa janë cekur apo përmendur dhe kjo i ka dhënë karak-

ter herë-herë reportazhist romanit. Ndërsa në kapitujt e fundit ku jeta revolucionare ka hyrë gjerësisht, nëpërmjet detajesh të gjetura, tipash të skalitur dhe bindës, ka ndodhur e kundërta, ka ndodhur që vepra e ka dhënë të ngritur në art realitetin pa rënë në stilin përshkruar enunjerativ, gati reportazhist. Historia e fshatit Seb, figura e Likës, kryetarit të këshillit, apo e fshatarit plak Pjetrit, digresioni për fisin e Gjokajve si dhe bota shpirtërore e inxhinieres Vera, janë faqe nga më të realizuarat për pasqyrimin e realitetit heroik në roman. Por s'mund të themi po këtë mendim dhe s'jemi të bindur se autori ka dhënë të ngritur në art realitetin kur flet për episodet dhe skenat e shoferëve në klub, ku s'dihet përse autori është shtyrë t'i japë aq vend një vajze të lindur idiote, e cila edhe ajo paska vajtur në atë aksion të madh! Ç'do të na thotë ky fenomen në veprë, ç'shtirije gjeti ai në realitetin e asaj kohe dhe, në fund të fundit, ç'dritë hedh ky personazh me veprimet e qëndrimin e vet, ta zëmë, lidhur me shoferin trupmadh, pijanec. Sido që të jetë, shfaqje të tilla, edhe sikur ato t'i ketë ndeshur autori në ndonjë rast në atë muaj heroizmesh e fitoresh, ku tipike qe lufta e ndërgegjeshme e njerëzve tanë për të arritur objektivat revolucionare, pa përfillur pengesat, s'duhet të zinin kurrë kaq vend për hir të dëshirës që «ta zhveshim veprën nga idealizimet, që të jemi më realistë». Të njëjtat vërejtje mund t'i bëhen romanit edhe për linjën e gazetarëve ku ndihet pak si tepër fruti elaborues i penës së autorit mbi realitetin, apo në ndonjë episod, siç është ai i plakut, që zbret në Laç, që herë pas here nxjerr kokë nëpër krejt romanin dhe që, si fenomen, mbetet jo plotësisht i zbërthyer. Këto cungime që i hasim në romanin «Dhjetor i shqetësuar» përsa i përket faktit se sa në faqet e veprës ka gjetur veten e vet jeta jonë, realiteti ynë, na bëjnë të mendojmë se autori është ngutur, s'ka arritur ta përpunojë mirë materialin e pasur, që ka patur në duar dhe, si rezultat, nuk na ka dhënë tërësisht madhështinë e atij heroizmi masiv e të atij realiteti jetësor.

Një anë e rëndësishme e jetës në këtë periudhë të fundit të thellimit të revolucionit tonë ideologjik është edhe evolucioni i fshatit tonë, transformimet e tij të mëdha. Një sërë përmbyesjesh që u realizuan në fshat, si kooperimi i plotë i bujqësisë edhe në zonat e thella mallore, përmbyesja dhe zhdukja e institucioneve klerikale si dhe lufta e ashpër kundër fesë si ideologji që nisi dhe po vazhdon të zhvillohet, lufta kundër kanunit dhe zakoneve prapanike, iniciativat e mëdha revolucionare të fshatarësisë sonë në dobi të forcimit të ekonomive bujqësore kooperativiste dhe tani së fundit, elektrifikimi i plotë i fshatit, bënë që jo vetëm faqja e fshatit të ndryshojë, por njëkohësisht shkaktuan edhe një transformim të marrëdhënjeve brendapërbrenda familjes fshatare, ku u lëkund roli patriarkal i të parit të shtëpisë dhe nisi të shihet gruaja dhe vajza nga pozita të njëjta me burrin dhe djalin. Sigurisht në këtë drejtim mbetet gjithmonë për të bërë.

Veprat e gjata në prozë, që janë marrë me këtë anë të jetës, kanë mundur shpesh me sukses t'i pasqyrojnë këto fenomene të rëndësishme. Kështu, romani «Ara në mal» i Petro Markos na ka dhënë bukur gjithë atë proces transformimi të madh ekonomik e shpirtëror të fshatit e të fshatarit tonë, që po përqafoje idenë e kolektivizimit, duke na vizatuar me forcë dhembjen apo tronditjen shpirtërore të fshatarit të sotëm të mesëm, lëkundjet e tij reale para se ta përqafojë këtë jetë të re. Krahas kësaj, autori me vërtetësi e nëpërmjet njohjes së plotë të fenomeneve shoqërore, që na përshkruan, ka mundur të zbulojë edhe dobësi e të meta tipike të punës drejtuese propagandistike në fshat si dhe rolin negativ të forcave reaksionare që, për arsye që janë të kuptueshme për ne, veprojnë tinëzisht në dëm të së resë.

Por, ndërsa në pjesën më të madhe të këtij romani e gjejmë të dhënë me realizëm e në mënyrë bindëse procesin e transformimit të fshatit tonë, në këtë etapë të fundit të kolektivizimit, në kapitujt e fundit të tij si edhe te ndonjë roman tjetër me po këtë emër si «Brezat» dhe

«Kthesat e forta», paraqitja e realitetit në vepër nuk ka arritur të jetë pasqyrim besnik i asaj që ndodhi në fshatin tonë. Këto vepra e idealizojnë realitetin, minimizojnë vështirësitë, që u deshën dhe duhen kapërcyer për të arritur lulëzimin e plotë të fshatit, dhe nuk motivojnë artistikisht shumë momente kthesash të rëndësishme në jetën e fshatit tonë duke e zbehur mjaft forcën dhe domethënjen e tyre reale. Në këto dy romane e veçanërisht te «Stuhia» është ekzagjeruar realiteti në atë aspekt ku nënvizohet tej masës roli pozitiv i kuadrove, që zbritën në bazë, qofshin këta agronomë, ekonomistë, punonjës me përgjegjësi në qytet, që iu përgjegjën thirrjes së Partisë. Realisht ndodhi vërtet që njerëzit e vajtur nga qendra ndikuan në procesin e zhvillimit të kooperativës apo të fshatit për probleme të ndryshme ideologjike apo ekonomike, por ky zhvillim nuk u mbështet vetëm tek ata, ai kishte nisur që më parë, kjo s'duhet harruar dhe, së dyti, ky zhvillim nuk do të ndalej edhe sikur të mos kishin vajtur njerëz nga qyteti në fshat, se edhe në fshat, si kudo, këto dekada të pasçlirimit kanë rrënjësuar frymën e revolucionit që nisi me përmbysjen e botës së vjetër.

Duke thelluar këtë të metë, në mënyrë të veçantë «Stuhia», injoron fare ndikimin reciprok të pamohueshëm të realitetit qoftë ky edhe realitet i një kooperative, që ka shumë mungesa e të meta, mbi formimin dhe bindjet e njerëzve të vajtur nga qendra, sado të ngritur e të formuar qofshin ata.

«Stuhia» është ndër romanet ku, më shumë se te të tjerët, autori s'ka mundur të kapë atë të re të fuqishme, së cilës i përket e ardhmja, ku materiali i pasur jetësor e ka tërhequr në vogëlsira që, duke u ndriçuar së tepërmi, duke qenë në qendër të romanit, janë zmadhuar tej përmasave reale dhe jo vetëm që ato vetë janë deformuar, por kanë bërë që aspektet e tjera të rëndësishme të mos marrin forcën e duhur përgjithësuese sikurse i gjejmë realisht në jetë.

Te «Vlaga e dheut», roman i Filip Ndocajt, realiteti i gjallë jetësor ka zënë vend fuqimisht dhe është pasqy-

ruar drejt lidhur me shkatërrimin e familjes patriarkale. Në këtë vështrim të pasqyrimin të shkatërrimit të patriarkalizmit, të kalbëzimit e prishjes së familjes patriarkale, e cila s'ka më asnjë funksion, s'luan më asnjë rol veç pengues, dëmtues për jetën e re, romani është një sukses për autorin. Kjo ka ardhur ngaqë autori e ka njohur atë realitet, është thelluar në të, e ka kristalizuar në ndërgjegjen e vet dhe na e ka dhënë me dorë të sigurt. Këtë s'mund ta themi për veprën kur aty nis e bëhet fjalë për forcat e reja, që iu kundërvunë patriarkalizmit, për ato forca që i thirri realiteti e jo dëshira e autorit, mirëpo, ngaqë ato s'njihen thellë nga autorët tanë, vizatohen të zbata, skematike dhe këtu s'arrijnë ta luajnë rolin e tyre ashtu si e luajnë realisht në jetë. Kjo mungesë doemos ka ndikuar keq në pasqyrimin e asaj që sot me të vërtetë ndodh në jetën tonë. Se, pavarësisht nga njohja e cektë, që mund të ketë një autor, e reja në jetën tonë është e fuqishme e vitale dhe vetëm në saje të këtij vitaliteti ajo çdo ditë fiton terren.

Thellimi i revolucionit ideologjik e kultural pati dhe ka si anë të rëndësishme luftën për emancipimin e plotë të gruas, çlirimin e saj nga çdo përbuzje e nënvleftësim, vendosjen e saj në pozita të barabarta me burrin. Romani i viteve të fundit e pasqyroj dhe i dha vendin e merituar këtij problemi.

«Ara në mal» është një nga romanet më të para që u mor më tepër me këtë problem. Ndonëse në plan të dytë, fatin e gruas e ndjekin edhe romane si «Brezat», «Stuhia» e ndonjë tjetër. Krahas luftës për krijimin e kooperativës, krahas përpjekjeve për të futur idetë e reja në fshat, autori merret edhe me fatin e Nifes, heroinës së romanit, që bëhet pre e zakoneve prapanike dhe jepet si plaçkë tek ai burrë, që do apo ka interes i ati, pa e përfillur fare dëshirën dhe ndjenjën e saj. Romani ka dhënë një reagim dizaprovues ndaj këtij fenomeni, është përpjekur t'u japë vend përpjekjeve të atyre që përfaqësojnë të ardhmen e jetës e të marrëdhënjeve në fshat si dhe një farë rezistence të vetë heroinës, ndonëse

kjo rezistencë është e pamjaftë, gjë që e ndjen dhe autori, i cili ua jep peshën kryesore të përpjekjeve për çlirimin e saj më tepër të tjerëve, bile edhe vetë keqardhjes dhe mirëdashjes së Zanit, burrit plak të Nifes, se sa vetë asaj.

Pikërisht në këtë gjë, domethënë në dhënjen e përpjekjes e për çlirimin dhe të drejtën e vetëvendosjes për fatin e saj është vepruar më drejt te romani «Kullat» i Gjergj Zhejit. Maja, heroina e këtij romani, s'është më një qenje e dobët në duart e të tjerëve, ajo aktivisht vepron vetë, në mënyrë që ajo dhe jo dikush tjetër të vendosë për të ardhmen e saj. Jo rastësisht autori në fund të veprës e lë heroinën vetëmpërvetëm kundrejt të atit, që është pengesa kryesore në lumturinë e Majës dhe ajo qëndron burrërisht duke pranuar më mirë vdekjen nga dora e tij se sa nënshtrimin përpara tekave dhe dëshirave të tij. Po kështu mund të pohojmë edhe për heroinën e romanit «Një lindje e vështirë» të Elena Kadaresë, ku Bardha, në përmasat që ja lejon autores mënyra se si e ka konceptuar këtë figurë, vepron kundër të gjitha forcave, që mundohen të pengojnë lumturinë e heroinës në emër të zakonit e të kanunit.

Realiteti ynë revolucionar është shumë i gjerë, jeta jonë ka mijëra shfaqje interesante, që flasin për sukseset tona, për njeriun e ri, për pulsën e vrullshëm të revolucionit tonë.

Shkrimtarët tanë mund t'i gjejnë subjektet e veprave të tyre kudo. Para letërsisë sonë mbeten akoma shumë detyra të rëndësishme; pasqyrimi i së djeshmes heroike dhe i së sotmes revolucionare e, mbi të gjitha, pasqyrimi i luftës, përpjekjeve dhe heroizmit të klasës sonë punëto-re, detyra që në vitet e ardhshme, patjetër gjithmonë e më mirë do t'i realizojnë prozatorët tanë në romanet e tyre.

1971

PËR HEROIN POZITIV TË ROMANIT TONË

Problemi i heroit pozitiv pa dyshim është një nga më thelbësorët, që lidhet drejtpërdrejt me vetë zhvillimin e letërsisë në tërësi, me vlerat e sukseset e saj. Prandaj rrahja e mendimeve për këtë element kryesor të veprës letrare-artistike, që njëherazi përbën edhe mjetin më komunikativ për të përçuar idetë e fuqishme revolucionare të kohës, është e domosdoshme.

Letërsia jonë, në tërë gjinitë e saj, si një letërsi e partishme e revolucionit, ka synuar gjithmonë t'i japë lexuesit, masës së gjerë idetë më progresive të kohës dhe, bashkë me to, figurën sublime të atyre që i mbartin këto ide, që i prijnë masës, duke i treguar asaj rrugët e së ardhmes. Në paraqitjen e heroit në letërsinë tonë, e veçanërisht në romanin tonë, janë arritur një radhë suksesesh.

Triumfi i revolucionit popullor, që solli me vete edhe triumfin e realizmit socialist në letërsi, si e vetmja metodë zotëruese letrare, bëri që në krijimet e ndryshme të zërë vend njeriu i ri, përfaqësuesi i thjeshtë i masës së gjërë të popullit. Heroi pozitiv u bë mishëruesi i idealeve më të larta shoqërore, tipi që me veprimet, tiparet dhe qëndrimin e tij udhëheq shoqërinë, bëhet shembull i lartë, që duhet ndjekur dhe imituar. Krejt ndryshe nga

heronjtë kryesorë të rrymave të tjera letrare, madje edhe të atyre më të avancuarave parasocialiste, që arrijnë vetëm sa ta dënojnë, të mbajnë qëndrim kritik ndaj realitetit të shëmtuar, që krijoi borgjezia, heroi ynë pozitiv është në vetëvete një potencë e fuqishme transformuese, që nxit për ndryshime të thella shoqërore, për përmbysje e rimëkëmbje në emër të së ardhmes së lumtur të njerëzimit.

Si i tillë, heroi pozitiv në letërsinë dhe artin tonë të ri zuri vend shumë herët dhe mori tipare e funksione, të cilat erdhën duke u pasuruar me nuanca gjithmonë e më të plota në vitet e mëpasme.

Pa u ndalur në një vështrim të hollësishëm rreth tipareve, që pati apo fitoi ky hero tek autorë dhe vepra të ndryshme, do të thoshim se në veprat me temë të Luftës sonë nacionalçlirimtare, figura e heroit pozitiv, pra e heroit që përfaqësoi luftëtarin popullor, partizanin e thjeshtë apo komandantin e komisarin, erdhi përherë duke u pasuruar, duke u fuqizuar, duke u bërë më reale dhe e besueshme në atë masë që e gjejmë të realizuar në veprat më të mira me këtë temë, si të «Komisari Memo» i D. Agollit e gjetkë. Por vlerat që arrin të na japë ky roman me heronjtë e vet, nuk duhen parë shkëputurazi nga vlerat, që autorë të tjerë mundën të realizonin me heronjtë e tyre, pavarësisht nga të metat dhe dobësitë që në një masë më të vogël mund t'i vërejmë edhe te romani që përmendëm. Kështu Memua, apo Rrapua, s'ka se si, në një kuptim të gjerë, të mos lidhen me galerinë e heronjve të tjerë të luftës, që na kanë krijuar veprat e tjera të mëparshme me vlerë të letërsisë sonë, duke nisur qysh me tregimet e para e duke arritur të «Komisari Memo». Vetëm një kundrim i tillë, që përmban në vetëvete zhvillimin dialektik të fenomenit letrar, do të na lejonte të gjykonim drejt për suksesin e veprës në fjalë, pa e vështruar atë të shkëputur si një shfaqje apo sukses të rastit, por si një vazhde suksesesh, që të ardhura njëra pas tjetrës, na japin të drejtë të shpresojmë për arritje të mëtejshme.

Ky lloj hero i eci dhe do të ecë duke fituar vlera që do t'i japin forcë gjithmonë e më përgjithësuese, nëpërmjet ngjeshjes së tij me një material më të pasur faktik jetësor, nëpërmjet pasurimit të tij me vlerat e kohës sonë. Vështrimi i tij nga pozitrat e kohës sonë, apo nga pozitrat e së ardhmes, do të shërbejë si mundësi potente për ta pasuruar atë hero, për ta zhveshur nga dobësi e të meta, po ashtu sikurse e vërejmë këtë zhvillim edhe me një krahasim të shpejtë të heroit të romaneve e novelave të para, me heronjtë e realizuar në vitet e fundit në letërsinë tonë.

.Disi më ndryshe qëndron puna kur është fjala për vepra, që kanë si pikësynim pasqyrimin e aktualitetit, pra që trajtojnë temën aktuale. Trajtimi i temës aktuale që në fillim ka qenë dhe mbetet edhe tani qëllim kryesor për letërsinë tonë të re, dhe nëse sot kemi vepra e sidomos romane të mira, që e trajtojnë në mënyrë dinjitoze këtë temë, duhet ta numërojmë këtë fakt si një nga sukseset tona më të rëndësishme. Siç është e natyrshme, trajtimi i temës aktuale përfytyron një pasurim të jashtëzakonshëm të veprave me aspekte jete nga më të ndryshmet dhe, me të drejtë, po të rikujtonim gjithë rrugën, që nga veprat e para të letërsisë sonë të re me këtë temë e deri te këto të sotmet, do të na binte menjëherë në sy larmia e madhe e tyre për problemet, që trajtojnë, për aspektet jetësore, që na japin etj. Siç është e natyrshme, kjo larmi e pasuri ka ndikuar edhe në pasurimin e heroit pozitiv të këtyre lloj veprave me tipare morale e shpirtërore, duke e bërë atë, heroin, gjithmonë e më shumë të denjë për misionin e tij në shoqëri. Pa u thelluar në dobësitë, që vihen re, edhe te heroit pozitiv i këtyre veprave (qofshin tregime, romane apo drama), mendojmë se kërkesë e përgjithshme e ditës dhe e domosdoshme për shkrimtarët tanë është që ata, në vështrimin e jetës e të realitetit, që i rrethon, duhet të ngrihen një kokë mbi bashkëkohësit, që të mund të dallojnë të renë, atë që do të ketë të ardhmen dhe heroin, që do ta përçojë këtë të re në jetë, se përndryshe s'do të mund ta dallojnë mirë, në tërë vlerat e tij, këtë hero pozitiv.

Kështu, Stavri Lara i romanit «Këneta» të F. Gjatës që një sukses i letërsisë sonë në rrugën dhe përpjekjet e saj për të gjetur heroin pozitiv edhe sepse heroji që njeriu i ditës, i kohës, që përshkruan romani, por njëkohësisht që edhe luftëtari i së nesërme, si të thuash, njeriu që paralajmëronte të nesërmen, që e paraprinte atë kundrejt masës shoqërore në një stad të caktuar. Gjithmonë në veprat me temë aktuale, heroji pozitiv erdhi duke u pasuruar me elemente jetësore, që e bënë atë më të fuqishëm e më të dashur për masën e gjerë, ku ai lind dhe të cilën e prin. Nëse pohojmë që Din Hyka i romanit «Përsëri në këmbë» të Dh. Xhuvanit është hero pozitiv, këtë e mbështetim në faktin që ai si tip shoqëror është veshur me tipare morale e shpirtërore të atilla, me të cilat qëndron mbi shtresën e gjerë të njerëzve ku jeton edhe vetë. Tipa si ai moralisht mishërojnë heroin e së nesërme, që duhet ndjekur, që ndikon në transformimin revolucionar të ambientit, gjithmonë të atij ambienti që i ka lindur, të atij ambienti ku autori e ka vendosur heroin, të atij ambienti shoqëror që ja ka sugjeruar këtë hero, se, po ta shkëputim heroin nga ai ambient, në gjykimin tonë, menjëherë do të binim në konkluzione të gabuara. Kështu duhet të gjykojmë edhe për pozitivitetin e heronjve të tillë si Maja e romanit «Kullat» të Gj. Zhejit dhe Bardha e romanit «Një lindje e vështirë» të E. Kardareshë.

Por zhvillimi dhe pasurimi i letërsisë sonë me vepra të një niveli të kënaqshëm ideo-artistik, larmia e stileve të shkrimtarëve tanë, sollën sidomos në zhanrin e romanit një sërë veprash, që dëshmojnë, përpos shumë vlerave të tjera, edhe për lulëzimin dhe pasurimin e gjithanshëm të artit tonë të ri.

Në arritjen e këtyre sukseseve ndikoi zhvillimi i hovshëm revolucionar i jetës sonë, thellimi i mëtejshëm i frymës revolucionare ndër njerëzit tanë, heroizmi i përditshëm e masiv, që rrëmbeu në shtjellën e vet mbarë popullin. Ky realitet s'mund të kalonte pa u vënë re apo, më mirë, shkrimtari dhe artisti ynë s'mund të mos e

ndjente në tërë madhëstini e saj këtë kohë revolucionare, këtë entuziazëm e pathos të pashembullt për të arritur e tejkaluar objektivat e pesëvjeçarëve dhe për t'u brumosur më mirë si njerëz me ndërgegje të re, me frymë revolucionare. Pikërisht kjo, si një nga arësyet themelore dhe, së dyti, zhvillimi i deritanishëm i romanit tonë, u bënë bazë për ecjen më tej, për lindjen e veprave, që dalin nga mënyra tradicionale e thurjes së subjektit, apo nga mënyra e krijimit dhe e zhvillimit të karaktereve, sidomos të heronjve pozitivë.

Shkrimtari, duke dashur të zgjerojë këndin e vështrimit, duke synuar të përfshijë në atë kënd sa më shumë nga realiteti aktual apo historik, shkëputet nga mënyra e tipizimit të vetive të një individi të vetëm me fuqi të madhe përgjithësuese dhe i sheh ato tipare në masën e popullit, prej nga i merr si fakte reale dhe na i rijep, duke i shndërruar në fakte artistike, pra duke i ngritur në art për të realizuar në vetëvete të njëjtin qëllim: ndikimin e fortë emocional te lexuesi nëpërmjet vështrimit të gjerë jetësor dhe nëpërmjet komunikimit të fortë artistik.

Në këto lloj veprash, në këtë mënyrë të pasqyrimit artistik të realitetit, lexuesi vëren me kënaqësi përpjekjen e autorëve tanë për të çarë në art shtigje të reja, për të gjetur forma sa më të shumëllojshme, sa më në përputhje me brendinë e re, gjë që vërteton vitalitetin e letërsisë sonë të realizmit socialist. Prandaj na duket se gabojmë rëndë kur, në studimet apo shkrimet tona, e injorojmë këtë zhvillim të vrullshëm e cilësor të romanit tonë. Nuk është aspak ardashës qëndrimi i atij kritiku apo studjuesi të letërsisë, i cili ngushton diapazonin e zhvillimit të vërtetë, që po shënon sot letërsia jonë, sepse këto apo ato vepra të atij apo këtij autori nuk hyjnë në kallëpe dhe skema, që ka formuar ai për të gjykuar letërsinë e gjallë. Zhvillimi i artit dhe i letërsisë socialiste asnjëherë s'është pajtuar dhe s'do të pajtohet me rutinën, uniformitetin dhe vobekësinë. Ajo i është shmangur e do t'u shmanget kallëpeve, ashtu siç e dëshmon edhe hovi ynë i sotëm letrar, larmia e romanit tonë.

Kështu në romanet si «Dasma», «Dhjetor i shqetësuar», «Kështjella», «Gjenerali i ushtrisë së vdekur», si dhe në ndonjë dramë e sidomos te «Ngjarja në fabrikë» nuk kemi të vizatuar një hero pozitiv ashtu si në veprat që përmendëm më sipër (pavarësisht nga shkalla e realizimit të heroit pozitiv në ato vepra). Por kjo «mungesë» asnjëherë s'duhet të na bëjë të mendojmë se këto të fundit çalojnë në tingullin e tyre ideor. Në këto romane apo drama, edhe pse s'gjejmë një hero pozitiv të atillë siç jemi mësuar ta njohim te autorë të tjerë, gjejmë të dhënë me vërtetësi jetësore e forcë artistike realitetin nga një kënd i ri vështrimi, gjejmë të pasqyruar realitetin nga pozita tona ideologjike, ndjejmë një frymë të thellë partishmërie t'i përshkojë ato nga kreu në fund. Kjo, pa dyshim, është e mjaftë që vepra të mos «harohet», por të jetë në qendër të vëmendjes së kritikut dhe historianit të letërsisë si një shfaqje e re e suksesshme letrare.

Nëse te «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» si personazhe kryesore kemi dy të huaj, një gjeneral e një priift, që shfryjnë e flasin me nervozizëm e ironi për popullin tonë, e nëse kundrejt tyre s'kemi ndonjë hero adekuat, prapë mënyra si autori na i lëviz në vepër këto personazhe, renditja që u bën ai ngjarjeve, retrospektivat që ka zgjedhur dhe vendosur në çastet më të nevojshme e të domosdoshme, të krijojë të qartë krejt idenë dhe qëllimin e shkrimtarit, që vetiu e bëjnë lexuesin të arrijë në konkluzionet e natyrshme për armikun e djeshëm e të sotëm, si dhe në dashurinë dhe respektin e thellë për popullin e për heroizmat e tij. Personazhet episodike të shumta në vepër e që përfaqësojnë popullin, duke nisur me plakën Nicë e Nik Martinin e deri te mullixhiu e punëtori i vjetër, janë personazhe, që i shërbejnë idesë së madhe të veprës, që e mbartin atë ide. Po kështu te «Dasma» apo «Dhjetor i shqetësuar» si dhe te drama «Ngjarje në fabrikë» mungesa e një heroit të vetëm pozitiv është e pandjeshme, se autorët kanë hapur gjerësisht kornizën e veprës për ta bërë atë arenë të jetës së masës, arenë të heroizmit masiv pozitiv, pa e ulur fare, por për-

kundrazi, duke i dhënë freski këtij elementi të rëndësi-
shëm në letërsinë tonë të re.

Pra mendoj se në këto romane e drama apo gjini të tjera letrare, s'ka asnjë arësye, që të na shtyjë ta gjejmë heroin pozitiv të grimtuar nëpër personazhe pozitive apo të përpigemi që ndonjë personazh pozitiv ta vetëquajmë hero pozitiv, ashtu sikurse s'është nevoja që ambientin material ta përfytyrojmë si hero njerëzor. Vepra mbetet plotësisht e realizmit socialist, kur ajo pasqyron jetën me vërtetësi dhe është e partishme, kur ajo militon për idetë e klasës punëtore, kur e sheh jetën nga pozitat dhe botë-kuptimi i asaj klase, kur vepra edukon me moralin tonë komunist, kur ajo ngjall emocione e ndjenja të fuqishme, që e frymëzojnë lexuesin me idealet e mëdha të partisë, me idealet e mëdha të lumturisë e të mirëqenjes së masës.

Pra pavarësisht se ç'rrugë zgjedh autori, pavarësisht se ç'formë ndjek ai në përputhje me brendinë, që derdh në vepër, është e mjaftueshme që kjo, përpjekja për formën, të mos bëhet qëllim më vete, të mos bëhet manierë stili. Kur është e ngjizur me një brendi të shëndoshë, me një kënd të drejtë vështrimi, kur autori në interpretimin e jetës është nisur nga pozita revolucionare, vepra e luan plotësisht rolin e saj. Me këtë mendim s'dua të kufizoj nevojën që ka letërsia jonë, në fazën e sotme të zhvillimit të saj, për krijimin gjithmonë e më të arrirë të heroit pozitiv, për paraqitjen gjithmonë e më dinjitoze të njeriut tonë të sotëm, heroit të ditëve tona, që me shembullin e vet të nxitë e të çojë shoqërinë përpara. Kjo kërkesë mbetet gjithmonë një ndër më kryesoret e më të ngutshmet para shkrimtarëve tanë. Por, nga ana tjetër, kjo kërkesë s'duhet përfytyruar si një pengesë për mënyra të tjera, që mund të zgjedhë autori në krijimin e vet. E domosdoshme është që përherë realiteti të shihet nga pozitat tona revolucionare marksiste-leniniste.

1971

RAPORTI MIDIS INDIVIDIT, FAMILJES DHE SHOQËRISË NË DISA ROMANE

Historiografia reaksionare, qysh nga përfaqësuesit e saj më të parë e deri te më të njohurit e kohëve moderne, ka mbrojtur dhe mbron tezën se historinë e popujve s'e bëjnë «turmat injorante» por «individët e shquar», ata që kanë veti dhe forca të mbinatyrshe për të drejtuar e komanduar, pra edhe sunduar. Është lehtësisht e kuptueshme se këta individë s'mund të jenë veç pinjollë të dalë nga gjiri i atyre klasave që, sipas po kësaj filozofie, janë përjetësisht «të ngarkuar nga zoti» për të sunduar mbi të tjerët.

Filozofia marksiste-leniniste, raportit individ-shoqëri, i jep një shpjegim të saktë e të drejtë. Pa mohuar rolin pozitiv të individëve të veçantë, marksizmi pohon se ajo forcë, që vendos në fatet e njerëzimit, që vë në lëvizje historinë, është forca e masës, e popullit, me fjalë të tjera, e shoqërisë në çdo rend e kohë. Edhe në kohërat e mëparshme, lëvizjet e masave, të «turmave» siç i quan me përbuzje borgjezia, kanë lëkundur nga themelet dhe kanë përmbysur mbretëri të tëra apo edhe sisteme shoqërore, ndonëse për arësye të ndryshme, të njohura për

ne, në rendet parasocialiste fitoren nuk kanë mundur ta korrin masat revolucionare, ato që derdhën gjakun dhe kryen përmbysjet gjigante, por sundimtarët e rinj më të egër e më shfrytëzues se të mëparshmit.

Në shoqërinë tonë socialiste problemi i raportit individ-shoqëri ka marrë një zgjidhje cilësisht të ndryshme, diametralisht të kundërt me atë në shoqëritë me klasa. Ky raport te ne e ka humbur natyrën e vet antagoniste. Ndër ne marrëdhënjet midis pjestarit të shoqërisë dhe vetë shoqërisë në tërësi janë shndërruar në marrëdhënje miqësore apo, më sakt, në ndikim reciprok të shoqërisë ndaj individit dhe e kundërta.

Këto marrëdhënje midis njerëzve e këtë ndikim reciprok ne e hetojmë domosdo edhe në letërsi veçanërisht në disa romane të botuara kohët e fundit.

Ç'është individi, që ndeshim në veprat tona? Ç'përfaqëson dhe ç'funksione mbart ai? Në ç'raport me pjesën tjetër të heronjve të romanit apo me masën në roman na është paraqitur?

Për t'ju përgjegjur këtyre e një sërë pyetjeve të tjera, duhen vështruar disa nga personazhet e romaneve ku është realizuar më mirë jo vetëm paraqitja e këtij raporti, por edhe e personazheve si figura me individualitet të plotë artistik.

Memua, i romanit «Komisari Memo» të Dritëro Agollit, është individi, që në vetëvete mishëron një funksion të rëndësishëm të luftës sonë, funksionin e njeriut të partisë. Ai është mishërimi i saj, i rolit të saj udhëheqës, i fjalës së saj të urtë dhe të dashur për popullin.

Ndonëse i ka veshur një funksion kaq të rëndësishëm, autori na ka dhënë një hero të zhveshur krejtësisht nga tipare të jashtëzakonshme apo nga cilësi të rralla. Përkundrazi, me moshën e re që ka, me faktin që sapo është larguar nga bangat e shkollës, me qëndrimin e veprimet e tij, autori na bën të mendojmë se kemi të bëjmë me një njeri më se të zakonshëm. Por pavarësisht nga këto aspekte të jashtme, për pjekurinë dhe besnikërinë e tij ndaj idealit të madh të partisë, për logjikën e tij

të hekurt, për zemrën e madhe e të bardhë që ka, ai dallohet qartë dhe qëndron mbi të tjerët, i udhëheq ata dhe është i denjë për misionin, që i ka ngarkuar koha.

Këtë funksion të personazhit në roman e ndeshim në shumë aspekte të veprës, që në skenat e para ku nis të flitet për jetën e Memos. Kujtojmë këtu takimin e tij me masën e fshatarëve kur ata blejnë kripë nga Mazllumi, tregëtari matrapaz. Veprimi i Memos, fakti që ai u shpërndan kripën falas fshatarëve, duke mos përfillur ankesat dhe protestat e Mazllumit, si dhe fjala e tij e ngrohtë dhe e guximshme po aq sa veprimi, u japin zemër fshatarëve, i bëjnë ata të formojnë bindje gjithmonë e më të madhe se komunistët, partizanët, janë mbrojtësit e tyre. Të tilla episode ka disa në roman, veçanërisht në pjesën e dytë të tij, ku zbulohet puna e madhe e komisarit për të bërë të ndërgjegjshëm e të disiplinuar batalionin e Rrapos. Më se një herë në bisedë me grupe partizanësh apo me krejt batalionin, në aksionet e shumta ku Memua merr pjesë vetë, ndihet roli i tij, ndikimi i tij pozitiv për të drejtuar e orientuar masën. Memua asnjëherë s'mbetet njeriu i deklaratave; në qoftë se të tjerëve u kërkon një herë të jenë të disiplinuar, të jenë të sakrificës, vetëvetes këto kërkesa ja bën të qindfishuara dhe këtë, jo në mënyrë artificiale, por se të tillë e ka edukuar partia, prej këtij brumi janë të formuar komunistët. Akti i fundit i heroit, në vazhdë të sa e sa momenteve të tjera në roman, pohon pikërisht këtë mendim, që theksuam më sipër. Gjithmonë këtë funksion e gjejmë në vepër edhe në ndikimin që ushtron Memua mbi qëndrimin e veprimet e ndonjërit prej personazheve të tjera, kështu, qoftë me familjen e doktor Kristo Borovës apo me komandantin Rrapo. Ai, megjithëse vepron në mënyra krejt të ndryshme, arrin në qëllimin e vetëm që këta njerëz t'i kthejë në forca aktive të ndërgjegjshme për luftën e popullit dhe idealin e partisë. Me familjen e doktorit autori na ka dhënë atë shtresë intelektualësh, që, ndonëse të paangazhuar në korrente politike të kohës, ruanin një qëndrim të ndershëm e patriotik, që i largonte

nga çanaku i okupatorit, nga përzierja me sahanlëpirësit dhe lakejt e tij, duke i predispozuar për një veprimtari më pranë luftës së popullit. Mbi këtë predispozitë mbësh-tetet Memua për të bindur doktorin dhe sidomos fëmijët e tij të hidhen vendosmërisht me anën e popullit, me luftën. Ndërsa me Rrapon ndikimi i Memos ka një natyrë tjetër. Rrapua është kryengritësi i stuhishëm, i revoltuari që ngrihet për qëllime të larta, që ka në vetëvete ideale fisnike, por që s'njeh e s'do të njohë disiplinë, organizim, udhëheqje, andaj Memos i duhet të punojë e të ndikojë në një drejtim tjetër këtu, që të kanalizojë forcën e urrejtjes së njerëzve si Rrapua e ta bëjë të ndërgjegjshëm atë dhe njësitin e tij partizan në shërbim të luftës së popullit.

Individi, si pjesëz përbërëse e shoqërisë, në letërsinë tonë, ashtu sikurse në jetë, ka të përqëndruara në vetëvete tipare morale apo karakteri, që ndikojnë mbi masën, por edhe të atilla, që, ndonëse ekzistojnë si potencë tek ai, nuk manifestohen. Heronj të tillë letrarë, me shoqërinë janë në raporte pak më të ndryshme se sa tipat drejtues dhe udhëheqës të masës. Të tillë në veprat e botuara kohët e fundit ne do të përmendnim Bardhën e romanit «Një lindje e vështirë» të Elena Kadaresë. Kjo heroinë është mishërimi i individit të marrë nëpër këmbë nga ambienti, që e rrethon. Prindi i saj, njerëzit e fisit, janë forca e errët, që synon ta ndrydhë, ta skllavërojë. Por protestën, qëndrimin këmbëngulës, autorja ka mundur të na e japë në ato përmasa reale e të pranueshme për atë stad të zhvillimit të heroinës, që na është vendosur në qendër të veprës. Individi këtu është, pra, në luftë me ambientin e mykur patriarkal, ai ndikon mbi shoqërinë jo në mënyrë të drejtëpërdrejtë, sikundër Memua, por më tërthorazi. Këtë e vërejmë në faktin se protesta e saj, lufta e saj që vjen duke u rritur në mënyrë të natyrshme, trondit opinionin e masës qoftë në fshatin e lindjes, në fermën ku jeton i shoqi e sidomos në familjet (në të sajën, apo në të Fadilit). Kështu që, mund të merret me mend se paskëtaj nuk do të mbahet ndaj feno-

meneve të tilla po ai qëndrim (është fjala këtu jo vetëm për Kadriun, Bajramin dhe nënën e Fadilit, por për krejt fshatin, për organizatat e rinisë, partisë etj.)

Ndofta ca më i tërthortë, ndonëse i ndijshëm dhe fort mirë i dukshëm, është ndikimi i Dinit, heroit të romanit «Përsëri në këmbë» të Dhimitër Xhuvanit mbi shoqërinë. Ky hero, njeri i thjeshtë, me qëndrimin e tij të papërkulshëm, këmbëngulës, triumfon mbi fatkeqësinë fizike, shkëputet nga plogështia dhe libreza e invalidit, sepse e urrente atë gjendje prej sakati, të mënjanuari të justifikuar, dhe arrin të rrjeshtohet në radhët e luftëtarëve të socializmit. Me punën e tij të gjatë e të heshtur në magazinën me materiale të mbetura, apo në «varrezë» siç e quanin punëtorët, ai jo vetëm i jep shoqërisë, por bëhet shembull, që nxit e frymëzon të tjerët të ndjekin atë inisiativë. Vjen një moment kur rikuperoja e Dinit bëhet qendra ku mbështetet puna e krejt kolektivit, për të realizuar detyrat që u vështirësuan për shkak të bllokadës revizioniste. Pra, këtë raport që e ndeshim shpesh në realitetin tonë të shprehur në inisiativat e mëdha revolucionare, të cilat bëhen shkak për thellimin e revolucionit tonë ideologjik, apo bëhen burim i fuqishëm i forcës së pashtershme të energjive krijuese të masave, autori e ka trupëzuar në roman nëpërmjet linjës së heroit të veprës. Është për t'u vërejtur që ky ndikim realizohet në roman kryekëput nëpërmjet veprimtarisë së Dinit, nëpërmjet asaj që kryen ai dhe asnjëherë me fjalën apo predikimin moralizues të tij.

Familja jonë në vitet pas çlirimit ka pësuar një transformim rrënjësor. Nga një familje thellësisht patriarkale, ajo sot është shndërruar dhe po forcohet si një familje e re socialiste. Ky proces është zhvilluar e po zhvillohet me shumë sukses ndër ne edhe për faktin

se Partia e vlerëson lart rolin e familjes si qelizë e shoqërisë sonë. Lufta për emancipimin e gruas si një hap i rëndësishëm në përtëritjen e familjes, së bashku me luftën kundër patriarkalizmit, fesë, zakoneve prapanike, i kanë dhënë një kuptim të ri funksionit të familjes mbi individin dhe raportit midis pjesëtarëve të saj. Sot në familjen tonë nuk ka bazë egzistenca e konflikteve të egra etër-bij si në shoqërinë borgjeze, apo e marrëdhënjeve të diferencuara si dikur, kur kryefamiljari ishte zot i plotfuqishëm mbi fatet e fëmijëve.

Jeta jonë sot po rrjedh në një mënyrë të atillë që kërkon si domosdoshmëri atë familje, e cila do të mund të harmonizojë kërkesat e nevojat e individit me interesat dhe mundësitë e shoqërisë, detyrë që mund të realizohet nëpërmjet ndikimit të drejtë të familjes mbi individin. Këtë aspekt, si fenomen jetësor, ne e gjejmë të reflektohet në letërsi në përmasa të ndryshme të autorë dhe vepra të ndryshme.

Roli i familjes në qëndrimin dhe veprimtarinë e individit në mënyrë të pashmangshme reflektohet në formimin e karakterit e të personalitetit të tij, ai shfaqet sidomos në mënyrën si reagon individit ndaj problemeve kardinale në jetë. Në të tilla raste do ta vërejmë qartë këtë shfaqje edhe në romanet, që përmendëm më sipër.

Nëse Memua është i tillë si na është dhënë në roman, kjo nuk ka ardhur shkëputurazi nga fakti që ai është bir i një familjeje të varfër, bir i dy pleqve të mirë, të thjeshtë e të dashur që, siç mund të merret me mend, i kanë mëkuar atij në shpirt dashurinë për popullin e varfër, urrejtjen e pafund për sundimtarët, për shfrytëzuesit si Sali Protopapa. Këto ndjenja i kanë kalitur atij në shpirt gatishmërinë edhe për sakrificën sublime në emër të idealit të lirisë. Sado në mënyrë spontane e të paorganizuar, ky embrion i shëndetshëm shpirtëror i heroit ka përbërë për të bazën e karakterit të tij. Po kështu s'mund ta shkëputim formimin shpirtëror të Rrapos, urrejtjen e tij të pakufishme kundër pushtuesve e sundimtarëve nga dhembja shpirtërore e tij për fëmijën, që është detyruar

ta braktisë, nga ndikimi i fatit të hidhur të familjes së tij.

Ndërsa Dini, megjithëse autori nuk i jep shumë rëndësi kësaj ane të formimit shpirtëror të personazhit, arrin aty ku na është dhënë në roman, i ndikuar, megjithëse shumë tërthorazi, edhe nga prejardhja e tij familjare. Jo më kot herë-herë autori ndalet nëpër digresione, që hedhin dritë mbi fatin e mjerë të prindërve të tij, mbi vuajtjet e rënda të nënës së tij, mbi faktin që fati i tij, i familjes së tij, u lidh me fatin e atdheut, më sakt, me çlirimimin e popullit nga zgjedha antipopullore, gjë që i dha mundësi heroit ta ndjejë veten zot të plotfuqishëm të së ardhmes së vet. Këtë e vërejmë edhe në raportet familjare të Dinit me të motrën, që në një farë mënyre reflektohen edhe në qëndrimin apo në aktet e guximshme, që kryen ai në jetë.

Familja mund të ndikojë për të mirë, por edhe për të keq të pjesëtarët e saj. Ky aspekt i dytë është fenomen, që ndodh rëndom në ato raste kur fryma zotëruese në familje është në mospërputhje me frymën e përgjithshme të shoqërisë. Konkretisht, në ditët tona të thellimit të revolucionit, të mposhtjes së frymës patriarkale kanunore, vërehen mospërputhje të tilla për arësyen e thjeshtë, se disa familje, ku për shekuj ka zotëruar patriarkalizmi, e kanë shumë të vështirë të ecin me ritmin e kohës e të shoqërisë. Pikërisht ky fenomen ndodh edhe në raportin midis Bardhës dhe prindërve të saj të romani «Një lindje e vështirë». Egërsia e sjelljes së Kadriut apo Bajramit mbi fatin e vajzës, shembulli i gjallë i robërimit fizik e moral, që kanë ushtruar mbi nënën e saj i ati dhe i ungji, shkurt, fryma thellësisht patriarkale zotëruese në familje, e revoltojnë vajzën deri në atë masë, sa që ajo mposht drojtjen dhe dashurinë e saj për njerëzit e shtëpisë dhe hidhet në veprim të hapët, orvatet të arratiset dhe, së fundi, kundër dëshirës dhe urdhërit të tyre, nuk rikthehet më në derën e babait, por shkon me të shoqin.

Duhet theksuar se jo vetëm në këto vepra, që po citojmë, por në tërësi në romanin tonë, pak vëmendje i

është kushtuar paraqitjes së ndikimit dhe rolit, që ka luajtur dhe luan familja në formimin e njeriut të shoqërisë sonë. Kjo mungesë, që mendojmë se rrjedh nga thellimi i pakët i shkrimtarëve tanë në marrëdhënjet e brendshme të familjes sonë socialiste, në konfliktet, kontradiktat dhe rrugëzgjdhjet, që gjejnë sot këto konflikte e kontradikta, duhet kapërcyer në mënyrë që në letërsi, ashtu si në jetë, të gjejë vendin e merituar kjo anë e rëndësishme e realitetit, e cila plotëson kuadrin e jetës sonë.



Aspekti i tretë dhe ndofta më i rëndësishmi i këtij problemi, që po trajtojmë, është se deri në ç'masë ka zënë vend në letërsinë tonë paraqitja e rolit të madh pozitiv të shoqërisë mbi individin, mbi qëndrimin, botëkuptimin dhe veprimtarinë e tij.

Edukimi i individit sot te ne është çështje, që i takon jo më ngushtësisht prindit apo familjes, por është çështje e krejt shoqërisë sonë. Kjo gjë përbën një bazë të shëndoshë, që na garanton se brezi i ri te ne s'do të ketë asgjë të përbashkët me frymën e ngushtë e të fëlliqur mikroborgjeze, që është karakteristikë për botën kapitaliste e revizioniste.

Duke e vlerësuar këtë aspekt të veprimtarisë së shoqërisë sonë, shoku Enver thotë: «Duhet të jemi të ndërgjegjshëm se lufta për edukimin e njeriut të ri është lufta më e gjatë, më e vështirë, më e ndërlikuar e më delikate, sepse pikërisht në këtë fushë rezistenca e botës së vjetër është më e madhe, më këmbëngulëse, më e thellë».

Që këtej del qartë se ç'rëndësi të madhe ka në jetë realizimi i kësaj detyre dhe ç'mundësi të gjera hapen para romancierëve tanë për ta pasqyruar denjësisht këtë anë të raportit midis individit dhe shoqërisë. E theksojmë

këtë se kemi përshtypjen që jo sa duhet është vënë objektivi i autorëve në këtë problem.

Rruga që ndjek në zhvillimin e vet linja e Dinit në romanin «Përsëri në këmbë» është një rrugë, e cila në çdo çast ndodhet nën syrin e shoqërisë. Dini asnjëherë s'është i vetmuar, megjithëse, për karakterin e tij, ai mundohet që shumë vështirësi t'i kalojë duke u mbështetur mbi forcat e veta. Për ta theksuar këtë ide, autori jo rastësisht e pa qëllim bën paralelizma me fatin e të gjymtuarve në vende kapitaliste, ku zotëron egoizmi dhe ndjenja e urrejtjes apo e mosinteresimit për fatin e individit, që shpesh arrin deri në fatalizëm apo vetëvrasje.

Dini rrethohet në çdo çast nga fryma e dashurisë së njerëzve, që i ndodhen pranë. Janë këta, pikërisht, njerëzit që i ndodhen pranë, të cilët e ndihmojnë kur ai bie nën rrotat e trenit, është mjeku dhe kolektivi i spitalit, që i japin forca të mos bjerë shpirtërisht, janë shokët e tij, që e rrethojnë dhe i frymëzojnë besim për të mposhtur vështirësitë, për t'u ngritur në këmbë. Së fundi, është kolektivi i punëtorëve të oficinës, që e mbështjell me ngrohtësi e dashuri, që mundohet t'i ngjallë besim në punën e tij, që me shumë takt mundohet të mos e prejë në gjymtimin e tij fizik dhe që ndjek me besim Dinin në inisiativën revolucionare.

Forca e këtij ndikimi ndihet qartë edhe në qëndrimin e revoltuar të Bardhës në romanin «Një lindje e vështirë», sidomos në pjesën e dytë të romanit, kur heroina ndodhet në maternitet. Duke rënë në kontakt me shoqet e dhomës apo duke qenë nën kujdesin e organizatës së partisë të spitalit, dhe konkretisht të mamisë komuniste, Bardha, jo vetëm i reflekton më thellë në vetëvete gjithë ç'i kanë ndodhur, por fiton besim më të madh dhe bëhet më e guximshme, se më në fund e kupton që ndryshe nga fryma e molepsur patriarkale, që sundon në familjen e saj e të Fadilit, në shoqërinë tonë, në ambientin e gjerë shoqëror, ka forca shumë të fuqishme përparimtare, të cilat i janë vënë përballë botës së vogël patriarkale dhe do ta shembin.

Në këtë plan jeta jonë sot është e mbushur me shembuj të panumërt, nga të cilët duhet të frymëzohen autorët tanë, për t'i dhënë vendin e merituar këtij aspekti të rëndësishëm dhe real të familjes dhe shoqërisë në shoqërinë tonë socialiste.

1971

PËR NJË LETËRSI ME FORCË MË TË MADHE IDEORE

Letërsia është pasqyrimi i realitetit. Ky realitet nga shkrimtarët e realizmit socialist jepet nëpërmjet prizmit të ideologjisë proletare. Në të pasqyrohet në radhë të parë transformimi i njeriut tonë, krijues i vlerave të mëdha materiale dhe shpirtërore. Duke pasur një objekt të tillë, letërsia shndërrohet në një armë të rëndësishme të thellimit të revolucionit ideologjik e kultural. Për këtë të bind rruga njëzetepesëvjeçare e letërsisë sonë. Shkrimtarët tanë, poetët dhe prozatorët, në krijimet e tyre, kanë arritur t'u transmetojnë masave idetë e mëdha të partisë, vrullin e madh revolucionar, kërkesë që vetë jeta e ka sugjeruar. Shfletojmë këto vepra dhe emocionohemi për të parët tanë, për ata që me gjak mblatuan lirinë tonë, të sotmen tonë socialiste revolucionare, apo ndjejmë jetën, që na rrethon, ndeshim njerëzit, që jemi mësuar t'i kemi pranë, madje dhe veten tonë, të mirat dhe të metat tona. Dhe kjo flet hapur për atë që letërsia, e në mënyrë të veçantë kjo e dekadës së fundit, ka hyrë në rrugën e pjekurisë së saj, në rrugën e një letërsie me dinjitet ideomocional dhe u është përgjegjur gjithnjë problemeve, që ka shtruar koha. Kështu, romanet e Ismail Kadaresë, Dritëro Agollit, Shevqet Musarajt, Jakov Xoxes, Dhimitër Xhuvanit, Gjergj Xhejit, Ali Abdihoxhës, Petro Markos,

Elena Kadarese; poemat e Ismail Kadarese, Dritero Agolli, Llazar Siliqi, Dhori Qiriazit, Agim Shehut e Fatos Arapit; apo novelat e tregimet e Dhimitër Shuteriqit, Naum Priftit, Sotir Andonit, Teodor Laços, Koço Kostës, Shefqet Tiganit etj. janë krijime, që shënojnë suksese të letërsisë sonë të realizmit socialist.

Këto vepra kanë, ndërmjet të tjerave, vlerën e madhe se janë pasqyruese besnike të realitetit tonë në zhvillim, i cili nuk është dhënë nëpërmjet shtampave dhe kallëpeve, por në përputhje me individualitetin artistik të shkrimtarit. Mënyra se si shkrimtari e shikon jetën, se nga nisët ai për ta kapur atë copëzë, që do të japë në vepër, përbën anën subjektive, që s'duhet ngatërruar me subjektivizmin, me paraqitjen e jetës ashtu siç i pëlqen shkrimtarit dhe me interpretimin e jetës siç ja ka qejfi atij. Kjo e metë është edhe mungesë përvoje të fillestarët, tek ata që i japin shumë vend vetes së tyre në veprat, që shkruajnë, por sidomos ajo bëhet e dëmshme tek ata që i besojnë shumë vetes, që nuk thellohen në realitetin tonë, që s'rrojnë pranë popullit, s'e njohin atë dhe botën e tij shpirtërore dhe që, nën ndikimin e «erudicionit dhe fantazisë» së tyre, arrijnë të na japin vepra, që s'kanë pika takimi me të vërtetën tonë jetësore, vepra libeske, që s'thonë atë që duhet të thonë dhe që s'komunikojnë aq sa duhet me lexuesin. Vepra të tilla subjektiviste nuk mund të jenë pasqyrë e realitetit, ato e shtrembërojnë të vërtetën dhe ky shtrembërim manifestohet në aspekte të ndryshme. Një nga këto aspekte është edhe zbukurimi i realitetit, paraqitja e jetës fushë me lule, minimizimi i vështirësive, aq sa të krijohet përshtypja se çdo gjë mund të kalohet lehtësisht deri në atë pikë sa të duket sikur të gjitha këto suksese të jetës sonë, s'kanë dashur veçse disa «urra!» dhe disa zotime për t'u realizuar. Kjo tendencë është e dëmshme, jo vetëm se kështu veprat dalin anemike, pa puls të jetës, pra aspak bindëse dhe skematike, por edhe se edukojnë keq, se krijojnë iluzionin që gjithshka është arritur, s'paska dashur shumë punë

e mund, dhe e predispozojnë lexuesin për një jetë të lehtë, pa telashe e kokëçarje. Kjo tendencë është vërejtur, ndonëse jo shpesh, në ndonjë tregim, në shumë nga poetitë e poetëve të rinj, që i kanë të mbushur vëllimet me këngë aksionesh, fërshëllima trenash apo lavde e hymne jetës sonë, pa arritur të krijojnë me detaje poetike e me origjinalitet tablonë e vërtetë të asaj që po ndodh, pa hyrë te njeriu, ndërtues i këtyre veprave, pa kapur botën e tij të pasur shpirtërore plot hove revolucionare.

Dihet se vala e aksioneve të mëdha të rinisë dhe të mbarë popullit tonë qenë dhe janë shkolla ku kalitet morali ynë i ri, fusha lufte të pamëshirshme kundër botës së vjetër, kundër ideologjisë së vjetër. Këtë luftë e kryen dhe po e kryejnë njerëzit tanë, rinia jonë, madje edhe ajo e fshatit, që po shqelmon kanunet e urryera, forcat e errëta skllavëruese të jetës së lirë. Po ky fenomen duhet parë në gjithë gjerësinë e vet, dhe sidomos në forcën dhe pjekurinë ideore të brezit tonë të ri, të malësoreve, që, të rritura dhe të edukuara nga partia, dijtën dhe dinë ta përballojnë me sukses presionin e botës së vjetër. Rreziku i subjektivizmit në pasqyrimin e këtij fenomeni jetësor e ka çuar ndonjë autor edhe deri aty sa të marrë guximin e të krijojë një roman të tërë pa u kujdesur për paraqitjen me vërtetësi të realitetit. Është fjala për fragmentin e romanit «Fushë e gjerë» të G. Kongolit, botuar në «Nëndori (Nr. 6, 1968). Duke i besuar vetëm fantazisë, duke i vështuar problemet e mëdha të ditëve tona, që nga krijimi i kooperativave të zmadhuara bujqësore dhe eksperimentimi shkencor në bujqësi e deri te lufta për emancipimin e gruas apo lufta kundër botëkuptimit fetar e patriarkal, (përfshi këtu edhe shumë inisiativa të tjera revolucionare) si veprime shumë të lehta, të realizueshme pa vështirësi, vetëm me ndonjë mbledhje, vepra e përjashton krejt konfliktin, krejt atë që do të shërbente për të evidencuar mendimin materialist, që e reja hyn në jetë me luftë të ashpër. Romani na dukej një fakt kuptimplot për të argumentuar atë të metë që shoku Enver Hoxha e vuri në dukje në fjalimin e vet në konfe-

rencën e 17 të partisë për Tiranën kur tha: «Në krijimet letrare ne shpesh gjejmë më shumë refleksin e botës së brendshme të autorit dhe më pak jetën e gjallë, luftarake, revolucionare të masave punonjëse, të atyre që luftojnë e veprojnë. Prandaj në mjaft vepra ka shumë subjektivizëm në trajtimin e temave, ka shumë subjektivizëm edhe në mbrojtjen e veprës nga vetë autori».

Një e metë e tillë vihet re edhe te romani «Vlaga e dheut» i Filip Ndocajt, si dhe në pjesën e dytë të romanit «Ara në mal» të Petro Markos. E keqja nuk qëndron në atë që autorët kanë skalitur mjeshtërisht tipat, që përfaqësojnë anët e vjetëruar të jetës sonë. Lulash Prekën, apo heroin e mesëm, që jeta e pruri në transhenë tonë, Zan Erzenin. Mund të themi se kjo është meritë e tyre, sepse autorët në të dy këta heronj mbajnë një qëndrim ideo-emocional të shëndoshë. E keqja është se në të dyja këto vepra e reja është anemike dhe jo sa duhet bindëse, se tipat e rinj janë të painedividualizuar, madje edhe me një mënyrë të foluri agjitative. Situatat që paraqesin të renë, triumfin e saj, vende-vende marrin një natyrë reportazhi, që deri diku dëmton idenë dhe qëllimin e veprës, pasi shprehin një tendenciozitet të paveshur si duhet me art, që i kundërvihet një situatë tjetër, apo tipave të tjerë, që janë të skalitur artistikisht dhe të besueshëm.

Një vërejtje e tillë mund t'ia bëjmë edhe romanit «Brezat» të Fatmir Gjatës, që ndonëse me merita ideo-artistike, na i jep disa heronj të veprës në raport vetëm me problemet e mëdha shoqërore, pa na dhënë siç duhet jetën e personazheve edhe në sferën e preokupacioneve të përditshme, në dukje të vogla, por që mund të shfrytëzoheshin më me efekt nga pena e shkrimtarit, për të dalë në problemet e mëdha shoqërore.

Pra, edhe nga këta pak shembuj veprash, që, me gjithë të metat, kanë vlera ideo-emocionale, del e qartë se subjektivizmi i shkrimtarit në pasqyrimin e botës objektive në letërsi, kur arrin në përmasa të ekzagjeruara, e injoron realitetin dhe e shtyn letërsinë drejt skematizmit. Është e qartë se ky rrezik s'ka të bëjë fare me qën-

drimin tendencioz, të partishëm, që duhet të mbajë shkrimtari ynë kur merr e shkruan për jetën dhe njerëzit, por është pasojë e asimilimit të cekët të realitetit në ndërgjegjen e autorit, është pasojë e mosthëllimit në jetë dhe, mund të shtojmë, e mosnjohjes së thellë të ligjeve të zhvillimit dialektik të shoqërisë sonë.

Por, duke pohuar nevojën e pasqyrit besnik të realitetit tonë në letërsi, asnjëherë s'duam të themi se shkrimtari duhet të jetë vetëm një riprodhues i thjeshtë i jetës, qoftë edhe nëpërmjet emocioneve, që na lindin nga mjeshtëria artistike e tij në këtë riprodhim. Kufizimi kaq i ngushtë i detyrës së tij do ta mohonte fare rolin e letërsisë si mjet i fuqishëm masiv edukues. Prandaj në mënyrë të pashkëputur shkrimtari duhet të gërshetojë këtë realitet, që arrin të njohë në jetë me aftësinë e tij për të parashikuar rrugët, që do ta çojnë më tej shoqërinë tonë. Për t'ja arritur kësaj, duhet që autori të thellohet aq shumë në materialin jetësor, të njohë aq mirë ligjet e zhvillimit tonë dialektik, sa që të mund të kapë të renë në jetë, sado e padukshme dhe e brishtë që të jetë ajo, dhe t'i japë prioritetin, ta përgjithësojë me art e me forcë tronditëse. Vetëm se kjo s'mund të realizohet ashtu lehtë, duke u mbështetur kryesisht në intuitën. Bile një besim i tepëruar në intuitën e autorit apo në fantazinë e tij të harlisur, shpeshherë me shpërftyrime të realitetit, çon në krijimin e veprave, që jo vetëm s'kanë vërtetësi jetësore, por edhe edukojnë keq. Prandaj, që shkrimtarët tanë të krijojnë vepra me vlera të vërteta njohëse, edukative dhe ideo-emocionale, duhet të kenë gjithmonë parasysh atë që na mëson shoku Enver: «E tanishmja pregatit të ardhmen dhe këtë të ardhme nuk e pregatit nëpërmjet ëndërrimeve dhe imagjinatave ireale, por nëpërmjet parashikimeve shkencore materialiste, të drejtuara nga ligje të zbuluara, të cilat shkencërisht ndihmojnë për të zbuluar të tjera».

1969

KUNDËR PSIKOLOGJIZMIT TË TEPRUAR, PËR NJË HERO TË LIDHUR ME PUNËN

Nga vetë natyra e tij si zhanër i shkurtër, tregimi është një lloj i tillë letrar, që kap një moment të fortë dramatik nga jeta e fati i heronjve, një çast këthese për heroin, pa u shtrirë në tërë gjerësinë e ndodhive të jetës së tij. Së këtejmi rrjedh kujdesi e vëmendja e nevojshme, që duhet pasur në krijimin e personazhit apo heroit kryesor, që do të mbartë të gjithë episodin në tregim.

Ky problem i heroit, e sidomos i përcaktimit të drejtë të heroit pozitiv në një vepër letrare, nuk preokupon vetëm tregimin, por të gjitha gjinitë e letërsisë sonë. Në radhë të parë heroi i veprës letrare duhet të jetë njeriu i ditëve tona, njeriu i ri, i vështruar në procesin e zhvillimit të tij jetësor, në procesin e formimit të ndërgjegjes së tij. I vështruar e i pasqyruar kështu në vepër, ai do të mund të kryejë funksionin e tij kryesor, të ndikojë në edukimin e masës së lexuesve, e veçanërisht në edukimin e brezit të ri.

Ndër prozatorët tanë më të rinj të këtyre viteve të fundit të bie në sy një prirje e theksuar drejt një tematike ndonëse aktuale, por që ngre probleme kryesisht të jetës familjare, pra, që mbyllet në një ambient të ngushtë pa u rrahur në tallazet e jetës së gjerë shoqërore. Kjo ten-

dencë natyrisht nuk duhet mohuar, se në fund të fundit jeta në familje është një pjesë e rëndësishme e jetës sonë, por përqëndrimi ngushtësisht aty i largon këta autorë nga shumë shfaqje të tjera të rëndësishme të realitetit tonë, ngushton objektivin e tyre në të vështruarit e realitetit dhe bën që heronjtë e tyre të jenë njerëz të shkëputur nga shoqëria, të atillë që luftojnë me vetëveten e të vetmuar duke mos u ndeshur asnjëherë gjatë tregimit me realitetin e gjerë shoqëror të ditëve tona.

Tipik në këtë drejtim është tregimi i E. Mandisë «Fustani nailon» botuar në revistën «Nëndori», prill 1962. Autorja trajton në këtë tregim një subjekt mjaft të njohur, me material jetësor të ditëve tona. Në vigjiljen e martesës së saj Diana, heroina e tregimit, vendos të braktisë të fejuarin e t'i kushtohet karrierës kinematografike. Ajo ka qenë e fejuar më shumë për hir të këmbënguljes së nënës, me një djalë të pasur, tek i cili vëren mbas fejesës një horizont të ngushtë e patriarkal. Autorja në karakterizimin e personazhit kryesor ka ndjekur kryesisht rrugën e zbërthimit psikologjik të heroinës. I gjithë tregimi zhvillohet në formë kujtimesh e mendimesh të Dianës. Mendojmë se psikologjizmi i tepëruar si dhe shkëputja e plotë e heroinës nga ambienti shoqëror, nga ndikimi i rrethit shoqëror, e ka ngushtuar shumë figurën e Dianës, për më tepër, duhet të kujtojmë që kemi të bëjmë me një vajzë të ditëve tona, një nxënëse të shkollës së mesme. Përse atëhere kjo shkëputje e plotë?!

Ne nuk pajtohemi as me qëndrimin e Dianës ndaj nënës. Sigurisht nëna ka në mentalitetin e saj shumë pikëpamje mikroborgjeze, por në fund të fundit, nëna s'është antagonist, ajo mbart pasivisht të vjetrën, ngaqë është pjellë e saj, por nuk mishëron rezistencën e pafytyrës të së vjetrës.

Qëndrimi i Dianës ndaj inxhinier Gjatës dhe birit të tij, të fejuarit të saj, Fredit, është i drejtë, por ky s'duhej të qe i njëjtë me qëndrimin ndaj nënës. Ne i japim të drejtë heroinës, që e përbuz botën e tyre të ftohtë, të ngushtë e egoiste, që shpërthen për të dalë në

jetë si forcë e gjallë aktive në shoqëri, që s'do ta ndryjë shpirtin e saj të lirë në «burgun e nailonit», por s'jemi me atë zgjidhje, që i jep autorja fatit të heroinës, e cila në veprimin e saj kryengritës kundër së vjetrës priret kryesisht dhe vetëm nga ndjenjat.

Më drejt E. Mandija e ka zgjidhur fatin e personazhit kryesor në tregimin tjetër «Gjyqi i heshtur» botuar në «Nëndori» korrik 1963. Ajkuna në fatkeqësinë e saj, në tronditjen e saj shpirtërore gjen mbështetje e përkrahje në shoqërinë tonë, në njerëzit tanë, qoftë në konvikt pranë bashkëstudentëve apo në mes minatorëve të hidrocentralit. Pra në këtë tregim autorja na vizaton edhe jetën jashtë subjektivës së personazhit, madje pikërisht në këtë jetë tërë gjallëri, thjeshtësi e freski gjen forcë për ripërtëritjen shpirtërore heroina.

Në të dy tregimet të bie në sy një zbërthim i detajuar psikologjik, i cili shtrihet në të gjithë tregimin. Kjo mënyrë të shkruari krahas anës së rëndësishme të zbulimit të lëvizjeve më të holla shpirtërore, ka edhe të metën e madhe, që ngadalëson aksionin në tregim. Zbërthimi psikologjik i gjerë e i hollësishëm është më i arësyeshëm e më me vend në gjinitë e gjata të prozës.

Zhvillimi dhe krijimi i heroit pozitiv si figurë bindëse, si forcë që përfaqëson të renë dhe ndikon në zhvillimin e saj, varet shumë nga tematika, që zgjedh autori, se sa kjo tematikë është reale dhe se sa vepra letrare ngre në diskutim një problematikë aktuale.

Është e kuptueshme për të gjithë se një hero të ditëve tona me tipare shpirtërore e morale të larta, që edukon në popullin tonë ideologjia e shëndoshë marksiste-leniniste, mund ta shohësh vetëm në procesin e punës, në procesin e marrëdhënjeve shoqërore. Veprimtaria shoqërore është kudhra ku farkëtohet e kalitet njeriu ynë i ri.

Por në disa tregime aty-këtu hasim shmangje nga kjo. Po të vëresh vëllimin e A. Cergës «Dritë në fushë», të bie në sy një gjë e tillë. P.sh. heronjtë e dy tregimeve «Dritë në fushë» dhe «Reze në botën time», që janë më të gjatët e vëllimit, janë vështruar kryesisht në jetën e tyre personale

apo më thjesht, në dashurinë e tyre. Si Ilirin e tregimit të parë, dhe Skënderin e tregimit të dytë, njëri veteriner, tjetri inxhinier gjeolog, pak dhe vetëm shkarazi i njohim në punë. Tregimet nisin me pasionin e tyre të madh për punën, por ky pasion jepet vetëm në mënyrë deklarative, me fjalët e autorit, ne s'bindemi për të, se asnjërin prej heronjve nuk e shohim në punë, ose e shohim shumë pak. Mbas kësaj, episodet që vijnë në tregim përqëndrohen në dashuritë e tyre, të cilat kalojnë nëpër një sërë situatash dramatike dhe kujdesi i autorit përqëndrohet kryesisht në zbërthimin e këtyre situatave, madje aq me hollësi, sa lexuesi e harron qoftë veterinerin, qoftë inxhinierin, dhe ka përpara dashnorin së pari fatkeq e në fund të lumtur. Kurse personazhet më të dorës së dytë shkëputen fare nga jeta e punës e nga jeta shoqërore, p.sh. Reti në tregimin e parë e Frana në të dytin, dalin të zbëta, pa forcë shpirtërore, bile pa personalitet. Shumë nga veprimet e tyre mbeten të mjegullta e të pamotivuar. Një njohje më e thellë e realitetit, një vështrim më i lidhur me jetën pra, një material më i pasur jetësor do t'u jepte shumë jetë e gjallëri këtyre personazheve.

Nuk duhet menduar se romantika e ditëve tona, apo ana e bukur e jetës sonë është vetëm dashuria për vashën. Së pari romantika apo e bukura e jetës sonë është ajo që realizohet në jetë në punë e sipër, ajo që krijohet duke u përfshirë këtu edhe krijimi i vetë njeriut të ri. Pra diapazoni i së bukurës që kurorëzon vështirësinë, mundin në jetë, ka një gamë shumë më të gjerë. Këtu, mendoj, duhet të përqëndrohet vështrimi i letërsisë sonë.

Një hero pozitiv, të karakterizuar dhe të realizuar më drejt, e gjejmë në tregimin «Mbarim vjeshte» të T. Laços. Haxhiu, heroi kryesor i tregimit, është një i ri i ditëve tona, ai është agronom dhe emërohet menjëherë sa ka mbaruar shkollën, në një sektor të largët të një ferme bujqësore. Atij i duhet të luftojë shumë me vetëveten për të mposhtur hezitimin e për të vajtur në krye të detyrës. Në kalitjen e tij shpirtërore ndikon shumë realiteti heroik dhe i vështirë. Me vërtetësi ne vërej-

më të pasqyrohet në tregim kthesa shpirtërore e heroit. Autori nuk e sponston planin e tregimit, dashuria e Haxhiut për Aishenë është vetëm një linjë, që hedh dritë edhe në botën shpirtërore të personazhit, duke e bërë atë më të plotë. Nga ana tjetër drejt është zgjidhur edhe raporti ndërmjet analizës psikologjike të personazhit dhe aksionit në tregim.

Edhe në tregimin «Një thërrime lumturi» nga i njëjti autor, është realizuar mirë personazhi kryesor, që është një tip negativ, me të cilin autori rreh të dënojë shfaqjet e shëmtuara aty-këtu në shoqërinë tonë. Nëpërmjet heroit kryesor, Stas Dhespotit, mishërohet shpirtvogëlsia mikroborgjeze e njerëzve, që rrojnë të mbyllur në guaskën e tyre.

Mund të përmendnim edhe ndonjë tregim tjetër, heronjtë e të cilit jetojnë ngushtë me problemet e kohës, të punës e të shoqërisë në ditët tona, po duhet thënë se tregime të tilla akoma ka pak, sidomos po të marrim parasysh gjithë atë material, që na sugjeron realiteti ynë i gjallë, si dhe nevojat në rritje të lexuesve.

1966

VEPRA LETRARE

Vepra letrare

PJEKURIA E NJË TALENTI

Pas një periudhe relativisht të gjatë heshtjeje, e kemi fjalën për vëllime të plota, (vëllimin e fundit «Shtigje malesh dhe trotuaresh», poeti e pat botuar pesë vjet të shkuara) ne kemi sot në duar një përmbledhje të re poetike të poetit tonë tanimë të njohur Dritëro Agollit. Kjo vonesë nuk përbën aspak një qëndrim të kritikueshëm, por është shprehje e qëndrimit egzigjent të autorit ndaj krijimeve të veta, është shprehje e respektit të tij për lexuesin tonë, që çdo ditë e më shumë po fiton shije më të lartë dhe po bëhet më kërkues ndaj nivelit ideor dhe artistik të krijimeve poetike. Së fundi, është shprehje e përgjegjësisë së madhe, që ndjen autori kur del para lexuesit tonë artdashës me një vëllim të plotë, qëndrim ky nga i cili mendojmë se duhet të mësojnë shumë poetët tanë të rinj.

Vëllimi «Mesditë» përmban një tufë lirikash dhe katër poema, frut i një krijimtarië disa-vjeçare të poetit. Dritëro Agolli edhe në këtë përmbledhje i mbetet besnik fizionomisë së tij poetike mjaft mirë të përcaktuar dhe individuale. Edhe te «Mesditë» poezia e tij është e thjesh-të, e ngrohtë dhe e kapshme. Në të autori flet me çiltërsi për jetën, për njeriun tonë, për të djeshmen e lavdishme dhe për të sotmen revolucionare të popullit tonë. Ai gëzohet për sukseset, lëndohet në shpirt për ndonjë të metë

dhe revoltohet me ata që pengojnë marshimin tonë përpara. Është karakteristikë për këtë poet që të jetojë me atë që na tregon, të shkrihet i tëri me shpirt e zemër me krijimin e vet. Është kjo cilësi, që na bën të ndjejmë menjëherë gazin dhe helmin e tij, që na bën të ndjejmë çdo dridhje apo emocion të tij. Duke vlerësuar drejt këtë mënyrë krijimi, na duket se poeti ndonjëherë nuk arrin të qëndrojë mbi atë që përshkruan, veti kjo që ka shkak-tuar ndofta herë-herë mungesën e një filozofimi apo të një qëndrimi përgjithësues për jetën tonë në tërësi apo për fenomenet e reja të jetës sonë në veçanti. Sidoqoftë poezia e këtij vëllimi ka shumë jetë, shumë ndjenjë, shumë dritë dhe pikërisht për këto vlera të saj ne do të flasim disi më hollësisht në këto shënime tona.

Lirikat e vëllimit «Mesditë» dëshmojnë se poeti ka ecur më tej në krijimtarinë e vet poetike dhe për këtë jo vetëm të bind, por edhe të gëzon fakti që tematika e poezive të vëllimit është shumë e gjerë. Dritëroin e shqetësojnë shumë aspekte të jetës së shoqërisë sonë, ai ndjen pulsën e jetës së vendit me një diapazon problemor, si rrallë poet tjetër. Nëpër vargjet e këtyre poezive ndihet krisma e pushkës partizane, dhembja për shokun e vrarë, krenaria e nënës për djalin e mbetur në fushën e lavdisë, gazi i fitores. Duke shfletuar vjershat e vëllimit njërën pas tjetrës, ne s'kemi si të mos jetojmë me fatin e heroit lirik të poetit, ne e njohim atë së afërmi, se kaq shumë komunikojmë me të, me malësoren e ndrydhur në kullë, që shpërtheu vargojt e kanunit për t'u bashkuar me shokët e shoqet e saj, për të vendosur vetë për fatin e saj; shohim vezullimin e telit, që shtrihet të çojë dritën dhe jetën e re në fshatin e largët malor, ndjejmë aromën dehëse të tokës së kthyer, shijojmë natyrën tonë të mrekullueshme, ndjejmë ngrohtësinë e dashurisë për gruan, për shoqen e jetës.

Për poetin nuk është e huaj jo vetëm gjithshka shqiptare, po madje edhe figurat e njohura të njerëzimit, gjënitë e shekullit, që me veprën e tyre progresive e çuan botën, artin dhe shkencën përpara pa përfillur injorancën dhe egërsinë e shekujve të mesjetës.

Jo më kot poeti ka përmbledhur në vëllim një numër të konsiderueshëm poezish, që marrin shkas nga mbresat e tij të pashlyeshme për epokën e lavdishme të Luftës nacionalçlirimtare. Në të njëjtën kohë kjo tematikë e trajtuar gjerësisht dhe e shpërndarë në krejt vëllimin, nënvizon mendimin e autorit se ajo etapë historike, jo e largët e popullit tonë, është e lidhur dhe e ndërthurur organikisht me jetën tonë sot, me sukseset dhe fitoret tona, është, në fund të fundit, themeli mbi të cilin po rritet dhe forcohet Shqipëria socialiste.

Padyshim, ndër poezitë më të realizuara të vëllimit në pikëpamje ideore dhe artistike është ajo që titullohet «Krevati i perandorit».

Në të, nëpërmjet një fabule në dukje të zakonshme, na jepet një sintezë e fuqishme e historisë sonë, sidomos e periudhës më të fundit deri në çlirim. E tërë poezia qëndron mbi antitezën: nga njëra anë perandori xhuxh e dështak, Viktor Emanueli III dhe, nga ana tjetër, luftëtari i revolucionit tonë popullor, partizani Meke.

Poezia procedon si monolog i partizanit Meke dhe vetëm rrallë në të ndërhyjnë autori. Kjo mënyrë e ka bërë më intime poezinë, më të ngrohtë dhe më komunikuese. Ajo është e mbushur me detale të gjetura bukur dhe mjaft kuptimplote. Herë-herë në të gjejmë përgjithësime, që tipizojnë krejt popullin, atë forcë që shtyn historinë përpara.

Poezia ka një ton të çiltër e me humor, por kjo s'e ka penguar autorin të kalojë në akuza të rrepta e të fuqishme kundër botës së urryer kanibaleske të këmishëzinjve. E ndeshim këtë cilësi të poezisë aty ku Mekja, pasi ka konstatuar me neveri tërë shëmtinë e paloperandorit, kujton djemtë e tij si diva, të cilët, sikurse shumë të tjerë, i zhduku ky xhuxh qesharak. Dhe ky Meke përgjithëson një popull të tërë që «... me opinga llastiku e me opinga lëkure, me masat, kobure e vezme në brez, dogji kazermat e ushtarët ia zuri (perandorit) që në Sicili e gjer në Bradashesh». Dhe kështu poezia, që lexohet me një frymë, prapë me një detal shumë të gjetur nënvizon idenë e triumfit të popullit:

*«Dhe humbi në mjegull perandoria;
Opingat e Uastikut qëndronin majëpërpyjetë
në jorganin sjellë nga Italia...»*

Ndonëse në pak rreshta është përmbledhur krejt historia e jetës së Mekes, ai, është kaq konçiz edhe kaq i dashur për ne. Ai është njeriu ynë babaxhan që, ashtu qetë-qetë, heshturazi, mbajti mbi supe peshën e luftës sonë gjigante, i cili, po aq i thjeshtë dhe i sigurt sa ç'është kur ndez eshkën dhe lëshon shtëllunga tymi nga duhani i tij erëkëndshëm, po aq i qetë dhe i sigurt është edhe kur i flet perandorit, sepse e ndjen veten zot dhe perandor të vendit të tij, siguri kjo që Mekes (popullit) ja dha partia.

Sa e konceptueshme është për ne dhembja e singertë e partizanit për shokun e vrarë, për komisarin trim, aq na mbush me krenari ajo nëna e thjeshtë shqiptare, që e numëron djalin e saj të rënë në radhët e rojeve të përjetshme të atdheut. Është e madhe dashuria, që ka në themel një ideal të lartë, që lind e formohet në llogore, nën kërcënimin e përhershëm të plumbave, por dhe në gazin e fitores së sigurt, na thotë poeti. Dhe ne e kuptojmë thellë mendimin e poetit, se dëshmorët e luftës sonë mbetën të përjetshëm në këngët popullore me vdekjen e tyre heroike.

Gjithmonë në këtë motiv të vëllimit, poeti ka materializuar ide të fuqishme të kohës, idenë e unitetit të popullit në luftën për çlirim dhe këtë e ka arritur nëpërmjet detajesh të qëlluara. Fshatari ynë luftoi, derdhi gjakun dhe fitoi lirinë e tokën e ëndërruar, ai njomi me gjak farën, që hodhi në arë, sepse s'deshi të *duronte mbi supe peshën e natës*, peshën e robërisë. Po këtë ide, në ndonjë vjershë, e gjejmë edhe në një aspekt tjetër të asaj kohe, kur jo vetëm fshatari, por edhe nxënësi la bangot e shkollës për të hedhur mbi supet e njoma pushkën e gjatë, pushkën që do sillte lirinë.

Ndërsa për heroin tonë Qemal Stafën, poeti me dy detaje: *«Kapitali» mbi tavolinë dhe violina mbi kanape,*

përgjithëson gamën e gjerë të interesave dhe të botës së pasur shpirtërore të tij. Po në këtë motiv ndihet edhe mendimi që Lufta jonë nacionalçlirimtare mund të kishte kërkuar edhe sakrificën sublime të poetit, dhe këtë ai e quan të natyrshme, bile do të ishte krenar për një vdekje të tillë, sepse edhe sot i njëjtë është ideali i tij: t'i shërbejë revolucionit, të cilit i ka kushtuar gjithshka, sepse ky revolucion, që nisi me Luftën tonë nacionalçlirimtare, po kryhet në emër të së ardhmes, në emër të lirisë dhe lumturisë së popullit kundër shtypjes, robërisë e varfërisë. Ky qëllim tingëllon edhe në vargjet:

*Dhe erdha vatrës t'ja ndez zjarrin,
që oxhaku prapë të nxjerrë tym,
që rreth oborrit të korr barin,
që murit t'i heq ndryshk e myshk...*

Poeti i jeton intensivisht ditët tona, sheh revolucionin tonë dhe është e natyrshme që këto mbresa të ndihen edhe në vargjet e tij, ta mbarsin frymëzimin e tij. Shpërthimi vigan i gruas shqiptare për të flakur tej gjithë mykun shekullor të kanunit e të zakoneve prapanike, që e kanë penguar në rrugën e saj, ka bërë që mëse një herë në këtë vëllim poetik ne të ndjejmë urrejtjen për çdo gjë të vjetër e të kalbur, apo gëzimin e gruas dhe të vajzës sonë, që me dinjitet po vihet në një radhë me burrin.

Poeti stigmatizon mblesët e shkesët duke i paralajmëruar vajzat që të ruhen prej tyre, që ta njohin dinakërinë e tyre e të mos bien viktima të tyre. Megjithëse ndofta do të duhej që poezia të ishte më unike, më e rrjedhshme, sidomos kur në të poeti kalon nga paraqitja e mblesëve tradicionalë te ata modernët, (që kanë vetëm një lustër modernizimi e asnjë ndryshim tjetër) prapë ajo thekson mendimin se ujku vetëm qimen ndërron dhe jo zakonin. Ndërsa te ndonjë poezi tjetër, gjithmonë në këtë hulli ideore, poeti me shumë humor trajton aspektin tjetër të këtij problemi, aspektin e luftës në ndërgjegje me kon-

ceptet e njohura, që duhet të bëjë burri për t'u shkëputur nga kanuni, për ta trajtuar gruan si shoqe jete dhe bashkëluftëtare. Toni plot humor i poezisë dëshmon për bindjen e autorit se, sado e egër të jetë kjo luftë, prapë fitorja mbi të është e padyshimtë, pra ndjenja e superioritetit tonë është shkaku i optimizmit dhe i humorit me të cilët poeti e trajton këtë subjekt.

Vrullin e ecjes sonë përpara, vrullin e marshimit tonë revolucionar D. Agolli e sheh në gërshetimin e shumë aspekteve të jetës së ditëve tona. Hapat e këtij revolucionari ai i gjen edhe te filli elektrik, që duke hyrë deri në kullat e thella të malësisë, do t'i çojë gëzimin Gjëlës malësore, do ta rilindë dhe do t'i japë krahë asaj për të luftuar më me guxim për të drejtat e veta. Ndaj poeti i thotë asaj:

*«Afrohu dhe përcille zallesh frikën,
izolatori izolon dhe mblesët...»*

Poezia, përveç idesë, është e fuqishme edhe në imazhet e natyrës, që ka krijuar. Ne ndjejmë, në vargjet e saj, madhështinë e maleve tona, ku ka folenë legjenda e bëmave burrërore të të parëve tanë:

*«Ortiqet uturijnë tatëpjetë,
si vargjeve të «Mujit e Halilit»,
thërmohen posi shkuma në përrenjtë
dhe grykash shket jehona e tyre dimrit.»*

Ndërsa aty-këtu në ndonjë poezi spikat edhe mendimi se koha jonë, koha e Partisë, është koha e dritës dhe e lumturisë së popullit të thjeshtë, dhe kjo kohë në mënyrë imperative i shërben me tërë forcat e saj së ardhmes. Pra poeti do të na thotë se sado e vështirë të jetë lufta me të vjetrën, e reja do të triumfojë. Një vajzë malësore ndoqi rrugën e shkollës, se atë e mori nën mbrojtje dikush, qoftë ky dhe poeti; po edhe sikur të mos kishte ndodhur kështu, prapë ajo s'do të kishte kurrë fatin e

nënës së saj, apo të të gjitha malësoreve, që provuan jetën e hidhur të kohëve të kaluara, se atë sot e përkrah Partia, që ja ka hapur të gjitha shtigjet e së ardhmes në jetë.

Gjithmonë në vazhden e kësaj ideje ne ndeshim në vëllim edhe lirika ku thuhet me plot gojën se përmbysja e koncepteve për femrën është një diçka që po kryhet edhe që fshati ynë, fshatarka jonë, po e ndjen veten të lirë dhe krenare, sepse u shembën minaretë e kishat, sepse u hoqën çitjanet e dimitët, sepse mes njerëzve po del pa drojtje dashuria, që ndrydhej pas dritareve të thurura me shufra. Dhe gjithshka ndodhi do të jetë e përrjetshme, s'do të ketë mort.

*«Kjo luginë gjithnjë e zgjuar do jetë
e gjithnjë toka sytë me vesë do t'i lajë,
e gjithnjë diell të ngrohtë do ketë,
e gjithnjë retë do mblidhen majë më majë...»*

Në një numër lirikash të përmbledhura në vëllim ne njihemi me poetin qytetar, që e preokupojnë problemet e jetës sonë në aspektin e saj moral lidhur me tiparet dhe virtytet e njeriut tonë të ri, e qytetarit dhe revolucionarit. Kjo lloj lirike ka shtrirje të gjerë problemore, se e tillë, e gjerë në problemet e veta, është jeta e njeriut tonë sot. Poeti u drejton përsëritje atyre që përjetë mbetën të rinj, atyre që të ushqyer me idealet e partisë, asnjëherë s'u plakët zemra, atyre që e shohin me dashamirësi e pa cmirë rininë.

Për vështrim të gjerë jo vetëm në jetën e popullit tonë, por në problemet dhe fatet e popujve të botës, që luftojnë kundër imperializmit dhe shtypjes, dëshmon ndonjëra nga vjershat e goditura të vëllimit ku poeti, duke marrë shkas nga ngjarje të zakonshme, mediton për fatin dhe luftën çlirimtare në Vietnam e në Afrikë duke stigmatizuar njëherazi forcat e errëta të imperializmit të sotëm në Amerikë apo gjetkë, të cilat kërcënojnë dhe mundohen t'u futin tmerrin popujve. Prandaj në poezi tingëllon mendimi se Shqipëria do të jetë në këmbë përherë në gjilencë të fitoreve të saj.

*Dhe do këndohet gjatë kjo këngë në kullën e shqiptarit,
gjersa nata e shekullit zien në planet si furrë...*

Ideja e solidaritetit revolucionar të popullit tonë u shpreh me tërë shkëlqimin e vet në ngjarjen e hidhur të tërmetit të Dibrës. Nga të katër anët e atdheut u sulmën për atje mijëra e mijëra nga bijt e bijat e popullit. Në poezinë kushtuar kësaj ngjarjeje të madhe, nëpërmjet varg-jesh të frymëzuara, që përgjithësojnë aspekte madhështore të atij heroizmi masiv, shpërthen dashuria dhe admirimi, njëkohësisht edhe krenaria e poetit për këtë popull me zemër të madhe e ndjenja fisnike.

Gjithmonë në këtë motiv të vëllimit buçet edhe krenaria për burrërinë e qëndrueshmërinë e shqiptarit, që furtunat e historisë s'kanë mundur dot ta përuhin, dhe heroi lirik i poetit, bir i kësaj toke, mburret me të parët e tij:

*«Erërat kanë fryrë mbi ta (mbi gjyshërit — D.D.)
e janë zmbropsur;
Dëborërat kanë rënë mbi ta
e janë shkrirë,
Shqipëri!*

Poetin e ka prekur jeta dhe vdekja e njeriut të thjeshtë të punës, i cili pa u ndjerë është shkrirë i tëri për t'i dhënë shoqërisë kudo qoftë, edhe në atë pyllin e largët e të heshtur me të cilin e kanë lidhur dhjetëra e dhjetëra vjet pune, ku ai është kujdesur për çdo rrënjë peme si për fëmijët e tij dhe ku ai dëshiron të prehet përjetësisht. Poezi të tilla kanë forcë emocionuese dhe për animizmin që autori ka përdorur në masë e me efekt. Nga ana tjetër edhe në poezi të tilla ne s'ndejmë asnjë notë sentimentalizmi, sepse edhe aty gjen vend ideja optimiste se dikush tjetër do ta vazhdojë punën e druvarit plak.

Gjerësia e lirikës qytetare të këtij vëllimi gjen shprehjen e vet edhe në faktin që për poetin jo vetëm që s'është i huaj, por përkundrazi shumë i afërt edhe gëzimi

plot humor i fëmijëve të tij, gëzimi plot naivitet i motrës për të vëllain e vogël, që pret. Dhe pak faqe më tej ky gëzim i poetit hidhet në entuziazmin për veprat e mëdha të pesëvjeçarëve, për kullat e fuqishme të azotikut, që do t'i japin fuqi tokës, bukës së popullit, lumturisë së tij, ndaj ai thotë:

*«Të priste e të thërriste toka e vjetër,
të vije siç erdhe, i madh e i bukur;
të priste gruri e pjepri,
po ti në mendimet tona ishe futur»*

Si poet me diapazon të gjerë tematik e problemor D. Agolli gjithmonë në terrenin e vet realist, nuk mund të mos shohë e të mos fshikullojë mikronjerëzët, ata që akoma notojnë në kënetën e interesit vetiak, të cilët i karakterizon bukur në vogëlsinë e botës së interesave të tyre egoiste:

*«Na pihet ujë,
pimë.
Na rriten thonjtë,
i presim!»*

Poeti edhe në këtë vëllim të ri e sheh të pandarë jetën e tij personale apo familjare nga jeta e mbarë shoqërisë sonë, për të gëzimet e atdheut janë dhe gëzimet e tij, ashtu sikurse gëzimet e veta ai i shijon duke tërhequr në to edhe shokët e tij të punës, ata me të cilët ka kaluar edhe çaste të vështira. Kështu në ndonjë poezi, heroi lirik i Dritëroit, që i përgjithësuar mund të ndodhet në çdo cep të atdheut, mbledh shokët druvarë të pyjeve të Pukës për të ndarë me ta gëzimin, për të gjetur me ta emrin e vajzës, që i ka lindur. Kjo nuk është diçka e rastit, por kuptimplote, që shpjegon raportin e sotëm midis individit dhe shoqërisë.

Edhe poezia «Larg qytetit» trajton problemin e marrëdhëneve familje-shoqëri, por në një aspekt tjetër, në

atë aspekt ku të bie në sy roli i shoqërisë për një raport të drejtë të marrëdhënjeve bashkëshortore. Kjo vetijë e jetës sonë të sotme është kryekëput e ndryshme nga cinizmi, që karakterizon shoqërinë kapitaliste, e cila e sheh krejt të shkëputur fatin e familjes nga shoqëria, pra ku shoqëria as që interesohet për individin, për dhembjet dhe vuajtjet apo mjerimin e tij. Heroi lirik këtu mundohet të bindë bashkëshorten për të hequr dorë nga rehatia mikroborgjeze, nga dëshira e madhe për konfort, që edhe ajo të njohë jetën e madhe të punës, gëzimet e kësaj jete. Por na duket se analogjia, që ka dhënë autori midis fatit të atij çifti fshatar, që mposhti pengesat e zakonit për t'u bashkuar me fatin e heroit të poezisë, s'është aq e realizuar, aq e shkrirë organikisht nga ana artistike me idenë, që ka dashur të materializojë poeti në këtë vjershë.

Ndërsa te poezia «Eskiz» mendimi i harmonisë së plotë të jetës sonë është dhënë më i arrirë artistikisht, më me personalitet. Në të poeti, duke na dhënë tërë vrullin e jetës së qytetit të madh, s'e shkëput këtë vrull e gëzim nga jeta e vatrës së vet dhe madje s'arrin ta kuptojë lumturinë e vet jashtë dhe larg jetës së madhe, larg lumturisë së popullit të tij:

*«Dhe në këtë apartament me libra e saksi
vjen zhurma e qytetit tonë,
vijjnë gëzimet e tij e shqetësimet e tij,
vijjnë përherë edhe kurrë s'pushojnë».*

D. Agolli është nga të paktët që në poezinë tonë u këndon figurave të shquara të artit të shkencës e të mendimit, të cilët me veprat e tyre kanë përbuzur errësirën dhe obskurantizmin e shekujve, kanë luftuar me guxim, duke provuar vuajtjet e mjerimet në emër të së ardhmes, apo duke dhënë edhe jetën për pasionet e tyre në dobi të njerëzimit. Poeti ynë në një sërë vjershash shkruan me dashuri e respekt plot ndjenjë për episode nga jeta e tyre qoftë ajo edhe intime, por me një forcë që përgjithëson vetijat e tyre më të larta. Kështu, duke folur

për Rembrandin poeti pohon mendimin se njeriun e bën të vlefshëm e të përjetshëm jo fisi apo pasuria, po vetëm puna e tij, ajo çka ka krijuar ai për njerëzimin. Ndërsa duke lexuar atë ndodhi tragjike të fatit të Saksias, gruas së Rembrandit, të cilën piktori i madh e bëri të pavdekshme në tablonë e tij «Danaja», poeti përçqas fatin e saj me fatin «e lumtur» të Elenës, gruas së Rubensit dhe na bën të mallëngjehemi me forcën emocionale dhe komunikuese të vargut, duke na ngjallur mendimin se talenti i vërtetë, vepra e frymëzuar ka qenë ajo që i ka qëndruar larg zvetënimit dhe shthurjes së oborreve princore.

Poeti, si përfaqësues i ideologjisë sonë, është përkrahës i çdo gjëje përparimtare nga kultura dhe shkencat botërore. Kundër dogmës idiote të kishës u ngritën mendimtarët e mëdhenj, u ngrit Xhordano Brunua, që prelatët e kishës kishin kujtuar se do ta zhduknin duke e djegur, po ja që s'ndodhi ashtu, por ndodhi krejt e kundërta dhe emri i Brunos mbeti i gjallë e i pavdekshëm, sidomos për ne, kur gjithë kotësia klerikale u përmbys përgjithmonë. Prandaj poeti me të drejtë krenohet kur thotë:

*«Bruno, edhe për ty ne morëm hak
dhe e fundosëm në mjegull këtë ideal, këtë mur!
(Kishën D.D.)*

Të tilla mendime dhe ide të shprehura bukur poetikisht i ndeshim edhe në vjersha të tjera ku tingëllon krenaria e ndërgjegjshme e autorëve të mëdhenj për artin e vërtetë, i cili përbuz falsitetin; apo për ata që në shekujt e mesjetës kanë pasur si shëmbëlltyrë njerëzit e gjallë, njerëzit e thjeshtë dhe jo figura të pashpirta shenjtorësh. Për këtë poeti shpërthen:

*Da Vinçi s'mund ta lodhte dorën me kufomë,
o kardinalë të marrë!
Ata që ju dukën juve si krishtër e madona
ishin hamenjt, fshatarë e fshatarë...*

I gjithë ky qëndrim i poetit ndaj asaj që është me vlerë në thesarin e kulturës botërore, është shprehje e qëndrimit të drejtë të Partisë sonë për vlerat progresive botërore, që i shërbejnë edhe shoqërisë sonë socialiste.

Një vend jo të vogël zënë në vëllimin «Mesditë» edhe poezitë e dashurisë, në të cilat poeti u këndon ndjenjave të pastra, dashurisë së dliurë, që ngrihet kundër ndjenjës së ngushtë e të vockël, që ka një shtrirje të gjerë në jetën tonë plot hov revolucionar e plot plane madhështore për të ardhmen, që s'ka asgjë të përbashkët me sentimentalizmin mikroborgjez, me ndjenjat e përdhosura, që ka përqaftuar e propagandon bota e kalbur borgjeze.

Në erotikën e këtij vëllimi zotëron nota optimiste e dashurisë së re që ka përqaftuar dhe po përqafton rinia jonë kundër gjithshkaje të shëmtuar, që kohërat e padrejta kishin konsakruar në kanunet e egra. Poeti herë-herë ka vizatuar në pak vargje një çast dashurie, tek e cila ndjejmë edhe ndonjë notë romantike, por më tepër aty zotëron frymëmarrja e gjerë e kohës dhe e njerëzve tanë, gëzimi që dashuria është bërë një ndjenjë forcëdhënëse për të çarë së bashku me vashën në jetë.

«Trimëria dhe dashuria më kanë ndjekur tërë jetën dhe jam i lumtur që të dyja kanë qenë bashkë në luftë për të vërtetë...»

E tillë është konceptuar kjo ndjenjë në tërësi në vëllim, por ka edhe ndonjë poezi ku autori tregon për trishtimin e vajzës shqiptare, që për shekuj me radhë s'ka mundur të jetë e lirë në dashurinë e saj, ajo ka bërë ç'ka mundur për të mbrojtur ndjenjat e veta, por shpesh fati i saj ka qenë tragjik, këtë na e thotë poeti popullor në ato pak vargje për Dudën nga Elbasani, për atë vajzë si mijëra shoqe të saj, që vdiq në moshën më të bukur.

Në tërësi kjo poezi, siç thamë, është e qartë, e singertë, e ngrohtë, por në ndonjë vjershë poeti s'ka mundur të arrijë që të jetë kaq i komunikueshëm, mendimi i tij

ka mbetur i errët dhe paralelizmi figurativ i pakapshëm, si rrjedhim dhe ideja që ka dashur të na transmetojë s'është aq e spikatur. E tillë na duket poezia «Në amfiteatrin e Butrintit». Këtu edhe analogjia midis dy të rinjve të ditëve tona (që dashurohen) dhe Orfeut me Evidikën mbetet pak e paqartë dhe jofunksionale për idenë e autorit.

Natyra e ka tërhequr dhe e ka frymëzuar poetin, ai i ka kënduar asaj me mallin e pashuar të njeriut, që te natyra nuk sheh vetëm ngjyrat dhe bukuritë e saj të mahnitshme, por sheh jetën e bukur, gjen frymëzimin e pafund për ta dashur këtë jetë. Poeti jo një herë e animizon këtë botë madhështore të maleve dhe fushave tona, se ajo është burim i jetës së lumtur të njeriut tonë. Në poezitë e peizazhit shpesh gjejmë tablo të bukura të dhëna me detaje origjinale, që na bëjnë të ndjejmë e ta dashurojmë ca më shumë natyrën tonë me bukuri të rralla:

*«Unë qëndroj e në burim vë buzët e mia të trasha
e thëthij forcën e lëngut të tokës bujare
dhe ndjej si kjo forcë e lartë
më vjen e më rend në damarë...»*

Në vëllim autori ka edhe disa poezi ku ka shprehur mendimet e veta për vargun, ku ka shpjeguar ashtu si i kupton ai, rolin dhe detyrat e vështira të poetit, por edhe misionin fisnik të tij. Poeti e dashuron poezinë popullore. Shumë motive të saj ai i ka derdhur e përpunuar në mënyrë origjinale në poezitë e këtij vëllimi. Në to mëse një herë ne hasim vargje të marra nga goja e popullit, që me shumë efikasitet kanë hyrë në mënyrë organike dhe janë shkrirë në krijimin origjinal të poetit. Kujtojmë p.sh. vargje si: «Ti çele herët, moj bajame!» në poezinë «Kur të vij një mëngjez», «Shtinin shtatë e vritnim tetë», në poezinë «Komisari», «Lule djemt' e nënave!», në poezinë «Dëshmori» etj. Pikërisht kjo dashuri e konsideratë për poezinë popullore e ka bërë Dritëro Agollin që të çmojë realisht poetin popullor Selim

Hasanin në poezinë «Rapsodi», e cila jo rastësisht hap vëllimin. Ideja e jetës apo përjetësisë së këngës popullore ka gjetur shprehjen e vet te xha Selimi nga Brataj, të cilin si poet, jeta jonë e lindi dhe e rriti në gjirin e popullit të varfër ku ai thithi nektarin e gjenisë popullore për t'ia kthyer po prapë popullit. Që në dy vargjet e para të poezisë jepet një imazh i goditur i natyrës sonë të ashpër dhe i popullit, që u bë vatra dhe djepi i poezisë popullore. Këngët e xha Selimit, thotë poeti, janë të ngjizura me jetën dhe fatin e popullit, ato kanë jetuar në shumë çaste të kësaj jete, në çaste të ëmbla e të hidhura, në çaste luftrash e heroizmesh. Me origjinalitet, nëpërmjet figurës së hejbeve është dhënë bukur ideja se kënga e poetit të vërtetë i takon popullit.

Këtë mendim për poezinë dhe poetin e vërtetë autori e zhvillon më tej duke kërkuar që poezia të shkundet nga gjithë myku i grumbulluar në të dhe që e pengon shpërthimin e lirë të mendimit të hovshëm revolucionar. Vullli i jetës revolucionare të sotme te ne nuk mund të rrijë pa u reflektuar dhe në vargjet e poetëve tanë. Kjo është domosdoshmëri e kohës, së cilës askush s'mund t'i shmanget, po të dojë të mos jetë anakronik. Gjithmonë në vazhden e mendimit që poezia duhet të jetë aktuale dhe militante, autori konstaton se shpesh jeta ecën shumë më përpara se poezia, ngaqë tempi i jetës sonë revolucionare është shumë më i shpejtë dhe shumë i vrullshëm, prandaj poetit i duhet të jetojë në mënyrë intensive dhe të pashkëputur me popullin e vet.

Sikurse kemi thënë edhe më sipër, vëllimi «Mesditë» përfshin edhe katër poema, që për vlerat e tyre të rëndësishme ideo-emocionale përbëjnë një hap pjekurie në rrugën krijuese të autorit.

«Baballarët» është ndër poemat më të realizuara të poezisë sonë. Autori sheh të përgjithësuar në brezin e prindërve tanë tipare më fisnike, më bujare, që kanë karakterizuar popullin tonë të lashtë. Ajo që është kryesore në poemë, është ideja e unitetit të brezave tanë, që ne dhe prindërit tanë s'kemi asgjë që të na ndajë, por gjith-

shka që na bashkon, dhe kjo gjithshka mishërohet në idealin e madh të lirisë dhe të lulëzimit të atdheut.

Letërsia botërore mëse një herë e ka rrahur këtë temë dhe gjithmonë ajo ka parë hendekun, që i ka ndarë brezat. I ka vështruar etërit dhe bijtë duke i kundërvënë si forca, që kanë penguar dhe shqetësuar njëra-tjetrën. Në këtë plan përherë etërit kanë përbërë barrierën, që ka pengua brezin e ri të çajë përpara. Konservatorizmi, mosbesimi dhe frika nga rinia kanë qenë cilësi që kanë karakterizuar brezin e vjetër në rendet dhe shoqëritë me klasa në të kaluarën apo në ditët tona në botën borgjeze. Kjo kontradiktë është thëlluar ca më tepër nga klasat në fuqi, të cilat gjithmonë kanë synuar që ta mbajnë nën zaptërinë, sepse ja kanë pasur frikën asaj, sepse janë trembur nga forca dhe dëshira e saj për të çarë përpara, për të përmbysur atë rregull çnjerëzor të vendosur me dhunë dhe të mbajtur me dhunë po nga të fuqishmit.

Shoqëria jonë socialiste, që s'e ka një strukturë të tillë, që s'ka klasa apo grupe shoqërore, që duan të ruajnë «statukuonë» përkundrazi është direkt e interesuar, me të gjitha shtresat e saj përbërëse, për një ecje përpara, për lulëzim e begatim të atdheut e të popullit, jo vetëm që s'ka arësye të kultivojë një përçarje brezash, por për krah dhe lufton të ruajë një unitet të çeliktë të popullit edhe në pikëpamje morale, duke e zhdukur krejtësisht hendekun antagonist midis brezave. Ky tipar i shoqërisë sonë socialiste rrjedh nga vetë zhvillimi historik i jetës së popullit tonë, është në bazën apo në themelet e kësaj shoqërie, e të këtij populli, që gjatë dekadave të shekullit tonë e sidomos në këta tridhjetë vjetët e fundit, luftoi e lufton për ta çuar Shqipërinë përpara, se për të gjithë, të rinj e pleq, ajo është e shtrenjtë, se të gjithë, të rinj e pleq, derdhën e derdhin gjakun e djersën për të.

Kjo është ideja, që përshkon krejt poemën «Baballarët» dhe këtë ide Dritëro Agolli e ka plazmuar me art e me ndjenjë në poemë. E gjithë poema përshkohet nga një frymë e ngrohtë dhe e sinqertë dashurie të madhe për baballarët, për brezin e prindërve të poetit, për ata, gjaku,

ndjenjat dhe idealet e të cilëve, lëvrijnë edhe në rrembat tanë ashtu si edhe në rrembat e poetit.

Qysh në vargjet e para, që në krahasimin: «*Të hollë si kosorë e jataganë*» poeti ka arritur të na japë jo vetëm një detaj, që i portretizon ata fizikisht, por më shumë portretin e tyre moral. Krahasimi plot funksion me kosorin e jataganin përgjithëson edhe rrugën e jetës së brezit të etërve tanë, të cilët e kaluan jetën me mund, me djerse, por edhe me pushkën krahut për të arritur në ditët tona. Dhe po kështu, duke i ndenjtur besnik mënyrës së tij të paraqitjes me vërtetësi dhe ngrohtësi të brezit të baballarëve, poeti na jep gamën e gjerë të problemeve, që i preokupon ata kur thotë:

*«Mendimi juaj zgjatet dhe zgjatet
nga kokrra e grurit*

gjer te qeveria;

Kapton luginat,

fushat dhe shpatet,

nga lëmi i fshatit

gjer te gjithësia...»

Këta baballarë, ky brez i prindërve tanë, nuk e ndjen veten të huaj me ne, bijt e tyre, ata i shqetëson puna jonë dhe jetojnë aktivisht me ne, me hallet, problemet e gëzimet tona. Jo vetëm kaq, por prindërit tanë na kanë zili (për mirë, sigurisht) që ne po çajmë përpara, madje ata krenohen me këtë. Kjo krenari ka dalë kaq e natyrshme dhe bindëse, sa që ne e besojmë menjëherë që etërit nuk e shprehin veç me një lloj trishtimi të singertë dhe dashamirësie për brezin e ri, kur krahasojnë kohën e tyre me rininë e sotme dhe vërejnë sa larg kanë shkuar djemtë.

Duke e vlerësuar brezin e etërve, autori përshkruan radhazi ato që përbëjnë vlerat e mëdha të aktivitetit të tyre: luftën e tyre legjendare që me Selam Musain dhe Bajram Currin e deri te Lufta nacionalçlirimtare. Pas kësaj ai skicon tablonë e mjerimit të vegjëlisë shqiptare kur

lindej brezi i poetit dhe atëhere ishin pikërisht prindërit ata që e mëkuan këtë brez me ndjenja dhe moral të tillë të shëndetshëm, me moralin komunist.

Besnik i letërsisë sonë realiste D. Agolli nuk e diea-lizon brezin e prindërve, por gjithmonë me mirëdashje ai ka hedhur në poemë, ndonëse me pak penelata, edhe qëndrimin e etërve, që ngurojnë të përqafojnë ndonjë normë të re të moralit tonë komunist, vetëm se i frenon zakoni i vjetër. Poeti e njih këtë si dobësi, nga e cila baballarët duhet të shkëputen për të qenë krahazi me bijtë e bijat e tyre.

«Po,
baballarë,
e keni të vështirë
t'ua vishni brucën ligjeve të reja!
Po me zakonin s'ikte blozë e nxirë
dhe s'ngrihej azotiku,
e Va- Deja!

Gjithë këtë tablo dashurie dhe marrëdhënesh socialiste, që egzistojnë në atdheun tonë, poeti ja kundërvë jetës borgjeze, të cilën e fshikullon edhe në etikën e saj pseudomoderne, që në vetëvete konservon banditizmin dhe shtazërimin moral. E natyrisht në një brez të tillë, që poeti e karakterizon kështu:

«Ata sot hedhin tuist fytyrëflakë
e nesër vrasin vietnamezë në arë
e nesër ngasin tanket nëpër Pragë!»

nuk mund të kërkosh harmoni, sepse aty do të gjesh vetëm urrejtje, ligësi, kanibalizëm.

Poeti i njih brezit të prindërve tanë vlerën e madhe që ata u bënë përkrahës e mbështetës të luftës së popullit të prirë nga Partia, që ata e ndihmuan dhe e mbështetën rininë në luftën e saj, se panë te ajo vazhduesen e ëndrrës së tyre për liri dhe tokë. Pikërisht mbi këtë bazë është

farkëtuar edhe uniteti i pathyeshëm dhe harmonia e vërtetë e brezave tanë. Duke ndjekur jetën tonë në dialektikën e saj, poeti e sheh jo vetëm me syrin e pjesëtarit të brezit të ri por edhe si prind që bijtë, rinia (brezi i tretë) sado çamarroke të duket, ajo «... me muskujt dhe me mendje, më lart se etërit do ta ngrejnë këtë tokë». Kjo ide finale është shprehje e qartë e dhënë me forcë emocionale nëpërmjet krejt poemës, që pohon me tërë zërin e autorit realitetin tonë objektiv, idenë e vazhdimësisë revolucionare të brezave të ne.

Duke iu referuar kujtimeve të fëminisë së vet, në poemën «Rebelimi i parë» Dritëro Agolli ka kapur një aspekt të asaj kohe për të goditur institucionet dhe përfaqësuesit e fesë nëpërmjet demaskimit të «shenjtërisë» së klerikëve, pas së cilës «shenjtëri» fshiheshin vese të fëlliqura dhe lakmia e pafund e tyre. Ndonëse nëpërmjet botës naive të fëmijës, prapë ka dalë e qartë në poemë gjithë ideja e autorit.

Babai i teqesë, mbi frikën që ka rrënjosur feja në shekujt të njerëzimit e popullit, ka mbështetur autoritetin e vet. Dhe gjyshi plak nga kjo frikë i kërkoi të nipit t'i puthë dorën babait.

*«Se nxehet babai e gruri s'na piqet,
se nxehet babai e kokërr nuk korrin,
se nxehet babai e plevica na digjet.»*

Pra ja ku mbështetej «autoriteti» i fesë, ja kush e ruante pushtetin e saj. Pas kësaj, gjithmonë duke zërtëyer mendimet e ndjenjat e heroit të poemës, poeti ka skicuar një sërë tablosh, ku ka vizatuar me vërtetësi gjithë fëlliqësinë e shërbëtorëve të zotit. Babai i teqesë s'është veç një përbindsh i gjelbër i pangopur, që lakmon të rrëmbejë gjithshka, edhe manarin e djalit të vogël. Poeti ka gjetur me shumë sukses në poemë si element, që e ndriçon, ca më tepër idenë e tij, kundërvënjen e botës së pastër shpirtërore të fëmijës me tërë hipokrizinë e fesë, vetëm se atij s'i ka shpëtuar edhe aspekti tjetër

karakteristik i kohës, revolta që po mbruhej në proletarët e qytetit e të fshatit, te vegjëlta apo te kovaçi Azis i poemës, që i lë aq mbresa të thella fëmijës kur e shan babain e teqesë «*Derr Anadolli, surrat Anadolli*». Pra është pikërisht kjo frymë, që kishte nisur të përhapej në ndër-gjegjen akoma foshnjore të fshatarit tonë dhe po i hapte sytë atij. Në poemë, edhe kur përshekruhen ritet fetare, edhe kur përshekruhet tronditja e nënës apo zemërimi i gjyshit për mendimet e djalit, ndihet kurdoherë toni qesëndisës, që arrin kulmin në thirrjen «Ejvallah!» të përsëritur tri herë si një kreshendo e ironisë së fuqishme të poetit.

Jo vetëm në këtë vëllim apo në poemën «Toka ime, kënga ime», por në gjithë krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit ndihet dashuria e tij e madhe për tokën. Poeti mëse një herë, duke marrë pozicionin e fshatarit të dashuruar me ashk pas tokës, ka kënduar plot ndjenjë për të dhe për punëtorin e saj, për bujkun.

Historia e tokës sonë është historia e popullit tonë. Në shekuj shqiptari ka luftuar për tokën, ai e ka vaditur atë me gjak aq sa edhe me djersën e tij. Toka për shqiptarin s'ka qenë thjesht objekti i lakmive apo mjeti për të realizuar qëllimet dhe interesat e tij, ajo gjithmonë ka qenë objekt adhurimi, shok jete, të cilën bujku ynë e ka konsideruar si mikeshën e vet, si shokun e vet, dhe e ka dashur si gruan e vet.

Në poemën «Toka ime, kënga ime», poeti i ka kënduar tokës tamam nga pozita e bujkut, që e njeh atë dhe që e do me shpirt. Animizmi i përdorur rëndom në të i ka dhënë më tepër gjallëri dhe forcë komunikuese dhe, nga ana tjetër, ka pasqyruar realisht raportin tokë-bujk, lidhjen e tyre të përjetshme.

Thamë se poeti i këndon tokës si bujk, me mallin e pafund të bujkut për arën, për brazat. Duke e vështruar kështu, ai di të ndjejë e të kapë poezinë e punës, poezinë e plugut, që çan ugarin, di të shijojë dhe, njëkohësisht, të na bëjë ne të shijojmë aromën e vlagës së saj. Për vite bujku ka derdhur djersë mbi tokën e dashur, por atë

nuk e lejonin ferrat e shoqërisë së kohës që ta ndjente tërësisht këtë mall e dashuri. Fshatari pa gjakun të derdhej mbi tokë, pa të shfrente urrejtja për të, pa ligësinë njerëzore të bridhte si e marrë mbi të duke ia vënë fajin asaj. Por toka që e pafajshme, ajo vetëm kërkonte mund nga bujku dhe i premtonte se do t'ia shpërblente me zemërgjerësi djersën atij. Toka kërkonte liri, kërkonte të flakte tej intrigën, ligësinë, shtypjen dhe nga kjo barrë atë mund ta lironte vetëm biri dhe zoti i saj, bujku. Me këtë frymë, me këtë ngrohtësi, në vargjet e poemës, poeti shtjellon gjithë këngën për tokën, këngë që doli nga gryka e pushkës dhe nga shkëlqimi i plugut, këngë që buron së thelli nga shpirti i poetit për të cilin plugu, pushka dhe penda qëndrojnë kaq pranë, saqë ai thotë:

*«Më ra shorti i bujkut e shorti i poetit:
Lëroj arë me plug e lëroj kartë me pendë,
i hap udhë hardhisë e udhë bereqetit,
i hap udhë vargut e udhë poezisë tënde;
E s'e ndava plugun pendën e maliherë,
por brodha me ta nga caku në cak
dhe gati kam qenë përherë
ta vadit kërcellin e grurit me djersë e gjak.»*

Poeti, siç kemi theksuar më lart, mëse një herë nëpër vjershat e këtij vëllimi ka trajtuar problemin e emancipimit të vajzës shqiptare. Ai i ka kënduar gruas dhe vajzës sonë duke i bërë thirrje të hedhë tutje zakonet dhe kanunet, t'i shqelmojë ato. Ndërsa te poema «Balladë e ashpër» është me interes fakti që autori e vështron fenomenin regresiv të martesave me mblesëri, jo te njerëz të deklasuar, që qëllimisht i ruajnë ato zakone për të penguar ecjen tonë përpara, por te njerëzit tanë, te ata që si xha Agushi «i vinin odës zjarrin kur priste partizanë». Pikërisht në terrene të tilla lufta me zakonet, me kanunin u bë e ashpër dhe e hidhur ashtu siç thotë poeti në vargjet:

*«Më vjen keq të shkruaj këto vargje,
vargje me mërzi e dhembje thurur!»*

sepse na u desh e na duhet të luftojmë me ata që na duan e i duam, por që e kanë të vështirë të heqin dorë nga e vjetra, nga ajo që po përmbysset e që duhet përmbysur. Duke ruajtur ritmikën e vargut të poezisë popullore, D. Agolli me figura të gjetura dhe të konceptueshme, ka arritur jo vetëm të ngrejë problemin, por edhe të na japë optimizmin a besimin e tij e të brezit të tij se, sado i fortë të jetë zakoni, ai do të mposhtet nga e reja në jetën tonë, së cilës i përket e ardhmja.

Mendojmë se poema do të kishte fituar mjaft, nëse ajo do që thelluar edhe ca në planin psikologjik, në zërbërthimin më të plotë të botës së brendshme të xha Agushit. Së dyti, nuk e gjejmë me vend faktin që autori vajzën e xha Agushit na e jep vetëm në sfond, pa e bërë pjesëtare aktive të luftës për shkëputjen e saj nga thonjtë e zakonit e të kanunit. Duke u gjallëruar figura e vajzës, duke e shkëputur atë nga sfondi (ne e përfytyrojmë atë vetëm në dy momente: kur plakat asaj i presin gërshetat dhe kur ajo në kullë dëgjon këngën e të rinjve) për ta vënë në qendër të poemës, përballë të atit, xha Agushit, na duket se vepra do të kishte fituar në thellimin e konfliktit, në pasqyrimin realist të jetës sonë. Si poemë me subjekt «Ballada e ashpër» fare mirë mund ta kish si element konfliktin ku përplasen dy botë, dy mentalitete, dy ideologji.

Vëllimi «Mesditë» në përgjithësi është një realizim i suksesshëm për autorin, por me gjithë vlerat ideo-emocionale të tij, në të ka edhe krijime, që dëshmojnë për një punë të nxituar dhe jo fort të frymëzuar. Në vëllim mund të ndeshësh nëpër vjersha, që kanë mendim apo ide të përifertha si dhe një konceptim figurativ të ngjashëm; si rrjedhim, këto lloj poezish të shkaktojnë situata emocionale të njëjta, gjë që e varfëron vlerën e tyre. Të tilla na duken poezitë «Ai mot» dhe «Shtëpia e vjetër në motin 1944». Edhe në raste të tjera në vëllim të bie në sy ndo-

një përsëritje motivesh, peizazesh, situatash poetike etj. Ka nëpër vjersha, ndonëse rrallë, vargje që s'kanë një kuptim të qartë, në mos që tentojnë për një figurë të errët, si ky te poezia «Fshatarët», «Mbi brirët e tyre (të qeve — D.D.) u ulën yjtë e hedhur nga retë»!! ku, sidoqoftë, logjika çalon. Ndonjë poezi na duket se poeti është përpjekur dhe e ka krijuar apostafat për të shprehur një mendim, që zë vend në fund të saj dhe që, për mendimin tonë, s'ia vllente mundimin, si te vjersha «Baladë për dy poetë e një çoban», e cila s'do t'i sillte asnjë dëm vëllimit sikur të mos përfshihej në të.

Por pa dyshim, me vlerat që ka arritur të na japë vëllimi në krijimet më të mira, që përfshin, të cilat s'janë të pakta, ai është një sukses i ndijshëm për autorin dhe për poezinë tonë të re.

1970

Bota shpirtërore e personazhit, ndjenjat, mendimet, gjithshka që lëviz dhe vepron thellë në ndërgjegjen e tij, ajo që përbën ato shtytje të heshtura, të padukshme, të lehta brenda shpirtit të njeriut, të cilat ashtu si rrëkezat e vogla të maleve vijnë e mbushin shtratin e lumit, që buçet e përmyt brigjet, shpërthejnë e manifestohen në veprimet e tij, përbëjnë pa dyshim një nga anët më interesante në një vepër letrare. Një nga anët më delikate dhe që kërkon thellim të shkrimtarit në punën e vet, në procesin e krijimit sigurisht kur ky aspekt është në funksion të qëllimit, që ndjek autori në vepër apo të karaktereve, që ai skalit, pa u shndërruar në qëllim në vetëvete apo thjesht në një mani stili.

E bëme këtë hyrje të shkurtër rreth kësaj veçorie të krijimit letrar, se na duket që në romanin «Një lindje e vështirë» të prozatores sonë Elena Kadare, që për mendimin tonë është një roman karakteresh, kjo veçori është një nga anët më të realizuara.

Siç mund të merret me mend që nga titulli i veprës, autorja ka vendosur në qendër të saj fatin e gruas, e vajzës shqiptare, e cila sot po shqelmon me guxim gjithshka të egër e të shëmtuar, që na ka mbetur si trashëgim nga e kaluara. Këtë përmbysje ajo po e bën jo më e vetmuar dhe pa shpresë, por duke pasur përkrahjen e opinionit tonë shoqëror dhe udhëheqjen e Partisë.

Fati dhe drama e Bardhës, heroinës së romanit, ndonëse nuk përgjithëson fatin e vajzës sonë sot, prapë ka terren në realitetin tonë ku akoma janë të përhapura fe-

nomene të tilla, mbeturina të botës së vjetër, kundër të cilave në radhë të parë luftojnë vajzat, viktimat të këtyre zakoneve të egra. Pikërisht ky aspekt i luftës, fakti që vajzat, deri dje skllave të heshtura e të bindura të vullnetit të prindërve, sot luftojnë për të mbrojtur të drejtat e tyre më të ligjshme, më njerëzore, është ana më interesante dhe më e rëndësishme e këtij fenomeni.

Bardha, si shumë shoqe të saj, është rritur në një ambient të fortë patriarkal. Në familjen e saj vendos fjala e egër e të atit, Kadriut dhe sidomos e të ungjit, Bajramit. Por fryma e re revolucionarizuese ka çarë shteg dhe është futur deri në fshatin e saj të largët malor, kjo e ka lëkundur tepër pozitën e konservatorëve, u ka dhënë kurajë vajzave që ato të mos e lënë veten e tyre në duart e të tjerëve, por të vendosin vetë. A është Bardha një përfaqësuese e tillë e guximshme dhe luftëtare këmbëngulëse për të drejtat e saj? Po. Autorja, me heroinën na ka dhënë një tip më të ndryshëm, më të qetë, më pak të bujshëm, por perseverant në qëllimet dhe synimet e veta.

Drama dhe lufta e Bardhës fillojnë me veprimin e përbindshëm, por «sipas zakonit, si e lyp nderi i familjes», që kryejnë i ati dhe i ungji, të cilët e shkëputin nga jeta e lumtur bashkëshortore. Në çastet e para vajza shtanget dhe tmerrohet nga ky vendim, ajo nuk e merr dot me mend se si këta, njerëzit e saj, babai i saj mund të jenë aq të ligj sa t'i shkatërrojnë jetën. Kjo e dërmon atë fizikisht e shpirtërisht, e hedh në shtrat. Pas këtij momenti të parë Bardha e kupton thellë të gjithë të vërtetën e hidhur, atë që ajo mëse një herë e parandjente, por që s'ja kishte marrë mendja se mund të ndodhte me të; ajo kupton tërë cinizmin e egër të sedrës së fyer, që i shkatërroi jetën dhe mundohet të ruajë gjakftohtësinë. Ky është dhe momenti i fillimit të luftës së saj. Në tërë zërtimin e mëtejshëm shpirtëror të personazhit, autorja ka ngulmuar dhe mjeshtërisht ja ka arritur të na vizatojë rritjen graduale të revoltës së heroinës. Kjo revoltë manifestohet në mënyrë të shumëllojshme. Bardha në krye

provon një ndjenjë urrejtjeje për të atin e sidomos për Bajramin, të ungjin, urrejtje që arrin kulmin kur ajo kupton se deri ku mund të vejë cinizmi dhe ligësia pothuaj shtazore e këtyre njerëzve, kur Bajrami ka guximin (dhe këtë e bën me thjeshtësi e si gjë të natyrshme) t'i propozojë së mbesës një martesë të dytë, atëhere ajo e përzë të ungjin nga dhoma. Ky veprim i saj s'është një gjë e vogël, por një veprim, që kërkon guxim shumë të madh. Këtë mund ta kuptojmë, po të kemi parasysh se sa fort qe e rrënjosur ndjenja e patriarkalizmit në këtë familje, ku gruaja qe skllave, siç kishte katandisur e ëma e Bardhës, qenje e nënshtruar plotësisht ndaj vullnetit të burrit. Protestën e heroinës autorja na e ka nënvizuar në mënyrë shumë të natyrshme nëpërmjet një sërë detajesh të gjetura, këtë protestë e shohim në ftohtësinë e saj shpirtërore ndaj gjithshkaje, që e rrethon, madje edhe ndaj së ëmës, dhe kjo s'është dhënë rastësisht. Bardha e ka kuptuar fare mirë që e ëma s'mund të bëjë asgjë, por, duke ndjerë edhe ajo vetë se dikush po mundohet që edhe atë ta kthejë në një qenje pa personalitet, pa asnjë të drejtë edhe mbi veten e saj, ta bëjë me një fjalë të njëjtë me nënën e saj, instiktivisht revoltohet edhe ndaj së ëmës.

Bardha asnjëherë nuk i nënshtrohet fatit. Kjo është ana më pozitive e figurës dhe këtu qëndron merita e autores në kapjen e problemit dhe në këndin, nga i cili niset ajo për ta vështruar jetën e heroinës. Gradualisht dhe në mënyrë të besueshme evoluon Bardha në qëndrimin e saj. Në krye ajo beson se i shoqi, Fadili, do të kujtohet për të, më pas do t'i bindë babain e xhaxhain me arësytën e fortë se është shtatzënë, dhe së fundi tenton vetë të arratiset, bile nuk thyhet në vendosmërinë e saj edhe pse mbetet e zhgënjyer në shpresat e veta të Fadili. Vetëm dobësia fizike e bën që të mos e shpjerë deri në fund revoltën e saj. Më pas në roman kjo revoltë dhe këmbëngulje merr forma të tjera, që na bindin plotësisht se Bardha nuk pranon asnjë nënshtrim, ajo është e vendosur për luftë dhe triumfon me gjithë pengesat e rreziqet e shumta, që i kanë nën.

Duke i ndenjtur besnike pasqyrimin realist të jetës, autorja na ka dhënë me vërtetësi vajzën fshatare, malësoren, që jeta jonë e ka armatosur me kurajo dhe forcë. Pa rënë në idealizim të figurës apo në paraqitje skematike të realitetit, E. Kadare ka mundur në mënyrë logjike dhe thjesht pa deklarata të na japë procesin e emancipimit të bashkatdhetares sonë, nëpërmjet luftës e këmbënguljes së saj në radhë të parë. Gjatë gjithë këtij procesi, Bardha mbetet në natyrën e saj, prandaj ne e besojmë dhe e ndjekim me interes në të gjitha përpjekjet dhe luhatjet plotësisht të motivuara. Një avancim i qëndrimit, një paraqitje e heroinës si vajzë më e hedhur, më energjike s'do të ishte bindëse, por artificiale. Kjo jo se te ne s'ka të atilla vajza e gra, përkundrazi autorja në qëndrimin e revoltuar të Sadijes apo edhe me linjën e Marjanës na e ka dhënë tipin e vajzës së hedhur, këtë radhë qytetare, që lufton më hapur e më me vendosmëri për të drejtat e saj, por se në rrethanat e kushtet ku jeton e vepron, Bardha, në atë ambient familjar aq të ndrydhur, në të cilin është rritur ajo, as që mund të pritej një formë tjetër revolte pa rënë në skematizëm e retorizëm. Pikërisht këtij rreziku autorja i është shmangur me shumë sukses.

Martestat me këmbim janë pa dyshim një shfaqje e shëmtuar e të drejtave kanunore, që gëzonte prindi mbi të bijën. Veç të tjerave ky zakon është një shprehje e mprehtë e përbuzjes së shëmtuar ndaj gruas, që ishte pothuaj në një konsideratë me kafshën. Ky fenomen përherë është shoqëruar me tragjedi e drama të rënda, që mbyteshin në lotët e vuajtjet e femrave dhe që shuheshin në nënshtrimin e tyre të heshtur. Kjo është e vërteta e shekujve dhe e viteve, që shkuan. E. Kadare, duke e trajtuar këtë fenomen në ditët tona, ka vërejtur dhe i ka mëshuar kryesisht aspektit të ri të këtij fenomeni: luftës që bën vetë gruaja jonë sot, qoftë edhe në fshatrat më të thella e në familjet më patriarkale, edhe në raste kur ajo s'ka përkrahjen e nevojshme të burrit apo kur ajo në familje ndodhet e rrethuar nga mentaliteti konservator, për të evidencuar të vërtetën se edhe në rrethana

të tilla, ajo mund të triumfojë, sepse fryma e kohës sonë, mendimi shoqëror përparimtar e përkrah atë, është me të, me të renë.

Në rrethana të tilla lufton Bardha, ajo ka kundërshtarë babain dhe xhaxhain, që janë mishërimi i gjith-shkaje konservatore, egoiste e mikroborgjeze. Në mënyrë të veçantë Bajrami të provokon një ndjenjë urrejtjeje të thellë në shpirt. Tek ai s'ka asgjë njerëzore, ligësia shpirtërore dhe cinizmi i tij të revoltojne sidomos në disa momente qoftë në raport me Bardhën, qoftë në raport me të kunatën, të cilën me të drejtën e të parit të shtëpisë, ai e trajton si kafshë duke mos i respektuar as ndjenjën e dhembjes së nënës për vajzën, që ka në rrezik. Në krah Bardha ka të ëmën, një mbrojtëse shumë e pafuqishme. Nëna për Bardhën është pasqyra e gjallë e fatit, që e priste edhe atë vetë, nëse do të nënshtrohej, nëse koha do të punonte për regresin. Tërë historia e jetës së nënës është pohim i përbuzjes dhe i keqtrajtimit të gruas, i sjelljes shtazore ndaj saj. Autorja e shpjegon plotësisht pse kjo grua ka pushuar prej kohësh së qeni njeri jo në vetëvete, por në konsideratën, që kanë burrat për të. Ajo e ndjen dhembjen e së bijës, ajo shfryn kundër të shoqit e të kunatit dhe e tërë qenja e saj të duket sikur është kapur e mbahet pas revoltës të së bijës jo vetëm pse i dhimbset vajza, por edhe se triumfi i së bijës do të jetë dhe triumfi i saj, se Bardha do të hakmerret edhe për të, edhe për vuajtjet e saj të shumta.

Një tip krejt i ndryshëm gruaje është e vjehrra e Bardhës. Grua autoritare në familje. Ajo ruan në vetëvete një dozë jo të vogël konservatorizmi në sjelljet me nuset e me djemtë. Do të ishte me interes që autorja të hidhte më shumë dritë mbi këtë karakter gruaje për të na bindur më tepër për vërtetësinë e saj. Ajo është fuqiplote në mendim jo vetëm mbi të shoqin, por edhe mbi djemtë, aq sa ata s'guxojnë as t'i duan gratë në sytë e saj, sidomos Fadili. E pra, sikurse e ëma e Bardhës, ajo është produkt i të njëjtës epokë, i të njëjtave rrethana e marrëdhënje shoqërore, pse atëhere është kaq e ndrysh-

me? Po kjo mungesë motivimi të bie në sy edhe kur është rasti për t'i dhënë shpjegim pse kjo grua e autoritetshme ndaj djemve është **kaq e lirë** ndaj Vjollcës, së bijës? Mendojmë se nuk është i mjaftueshëm për ta shpjeguar këtë fenomen, fakti që kjo grua me familjen e saj ka jetuar në fermë pra në marrëdhënje shoqërore shumë më liberale se sa marrëdhënjet konservatore të një fshati të humbur siç është fshati i Bardhës. Në qoftë se do të kënaqeshim me këtë shpjegim, prapë do të na mbetet i pashpjegueshëm konservatorizmi i saj ndaj djemve dhe ftohtësia e saj ndaj nuseve, që afron shumë me qëndrimin e Kadriut dhe të Bajramit ndaj Bardhës apo ndaj së ëmës së saj.

Në gjithë këtë dramë të hidhur të fatit të heroinës personi më i afërt, ai ku Bardha mbështet ëndrrat, gëzimet dhe shpresat e saj në ditët më të trishtuara, është Fadili, i shoqi, ai që çeli për të lumturinë. Autorja e motivon plotësisht se si ndodhi që vajza mundi të merrte atë njeri, për të cilin ndjeu diçka qoftë dhe intuitivisht, qysh në takimin e parë. Kadriu me Bajramin pranojnë ta japin vajzën, megjithëse marrin vesh që ajo është parë me djalin, jo vetëm se u pëlqen ai dhe familja e tij, por edhe për të mos e lejuar Bardhën të shkojë në aksion. Fadili e do Bardhën, ai e ndjen qetësinë dhe shplohjen shpirtërore pranë saj, por këtë ndjenjë ai mundohet ta fshehë jo vetëm se këtë ja kërkon «sedra» e tij, por edhe se opinionin në familje ja detyron një qëndrim të tillë. Ndërsa Bardha e manifeston lumturinë dhe dashurinë e saj me njëmijë mënyra të ndryshme, që autorja na i ka dhënë nëpërmjet detajesh të gjetura bukur. Fadili rezervohet edhe kur është fjala të përkujdeset për të, thjesht si për gruan e tij, se kështu do e ëma (kujtojmë atë ditë shiu kur Fadili e la Bardhën të bëhej qull, apo rastin tjetër kur ai hoqi krahun nga supet e së shqes nga që u druajt se e pa e ëma). Pra Fadili është një tip i tutshëm dhe i pavendosur, kjo është e mundshme dhe e besueshme në jetë, ndonëse në roman do të qe e nevojshme që të motivohej më mirë. Kjo kërkesë ndaj perso-

nazhit na duket se bëhet më e domosdoshme në tërë atë pjesë të romanit ku na përshkruhen lëkundjet dhe hezitimet e tij të gjata për të vepruar, për të mbrojur të drejtën e vet si bashkëshort, që dikush ja ka marrë nëpër këmbë. Në shumë momente autorja e ka justifikuar mirë ngurimin e Fadilit duke na zërthyer shqetësimet e tij shpirtërore apo ndikimin e madh të frymës konservatore, të sedrës së sëmurë që ia imponon rrethi i tij familjar. Por në ndonjë rast, si aty kur pas bisedës me Gogon, sekretarin e organizatës së partisë të fermës, Fadili heq dorë nga vendimi për të vajtur te Bardha vetëm pse dëgjon që dikush në errësirë, krejt rastësisht bisedon për të, na duket se motivimi s'është i mjaftë, përkundrazi kemi përshtypjen se autorja ka përdorur thjesht një truk që të mbajë gjallë atë që do ajo vetë. Ndofta do të që më me vend që Fadili të niste të vepronte që këtu, pra ta niste që këtu atë që ai do të bëjë më vonë në faqen e fundit të romanit. Kështu ajo do ta përçonte më mirë linjën e këtij personazhi pa e cënuar aspak atë që ka kryesore në idenë e vet: luftën e vetë heroinës për triumfin e të drejtave të saj.

Duke vënë në themelin ideor të veprës luftën e një gruaje të ditëve tona kundër konservatorizmit dhe patriarkalizmit, Elena Kadare në romanin e saj «Një lindje e vështirë» është nisur nga pozita të shëndosha dhe thellësisht të partishme në interpretimin e realitetit. Autorja e ka paraqitur drejt dhe me vërtetësi këtë aspekt të rëndësishëm të revolucionarizimit të jetës sonë. Megjithëse e rrethuar nga një opinion mbytës në familjen e saj, apo nga një qëndrim pasiv dhe inert në familjen e të shoqit, prapë heroina nuk është e vetmuar në luftën e vet. Qoftë në fshat, në fermë e sidomos në maternitet, autorja ka ditur të vërë në pah atë frymë përparimtare, që e përkah veprimin e heroinës, e miraton luftën e saj. Në roman mund të vëresh dhjetëra skena, që e pohojnë këtë.

Lufta e kësaj vajze gjen mbështetjen e plotë dhe pa rezervë të partisë, të komunistëve, edhe pse në roman gjejmë ndonjë komunist, që nuk thellohet në atë që po

$\rho = \frac{m}{V} = \frac{8 \cdot 10^3}{4} = 2 \cdot 10^3$

ndodh me Bardhën, apo thjesht me fatin e një gruaje. Këto janë raste të shkëputura, që flasin për forcën realiste të veprës, por ajo që zotëron në paraqitjen e qëndrimit të partisë, gjen shprehjen në qëndrimin e organizatës dhe të komunistëve të spitalit apo në qëndrimin e ngrohtë vëllazëror të Gogos ndaj hallit të Fadilit.

Me këtë vepër të re Elena Kadare ka bërë një hap të dukshëm përpara në krijimtarinë e saj. Nga tregimet e disa vjetëve më parë, te novela «Shuaje dritën, Vera» dhe deri te ky roman ne me kënaqësi vërejmë rritjen dhe pjekurinë e talentit të autores. Naracioni i pasur, i shtruar dhe plot ndjenjë, zbërthimi i botës shpirtërore të heronjve me shumë ngrohtësi, sinqeritet dhe forcë komunikuese, detajet e gjetura dhe imazhet e gjalla, që na ka krijuar, janë disa nga vlerat kryesore të këtij romani të parë të gruas shqiptare, që pa dyshim shkrimtarja do t'i përsosë e do t'i shpjerë më tej në veprat e saj të ardhshme.

1970

NJË ROMAN I BUKUR PËR LUFTËN NACIONALÇLIRIMTARE

Gjithmonë brenda kërkesës për një trajtim më dinjitoz e më të plotë të temës aktuale — në kuptimin e gjerë të kësaj fjale — bën pjesë edhe kërkesa për thellim, zërtim e paraqitje sa më dinjitoze të temës së Luftës sonë nacionalçlirimtare. Në këtë drejtim letërsia jonë e në mënyrë të veçantë proza e gjatë po arrin rezultate e suksese të ndijshme. Prozatorët tanë e sidomos romancierët me veprat e botuara viteve të fundit po ecin drej plotësimit të asaj kërkesë të madhe, që ka lexuesi ynë për atë temë, po ecin drejt plotësimit të atij detyrimi të madh e fisnik, që i ka letërsia periudhës më të ndritur të historisë sonë, periudhës së revolucionit tonë popullor kur në mënyrë më të shkëlqyer, si asnjëherë më parë, u manifestuan cilësitë e rralla e të larta morale të shqiptarëve.

Pasqyrimi i Luftës nacionalçlirimtare në letërsinë tonë të re ka zënë fill qysh në shkrimet e para partizane dhe erdhi duke u thelluar nga ditë e më tepër me çlirimin e vendit, me konsolidimin e pushtetit popullor dhe të rrymës së realizmit socialist si shkollë e vetme e letërsisë shqipe. Në të gjitha gjinitë e gjejmë të trajtuar këtë temë, por romani për vetë natyrën dhe karakteristikat e tij, që dhe është forma më e përshtatshme për ta trajtuar. E them këtë jo për të nënvleftësuar gjinitë e tjera po

për t'u mohuar atyre të drejtën që gjithmonë e më mirë ta trajtojnë temën e Luftës sonë nacionalçlirimtare, por sepse për vetë llojin e tij epik, romani i shkon më për shtat kësaj teme me epicitet e dramacitet të rrallë në jetën dhe historinë e popullit tonë.

Është lokuent fakti që në katër romanet e para, që dolën në vitet pesëdhjetë dy, qenë krejtësisht me temën e luftës, ndërsa dy të tjerat pjesërisht e tërthorazi të çonin te kjo temë.

‡ Pavarësisht nga veçoritë dhe vlerat apo mungesat, romanet tona me këtë temë e vështruan realitetin, që trajtuan në dy forma: ose në aspekte të veçanta të asaj lufte, duke u përpjekur që nëpërmjet të kësaj të veçante të përgjithësojnë, ose në mënyrë shumë të gjerë në formën e romanit shumë vëllimesh apo të romanit epike. Pra vetë tema u sugjeroi dhe u sugjeron mundësi të shumta autorëve për t'u trajtuar.

‡ Në këtë krijimtari që erdhi duke u shtuar e pasuruar nga viti në vit, ndihet si e përbashkët paraqitja e revolucionit tonë popullor nga një kënd i drejtë dhe i partishëm vështrimi. Lufta jonë aty është dhënë si luftë popullore, luftë e ndërgjegjshme, që qysh në fillimet e saj u armatos me teorinë e socializmit shkencor, të cilën partia, komunistët u përpoqën dhe në shumë mënyra mundën ta futnin në ndërgjegjen e luftëtarëve partizanë, në ndërgjegjen e popullit. Është pozitiv në romanet e kësaj teme fakti që lufta jonë është parë si luftë e popullit, e masës së gjerë. Në disa prej tyre qartazi dallohen vlera të mira qoftë në realizmin e karaktereve, sidomos të figurave negative, qoftë në vizatimin e skenave dhe episodeve nga më të ndryshmit, qoftë në shtjellimin kompozicional të drejtë të subjektit, që ngërthejnë ato.

Por, me gjithë anët e realizuara e të suksesshme, si-kurse është vënë në dukje nga kritika jonë herë mbas here, në romanet e kësaj teme ndihet hapur tendenca e një paraqitjeje të pathelluar të atij realiteti, tendenca për të dhënë anë të bujshme të luftës sonë. Kjo, sigurisht, kur në një vepër apo në disa vepra është proporcionale,

në raport me anët e tjera të realitetit, që autori ka vënë në objektiv të krijimit të vet, s'ka asgjë të keqe.

Përbën dobësi, gjithmonë në veprat e kësaj teme, edhe paraqitja e subjektit me një stil si shumë agjitativ e gazetaresk, sidomos për shkak të ndërhyrjeve të shpesh-ta e të pavend të autorëve në fatin e ngjarjeve e të personazheve, veçanërisht të heronjve pozitivë, që vuajnë nga doza të theksuara skematizmi, nga dëshira për t'i paraqitur sa më të përkryer ata, gjë që ka minimizuar deri në zhdukjen e plotë evoluimin e tyre dialektik si heronj me mish e me kocka, me të mira e të meta si njerëz realë e të gjallë.

- Dajla e romanit «Komisari Memo» të Dritëro Ago-llit, mund ta themi me plot gojën është një sukses i ndijshëm, një hap i mëtejshëm në trajtimin dinjitoz të temës së Luftës nacionalçlirimtare në romanet tona. Vepra është si një këngë e ngrohtë plot ndjenjë, dhembje e krenari, që i thuret atyre që dhanë edhe jetën për këtë truall, për lirinë e këtij populli. Në të ndihet me forcë të madhe dashuria dhe respekti për njeriun e thjeshtë, për luftëtarin e panjohur, për atë që simbolizon heroizmin e pashembullt partizan.

Ndonëse romani trajton një aspekt pak si të veçantë të luftës, dhe ngjarjet që përfshin ai lokalizohen në kra-hina e qytete të caktuara, prapë forca përgjithësuese e tipi-zuese e tij ka bërë që ai të tingëllojë më tepër si një eho e fuqishme e krejt luftës sonë në shumë anë të saj. Pikë-rishtë kjo vlerë e veprës na bën të pohojmë se edhe pa u angazhuar me paraqitje shumë të gjera të një realiteti të caktuar, edhe pa synuar për romane shumëplanshe, shkrimtari me forcën e artit të vet, kur ai di ta vërë këtë në shërbim të temës, që merr të trajtojë, mund t'ja arrijë të na japë vepra të fuqishme e me kënd të gjerë vësh-trimi. Me këtë s'dua të mohoj të drejtën e pakufishme që ka edhe romani i llojit shumëplansh për ta trajtuar denjë-sisht jetën në çdo periudhë historike me shumë sukses.

Gama e problematikës që ndërthen vepra, që shtron dhe zgjidh autori në të, është shumë e gjerë dhe e larme,

ashtu sikurse që në vetë atë realitet. Romani ka arritur të na japë atë mori problemesh apo atë shumëanshmëri të rolit, që lojti revolucioni ynë jo vetëm në shporrjen e okupatorëve dhe të sundimtarëve, por edhe në lindjen e njeriut me moral të ri, në krijimin e atij uniteti të çeliktë, mbi të cilin u mbështet e u garantua fitorja jonë e madhe, në rolin e madh e vendimtar të ndikimit pozitiv, që mundi të realizojë udhëheqja e partisë në atë revolucion, probleme dhe funksione këto që i sugjeronte realiteti heroik i atyre viteve.

Romani ka meritën e madhe që në një mënyrë shumë të natyrshme e të besueshme, ka mundur të na japë atë të vërtetë të madhe që këtë epike më të lavdishme të historisë shqiptare e udhëhoqi dhe e drejtoi Partia Komuniste Shqiptare (sot Partia e Punës), themi që kjo është meritë e romanit jo sepse vepra të tjera të kësaj teme s'e kanë dhënë, pra jo se kjo është diçka e re, që na habit e na mrekullon, por se te «Komisari Memo», ndonëse nuk flitet në mënyrë të veçantë e direkte që celulat e partisë apo qarkori bëjnë këtë apo atë mbledhje, marrin këtë apo atë vendim, për aksion, për atentat, për sulm mbi ballistë apo mbi gjermanë, prapë këto aspekte të luftës sonë nuk mungojnë në vepër, ato kryhen dhe në momente shumë me efekt dhe nënvizojnë që në çdo çast të aksionit të romanit apo të jetës së personazheve, fryma e partisë, dora e partisë është e pranishme, ajo i frymëzon dhe i udhëheq heronjtë e romanit. Kështu shpërthimi i zjarrit në depot e municioneve vjen e ndodh tamam në çastin kur atmosfera në familjen dr. Kristo Borovës ka arritur një mprehje të veçantë, po kështu atentati kundër spiunit Lefter Lefteri kryhet thjeshtë e në një moment, që ndikon në rrugën, që do të ndjekin në vepër personazhe si Andrea, dhe, megjithëse gjithshka ndodh papritur e pa ndonjë përgatitje të veçantë, ne e ndjejmë që për këtë aksion të rrezikshëm patjetër janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme, dhe po kështu, me finesë artistike është dhënë forca e partisë, që drejton e udhëheq

edhe në veprimet e batalionit «Shkrepëtima» sidomos në fund të romanit, në betejën e egër të Gur kusarit etj.

Pra, duke iu mënjanuar përshkrimit të anës organizative të punës drejtuese të partisë, duke iu rreshtur përshkrimeve të gjata e të hollësishme të skenave të mbledhjeve e detajeve të tjera, që synojnë të sqarojnë rrethanat kur ndodh aksioni (sikurse e ndeshim rëndom në ndonjë roman tjetër) autori ka arritur që të mos e frenojë aksionin e veprës e të mos e humbë interesin tonë duke na e larguar vëmëndjen nga ajo që është kryesore, pa e errësuar aspak, po përkundrazi, duke na e dhënë në një mënyrë mjaft origjinale dhe interesante idenë e ndikimit të përhershëm të udhëheqjes së partisë. U ndala disi gjatë në këtë aspekt ideor të romanit për të vetmen arsëye se te kjo vepër si te rallë ndonjë tjetër, është dhënë në nëpërmjet shmangjes së plotë prej shablloneve dhe skemave, pra me një mënyrë shumë të gjetur e orgjinale, roli i Partisë në krejt aspektet e shumta të Luftës sonë nacionalçlirimtare.

Lidhur ngushtë me këtë anë ideore, romani ka hedhur dritë edhe mbi derivatin e drejtëpërdrejtë të saj, që shprehet në qëndrimin e masës ndaj ngjarjeve të mëdha të kohës, pra që ka të bëjë me mobilizimin dhe afrimin e masës, me tërheqjen e saj në radhët ilegale apo sidomos partizane. Këtë funksion autori e ka konkretizuar dhe mishëruar nëpërmjet Memos kryesisht si dhe nëpërmjet personazheve të tjera komuniste, apo nëpërmjet aktivitetit të celulës dhe qarkorit të partisë ndonëse në një masë më të pakët. Realizimi i kësaj ideje, pasqyrimi i këtij aspekti ka materializuar dhe ka zgjidhur drejt, nga pozita të shëndosha të ideologjisë sonë, raportin individ-shoqëri dhe rolin ndikues të të parit te e dyta.

Është me shumë interes të vërehet se si në roman autori, ndonëse ngjarjet i ka vendosur në periudhën e okupacionit nazist, megjithëse për asnjë çast nuk na e largon përshtypjen reale, se lufta jonë po zhvillohej pikërisht në këtë kuadër, e ka sfumuar këtë aspekt të përleshjes me armikun e huaj dhe ka vënë në fokus të vësh-

trimit të tij luftën me tradhëtarët e vendit, me ata që për interesa egoiste i shërbejnë okupatorit pa asnjë skrupull në ndërgjegjen e tyre, apo me organizatën tradhëtare të «Ballit Kombëtar» e sidomos me çetat e tij, që në atë periudhë përbënin një diversion të rrezikshëm kundër frontit të Lëvizjes nacionalçlirimtare. Doza e rrezikshmërisë së tradhëtarëve të ballit që shtuar për më tepër se, ndryshe, nga koha e okupacionit fashist italian, ky diversion ishte demaskuar nga Partia, ndaj që detyruar të dilte nga qëndrimi i vet demagogjik i dyanshëm e të merrte qëndrim të prerë e të hapur kundër interesave të popullit, pra të hidhej në luftë të hapur kundër njësiteve të ushtrisë nacionalçlirimtare, kundër luftëtarëve aktivë ilegalë duke e justifikuar këtë veprimtari të fëlliqur me demagogjinë e dalë boje se gjermanët na qenkëshin ndryshe nga italianët, se ata s'na paskëshin pushtuar, por vetëm na paskëshin ardhur tranzit për qëllime ndaj vendeve të tjera, kurse Shqipëria që shkelur prej tyre vetëm rastësisht, se na u ndodhkej në kryqëzim rrugësh. Ky helm demagogjik del i plotë në një nga momentet më dramatike të veprës, në bisedimet ndërmjet dr. Kristo Borovës dhe Spiros, dhëndërit të tij, kur më në fund nën ndikimin e Memos, si doktori dhe fëmijët e tij, sidomos Alma, kanë vendosur ta prishin fejesën dhe t'i tregojnë derën Spiros.

Nga ana tjetër kjo mënyrë e të vështruarit të atij realitetit historik i shërben plotësisht edhe nënvizon mendimin e drejtë se meriton përbuzje më të madhe dhe duhet luftuar me të njëjtën ashpërsi e urrejtje edhe vegla e armikut, ajo pjesë e fëlliqur e shoqërisë, që vihet në shërbim të të huajit për egoizmin e vet klasor dhe, siç është e natyrshme, kjo pjesë në shumicën e vet përbëhej prej përfaqësuesve të klasave të pasura, se ata i kishin interesat ngushtësisht të lidhura me pushtuesin dhe krejt të shkëputura me interesat e popullit e të atdheut.

Në pjesën e parë të veprës, duke qenë se autori merret edhe me problemin e qëndrimit të diferencuar të masave e të shtresave përbërëse të shoqërisë shqiptare të

asaj kohe ndaj problemit bazal: qëndrimin ndaj pushtuesve të huaj, ai i ka kushtuar vend edhe qëndrimin të intelektualëve. E them që në krye se te «Komisari Memo» ndryshë nga te disa vepra të tjera të kësaj teme, ky aspekt i qëndrimin të intelektualëve ndaj luftës nuk është shfrytëzuar në dëm të anëve të tjera të realitetit, ai ka proporcionin e nevojshëm dhe s'është përdorur për të ngjallur irealisht kuriozitetin e lexuesit se në të vërtetë kjo, qëndrimi i intelektualëve, ndonëse qe një aspekt i rëndësishëm, të cilit Partia i kushtoi vëmendje, nuk qe ana më e rëndësishme. Intelektualët autori i ka vështruar në mënyrë të diferencuar. Ndër ta, ne kemi bij të vërtetë e besnikë të popullit, që së bashku me të, që në fillim u hodhën kundër okupatorëve. Të tillë në vepër janë Thomai apo mësuesi, siç e thërresin fshatarët dhe kolegu i Kristo Borovës, doktor Shahini. Këta përfaqësojnë intelektualët e shtresës, që asgjë s'i ndau nga populli e nga fati i popullit, që i njohën mjerimin dhe hallet e fshatarit e që s'kursyen asgjë për të, për t'i shërbyer atij.

Kurse dr. Kristo Borova disi më ndryshe nëpërmjet lëkundjesh të forta e nëpërmjet një rruge më të ndërlëkuar arrin në **pozitat e kolegut të tij e të Thomait**. Por prapë edhe doktori, megjithëse jo ashtu vendosmërisht, nuk është shumë larg popullit të tij dhe idealeve e dëshirave të popullit. Ai është i predispozuar për të qenë me luftën tonë, se pikëpamjet e tij demokratike dhe fizionomia e tij morale prej patrioti dhe njeriu të ndershëm, të prirë drejt virtutit, nuk mund ta çonin gjetkë. Kristos i duhet vetëm një nxitje, një syhapje, si ta themi, që ai të shihte se ç'po ndodhte rreth tij. Këtë kolpo ai e merr nga ç'ndodh në familjen e tij pas ardhjes së Memos së plagosur. Është e rëndësishme që autori në përpunimin e këtij personazhi e të kësaj linje ideore nuk është përpjekur të na joshë me eksperimente të laboratorit të tij krijues, duke u marrë me të jashtëzakonshmen e të rralën, por është marrë me atë, që është më tipike, më e mundshme në atë kohë dhe në atë realitet. Kategorinë tjetër, gjithmonë të inteligjencës, e mishëron Spirua, figura

e ndyrë e asaj pakice intelektualësh, që ranë poshtë në llumin e tradhëtisë e në flirt me okupatorin, saqë asgjë s'i dallonte nga spiunët më të rëndomtë e më të urryer si Lefter Lefteri. Me këtë tip përfaqësues, autori, nuk i vë kurrë përballë në debat njerëzit e popullit, apo intelektualët komunistë. Edhe kur diskuton apo më mirë kur takohet Memua me të e sheh më të përshtatshme që t'i hedhë pështymën në surrat, se sa të ulet e të diskutojë. Me të me urrejtje e me një ndjenjë pështirosjeje i ndau lakrat edhe dr. Kristua, ndonëse e kish të fejuarin e vajzës dhe ndonëse akoma Kristua llogaritej në rrethin e miqësisë së asaj shtrese nga kishte dalë edhe Spirua.

Kështu, romani me këta tre përfaqësues, ka shtruar e zgjidhur tërësisht dhe nga pozita shumë të shëndosha ideore problemin delikat të qëndrimit të inteligjencës së asaj kohe ndaj luftës së madhe të popullit tonë.

«Komisari Memo» është një vepër sa e pasur në ide, sa e thelluar në njohjen, ngritjen e trajtimit të problemeve, nëpërmjet përshkrimit të jetës së gjallë e reale, aq edhe e ngritur në vlerat e saj artistike, në mjeshtërinë letrare.

Edhe në një lexim të zakonshëm, pa ndonjë qëllim të caktuar, të bie në sy shkathtësia e autorit në përshkrimin e ambienteve, kjo cilësi e tij rrjedh sigurisht ngaqë autori e njeh mirë jetën dhe ambientin shqiptar, apo edhe pse ai është thelluar në këtë drejtim, ngaqë ka ndjerë nevojën e një njohjeje e zotërimi të sigurt të këtij elementi të rëndësishëm, që ndikon fuqimisht në shumë elemente të tjera të romanit. Kur them ambient, nuk nënkuptoj vetëm gjithshka që ndodhet fizikisht në një vend të caktuar, goftë kjo dhomë ose vend tjetër, por edhe atë të pakapshmen, frymën, atmosferën që përshkon ndodhinë e njerëzit që lëvrijnë dhe që e gjallërojnë ambientin apo, si të thuash, të gjitha ato që autori i përshkruan, në funksion të personazhit dhe të idesë së vet. Kështu, që kur prezantohemi me Dr. Kristo Borovën dhe familjen e tij, që kur njohim vilën e tij të heshtur e të qetë, e cila duket si një kënd i patrazuar në vorbullën e

ngjarjeve të mëdha të kohës, ne kuptojmë se kemi të bëjmë me një ambient intelektual mikroborgjez dhe këtë përshtypje na e forcon ca më tepër bota shpirtërore, mënyra se si e gjykon jetën e zonja e shtëpisë, Kristina. Tronditja e saj pas ardhjes së Memos, fraza e gjetur «Bobo, ç'na gjeti ne të zestë!» që është vënë si refren në gojën e kësaj gruaje, e forcojnë këtë përshtypje. Jo vetëm kaq, por edhe nota e jetës së krejt familjes para ardhjes së Memos, detajet që autori ka gjetur për të na përshkruar interesat e pjesëtarëve të familjes, i shërbejnë po të njëjtit qëllim. Kështu ne ndeshim në këtë ambient, një vajzë, Almën, që vret kohën dhe helmon botën e vet shpirtërore me lexime të pafundta veprash pa vlerë si «Ura e psherëtimave», ndeshim të vëllain e saj Andrian, që, ndonëse përbuz preferencat e së motrës, prapë edhe ai bën të njëjtën gjë si ajo duke skicuar vazhdimisht koka që i kopjon, pa mundur që talentin e vet ta përdorë për diçka të dobishme dhe me vlerë, ndeshim vetë doktorin, që ka rënë në një plogështi të plotë fizike dhe shpirtërore. Dhe këtij ambienti, kësaj fryme i shërbejnë përsosmërisht gjithshka përshkruhet, çdo send dhe detal që ka vendosur autori për të hedhur dritë mbi karakteret dhe frymën, që përcaktonte shtresën e lëkundur të kohës. Kulmin ky ambient, si një strofkë mikroborgjeze, e arrin në skenën kur familjes së doktorit i vijnë për vizitë zoti Tasi me tezen dhe Fredin. Bisedat e kota bile nervozuese për Kristin, etiketa boshë e grave, trashesia mendore e zotit Tasi, mendjehetësia e Fredit, që përfaqëson të riun tipik të klasave të pasura, loja me letra, kafetë që vijnë njëra pas tjetrës e deri edhe te lekët, që bëjnë xhëng-xhëng në xhepin e zotit Tasi apo tek ai zakoni i Fredit, që lëpin buzën e poshtme me gjuhë, janë krejtësisht të gjetura e të vendosura me qëllim për të na krijuar me realizëm botën e vogël mikroborgjeze, që autori ja ka arritur ta ndërtojë me sukses. Ardhja e Memos në këtë ambient bie mbi këtë familje krejt papritur dhe krijon atë shqetësim e lëvizje, që do të shkaktoje rënja e një guri të madh mbi sipërfaqen e fjetur të ujit të një kënete.

Krejt ndryshe, dhe një ambient krejt tjetër kemi në atë pjesë të romanit ku ngjarjet na kanë shpënë në shtëpinë e kryetarit të këshillit nacionalçlirimtar të fshatit, Zylganiut, ku kalojnë natën Rrapua me Memon e me të tjerët pas betejës. Fryma gazmore, e thjeshtë, e sinkertë dhe dashuria me të cilën Jashari, babai i Zylganiut, me të shoqen presin Rrapon me shokë, flet hapur për dashurinë, që ushqente populli për bijt e vet partizanë. Çdo gjë në këtë ambient: që nga shiltet e jastëkët e shtruar rreth e rotull odës e deri te bisedat e gjalla apshakatë e plakës me Jasharin dhe mundja e plakut me të birin, që u hedh shumë romuze së ëmës dhe të atit, dëshmojnë jo vetëm për të nënvizuar idenë që përmendëm më sipër, por edhe na bindin se autori e njeh mirë dhe është po aq i sigurt në skenën, që ndërton sa ç'e pamë edhe kur na skicoi ambientin intelektual mikroborgjez.

Por gjithshka gjejmë këtu ndryshon kryekëput nga ahengu e ziafeti, që ngre Bamkë Qyllollari, kur pret për darkë Sali Protopapën. Darka e Bamkës, siç e njohim nëpërmjet përshkrimit të Arifit, me atë errësirë të natës, me britmat e rojeve, me tromaksiet e grave, që u shpëtojnë enët nga duart, me atë plak të verbër, që kruan ndonjë kockë në kuzhinë apo me ato këngë të shthurura, me krismat e revolverit të Saliut e sidomos me atë dash, që therret në sofër e që spërkat me gjak muret dhe duart e Saliut, ka diçka si një hije të errët, si një tingull të kobshëm e fatal për ata që dëfrenjë e zhgryhen në atë orgji.

Në krijimet e ambienteve autori operon me shumë sukses nëpërmjet detajeve, që di t'i zgjedhë e t'u japë herë-herë edhe një natyrë simbolike apo funksion të tillë, që karakterizojnë frymën zotëruese, ndriçojnë e nxjerrin në pah më mirë idenë dhe mendimin, që do të na transmetojë ai. Aty asgjë s'është e kotë, asgjë s'është e tepërt dhe e panevojshme.

Për çdo episod që ndërton, për çdo skenë ku lëvizin, marrin jetë e zhvillohen karakteret e veprës, autori ka gjetur dhe na ka derdhur elemente shumë individualizuese

e tipike, që na bëjnë t'i kemi të gjalla e të diferencuara skenat e ndryshme të romanit edhe kur këto mund, për shkak të afërsisë së qëllimit, që ka ndjekur autori në to, të ishin shumë të ngjashme. E kam fjalën konkretisht për mënyrën dhe mjetet, që ka përdorur Dritëroi në vizatimin e betejave. Në letërsinë tonë ne sot kemi disa romane të temës së Luftës nacionalçlirimtare, që na përshkruajnë skena betejash, por në ndonjë prej tyre s'mund të dallosh një betejë nga tjetra, kaq të ngjashme dhe të njëjta janë përshkrimet e tyre. Kurse te «Komisari Memo», për ato vlera që përmenda më sipër, i dallojmë mirë dhe na mbe-ten të individualizuara në kujtesë tri betejat: ajo me au-tokolonën gjermane, ku komisari me Xhemalin marrin pjesë për herë të parë, ajo në Lajthizë kundër Sali Proto-papës, që u ikën dhe që përfundon me vrasjen e Bamkë Qylollarit dhe beteja e fundit në grykat e Gur-Kusarit në Operacionin nazisto-ballist të dimrit, që përfundon me vdekjen e Saliut dhe me fitoren e partizanëve të bata-lionit «Shkrepëtima» të Rrapo Tabanit. U mundova të rikujtoj me ndonjë tipar kryesor këto tri skena ku aq shumë ndryshon situata nga situata, ndonëse në të tria kemi beteja partizane, për të nënvizuar mendimin që shpreha për larminë e përshkrimit të autorit, e cila është aq e evidente, saqë më duket i tepërt çdo rikthim analizues e vlerësues.

Sikurse do ta shohim edhe më poshtë, romani për nga natyra e tij afron shumë më tepër me një vepër, që ka në epiqendër të vet zbërthimin e karaktereve njerëzore, qëndrimin e shoqërisë së asaj kohe kundrejt fatit të at-dheut. Pra vepra më pak shquhet për pasuri episodesh apo për interes të veçantë në zhvillimin e ngjarjeve e të ndodhive, që përshkruhen në të.

Autori ka synuar që të na vizatojë më tepër tipat e kohës dhe rolin e tyre duke ndërtuar drejt e nga pozita marksiste raportin e tyre me masën.

Në këtë aspekt të interesave të autorit në roman, zë një vend të dukshëm protagonistin e veprës, Memo Kovaçi, që pa dyshim është figura më kryesore e më me funksion

e veprës. Siç kam përmendur, Memua është përgjithësimi i komunistit, i luftëtarit të ndërgjegjshëm, që ka mbi shpatulla misionin e rëndësishëm e fisnik të zgjimit të ndërgjegjes ndër njerëzit e thjeshtë e patriotë, të cilët e urrenin okupimin dhe ishin hedhur kundër okupatorëve ose që e ndjenin si një diçka të keqe e të papranueshme atë realitet të hidhur, që i ishte imponuar atdheut, por që ende s'ishin hedhur në veprim, ende lëkundeshin pa mundur të gjenin rrugën e tyre. Ky mision i heroit, që në fakt qe misioni kryesor dhe një nga detyrat më të rëndësishme të Partisë, gjen rrugën e realizimit në krejt linjën e Memos, në krejt veprimtarinë e tij. Qysh në takimin tonë të parë me Memon në fshatin Lajthizë, në mbledhjen me kryetarët e këshillave nacionalçlirimtare e më pas, në familjen e dr. Kristo Borovës e në batalionin «Shkrepëtima», ne ndeshim shtjellimin e këtij misioni të heroit të romanit. Memua kudo është përhapës i zjarritë i fjalës së partisë dhe këtë ai e realizon me forma e mënyra të ndryshme, duke iu përshtatur sa më mirë ambientit, rrethanave e njerëzve, me të cilët ka të bëjë. Ai herë ndërhyt me veprimin e prerë revolucionar e me këtë i bën njerëzit e thjeshtë të shohin e të binden që vetëm komunistët janë ata që luftojnë për interesat e atdheut e të popullit, (kujtojmë episodin me gratë e Lajthizës) herë përdor debatin ku i armatosur me logjikën e hekurit të botëkuptimit revolucionar komunist triumfon mbi njerëzit, me të cilët hyn në këto debate, (kujtojmë diskutimet e Memos dhe bisedat e tij me fëmijët e doktorit e veçanërisht me vetë doktorin) apo herë i duhet t'i kombinon të dyja këto mjete për t'ia arritur qëllimit (kujtojmë aktivitetin e tij të dendur e të gjatë në batalion për të bindur si Rrapon, dhe shumë të tjerë që të kuptonin nevojën e një disipline e organizimi më të shëndoshë, më të ndërgjegjshëm).

Për mendimin tim Memua është një figurë e gjallë, me mish e me kocka, i besueshëm dhe mjaft real, që ka, siç e ka dhënë autori, një botë shpirtërore të vetën e të pasur, që ka edhe ndjenjat dhe dëshirat e tij e mbi të gj-

tha, që ka një dashuri e vendosmëri të pashembullt për idealet e partisë së tij. Autori rrëshqitazi flet për të kaluarën e Memos, për vitet e tij të liceut, për aktivitetin e tij revolucionar, këto thërmija të dhënash ne i marrim nëpërmjet gojës së plakut të Memos, apo nëpërmjet ndonjë episodi siç është njohja e tij me Spiron dhe kujtimet e Almës e të Andresë. Kjo ka ndodhur në roman, se autori na ka dhënë një kohë relativisht mjaft të shkurtër të ngjarjeve, kryesisht vjeshtë-dimrin e 1943-44 e si rrjedhim, ai më tepër është përqëndruar në fazën kulminante e të fundit të veprimtarisë së personazhit. Duhet ta kemi parasysh se partia dhe komunistët në këtë periudhë të shkurtër, por shumë të rëndësishme, kishin fituar mjaft përvojë, ishin kalitur nëpërmjet betejash me armiqtë e jashtëm e të brendshëm, e kishin demaskuar lojën e dyfishtë të «Ballit Kombëtar» dhe demagogjinë e okupatorëve, dhe sistematikisht i kishte ushqyer me literaturë marksiste kuadrot e saj. Prandaj është e kuptueshme dhe s'më duket aspak e nevojshme që autori t'i jepte vend në roman rrugës së rritjes dhe formimit të Memos. Kjo kërkesë më duket del jashtë kornizës së veprës dhe nuk mund t'i shtrohet autorit si një mungesë. (Po të flasim për këtë vepër, që kemi përpara e jo për një tjetër, që do të donim ne). Nga ana tjetër, Memua ka mjaft të spikatur, qoftë edhe shkurt jetën e tij, ndjenjat e tij, atë çka është intime te çdo njeri dhe kjo është dhënë bukur në marrëdhënjet e Memos me të vëllain, Rustemin, në dashurinë e ngrohtë për prindërit apo edhe në atë ndjenjë të ngrohtë e të ëmbël, që ushqen ai për Almën, atë ndjenjë që mbeti më tepër si një diçka flurore, e pakapshme, e pashprehur, por gjithmonë e pranishme për të dy të rinjtë. Këto mendoj se janë plotësisht të mjaftueshme e na bindin që te Memua nuk kemi të bëjmë më tepër me një *mishërim idesh e konceptesh se sa me një tip të nxjerrë nga jeta e gjallë e kohës*, por kemi të bëjmë me një figurë të realizuar komunisti. Natyrisht, në krijimin e heroit pozitiv nuk dua të them se me Memon, Dritëro Agolli ka arritur përsosmërinë, ne dhe ai vetë kemi gjithmonë

kërkesa në këtë drejtim, por unë kam mendimin se me Memon, Dritëro Agolli ka bërë një hap të ndijshëm përpara drejt largimit nga skematizmi në krijimin e heronjëve pozitive, që jo vetëm në ndonjë roman, por edhe në mjaft tregime, novela, drama e ndeshim si një të metë të rëndësishme, të cilën letërsia jonë po e shmang çdo ditë e më me sukses. Romani «Komisari Memo» në këtë drejtim është një hap i suksesshëm.

Revolta spontane dhe lufta për liri, që populli ynë ka bërë ndër shekuj kundër okupatorëve, ka lindur përherë heronj, që janë bërë shembuj të gjallë frymëzimi. Ky fenomen i pasuruar cilësisht me elementet e kohës, u vërejt edhe në Luftën tonë nacional-çlirimtare. Kjo e vërtetë e ka frymëzuar autorin në krijimin e Rrapo Tabanit, që në romanin «Komisari Memo» pa dyshim është figura më e realizuar. Rrapua është një figurë plotësisht shqiptare, me gjithë ndonjë ngjashmëri të lehtë e të largët që mund të vërejmë te ky personazh me ndonjë figurë të letërsisë së huaj, kjo s'e lëkund vlerën dhe origjinalitetin, me të cilin na është dhënë Rrapua, nga ana tjetër, mendoj se është plotësisht e justifikueshme që të ndihet ndonjëfarë afërsie ndër figura të tilla, për vetë faktin se është e kuptueshme për të gjithë që situata të ngjashme historike të lindin edhe tipa apo fenomene të ngjashme. Por pavarësisht nga kjo, e theksoj edhe një herë që Rrapua është deri në majën e thonjve shqiptar. Rrapua është tipi i luftëtarit popullor, që u ngrit i frymëzuar nga urrejtja për pushtuesin. Te këta lloj komandantësh është e natyrshme që do të ndjehen karakteristikat e një lufte krahinore, njëfarë kokëfortësie, njëfarë vetëbesimi i tepëruar, e mbi të gjitha, dëshira për të qenë të pavarur. Rrapua është individualizuar jo vetëm me bindjet dhe mentalitetin, që e karakterizon, por edhe nëpërmjet botës së tij shpirtërore, që e manifeston në çdo fjalë dhe veprim të tijin. Rrapua është jo vetëm trim, ai ka dhe një zemër të ngrohtë, të mbushur me dashuri për njerëzit. Tek ai s'gjejmë asnjë shenjë egërsie instinktive, por ai është i pamëshirshëm me armiqtë, me ata

që ja kanë nxirë jetën, që e kanë lënë të vetëm, që e kanë ndarë edhe nga i biri foshnje, të cilin është detyruar ta braktisë. Mëse një herë heroi konfesohej me shumë sinqeritet para nesh dhe na del me një shpirt të ngrohtë e një zemër të madhe e të dhembshur:... «unë s'kam ç'të mendoj për shtëpinë, po edhe unë mendoja. Një grua që kam pasur më vdiq. Eh, më la dhe një fëmijë rja gjashtë muajsh. E mbështolla fëmijën me pelena, e futa nën gunë dhe e shpura në stan të një miku im çoban» (f. 171) ose më tej: «Eh, more djem, ruajuni, bre, nga ata që fshihen në hendekë e në driza, mos e flini, bre, mendjen! Ja, unë s'flas dot më, se më vjen keq për Nurkën. . . » (f. 183) apo edhe më tej: «. . . Eh, ç'valle. Në tepsi mund ta hidhja vallen! Ikën vitet, iku mendjelehtësia e Rrapos. Rrapua heq një valle tjetër tani. Valle buzë xhadeve nën krismën e mitralozëve, valle në mes të korieve nëpër shira. Valle në stanet e Gur-Kusarit në mes të dëborës e të furtunës. . . Lëviz Rrapua në male, lëviz!»

Është meritë e romanit që kjo figurë na jepet në rritje, në zhvillim, pra në mënyrë dialektike. Prej momentit të parë, kur e ndeshim Rrapon në roman e deri në aktin e tij të fundit, pas vrasjes së Memos, ne njohim një Rrapo më tjetër, një Rrapo, që ka evoluuar në bindjet e tij.

Përballë kësaj bote heronjsh plot ideale e gatishmëri për çdo sakrificë, autori mjeshtërisht dhe me shumë funksion na ka vizatuar mëse një tip përfaqësues armiqsh. Këto figura të vizatuara me vërtetësi e japin bashkërisht portretin e plotë të tradhëtisë, por unë do të dëshiroja të ndalesha shkurt tek ajo më kryesorja dhe më e realizuara, te figura e Sali Protopapës. Saliu është tradhëtari pa skrupull, që është vënë në shërbim të pushtuesve, jo thjesht për të siguruar pozitë apo ndonjë përfitim, por se ai e ndjen rrezikun, që i kanoset klasës së tij. Dhe në këtë drejtim, si përfaqësues i klasës së tij feudale, ai është dhënë me plotshmëri. Duke e bërë atë armik të egër, autori ka bërë shumë mirë që s'ka rënë në karikataturizmin e figurës. Edhe në pije, edhe gjysmë i dehur, Saliu nuk

e harron urrejtjen, që ka në shpirt për komunistët dhe për Memon, por pikërisht në pije atij i shpërthejnë instiktet e tij prej kafshe: do të therë, të shohë gjak. Edhe skena kur Saliu u flet fshatarëve të Lajthizës e sidomos kur ai si papagall thotë fjalët e oficerit gjerman, është kuptimplote, se hedh dritë mbi funksionin e vërtetë e rolin, që luanin atëhere këto klasa të shoqërisë shqiptare, të cilat qenë shndërruar në vegla të vërteta e besnike të të huajve. Saliu është armik, por është trim, kjo cilësi e tij, që del në vepër e që na thuhet edhe me gojën e Rrapos, ka ndihmuar për të dhënë me vërtetësi atë fakt, që lufta jonë ka qenë e ashpër, se është zhvilluar jo vetëm me një armik të huaj, të egër e të fortë, por edhe me armiq të brendshëm, tradhëtarë, përfaqësues të klasave të pasura, që nuk u tallën, nuk hynë me mendjelehtësi në vallen e luftës së madhe, por që u munduan me të gjitha mjetet e forcat e tyre ta mbytnin revolucionin tonë, qëllim që s'e arritën, se lufta jonë qe më e fortë për vetë idealet, që i frymëzonin luftëtarët tanë, dhe për vetë faktin që me të u bashkua krejt populli apo më sakt, masa e vegjëlisë së fshatit e të qytetit. Fundi i Saliut, vdekja e tij plot egërsi si ajo e tigrin, kur ngordh, thekson edhe një herë mendimin se sa me vështirësi heqin dorë sundimtarët nga jeta e tyre, nga privilegjet e tyre.

Romani ka një karakter thellësisht popullor, kjo veçori e tij, e cila e përshkon fund e majë veprën, ndihet në shumë komponentë të saj. Që në mënyrën e të konceptuarit, në mënyrën se si autori e sheh dhe na e paraqit realitetin, jetën, ngjarjet e kohës dhe njerëzit e kohës. Ky karakter popullor ndihet edhe në faktin që autori nisat nga pozitat më të përparuara për ta vështruar e për të na e paraqitur realitetin. Botëkuptimi i shëndoshë i autorit, këndi i vështrimit dhe pozitat revolucionare nga nisat ai për ta shpjeguar dhe zbërthyer atë fragment jete, që ka futur në vepër, dëshmojnë për qëndrimin thellësisht popullor e marksist të autorit. Në vështrimin që i hedh jetës dhe ndodhive, veprimeve të heronjve e luftës së tyre, kudo, prozatori ynë nisat nga pozitat e popullit

të tij, i mbron ato me tendenciozitet dhe realisht e me forcë dënon çdo fenomen social negativ, që bie ndesh me interesat e masës dhe dënon, përbuz e tall forcat kundërshtare, ato që i janë kundërvënë interesave të masës, ato që përpiqen të mbrojnë interesat e ngushta egoiste të pakicës, që sundonte mbi shtresën e gjerë të popullsisë së fshatit apo të qytetit. Edhe një varg elementesh të tjera, që përcaktojnë karakterin popullor të veprës, i ndeshim te romani «Komisari Memo»: Kështu proza që gjejmë në të, është një prozë thellësisht popullore, e pasur me një mori shprehjesh të gojës së popullit, të cilat ndihmojnë mjaft në tingullin shumë popullor të veprës. Në të kemi një mori skenash, që pasqyrojnë drejtpërdrejt jetën e popullit, hallet, brengat, gëzimet dhe fitoret e tij. Sado që në vepër hasim edhe tablo apo kapituj ku na është përshkruar jeta e inteligjencës, e borgjezisë apo tradhëtarëve, prapë në të zotëron, në masën më të madhe, dhe zë vendin kryesor pikërisht pasqyrimi apo paraqitja e jetës dhe e luftës së popullit. Ky karakter popullor ndihet edhe në gjuhën, mënyrën e të folurit shumë popullore të disa prej personazheve apo bile edhe në vetë frymën popullore, me të cilën autori shkathtësisht ka plazmuar disa prej heronjve kryesorë të veprës.

Konflikti bazë, konflikti kryesor, që mbart romani gjatë gjithë shtjellimit të subjektit të tij, është konflikti i madh i kohës, antagonizmi i thellë midis popullit të prirë nga Partia që lufton për çlirimin e vet nacional e social nga njëra anë, dhe forcave armike, pushtuesve të huaj dhe tradhëtarëve të vendit, që janë venë në shërbim të pushtuesit nga ana tjetër. Ndonëse në shtjellimin e romanit kemi edhe konflikte të vogla më të dorës së dytë, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e komisarit qoftë në jetën e tij ilegale apo në atë në mal, këto asnjëherë nuk mbizotërojnë, nuk e errësojnë për asnjë çast konfliktin themelor. Kjo mënyrë e të vështruarit të realitetit përbën një vlerë pozitive të veprës, se e bën atë pasqyrë realiste të kohës të vështruar me qartësi ideore nga ana e autorit. Ky konflikt na është dhënë nëpërmjet një subjekti

shumë të thjeshtë, krejt romani me dy fjalë është rruga e veprimtarisë së një komisari, i cili, nga çasti kur merr urdhërin për të shkuar si komisar në batalionin «Shkrepëtima» e derisa mbërrin në batalion, kalon disa ndodhi dhe, pak kohë pasi vete në krye të detyrës, bie nga plumbat e tradhëtisë.

Ky subjekt është shtjelluar nëpërmjet një kompozicioni interesant, ku zotërojnë retrospektivat e njëpasnjëshme, që plotësojnë kuadrin e romanit. Kjo mënyrë kompozicioni, ku shtatë nga shokët më të afërt të komisarit në çastin kur janë duke shpënë bustin e tij për të vendosur në fshatin e tij, kujtojnë ç'i lidhte me komisarin e si e njohën ata komisarin, i ka dhënë dorë autorit që të zhvillojë krejt subjektin në një mënyrë të këndshme e të lehtë për lexuesin. Mendoj se ai ka bërë mirë që s'është shtyrë tej këtij caku, se përndryshe, nëse do të lakmonte të na fliste për kohë më parë ngjarjeve që ndodhin në roman, do të qe detyruar të bënte digresione pas digresionesh, gjë që do të përbënte një shkak për lodhje e humbje interesi të lexuesit për atë që është kryesore në vepër. Në thurjen të romanit kam përshtypjen se autorit i ka munguar dhe s'ka mundur të gjejë mënyrën më të përshtatshme për t'i harmonizuar dy pjesët e mëdha të tij, të cilat përveç së njëjtës figurë, Memos, ashtu edhe në të dytën, kanë shumë pak pika takimi ndërmjet tyre. Këto dy pjesë për problemet e ndryshme që ngrejnë fare mirë mund të egzistonin edhe më vete. Pra do të qe më me vlerë që unifikimi i tyre apo një shkrirje më e plotë e tyre në shërbim të idesë të bëhej më mirë.

Dritëro Agolli, ashtu si në poezinë e tij, edhe në këtë roman të parë ka ruajtur po ato tipare stili, që janë karakteristike për të. Proza e tij ka një frazë të punuar, të figurshme, shumë të ngrohtë dhe shumë të komunikueshme. Autori jeton me atë që tregon dhe jo vetëm kaq, por ai na e jep me aq forcë e ngarkesë emocionale mendimin e tij, sa që na bën edhe ne të jetojmë deri në dridhjet

më të holla, gjendjen shpirtërore të heronjve të tij, të shikojmë episodet, që përshkruhen në vepër. Fraza e romanit është jo vetëm e punuar dhe me shumë kolorit popullor, por ajo shpesh të jep imazhe të fuqishme përgjithësuese. Kështu, batalioni mëse një herë është konceptuar figurativisht në vepër si një qenje e gjallë, që reagon bashkërisht në një mënyrë të vetme. . . *Dhe përsëri goja e madhe e batalionit qeshi.* . . thuhet diku (f. 236). Kjo jo vetëm për të na dhënë unitetin monolit të partizanëve të batalionit, por edhe për ta perceptuar atë si një organizëm të gjallë e të fuqishëm, të pamposhtur.

Pa dashur të bëj një zbërthim të plotë të vlerave artistike të veprës, do të theksoj goftë dhe shumë shkurt se romani ka mëse një përshkrim të bukur, të ndjerë dhe origjinal të natyrës. Citojmë vetëm ndonjërin prej tyre për të njohur këtë anë të mjeshtërisë artistike të autorit: «Në këmbët e Gur-Kusarit ra mëngjezi. Shkëmbinjtë ende flinin të mbuluar me çarçafin e madh të bardhë. Furtuna kishte pushuar, por pluhuri i bardhë i dëborës, i ngritur prej saj, vazhdonte mbi Gur-Kusar ngadalë-ngadalë. Në istikamet e bardha heshtte batalioni «Shkrepëtima» (f. 272).

Po kështu të bën përshtypje në vepër aftësia e autorit që me shumë kursim, nëpërmjet detajesh të pakëta, por shumë të gjetura, ai ka aftësinë të portretizojë tipa, që mbeten të individualizuar në kujtesën tonë:

«Mak Mokra, i zbetë, me flokë të zez, të drejtë e të shtruar për koke, shikonte herë Rrapon, herë Memon. Ai rrinte drejt në sofër dhe për një kohë të gjatë nuk lëvizti as kokën, as duart. Rrinte e shikonte i menduar. Xhodo Greni, tek rrinte në sofër, dukej sikur qëndronte në këmbë, ngaqë ishte i gjatë. Dy dhëmbët e parë i kishin rënë dhe, kur hapte gojën, zbrazësia e tyre nxinte. Në sofër dukej si i zemëruar me të gjithë. Vetullat i mbante gjithnjë të rrudhura. Vetëm Fatja buzëqeshte e fërkonte gishtin për sofër.» (f. 191).

Për mendimin tim, romani në shpalosjen e subjektit të vet, vjen duke u ngritur nga kapitulli në kapitull dhe

përveç disa kulmeve, që arrihen disa herë në të, ai arrin një kulm të fuqishëm, emocional e të dhënë me forcë artistike në momentin e vdekjes së Memos e sidomos kur na përshkruan tronditjen e batalionit e veçanërisht të Rrapos për humbjen e komisarit.

Duke përfunduar, nënvizoj se edhe nga sa u mundova të theksoja në këtë analizë, që i bëra veprës, edhe nga sa thotë vetë romani, «Komisari Memo» është pa dyshim një vepër shumë e sukseshme e autorit, që dëshmon për talentin e tij në fushën e prozës së gjatë, ashtu sikurse në poezinë e tij.

1970

VENDI I SË RESË DHE I SË VJETRËS NË NJË ROMAN

Paraqitja në një vepër letrare e jetës së malësorëve tanë sot, njohja, nëpërmjet emocioneve, që na shkaktojnë veprat e shkruara me dinjitet artistik, me realitetin tonë që po transformohet me ritme të shpejta, është gjithmonë një sukses i shënuar jo vetëm i autorit, por edhe i letërsisë sonë në tërësi. Malësia jonë ka dhjetëra vjet që ka hyrë në rrugën e re, qëkur tabloja e mjerimit u gris nga pushka partizane, që partia ua dha në dorë edhe malësorëve kreshnikë, sikurse mbarë popullit tonë.

Njerëzit e bjeshkëve tona tani i preokupojnë të tjera dëshira dhe nevoja; se si të ecin edhe ata me hapin e gjithë vendit, se si të shkulin nga vatra dhe mendja të vjetrën, të shëmtuarën, që u la si trashëgim të hidhur e kaluara.

Pikërisht në këtë plan, për të na përshkruar këtë pjesë të jetës shqiptare, synon romani «Vlaga e dheut» i prozatorit Filip Ndocaj. Romani me realizëm dhe ndjenjë arrin të na krijojë imazhe të bukura të jetës e zakoneve malësore apo tipa të gjallë e përgjithësues, që në një masë të mirë janë bindës për lexuesin. Nga ana tjetër, duke qenë se gjithë subjekti i romanit vërtitet rreth një familjeje të madhe patriarkale, tipike malësore, është me

interes dhe e realizuar lëvizja e çdo linje, që ndjek në subjekt secili personazh. Sigurisht e kemi fjalën për personazhet më kryesore, që përfaqësojnë komponentët më të rëndësishëm të veprës. Nëpërmjet kësaj mënyre të procedimit të vet, romani ka mundur të na krijojë, me episodet e tij të shumta, aspekte interesante jete ku përplasen e reja me të vjetrën, progresivja me regresiven dhe kështu të trajtojë probleme kyçe të jetës sonë, probleme preokupante për të gjithë letërsinë tonë të sotme.

Ndonëse në qendër të subjektit është fati dhe rruga e pjesëtarëve të një familjeje të madhe malësore, të familjes së Nik-Buqajve, romani del nga kjo kornizë e ngushtë dhe rreh që të na përgjithësojë atë rrugë të transformimeve të mëdha, që po kalon fshati ynë malor për t'u futur në jetën socialiste, nëpërmjet kooperimit; si dhe luftën e gjatë dhe të vështirë të ndryshimit të botëkuptimit apo mentalitetit të njerëzve tanë, që, duke u ushqyer nga ideologjia e Partisë sonë, po hedhin hapa të sigurt drejt socializmit.

Njohja relativisht e gjerë e realitetit dhe veçanërisht e atij realiteti, që filloi të dekompozohet qysh me triumfin e revolucionit tonë popullor, i ka vënë në dorë autorit një material të bollshëm jetësor, që i ka shërbyer, përpos të tjerave, edhe për të skalitur tipa të gjallë dhe me forcë përgjithësuese, që mbeten të gdhendur. Por nuk mund të themi po të njëjtën gjë për realitetin e ri, apo forcat e reja shoqërore, që mbartin të renë në fshat, pra që i kundërvihen regresit dhe së vjetrës në dekompozim. Në këtë aspekt të dytë ndihet mjaft mungesa e zhbirimit të plotë të jetës, gjë që ka sjellë një farë anemie, pasigurie, në krijimin e forcave të së resë që, siç ndodh në të vërtetë, jo vetëm janë të denja t'i kundërvihen regresit, por janë shumë më superiore përderisa po triumfojnë.

Pa u larguar nga ky problem, pra se sa besnikërisht dhe me vërtetësi na e ka dhënë autori realitetin, do të shtojmë se njohja jo vetëm e njerëzve dhe e marrëdhënjeve të tyre, por edhe e ambienteve, i ka shërbyer për të evidencuar idenë, për të na e dhënë atë në mënyrë bindëse. Kështu Lulash Preka, mishërimi i malësorit, që

mbart tipare dhe vetija të njeriut të popullit bashkë me botëkuptimin e vet thellësisht patriarkal, është gjithmonë i vërtetë edhe për faktin që autori e mban atë po në të njëjtin ambient (është fjala këtu për zakonet, për frymën thellësisht patriarkale apo edhe për prapambetjen e madhe megjithëse kanë kaluar njëzet e ca vjet pas çlirimit). Në një fshat tjetër, ku e reja do të kishte hyrë më me vrull dhe më thellë, një Lulash apo një butëkuptim si i Lulashit nuk do të mund të na jepej aq në gjithanshmëri sa na është dhënë, dhe kjo është një meritë jo e vogël e veprës.

Autori në roman ndjek fatin e heronjve dhe e shtrin subjektin nëpërmjet një morie episodesh, që shtjellohen duke thelluar konfliktin themelor të veprës, konfliktin midis së vjetrës dhe së resë. Cilësi e romanit është se ky konflikt është vështruar së pari dhe kryesisht në plan ideologjik. Kjo prirje e romanit, për t'u zhvilluar në këtë plan, sigurisht e bën më të vështirë edhe më delikate detyrën e autorit, i cili, si shkrimtar i yni, duhet të mbrojë me tendenciozitet pozitativ tona ideore, që janë pozitativ e së resë, e asaj së reje, që edhe pse në ndonjë moment të caktuar mund të duket si e dobët, e pafuqishme, prapë ka perspektivën me vete, është si ato piketat e një veprë të madhe, të cilat, sado që sot i rrethojnë ferrat e drizat dhe trungjet, nesër mbi to do të ngrihet madhështore godina, shenjën e parë të së cilës dhanë pikërisht ato piketa të brishta.

Konkretisht në romanin «Vlaga e dheut» autori është nisur për të mbrojtur të renë duke na dhënë së pari degradimin gradual të frymës patriarkale, të cilin e gërshton me fuqizimin gradual të koncepteve tona përparimtare. Na duket se ky vështrim i dialektikës së jetës, pra kjo mënyrë e paraqitjes së evoluimit dialektik të realitetit nuk është ajo më e drejta, që do ta përfaqësonte ashtu si duhet qëndrimin tendencioz të autorit, sepse dashur padashur e vë në pozita inferiore forcën e së resë, e cila nuk sulmon e para që të shpartallojë të vjetrën, por së pari e pengon atë dhe pastaj i rrëmben asaj pozitativ do-

minuese. A ndodh po kështu edhe në realitet? Ne mendojmë se jo.

Triumfi i revolucionit tonë popullor e shpartalloi që këtu e një çerek shekulli më parë pozitën dominuese të patriarkalizmit dhe regresit, duke krijuar terren plotësisht të favorshëm për ecjen e shoqërisë sonë përpara; po të kemi këtë parasysh, sado e fuqishme të duket në momente të caktuara e vjetra, asnjëherë s'ka pse të kemi iluzione se ajo në plan global mund të triumfojë, prandaj do të na dukej më e drejtë që dialektika e zhvillimit të realitetit, që është pasqyruar në roman, të vendosej pikërisht në këtë kuptim: duke u nisur nga pasqyrimi i së resë, sado e pafuqishme dhe e dobët që të jetë ajo, të ndihej ecja dhe rritja e saj, që pa dyshim do të gërshetohej me tentativat e dëshpëruara e të pasuksesshme të së vjetrës për të penguar. Kështu nuk do të ndodhte që në këtë pjesë të parë të romanit të zotëronte kryesisht Lulash Preka me mentalitetin e tij të mykur, që edhe pse deri diku në mënyrë të pavetëdijshme ai e mbart, por do t'i jepej më tepër vend Pjetër Ukës, të nipit, që me gjithë të metat, mungesat dhe dobësitë, është përfaqësuesi i së resë, që ka të ardhmen, e cila do të vijë duke u fuqizuar, siç fuqizohet në fakt në roman me Çun Ukën, stërnipin e Lulashit, apo me Tuçin, Lekën, Lulën etj.

Kjo pikënisje e autorit në roman ka sjellë herë-herë një farë paqartësie në qëndrimin e tij sidomos ndaj personazheve. Autorin e ka rrëmbyer figura e Lulash Prekës dhe i ka falur atij edhe ndonjë «mëkatë», këtë e vërejmë sidomos në raport me Pjetër Ukën, apo edhe në raste të tjera kur e vështron me objektivizëm plakun pa shprehur qëndrimin e tij ideo-emocional, qoftë nëpërmjet fjalës së tij, po edhe me ndonjë replikë të personazheve. Kështu në një diskutim me Pjetër Ukën, Lulashi thotë: «Po, more, se, s'a mahi (s'është shaka) me Partinë tonë, se çka e tha, edhe e bani! Por, besa, këtu te ne, s'ka çka ban as Partia, as perëndia. Jemi të patokë, Pjetëro, kemi le me hjek keq për një bark bukë. Ai që ka hall bukën, s'ka qysh të mendojë për ato të tjerat, që thue ti me ato sho-

ket e tu!» Më poshtë autori, duke treguar se edhe të tjerë fshatarë kanë po këtë mentalitet të mykur, që ua dikton prapambetja e thellë e fshatit të tyre, madje dhe atyre që kanë shëtitur nëpër atdhe dhe kanë parë me sytë e veta sukseset tona të mëdha, shkruan: «... Edhe ata kanë nisë të mendojnë si të parët e tyne dikur: se një kob i zi, një si namë shekullore rondon mbi ato katunde, se aty ka plasë toka e i ka qitë jashtë, veç për të heqë zi për kafshatën e gojës...» Dhe gjithë këtyre mendimeve të zymta nuk u kundërvihet ndonjë mendim i shëndoshë e pozitiv. Ndërsa Pjetër Uka, një nga personazhet e trajtuara më me vërtetësi e guxim, një sukses i dukshëm në roman, i cili për fat të keq lihet në plan të dytë e nuk zhvillohet sa duhet, bir dëshmori dhe një ndër partizanët e parë të fshatit, kryetar i këshillit të fshatit fill pas çlirimit, njeri i lidhur me mish e me shpirt me Partinë, me sytë e Lulashit është vështruar si një shpijak i pazoti, që humb kohën nëpër mbledhje, që s'i kupton drejt mendimet e drejta të plakut, që s'e vlerëson punën e bujqësisë në malësi, që është përherë i kredhur në mendime e telashe, apo që s'është i aftë të organizojë njerëzit për të hapur toka të reja, siç bëjnë Çuni dhe Leka. Një paraqitje e tillë e Pjetrit, që si filiz i parë i së resë në fshat ishte në pararojë të punëve për mbrojtjen nga armiqtë e hapur e të fshehtë e për transformimet revolucionare në fshat, edhe pse në ndonjë çast ky hero mund të ketë humbur perspektivën e të mos jetë më në krye të punëve, nuk tingëllon fort e drejtë. Dhe kjo na duket se bëhet vetëm e vetëm për t'i lënë prioritetin Çunit, që në fakt është një vazhdues i asaj së reje, që nisi Pjetri me shokë dhe jo nisjator i saj.

Thurja e romanit procedon drejt, autori shtjellon fabulën nëpër një linjë të shtrirë, pa ndërlikime të tepërta e të panevojshme, që do të bënin të vështirë të kuptuarit e saj. Njëpërmjet trugut kryesor të familjes së Nik-Buqajve, njëpërmjet kontradiktës të patriarkales me të renë, skaliten heronjtë e romanit, gërshetohen linjat e tjera të tij, lindin e zhvillohen personazhet e reja etj. Në përgji-

thësi kapitujt e romanit janë funksionalë dhe luajnë rol në raport me idenë e tij themelore, por ka dhe ndonjë si kapitulli «Lufta ma e vështirë, beteja vendimtare», që zgjerohet pak si tepër dhe pa nevojë, sepse s'i shërben problemeve themelore të veprës, përkundrazi na duket se është një ndalesë e panevojshme, që e vag interesin e lexuesit. Në këtë kapitull përshkruhet gjerë e gjatë se si Tuçi shpëton nga vdekja Gjelën, vajzën e Markolajve. Kapituj të tillë ose pjesë të tilla mund të hiqeshin pa e dëmtuar veprën. Duke folur gjithmonë për vlerat artistike të romanit, shënojmë se në tërësi ai nuk qëndron në të njëjtin nivel. Ndërsa në pjesën e parë na jepet e realizuar dhe me vlera të mira njohëse jeta e malësive tona të thella, në pjesën e dytë, ndofta për nxitim të autorit, apo për mosnjohje të saktë të forcave të reja në fshatin tonë malor, i është kaluar përciptas fabulës, nuk është thelluar ajo dhe, vende-vende romani ka marrë një karakter reportazhi, sidomos kapitulli «Andërrime njerëzish» e veçanërisht pjesa, që përshkruan kthimin e Çunit e të Lekës nga ushtria. Romani është shkruar me një gjuhë të pasur, vetëm se mania për t'u dhënë pas formave shumë dialektale dhe hipergegnizmave, sikur e ka rënduar ca. Individualizimi gjuhësor nuk është mjeti kryesor dhe ca më pak mjeti i vetëm për të rilevuar personazhet, që ne i dallojmë nga mendimet dhe veprimet e tyre, nga botëkuptimi i tyre. Tepërimet gjuhësore në të dyja dialektet tona sjellin me vete edhe rrezikun që vepra të bëhet e vështirë dhe e pakuptueshme për lexuesin e gjerë.

Duke mos u ndalur hollësisht në meritat dhe vlerat edukative dhe njohëse të romanit, ne folëm më gjatë për disa anë jo fort të realizuara të tij, me qëllim që t'i vijmë në ndihmë autorit për t'i shmangur të meta të kësaj natyre në veprat e tjera të tij.

SI LINDI PËR POPULLIN TONË NJË AGIM I RI

Vitet që erdhën pas dështimit të revolucionit demokratiko-borgjez të 1924-ës rikthyen në Shqipëri format e urryera të feudalizmit oriental, të cilat me fitoren e parvarësisë, jo vetëm që s'u çrrënjosën, por as që u lëkundën. Sundimi zogollian u përpoq dhe arriti që me forcën e egër të kërbaçit të ruante po atë fizionomi shoqërore duke zhdukur dhe ndjekur të gjitha tentativat e një fryme përparimtare. Feudalët, pronarë tokash, vijuan si në kohën e osmanëve të shfrytëzonin deri në palcë fshatarësinë e varfër gjysmë bujkrore pa u interesuar bile as për futjen e metodave kapitaliste moderne në shfrytëzimin e çifliqeve, por duke u mbështetur në bujqësinë e prapambetur dhe në shfrytëzimin e egër të krahut të punës. Pasive dhe pa inisiativë u tregua edhe borgjezia shqiptare, e cila në ato rrethana të pafavorshme, që u krijuan me ardhjen e Zogut, mbeti si klasë me një fuqi të vogël ekonomike dhe pothuaj fare pa fuqi politike. Kështu borgjezia që krejt e paaftë për të ndërmarrë veprime, që do ta ndërtonin gjendjen, ndonëse edhe ajo që e pakënaqur me situatën e krijuar. Sa për klasën punëtore, ajo, jo vetëm në vitet e para të sundimit, por edhe më pas mbeti një klasë punëtore e vogël më tepër e përbërë prej zanat-

cinjsh të vegjël e çirakësh dhe shumë pak prej punëtorësh me mëditje, që punonin nëpër punishte ushqimore apo ofiçina të vogla. Por edhe pse e tillë, kjo klasë u bë mbështetja më e parë e ideve përparimtare që filluan të kultivoheshin nën ndikimin e ndryshimeve të mëdha, që solli në historinë botërore Revolucionin Socialist i Teorit dhe teoria e socializmit shkencor të Marksit. Nuk duhet harruar se në këtë drejtim, në përfaqimin dhe përhapjen e ideve të reja revolucionare, lojti rol edhe rinia shkollore dhe inteligjenca përparimtare, që i kishte më të mëdha mundësitë për të rënë në kontakt me idetë përparimtare revolucionare dhe që i përhapin ato në shtresat e ndryshme të popullit, kryesisht në klasën punëtore, e cila nisi të organizohej në shoqëritë e punës dhe në masën e vegjëlisë së qyteteve. Kjo gjendje e forcave lëvizëse të shoqërisë sonë të asaj kohe, ndonëse e mbarsur me urrejtjen kundër sundimtarëve dhe sistemit, që akoma latente për të vetmen arsye, se mungonte një dorë organizuese drejtuese, që do ta kanalizonte dhe do ta shpërthente këtë forcë drejt një përmbysjeje të madhe shoqërore.

Karakterizimin më të saktë të gjendjes së Shqipërisë të asaj kohe na e ka dhënë shoku Enver kur thotë:

«Mbi kurrizin e popullit shqiptar imperialistët vendosën regjimin gjakatar të Zogut, regjim satrap, regjim i «portës së hapur» dhe i kapitullimit pa kushte përpara ndërhyrjes së huaj imperialiste».

(Enver Hoxha: Raport i mbajtur në Kongresin I të Partisë Komuniste të Shqipërisë).

Në ndryshim me këto tendenca dhe forca progresive, feudoborgjezia shqiptare e sidomos krahu i saj më i pakënaqur, ai që e shprehte më hapur këtë pakënaqësi ndaj sundimit të kohës, endej qorrazi nëpër pikëpamjet e ndryshme filozofike reaksionare dhe ëndërronte regjimet borgjeze perëndimore, demokracitë e tipit evropian vetëm pse donte t'i siguronte vetes mundësi dhe kushte më nor-

male zhvillimi; apo sepse donte të përmbyste supremacinë e feudalëve për të marrë në duart e saj frenat e qeverisjes e të sundimit.

Në këtë gjendje kaotike e gjeti mendimin shqiptar dhe në të tillë mjerim e varfëri e gjeti popullin shqiptar pushtimi fashist i 7 prillit 1939. Bashkë me hordhitë e zeza fashiste, në Shqipëri u kthyen edhe shumë «patriotë» antizogistë, që kishin marrë rrugët e kurbetit apo emigracionit politik «të pakënaqur» nga ardhja e Ahmet Zogut në fuqi, meqë s'ishin të tarafit të tij dhe që me demagogji shiteshin si patriotë të kulluar. Vitet më vonë ua çorrën maskën këtyre pseudopatriotëve, të cilët në forma të ndryshme erdhën dhe u lidhën pas qerres së fashizmit dhe më vonë të nazizmit.

Pushtimi i Shqipërisë i dha hov të madh vrullit të luftës për liri të popullit. Urrejtja klasore që ishte shprehur e mprehtë që në vitet e fundit të regjimit zogist, nëpërmjet demonstratave, grevave dhe përleshjeve në qytete e fshatra, erdhi dalëngadalë duke u fuqizuar gjithmonë e më shumë si një lëvizje, që po merrte një ngjyrë politike çlirimtare antifashiste, pra jo më si një lëvizje spontane ekonomike. Në këtë fazë të re të luftës popullore, ngjarja më e shënuar që lindja e dorës drejtuese të luftës së popullit, lindja e Partisë Komuniste Shqiptare, që u bë inisiatore dhe drejtuese e fuqishme, e cila gjatë viteve të luftës u përlesh në dy fronte: kundër pushtuesve të huaj dhe kundër organizatave tradhëtare si «Balli Kombëtar», «Legaliteti» e të tjera. Të gjitha këto rryma apo organizata pseudopatriotike qenë pjellë e klasave të pasura, që i lindën për të ruajtur sundimin e vet, qëllim ky që ato e maskonin prapa frazave gjoja patriotike. Është kuptimplotë dhe domethënëse, që vërteton atë që thamë më sipër, fakti se këto organizata «nacionaliste», legjitimiste etj. u krijuan vetëm pas formimit të PKSH, bile kur lufta e saj po përfshinte në gjirin e vet masën e gjerë të popullit, dhe së dyti, kur pushtuesve po u shkisnin këmbët dhe po shporreshin nga trualli ynë (është fjala për kapitullimin e Italisë fashiste).

Ky qe shkurtimisht sfondi historik, në të cilin e ka vendosur subjektin e romanit «Para agimit» autori i tij Shevqet Musaraj.

Te kjo vepër ne gjejmë të arritur me sukses pasqyrimin me një kënd vështrimi të gjerë të heroizmit popullor, që bëri të mundur fitoren e plotë mbi armiqët e jashtëm dhe të brendshëm. «Para agimit» ka meritën e madhe se më mirë se në disa vepra të tjera, na ka dhënë luftën e popullit tonë. Autori nëpërmjet të përfaqësuesve, karaktereve letrare që ka krijuar në vepër, ka ditur mirë të na japë duke na i vizatuar në mënyrë ngulitëse ato forca, që e bënë luftën e popullit tonë.

Por krahas këtij procesi, ai ka arritur të zbërthejë edhe shumë anë të tjera të paraqitjes së forcës së revolucionit tonë popullor dhe sidomos të rolit edukues dhe mobilizues në masën e gjerë të popullit, që kreu ky revolucion, rol sigurisht jo spontan, por që u realizua nëpërmjet dorës udhëheqëse të Partisë. Pikërisht realizimi i kësaj detyre, ushtrimi i këtij funksioni, bëri të mundur që masat e gjera të vegjëlisë së qytetit dhe të fshatit të përqaфонin idetë e Partisë dhe të bashkoheshin në radhët e ngjeshura të revolucionit. Kështu ne shohim qartë në roman rymat e lëvizjes shoqërore, që, duke u bërë gjithmonë e më të fuqishme, më shungulluese, u derdhën me urrejtje në luftën popullore. Nga ana tjetër, autori ka hedhur dritë edhe mbi funksionin e dytë të madh të luftës sonë, që u shpreh në diferencimin, që realizoi ajo në shtresat shoqërore të popullit tonë. Lufta nacionalçlirimtare flaku tej masën pseudopatriotike të të ashtuquajturve «baballarë të kombit», që fshiheshin pas parullave nacionaliste dhe mundoheshin të bënin për vete popullin, të cilit aty për aty ja kishin nevojën, për ta tradhëtuar më vonë, kur të merrnin frenat e qeverisjes së vendit në duar. Për këtë qëllim autori i ka dhënë një vend jo të vogël në roman paraqitjes së përfaqësuesve të «Ballit Kombëtar», «Legalitetit», në një masë më të vogël gati po-

thuaje të pamjaftueshme, dhe degëzimeve të mëvonshme të tyre: social-demokratëve etj. Është interesant të vihet re se në roman në mënyrë të vetvetishme është dhënë ajo e vërtetë e madhe që lufta jonë thëthiti e bëri për vete njerëz nga më të ndryshmit: të rinjtë dhe prindërit e tyre, fëmijët, burrat, gratë, pra që nga më të moshuarit dhe deri te të miturit; që nga babë Llani dhe deri te Tafili i vogël. Kujtojmë për t'u bindur për këtë të vërtetë të veprës një sërë personazhesh që hyjnë në mënyrë të ndërgjegjshme, ndonëse me rrugë të ndryshme, në vorbullën e revolucionit. Të tillë janë: nëna e Kopanit, plaka Sadete, që ia dha djalin e vetëm lirisë së atdheut, por që edhe pas kësaj e mbajti shtëpinë e saj çerdhe të punës ilegale; Shit Mézyrin, që, kur u bind se i biri partizan ishte në rrugë të drejtë, u bashkua me idealet e tij aq ngusht, saqë diti t'i rezistonte edhe kamxhikut të gestapos apo torturave të kampit të Prishtinës ku dha jetën me këto fjalë në gojë: «*Dojshe me jetue edhe pak që t'i shifshe me sytë e mi këta të mallëkuem se si do t'i paguejnë mëkatet. Por s'qenka thanë. Vec vdes i bindun se ka me i pa çuni em, ka me i pa rinia, ka me i pa Shqipnia...*» apo babë Sula, që nga gjithë pasuria e vet i la Rexhës si kujtim kutinë e duhanit prej fakfoni ku mbi minaretë e xhamisë së Aja Sofisë së Stambollit, që zbukuronin kapakun e saj, plaku pat gërvishur një yll me pesë cepa. Risten e Evgjenisë, që nga një njeri i drojtur e i frikshëm, arriti të ketë aq guxim sa edhe ai vetë të kryejë punë ilegale, apo Shejen, që, duke shërbyer pa rënë në sy të major Jahjas, është bërë një informatore e guximshme për Partinë. Po kështu me dhjetëra figura fshatarësh deri te axhë Jazi, që arrin të kryejë detyra të rëndësishme partie, babë Llani, që s'e ka për pesë t'i thotë Xhemal Petrelës, agait të fshatit: «*Ajo qeveria që më tregoi zotnia jote, i takon tjetër kujt, jo atij Ballit tat, që u ba qepaze*». Këto ja thotë atij agai, i cili pas ndodhisë së shëmtuar të Mukjes, sikurse shumë krerë të «Ballit» ka iluzionin se edhe «Balli» mund të futë diçka në dorë në qeverisjen e vendit.

Lidhur ngushtë me këtë vlerë ideore të rëndësishme, që nënvizuar më sipër, romani ka edhe meritën e madhe se autori më me sukses se në shumë vepra të tjera, që trajtojnë për afërsisht në të njëjtën formë këtë temë, ka ditur të vërë në pah të vërtetën e madhe të kohës: rolin vendimtar që luajti Partia Komuniste Shqiptare në triumfin e revolucionit tonë popullor. Në roman, paraqitja e rolit të partisë është dhënë në mënyrë fare të natyrshme, pa ndërhyrjet deklarative të autorit, pa fraza pompoze dhe të fryra. Përkundrazi, në çdo episod të romanit, që ka të bëjë me punën dhe luftën e heronjve ilegalë, ndihet prania e dorës drejtuese të partisë. Është ajo që mbjell në zemrat e njerëzve urrejtjen për armikun që i hap sytë popullit për të parë se kush është fajtori, që duhet sulmuar e shembur i pari për të shpëtuar gjithmonë nga vuajtjet dhe shtypja. Është dora e partisë që u çjerr maskën shpifjeve dhe demagogjisë së tradhëtarëve.

«Ishte Partia ajo që ngriti në këmbë popullin në Luftën nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë e tradhëtarëve, që e udhëhoqi atë në fitoren vendimtare, që bëri të mundur të përmbyseshin klasat shfrytëzuese reaksionare dhe të vendosej në Shqipëri pushteti popullor», thotë shoku Enver në fjalimin e mbajtur me rastin e 25 vjetorit të çlirimit të atdheut dhe fitores së revolucionit popullor. (Enver Hoxha «25 vjet luftë e fitore në rrugën e socializmit» f. 71).

Korniza historike e ngjarjeve që jepen në romanin «Para agimit» përfshin vitet prej 1937-1944 dhe sidomos romani është i përqëndruar në vitet 1941-1944. Pra autori kryesisht ka për qëllim të paraqitë vitet e luftës. Kjo e justifikon faktin që Shevqet Musaraj nuk ka përkthuar se si evoluoi mendimi komunist në Shqipëri, si lindën dhe u përhapën idetë komuniste nëpër grupet e para deri në mbledhjen historike të formimit të Partisë. Të gjitha këto do t'i përkisnin një romani tjetër dhe jo këtij që kemi ne në dorë. Kurse ngjarjen e madhe historike të formimit të Partisë ai e ka dhënë me masë

nëpërmjet jehonës entuziazte, që ngjalli ky lajm në gjirin e ilegalëve dhe të masës së popullit nga njëra anë, dhe të frikës e panikut, që ngjalli në radhët e okupatorëve dhe veglave të tyre nga ana tjetër.

Autori e ka zhveshur plotësisht figurën e Partisë nga ndonjë paraqitje sado pak artificiale, misterioze, përkundër, figura e Partisë është shumë e kapshme dhe e konceptueshme si për heronjtë e romanit, edhe për lexuesin. Qoftë shoku Hysen, sekretari i qarkorit të Partisë, që paksa skicohet disa herë nëpër episode, qoftë Zef Moisiu apo Alerti, Dekua etj. që, jo vetëm janë anëtarë të qarkorit të Partisë, por zgjidhen edhe sekretarë të tij, në periudha të ndryshme, janë njerëz nga më të zakonshmit për popullin, fatin dhe rrugën e të cilëve në jetë lexuesi e ka të qartë dhe e njeh mirë. Pra këta janë ata që e përfaqësojnë partinë, kjo është Partia e dashur dhe zemërgjerë për popullin, aq sa është e tmerrshme dhe e pamëshirshme për të gjithë armiqtë e popullit, veglat e okupatorit dhe okupatorët.

Pikërisht kësaj paraqitje të natyrshme dhe bindëse të figurës së Partisë, i dedikohet fakti që edhe në ata kapituj ku përshkruhen skena mbledhjesh apo ku bëhet fjalë për qëndrimin parimor, kritik dhe autokritik të komunistëve, romani nuk bie në pasazhe të mërzitshme, por lexohet me interes dhe komunikon me ne. Sjellim ndër mend skenën e asaj mbledhjeje celule ku propozohet Nekija për t'u pranuar në parti, të tilla ka disa në roman dhe në tërësi ato janë të realizuara. Së fundi në të gjitha aspektet e jetës që përfshihen dhe përshkruhen në roman, që nga aksionet e vogla të përditshme nëpër qytete dhe deri te veprimet e mëdha luftarake, që kryejnë njisitet e mëdha të Ushtrisë nacionalçlirimtare për spastrimin e zonave të tëra të atdheut nga pushtuesit nazistë. Që nga debatet e vogla midis anëtarëve të celulave apo midis njerëzve të thjeshtë të popullit e armiqve dhe deri te mbledhjet, që demaskojnë vijën armiqësore të organizatave tradhëtare pseudopatriotike, siç është rasti në roman i mbledhjes që bëjnë krerët

apo përfaqësuesit e këtyre organizatave me Zef Mojsiun, ndihet prania e fjalës së urtë, të matur dhe inkurajuese të partisë, e cila u jep krah bijve të saj, e cila i armatos ata me guxim, zgjuarësi dhe siguri në veten e tyre për të përballuar çdo situatë sado e vështirë qoftë, sikurse ua farkëton edhe zemrat me një dashuri të tillë për popullin, që atyre të mos u dhimset as jeta për të, ashtu si vepron në roman Kopani, Arta, profesor Filipi, Shtëllunga dhe shumë të tjerë.

Një aspekt tjetër ideor të veprës përbën edhe fakti që autori i ka kushtuar një vend jo të vogël problemit të fatit e rrugëve, që ndoqi intelijenca shqiptare, apo qëndrimin të diferencuar që mbajti ajo ndaj ngjarjes më të madhe të kohës, ndaj revolucionit tonë popullor. Siç do ta shohim edhe kur të flasim më poshtë për subjektin e romanit, autori veçanërisht në pjesën e parë të veprës, e përqëndron vështrimin e vet në turbullirën ideore, që kishte përfshirë inteligjencën e pakët shqiptare, e cila ngatërrohej në një lumë pikëpamjesh nga më të ndryshmet, pa mundur të gjente shtegdalje, pa mundur të vinte në përdorim forcat e saj, se i tillë qe regjimi anadollak i Zogut, regjim që s'hapte asnjë perspektivë as për ato forcat e pakta intelektuale, që egzistonin. Autori me realizëm hedh dritë mbi këtë aspekt, duke na e dhënë vërtetësisht tendencën dominuese të kësaj inteligjence, e cila, duke qenë pjellë e klasave të larta, s'mund të tradhëtonte dot origjinën e saj, ndonëse nuk pajtohej me frymën e mykur feudale që zotëronte asi kohe për shkak të ideve liberale, që kish njohur nëpër kryeqytetet e Evropës ku qe formuar kjo inteligjencë. Kjo shtresë e vogël shoqërore qe krejt e pafuqishme, e pazonja për të ndërmarrë diçka serioze, sepse gjer në palcën e vet ajo qe e kalbur nga idetë metafizike të filozofisë idealiste borgjeze evropiane, dhe bile edhe në krahun e saj më të avancuar, ajo nuk kalonte tej caqeve të ëndrrës së saj më të guximshme për ta parë monarkinë shqiptare të përmbysur dhe Shqipërinë një shtet borgjez të tipit anglez. Pra, ndonëse jemi mbi rreth dy-

zet vjet mbas ideologut të famshëm të Rilindjes sonë kombëtare Sami Frashërit, prap ënteligjenca e asaj kohe s'ka ecur asnjë hap sado të vogël përpara në idealet e saj. Kuptohet se gjithë ç'thamë më sipër romani na i jep për atë shtresë të intelektualëve shqiptarë, që nuk shqiteshin dot nga prehri i klasave të pasura, që s'kishte realisht asgjë të përbashkët me popullin dhe idealet e tij. Është kuptimplotë fakti që me t'u ndjerë rapëllima e parë e tankeve fashiste mbi tokën tonë apo e avionave të pushtuesit në qiellin tonë, kjo inteligjencë u tret si kripa në ujë, i la «ëndrrat» dhe «dëshirat» e saj dhe mori udhët e emigracionit, ose u bashkua në një kor me pushtuesin ose, në rastin më të mirë, u tulat në vetëvete pa u bërë e gjallë ndaj ngjarjeve të mëdha historike të kohës. Me fjalë të tjera, në rastin më të mirë, heshtën në rastin më të keq u bënë kalemxhinj të fashizmit. Por vështrimit realist të autorit nuk i ka shpëtuar as fenomeni tjetër i rëndësishëm i kohës, që lidhet drejtpërdrejt me inteligjencën shqiptare të asaj kohe. E kemi fjalën këtu për atë pakicë njerëzish të shkolluar nga masa e gjerë e vegjëlisë shqiptare, e cila me njëmijë mundime dhe privacione, me sakrifica të mëdha mundte të çante rrugën deri nëpër shkollat e mesme dhe më pas në mënyrë autodidakte arrinte të zotëronte një farë kulture. Kjo pakicë intelektualësh e dalë nga populli, ndryshonte me gjithësej nga tarafi i intelektualëve të kallëpit të mësipërm. Këta qenë ata bij të popullit, që edhe pse u ngritën mbi nivelin e prindërve dhe bashkëfshatarëve të tyre, nuk e harruan për asnjë çast mjerimin nga kishin dalë, dhe bile qe origjina e tyre klasore që i shtyu drejt ideve të luftës për përmbysje. Sepse vetëm këta e dinin se si vuante e shtypej populli, se në ç'mizerje dhe errësirë jetonte ai, prandaj kjo kategori intelektualësh u bënë luftëtarë të vendosur për lirinë dhe demokratizimin e vendit, u bënë partizanë të flaktë për përmbysje të mëdha shoqërore. Pushtimi fashist ata nuk i meku, as i hutoi, por i revoltoi ca më tepër, ndërsa formimi i PKSH u dha krah dhe

i bëri luftëtarë të vendosur deri në fund, deri në triumfin e revolucionit tonë popullor. U ndalëm pak më gjatë mbi këtë problem të intelektualëve shqiptarë në roman, se nga këto dy kategori të kundërta të kësaj shtrese shoqërore, autori ka nxjerrë dy protagonistët e veprës së vet, Qemal Orhanajn dhe Emira Velon.

Në zërthimin e karaktereve në këtë vepër ne gjithmonë duhet të kemi parasysh se autori ka krijuar tipa që jo vetëm janë individualizuar mirë, por që njëkohësisht edhe përgjithësojnë njerëzit e atyre viteve të zjarrta apo, më mirë të themi, fizionominë e shoqërisë sonë në atë periudhë historike. Pavarësisht nga shkalla e realizimit të tyre artistik, këta përfaqësonjës të kohës na japin të gjallë tablonë e ngjarjeve dhe përpos kësaj, forcën morale të njerëzve që bënë revolucionin nga njëra anë dhe tërë fliqësinë morale, frikën që kishin klasesat e pasura, sundimtarët se mos humbnin privilegjet dhe pozitën, për të cilat, kur shohin se u rrezikohen, ata janë gati të ndërmarrin çdo veprim dhe të kryejnë çdo akt sado shtazor qoftë ai.

Ndër figurat qëndrore në roman, pa dyshim ai mbi të cilin bie më shumë theksi i vëmendjes së autorit është Qemal Qehanaj, protagonist i veprës. Qemali përfaqëson rininë e pakët shkollore shqiptare të atëhershme, e cila, duke hyrë në radhët e inteligjencës, pruri me vete një frymë të shëndoshë demokratike përparimtare. I ardhur nga shtresat e varfëra, nga fshatrat e labërisë, Qemali me shumë vështirësi ka mundur të kryejë një shkollë të mesme dhe të zërë një nëpunësi të vogël pranë një farë zoti Bakalli, komisionier në Tiranë. Jeta në kryeqytet, ku aso kohe qe mbledhur gjithë «elita» e vendit, i dha mundësi Qemalit të njihet së afërmi me pikëpamjet që sundonin në opinionin përparimtar të kohës. Djaloshi duke dëgjuar diskutimet e gjata të «apostujve» të mendimit demokratik shqiptar, ndjeu se niveli i tij kultural ishte shumë i mangët, por ndjeu se këta të ashtuquajtur demokratë spekullojnë me frazeologji gjoja për popullin por në të vërtetë as që e njohin fare

se cili është populli, se si rron ai, apo më mirë, si vuan ai, prandaj ai mendon: «Elitë si ky rrethi juaj! Ju me mua, që i kam pesë harfe shkollë, dhe shiko se ç'qëndrim mbani... Po me ata mijëra gunëgrisor e potureçjerrë si do silleni?»

Duke kuptuar gjithë falsitetin e gjoja ndjenjave demokratike të kësaj «elite» llafazanësh, që vërtitej qorrazi nëpër pikëpamjet e ndryshme filozofike nga më të kundërtat, Qemali lufton në vetëvete për të gjetur rrugën që duhet të ndjekë. Ai do të nxjerrë një gazetë me tendenca shumë përparimtare dhe këtu ai lidhet me shokë si zeshkani, (për të cilin nga ato pak fjalë që na ka thënë autori, kuptojmë se është një revolucionar i vendosur dhe i pastër, por që për fat të keq mbetet shumë episodik dhe i pazhvilluar), e të tjerë të rinj me ide progresive dhe liridashëse.

Në këtë dilemë morale e gjen Qemalin pushtimi fashist i Shqipërisë. Kjo ngjarje, sikurse shumicën e patriotëve të vërtetë, edhe heroin e romanit tonë e nxori nga dilema, nga qorrrokaku, sepse tashmë qe e qartë se duhej luftuar i huaji, që na kishte pushtuar. Qemalin e shohim në demonstratat e para kundër pushtimit, më vonë duke u përpjekur për të siguruar një copë nëpunësi të vogël, sepse kudo e shohin me sy të keq për idetë dhe qëndrimin e tij antifashist, derisa bie në kontakt me shokë të tjerë të së njëjtës ide, me të cilët lidhet përgjithmonë. Formimi i Partisë dhe fillimi i luftës sonë, e zgjidhin përfundimisht rrugën e ardhshme të heroit. Ai bëhet luftëtar i vendosur i çështjes së madhe të popullit dhe sakrifikon çdo gjë personale, madje deri edhe dashurinë e vet në emër të këtij ideali. Qemali, në vepër, përpos aspektit shoqëror, na është vizatuar edhe në jetën e tij intime. Edhe në këtë aspekt të dytë, ai si karakter është i njëjtë, i vendosur dhe i singërtë. Dashuria e tij me vajzën jo nga shtesa e tij, Emira Velo, i lind djaloshit që në përpjekjet e tij të para në rrugën e luftës për të drejtat e vegjëlisë, që regjimi i urryer i kohës ja kishte mohuar. Qemali është i ndërgjegjshëm

që në krye të këtyre marrëdhënjeve se rrethi i së dashurës së tij s'është ai i njerëzve të tij, ai e ndjeu qëndrimin e ftohtë dhe herë-herë mëshirues që mbajnë njerëzit e Emirës për këtë djalosh këmishëgrisur, por ai i beson dashurisë së vajzës, se tek ajo personalisht sheh një njeri pak më të ndryshëm se rrethi i saj, sheh një vajzë me ideale si të vetat. Lufta çlirimtare, flaka e së cilës po kërcënonte bashkë me armikun e huaj edhe armiqtë e brendshëm, e ndan shapin nga sheqeri dhe Qemali e kuptoi më në fund se shpresat që ai kishte ushqyer te Emira, qenë të kota. Por i armatosur me idetë e mëdha të revolucionit dhe i ushqyer nga fjala e urtë e partisë, Qemali mundi ta mposhtë në të gjitha rastet dobësinë njerëzore për të vënë mbi të idealin e madh shoqëror. Ai e nxori nga zemra Emirën, sepse nuk mund të bënte pazarllëk me ndërgjegjen e tij të brumosur revolucionare.

Të gjitha këto momente në roman tregojnë se figura e këtij personazhi është dhënë në zhvillimin e saj dialektik. Qemali nuk na jepet i formuar njëherë e mirë, por ai formohet në jetë, në luftë, në revolucion. Karakteri i tij vazhdimisht fiton tipare të reja dhe tamam për këtë ai na duket mjaft bindës dhe i besueshëm. Me këtë personazh autori ka dashur të na japë figurën e komunistit, që me shumë cilësi të saj kish filluar të bëjë figura më e shquar dhe më e dashur për popullin, (me gjithë shpifjet dhe helmin që përhapte propaganda e armikut kundra tij) saqë armiku dhe klikat kuislinge në fuqi e urrenin dhe e ndiqnin si vdekjen. Te Qemali janë mishëruar disa tipare morale: ai është i zgjuar, i sjellshëm, i dashur me shokë, i gatshëm për çdo sakrificë, gjakftohtë në çdo rrethanë sado të rrezikshme e të papritur, kërkues ndaj të tjerëve, por sidomos ndaj vetëvetes. Po këto tipare e karakterizojnë atë edhe kur vihet në krye të qarkorit të partisë. Qemali ka një shpirt të ndjeshëm dhe të dhembshur, ai ndjen dhembje për popullin, që vuan, për shokët, që vriten, por ai nuk e lëshon asnjëherë veten, di të gjejë kurajë edhe në rastet

më të rënda. Por ky personazh është zbehur ndonjëherë nga karakteri pak agjitativ, që i ka dhënë autori në ndonjë situatë, gjë që tingëllon pak si artificiale në tërësinë e figurës, që është realizuar mirë.

Figurën e komunistit autori e ka dhënë të vështruar në mënyrë të plotë edhe nëpërmjet personazhesh të tjera, që janë individualizuar me detaje të gjetura. Kjo galeri personazhesh, që ka pikë takimi idealin, që i frymëzon në luftën dhe aktivitetin e saj, prapë mbetet e dallueshme dhe plotëson figurën e përbashkët morale të komunistit.

Ndër ta të bie në sy Veleidin Goxhua, ish-ndihmës shoferi i ardhur nga fshatrat e Jugut për të gjetur punë të Tiranë, njeri i vuajtur dhe i marrë nëpër këmbë, që bashkohet pa rezervë me lëvizjen. Njeri i shkathët dhe i gjallë, ai bëhet korrier i talentuar, që s'përfill rezi-kun, por në çdo kusht përpiqet ta çojë në vend detyrën, që i është ngarkuar. Ndërgjegjja e tij e lartë prej partizani ka gjetur shprehjen e saj më të bukur në aktin e fundit që Velua kryen si korrier, kur, ndonëse i plagosur rëndë dhe me temperaturë të lartë, nuk mendon për vete, por për xhokën që s'e gjen pranë vetes, se aty ka fshehur letrën që duhej të çonte në Pezë. Pra mbi jetën, mbi veten ai vë detyrën, që i është besuar.

Kopani është tipizimi i punëtorit të lidhur me mish e me kockë me partinë dhe luftën e madhe çlirimtare. Edhe në ato pak të dhëna biografike që ka dhënë autori për të, ne mësojmë shumë mbi këtë punëtor, për të cilin e kaluara që vetëm një kalvar vuajtjesh dhe urie. Sa njerëzore del figura e tij kur mësojmë të vetmen brengë që ka ai: Kopani vuan se do të hidhet në mal vetëm e vetëm që të mos jetë i detyruar ditën, në shtypëshkronjë ku punon, të radhisë lajmet e fashizmit e të kuislingëve. Por Kopani është hero i vërtetë, është një nga mijëra bijtë e këtij trualli, që u ushqye me idealet e larta të Partisë, dhe që s'kurseu as jetën për të, për shokët e tij. Kopani me trimëri shkoi drejt rrezikut. Edhe kur plumbat e hitlerianëve e shtrinë djaloshin përtokë, ai

pati vetëm një mendim në ato çaste të fundit, që letra e shokëve të mos binte në dorë të armikut.

Partia jonë si parti e klasës punëtore në synimin e vet për të vendosur diktaturën e proletariatit, diktaturën e shumicës, paqë parasysh qysh në fillimet e rrugës së saj revolucionare që të tërhiqte në gjirin e saj jo vetëm klasën e saj, klasën punëtore, por edhe aleatët e natyrshëm të saj, — fshatarësinë e varfër dhe inteligjencën popullore. Edhe Luftën nacionalçlirimtare Partia e kreu e mbështetur mbi të gjithë masën e gjerë të popullit. Në roman ndër ata që përfaqësojnë me dinjitet fshatarësinë tonë punonjëse, ne do të përmendim një mori emrash, por si më të realizuar janë ndër të tjerët babë Llani. Te kjo figurë, autori ka përmbledhur dhe përgjithësuar cilësitë më të mira të fshatarit. Plaku është nga ata që ka parë shumë në jetë, që ua ka pirë lëngun agallarëve dhe bejlerëve, të cilët i njeh mirë dhe jo vetëm i përbuz, po s'ua ka për pesë t'ua përplasë në fytyrë të vërtetën sidomos tani që e ndjeu se lufta është e tij. Plaku nuk kursehet as të ndërmarrë vetë veprime ilegale, ai i do luftëtarët e lirisë dhe bëhet copë për ta. Burrë i urtë, i dashur, i zgjuar plot kurajë dhe mirësi shpirtërore, ai përfaqëson fshatarin shqiptar të Shqipërisë së Mesme në vetijat e tij më të mira. Në roman ka disa figura pleqsh simpatikë e ndër ta do të përmendim edhe axhë Jazin, kosovarin trim e sypatrembur, që, ndonëse në moshë të thyer, është bashkuar me të gjithë njerëzit e vet me luftën e madhe, që edhe këtij kosovari plak do t'i realizojë ëndrën shekullore për tokë. Pak më të ndryshëm, por gjithmonë me prejardhje fshatare janë edhe Nekija me Ferikun, më tepër se fshatarë në kuptimin klasik të kësaj fjale, këta të dy janë punëtorë, robër të tokës. Historia e jetës së tyre të dhimbshme përgjithëson fatin e një pjese të madhe të fshatarësisë së atëherëshme të patokë, e cila pa rezervë u bashkua me luftën. Lufta për liri i bëri të dy këta njerëz të vërtetë, me dinjitet dhe guxim, deri në atë masë sa që ata në luftë e sipër gjetën mundësitë reale për ta për-

ballur rrezikun e përjetshëm, që u kërcënohej nga Galip beu, dhe bile lufta i bëri që këta të manifestonin aftësitë e tyre e zgjuarësinë e tyre. Nekija nga një grua krejt e drojtur dhe e mbyllur, arriti të ishte pjesëtare e Partisë Komuniste Shqiptare, kurse Feriku arriti të ishte një komandant i aftë dhe me autoritet. Njëpërmjet këtyre dhe mjaft heronjve të tjerë pozitivë, autori ka nënvizuar mendimin se pikërisht njerëzit më të zakonshëm, më të shtypur, në saje të fjalës dhe udhëheqjes së partisë, arritën të bëhen kuadro të afta të luftës së madhe për çlirim.

Një nga figurat më të realizuara të veprës është pa dyshim heroina e romanit, Emira Velo. Meritë e autorit në krijimin e këtij personazhi është se në gjithë linjën ku ai trajton këtë figurë ka ditur me siguri dhe qartësi ideore të trajtojë një problem mjaft delikat siç është problemi i paraqitjes së qëndrimit dhe rolit negativ të inteligjencës borgjeze, pa pasur asnjëherë iluzion se kjo shtresë e klasave të pasura mund të tradhëtojë interesat e veta e të përqafojë idealet e klasës punëtore. Këtë konkluzion marksist ka ditur të na e transmetojë me vërtetësi dhe emocione njëpërmjet veshjes letrare, që ka realizuar në paraqitjen e realitetit.

Emira është bijë klase të pasur, që ka predispozita shpirtërore demokratike borgjeze. Në kohën e sundimit feudal zogist një ndjenjë e tillë egzistonte sidomos në radhët e borgjezisë apo të intelektualëve me origjinë feudale, që kishin studjuar në shkollat e vendeve borgjeze evropiane. Dhe kjo që e natyrshme, sepse klika zogiste që bërë një pengesë e urryer edhe për këto shtresa. Kjo është një nga arësyet themelore, që shpjegojnë qëndrimin përparimtar të kësaj vajze. Emira ka në një farë mase një ndjenjë mëshire dhe keqardheje për të varfërit, por kjo është thjesht ndjenja e njohur sentimentale dhe filantropike e gënjeshtërt e borgjezisë, sepse është paradoksale të mendosh që klasave të pasura u ardhka keq për një lypës apo jetim, kur po këto klasa e sigurojnë begatinë dhe luksin e tyre duke

shfrytëzuar në mënyrë të pashpirt mijëra punëtorë apo fshatarë të tjerë. Sidoqoftë Emira është e pranueshme të ketë ideale progresive për atë kohë dhe është akoma më e pranueshme dhe reale që ajo këto ideale t'i tradhtëtojë kur ndjen, ashtu si klasa e vet, që realizimi i tyre çënon sado pak interesat e pronës dhe mirëqenjes së saj. Njohja me Qemalin dhe dashuria me të qenë një element i rëndësishëm në qëndrimin, që mban Emira ndaj ngjarjeve të kohës dhe pushtimit fashist, dhe, nëse këto marrëdhënje do të qenë çelnikosur edhe mbi unitetin ideor të të dy të rinjve, mund të ndodhte që, si rast i veçantë, Emira të tradhëtonte interesat e klasës, që përfaqëson, një fenomen i tillë, sado i rrallë, është i mundshëm. Por kjo s'u arrit, Emira, sikurse është e logjikshme, ra nën ndikimin e ideologjisë pseudopatriotike të përfaqësuar nga Mithat Frashëri, ideologji hipokrite, që pas frazave nacionaliste fshihte synimet dhe interesat e klasave të pasura. Figurën e kësaj heroine të veprës e bëjnë të besueshme edhe ato çaste lëkundjeje të lehtë, që vërejmë tek ajo kur sheh degjenerimin e plotë dhe paaftësinë e krerëve nacionalistë, për të cilët i qan zemra, dhe forcën e madhe vitale të luftës së popullit të prirë nga partia, por këto janë vetëm lëkundje çasti dhe asgjë tjetër. Ajo mbetet konseguente në rrugën e vet dhe në këtë rrugë ajo degradohet deri në një grua të zakonshme pa ideale dhe pa qëllime shoqërore, të cilën revolucioni e flaku tej si diçka pa vlerë, sepse ajo u vu kundër valës së tij. Kuptimplotë është fakti që, kur vjen rasti që Qemali të njihet me pikëpamjet nacionaliste të oficerit kuisling Petrit Kasimatit, ai gjen pika takimi të shumta midis këtij armiku të fëlliqur dhe Emirës. Pra si të thuash të dy këta: Petriti dhe Emira në thelb janë të njëjtë. Ata ndryshojnë vetëm në manifestimet e tyre të jashtme, në çeshtje karakteri, kurse në botëkuptim, në ideologji janë të njëjtë. Në skalitjen e kësaj figure autori ka ndjekur një rrugë trajtimi serioz duke mos spekuluar me rrugën e lehtë që të na ngjallte neve përbuzje duke na e përshkruar Emi-

rën si një vajzë me moral të lehtë, jo. Ai e ka dhënë atë të vërtetë e bindëse.

Ndër tipat e tjerë, që përfaqësojnë botën e kalbur, së cilës i ka tingëlluar ora e fundit, janë të dhënë bukur dhe me forcë e vërtetësi Mithat Frashëri dhe Galip bej Frakulla. I morëm bashkë këto dy figura jo rastësisht, se që të dy janë mbrojtës të një ideali dhe përfaqësues të së njëjtës klasë. Por, ndërsa i pari fshihet pas asaj lustre kulture dhe është i rafinuar, i dyti është beu i egër, injorant e xhahil, i lig në shpirt dhe frikacak, që është gati në çdo çast në emër të interesave të tij të tradhëtojnë çdo ideal. Demaskimin më të fortë të kësaj figure ne e ndeshim në ata kapituj ku përshkruhet fundi i Galip beut, i cili me qëndrimin e tij bëhet i neveritshëm. Por edhe pse në dukje kaq larg Mithat beut, në fakt ata janë këlyshë të pështirë, që hanë në një çanak, në çanakun e okupatorit, të cilit i shërbejnë vetëm e vetëm që të sigurojnë lëkurën e tyre pa i ngrënë hiç merakun për fatin e popullit, megjithëse me fjalë ata gdhihen e ngrysen me emrin e popullit në gojë. Mithat beu është demagogu i rafinuar, që në saje të kësaj demagogjie, ka arritur të ketë një farë autoriteti të gënjeshtërt në një pjesë njerëzish të thjeshtë, të cilët ishin të verbuar nga propaganda dhe reklama, që klasat e pasura i bënë këtij «babai të nacionalizmit» për interesat e tyre. Kurse hafiz Turhani paraqet interes si tip i realizuar, që përfaqëson atë grup njerëzish, të cilët luanin politikën e shumë flamurëve duke u mbajtur si më të majtë në tarafin nationalist, por që edhe këtyre lufta e popullit ua çorri maskën, se i detyroi në fund të fundit të futeshin në llogoren e armiqve duke hequr dorë nga loja me shumë faqe, me të cilën spekuluan për një kohë të gjatë.

Ndër kolaboracionistët apo bashkëpunëtorët gjysmëlegalë me armikun e huaj, më të realizuara janë figura e Safet Palkës dhe Eqrem Bankës. I pari bej që gënjen veten duke besuar se është fshehur kaq mirë, sa që lojën e tij dyfishë për Gestapon nga njëra anë

dhe për lëvizjen nga ana tjetër, e ka kurdisur kaq bukur, sa asnjëra palë s'ja ka marrë vesh hilen. Kurse i dyti kalemxhi i fëlliqur, njeri i pamoral, që ka siguruar karrierën e tij nëpërmjet miqësive të fëlliqura, që lidh e shoqja deri edhe me oficerët e gestapos. Egrem Banka është ndër njerëzit më të pafytyrë, i cili disa herë me radhë del sheshit që në çast është i gatshëm të hedhë tej çdo parim moral, majfton që të mos humbë të mirat materiale, që gëzon.

I afërt me dy të mësipërmit është edhe Petrit Kasimati, njeri imoral, i paafte për asgjë tjetër veç poshtërsive. Oficer i përgatitur në akademitë fashiste, ai vjen në Shqipëri me idealet e okuptatorit italian, të cilat s'e ka për gjë t'i këmbëjë duke u vënë në shërbim të nazistëve. Ky personazh, që na jepet drejtpërdrejt vetëm në kapitujt ku përshkruhet fundi i tij i turpshëm, merr përpara lexuesit një sërë vlerash, që nuk janë justifikuar dhe përligjur sa duhet nga autori. Derisa kapet nga partizanët, ne kemi përshtypjen se Petriti është një njeri jo vetëm pa skurpuj dhe i pamoralshëm, por edhe i lehtë dhe i cekët. Kurse në fundin e kësaj figure, e si domos në kujtimet që ruan në ditar për të Qemali, ne kemi të bëjmë me një armik jo vetëm të vendosur, por edhe të zotin, që di të mbrojë nga pozitat e tij, klasën e vet dhe organizatën e saj pseudonacionaliste «Ballin Kombëtar». Bile të mbajë dhe qëndrim të ashpër ndaj Galip beut për qëndrimin e tij prej njeriu frikacak. Ky qëndrim nuk i shkon Petritit, që kemi njohur në roman.

Romani «Para agimit» është një ndër të paktët romane të gjatë, që u dukën në letërsinë tonë ndër këto vitet e fundit. Ky fakt letrar së bashku me shumë shfaqje e suksese të tjera të letërsisë sonë, siç janë edhe romanet dinjitoze njëvëllimshe, që u botuan këto vitet e fundit, nuk janë një gjë e rastit, po rrjedhim i natyreshëm i rritjes së letërsisë sonë, si letërsi me shumë vitalitet e pjekuri artistike. Shumëllojshmëria e romanit tonë të sotëm është dëshmi e pjekurisë artistike, që ka arritur letërsia shqipe si letërsi e realizmit socialist, që i

përmbahet me besnikëri pasqyrimin me vërtetësi të jetës, duke synuar që të japë konturet e së ardhmes gjithmonë e më të ndritur. Për romanin tonë në tërësi, si për gjithë letërsinë tonë të re, janë të huaja të gjitha manitë letrareske të rrymave dekadente që e kanë degjenuar letërsinë e sotme borgjeze perëndimore. Dhe në këtë drejtim, në mohimin e të gjitha izmave që e karakterizojnë letërsinë e sotme borgjeze dhe revizioniste, (e cila mundohet ta imitojë borgjezinë edhe në fushën e krijimtarisë shpirtërore — artistike) edhe romani «Para agimit» është një sukses i ndijshëm.

Në qendër të veprës autori ka vendosur konfliktin e madh të kohës, luftën midis popullit tonë të udhëhequr nga Partia dhe okupatorëve nazifashistë me tradhtarët e vendit. Ky konflikt bazal, që përbën kolizionin, shtrihet në gjithë subjektin e veprës dhe është i detajuar në një sërë konfliktesh deri te më të voglat, apo më sakt, është dhënë në gjithë aspektet e vërteta të kohës. Siç dihet, Partia i bëri thirrje popullit të ngrihej i tëri pa asnjë dallim kundër okupatorëve të huaj, po ajo asnjëherë nuk e harroi se krahas këtij qëllimi të madh, imediat duhej luftuar dhe demaskuar klika kuislinge, që ishte vënë haptazi në shërbim të të huajve, apo edhe lëvizja pseudonacionaliste, që e gënjente popullin me demagogjinë e rafinuar, që propagandonte, ndërsa në të vërtetë qe lidhur dhe i shërbente fshehurazi armikut, ose qe e padëmshme për atë po aq sa qe e dëmshme për luftën e popullit tonë. Kështu ne shohim që në roman të lindin e të zbërthehen një sërë konfliktesh antagonistë, të cilat me vërtetësinë e tyre, i japin gjerësi veprës. Ndër konfliktet më pikante ne do të përmendim edhe konfliktin e marrëdhënjeve intime midis Qemal Orhanajt dhe Emira Velos. Ky konflikt nuk është thjesht një mosmarrëveshje dashurore midis dy të rinjve, por diçka shumë më e thellë. Qemali në këtë anë të jetës së vet, në marrëdhënjet intime personale udhëhiqet nga parimi i shëndoshë se jashtë interesave të mëdha shoqërore, jashtë fatit të atdheut, s'mund të ketë lumturi

personale. Ai e ka bërë të veten devizën e njohur të poetit të njohur hungarez Petëf, i cili thotë. «Për dashurinë sakrifikoj jetën kurse për lirinë sakrifikoj dashurinë».

Qemali s'mund ta kuptojë ndryshe lumturinë personale. Ai përpiqet mjaft ta bindë dhe ta tërheqë në anën e popullit Emirën, po, kur s'ja arrin kësaj, kur sheh se Emira në mënyrë konseguente rrëshqet në llumin e armiqve të popullit, ai jo vetëm që e nxjerr nga zemra, por dhe e urren, e përbuz si të gjithë armiqtë e tjerë, me të cilët populli qe në luftë të papajftueshme.

Ngjarjet në roman shtjellohen kryesisht simbas dy linjave kryesore: e para linja e luftës që përfaqëson edhe konfliktin kryesor apo kolizionin e veprës; e dyta, linja e marrëdhënjeve intime të të dy të rinjve. Kjo mënyrë i ka dhënë dorë autorit të na japë një vepër të thjeshtë e të tretshme për çdo lexues, një vepër me kompozicion të pakomplikuari. Drejt procedojnë edhe kapitujt, nëpër të cilët fabula e romanit rrjedh në mënyrë të natyrshme pa të papritura dhe komplikime të panevojshme. Edhe retrospektiva është përdorur me masë dhe aty ku duhet. Por do të qe më mirë sikur disa kapituj ku përshkruhen disa anë dhe veprime ilegale, të qenë hequr apo shkurtuar, se i kanë dhënë zgjatje të kotë veprës.

Pra në tërësi, si arkitekturë, romani qëndron në këmbë denjësisht. Duhet theksuar se autori e njeh mjaft mirë gjuhën, që përdor. Ai ka një fjalor të pasur dhe të zhdërvjelltë. Mjaft mirë është përdorur në roman gjuha si një mjet individualizues, që i karakterizon dhe u jep më shumë kolorit personazheve. Këtë veti të ne e kuptojmë lehtësisht po të sjellim në mend mënyrën e të folurit të babë Llanit dhe disa personazhe të tjera të Shqipërisë së Mesme, ku ndjejmë vetëm intonacionet karakteristike të kësaj të folmeje, por edhe logjikën e shëndoshë të popullit. Sjellim ndër mend po këtë funksion të gjuhës në roman të mënyra e të folurit të partizan Baxhulit dhe do të kuptojmë se sa fun-

ksionale është gjuha në karakterizimin e personazhit. Të tillë funksion të gjuhës në vepër e gjejmë edhe në mënyrën e në manierat e të folurit të Mithat beut, që në çdo frazë doemos do të futë disa fjalë frëngjisht; apo te shumë personazhe të tjera, dhe do të bindemi se autori është mjeshtër i përdorimit të këtij mjeti të fuqishëm artistik siç është gjuha. Romanit nuk i mungojnë as përdorimet e figurshme të fjalëve, nuk i mungojnë metaforat, krahasimet, epitetet e shumta, që i kanë dhënë forcë emocionale e të figurshme veprës. Por duhet të vërejmë si të metë që shpesh autorit format e ngurta dialektale i kanë hyrë thellë deri edhe në gjuhën e tij si autor, pra, kur flet ai vetë në vepër, rast ky që në mënyrë të domosdoshme kërkon një gjuhë të pastër e të krehur nga dialektalizmat.

Me tërë këto vlera dhe veçanti, që u munduam të analizojmë shkurt, romani «Para agimit» vepra më madhore e autorit, është një roman me vlera të padiskutueshme ideo-artistike. Kjo vepër që flet gjerësisht për Luftën tonë nacionalçlirimtare, për të kaluarën e hidhur, por edhe për frymën luftarake, liridashëse të popullit tonë, ka vlera njohëse dhe edukuese të mëdha për lexuesin tonë e sidomos për brezin e ri, i cili gjen këtu një tablo të gjerë e të vërtetë të atyre viteve të stuhishme dhe të paharrueshme të revolucionit tonë popullor.

1969

VËRTETËSI DHE FORCË EMOCIONALE

Si rrallë në ndonjë vepër tjetër të letërsisë sonë, te «Kronikë në gur» e I.Kadaresë jeta, realiteti i gjallë, janë dhënë në tërë larminë e madhështinë e tyre, janë dhënë me aq forcë emocionale dhe nëpërmjet një ngjeshjeje të atillë, sa që i japin lexuesit mbresa dhe i ngjallin mendime, që ndoshta s'do të qenë në gjendje t'ia ngjallnin vëllime të tëra.

Në këtë roman realiteti na parakalon me atë vërtetësi dhe me atë forcë tronditëse, që do të kishim provuar po t'i jetonim ato vite. Skena të jetës së plogësht, të meskiniteteve mikroborgjeze, plot trillime, bestytnira e thashetheme, ndryjnë në gjirin e tyre fatin dhe jetën e njerëzve. Jeta është e fjetur, e mbytur në rutinën dhe hallet e përditshme dhe të duket për një çast se kështu do të vazhdojë edhe më tej; por kjo vetëm për një çast. Pas plogështisë së dukshme, në brendësi të saj, jeta ka nisur të vlojë, njerëzit kanë nisur të shqetësohen, ata përherë e më tepër po i preokupon e ardhmja, e nesërmja. Këto aspekte vijnë e ndërthuren me të tjerat për të plotësuar kuadrin gjigant të atij realiteti. Kështu, në roman gjejmë bashkë gëzimin dhe hidhërimin, në të flitet për dasma, lindje, vdekje, në të zëvend mentaliteti i kohës, bestytnitë, botëkuptimi reaksionar fetar, ideologjia e sunduesve dhe e pushtuesit të

huaj, që nis e u lëshon terren forcave dhe botëkuptimit të ri progresiv, i cili po triumfon në jetë, në shoqëri. Kjo karakteristikë e brendisë së veprës, fakti që autori ka vendosur pranë e pranë jetën dhe vdekjen, të renë e të vjetrën, luftën dhe përleshjen midis tyre, ka bërë që romani të marrë thellësi odeore dhe gjerësi vështrimi jetësor.

Kjo mpleksje e fuqishme e realitetit në vepër e ka nxitur autorin që ta shpejtojë gradualisht shtjellën e ngjarjeve në përputhje me pasurimin e vetë realitetit të asaj kohe me ato ide e ngjarje. Kështu, kapitull pas kapitulli, romani fiton ritëm, ashtu sikurse vetë jeta, sikurse vetë realiteti, që na përshkruhet në të.

Duke e përmbledhur tërë këtë pasuri idesh e mendimesh përbrenda mbulesës së gurtë të qytetit të hirtë, I.Kadare ka dhënë me forcën e tij përgjithësuese jo thjesht një qytet, që jeton disi i veçuar nga atdheu, por krejt atdheun në përleshjen e tij gjigante për të flakur tej zgjedhën dyfishe, që i rëndonte popullit mbi zverk.

Romani «Kronikë në gur» është një vepër e fuqishme realiste. Ai përshkohet nga ndjenja e ngrohtë e dashurisë për njerëzit, për vështrirësitë, vuajtjet dhe gëzimet e tyre.

Në vepër lexuesi do të gjejë në një gërshetim harmonioz e të natyrshëm tragjiken me komiken, do të njohë skena jete ku rrjedhin zakone e doke të një populli, së bashku me bestytin fanatizëm, moral patriarkal apo me skena të degjenerimit moral, që pruri me vete okupatori, si dhe nismën e përplasjes ideologjike apo luftës politike, që mori zjarr përherë e më fuqishëm duke përfshirë masën e gjerë të popullit.

Ngjarjet që përfshihen në kornizën e romanit shtrihen afërsisht në vitet 1940-43.

Qysh në faqet e para të veprës lexuesi e ndjen ambientin e fjetur e të plogët feudal të qyteteve tona të asaj kohe, ku njerëzit merreshin me vogëlsira, me thashetheme dhe asgjë serioze nuk e preokuponte mendjen dhe dëshirat e tyre. Në qytet bën përshtypje të një sensacioni të rrallë lajmi që vajzës së Çeço Kailit i ka dalë mjekër, apo që Isai vuri syze dhe sidomos shpërrthimi i magjive, që thëthnin tërë vëmendjen dhe ngjall tmerr te njerëzit naivë. Po këtë plogështi jete vërejmë edhe te dëshira e njerëzve për të kaluar orë të tëra duke bërë sehir se si theren bagëtitë në kasaphanë. Periudha e jetës së amullt, e zbrazësirës shpirtërore, trashëgim i fortë e i freskët i kohës së sundimit feudal të Zogut, fillon të tronditet nën goditjet e ngjajreve të luftës, që po rrokulliseshin me rrëmbim dhe që po e shkundnin qytetin.

Në krejt romanin, duke u nisur që në kapitujt e parë të tij, ndihet qartë si nëntekst i fuqishëm një ndjenjë shqetësimi. Qyteti është i shqetësuar, përditë ndodhin gjëra të papritura, për ditë shpërthejnë alarme; gjithkush i kupton e mundohet t'i shpjegojë si di vetë këto, por një gjë është e qartë për të gjithë: mbaroi përgjithmonë plogështia shumëvjeçare anadollake e mbretërisë famëkeqe. Priten ngjarje gjithmonë e më tronditëse, që do ta përmbysin përfundimisht botën e kalbur e të padrejtë. Ankthi, alarmet, shqetësimet, janë parandjenja e sigurt e njerëzve për përmbysjen e afërme. Në jetën e përditshme të njerëzve tanë nisën të hyjnë shqetësime të reja, që s'linin më vend për vogëlsirat meskinë të dikurshme. Bombardimet, lëvizjet e frontit, krijimi i bazës ajrore në qytet, viktimat e para të luftës, nxitin protestën e njerëzve, urrejtjen e tyre për pushuesin, që nis të manifestohet në forma nga më të ndryshmet, nga mallëkimet e plakave e deri te aktiviteti ilegal i rinisë, e cila organizohej e udhëhiqej nga Partia Komuniste e porsaformuar.

Në vendosjen e skenave të tilla me episode nga më të ndryshmet, autori ndjek një qëllim të dyfishtë: ai jo

vetëm e pikturon realitetin e kohës, por edhe e sfidon atë, duke e qesëndisur në një mënyrë shumë të hollë, shumë fine. Kështu, njerëzit si Çeço Kaili, Aqif Kasha-hu etj. vihen në rrethana, që e vënë në lojë pseudomoralin e tyre; edhe më fort ndihet kjo, kur bëhet fjalë për të bijën e Mak Karllashit. Sigurisht, me këto vija sekondare të subjektit, autori synon dhe arrin ta vësh-trojë të diferencuar jetën me fenomenet e saj, siç ma-nifestoheshin ato në shtresa të caktuara shoqërore të kohës. Për të realizuar këtë, ai ka përdorur me shumë sukses si mjet kryesor artistik ironinë. Ironizimet, si-tuatat qesharake e tallëse i gjen kudo në roman si shprehje të demaskimit të moralit sundues të kohës.

Gjithmonë brenda këtij diferencimi në vështri-min e vet, në një mënyrë krejt tjetër, me ndjenja rrë-njësisht të ndryshme, autori ka vizatuar një nga linjat kryesore të subjektit të romanit, atë të njerëzve të thje-shtë, të atyre që përbëjnë e përfaqësojnë masën, po-pullin. Për këtë arsëye ai vendos në qendër të romanit një grup personazhesh, gra të një moshe të shkuar, që përfaqësojnë gjykimin dhe qëndrimin e popullit për ngjarjet e kohës.

Dhe këtu, pikërisht në këtë ambient, mes kësi per-sonazhesh lëvrijnë nëpërmjet ngjarjesh, idetë, pikë-pamjet dhe mendimet e njerëzve për preokupacionin e tyre kryesor: luftën, pushtuesin dhe çlirimin e Atdheut. Por edhe në këtë plan autori nuk e tepron, ai nuk i idealizon qoftë edhe këta njerëz të thjeshtë, qoftë edhe gjyshen, që është njeriu më i afërt i heroit, por i ski-con ato në kompleksitetin e ndjenjave e mendimeve të tyre, duke qëndruar, para së gjithash, realist në pas-qyrimin e në zbërthimin e linjës së tyre.

Selfixheja është ndoshta nga figurat më të skali-tura e më simpatike. E qetë, krenare, me logjikë të rrallë për moshën e saj, në gjykimin për ngjarjet dhe njerëzit, ajo fiton jo vetëm dashurinë, por edhe res-pektin e lexuesit. Kjo grua, e cila po i afrohet asaj moshe të respektuar, që do ta largojë nga vogëlsitë e

meskinitetet e jetës së përditshme, rritet gradualisht në faqet e romanit, jo thjesht dhe vetëm në raport me ndjenjat e heroit të veprës, por edhe në raport me gjithë ç'ndodh në jetën e qytetit. Duke mos e shkëputur nga mentaliteti i kohës, pjellë e të cilit është dhe Selfixheja, prapë qëndrimi i saj është shumë më i ndryshëm nga i ambientit, që e rrethon, nga ai i grave të tjera. Qoftë ndaj magjive, qoftë ndaj ngjarjeve të tjera, ajo vetiu qëndron më lart se Xhexhua, Kako Pinua apo hallë Xhemua, të cilat, ndonëse në mënyrën e vet, alarmohen apo parashohin zi dhe tmerre. Gjyshja plakë është në një kuptim si një forcë ekuilibruese ndaj çdo alarmi të ri në jetën e familjes. Ajo di të ruajë gjakftohtësinë e t'u ushqejë besim njerëzve me qëndrimin e saj edhe kur përreth zhurmojnë avionat dhe shpërthejnë bombat. Fjala «*placi*», që u thotë ajo bombave dhe qeverive, është, në mënyrën e vet, protesta dhe mospërfillja popullore ndaj çdo rreziku dhe kërcënimi të armiqve. Selfixheja di të qetësojë e t'i japë kurajë kujtdo, siç ndodh kur tezja e vogël e heroit ka dalë partizane: Ajo arrin me intuitën e saj të njohë drejt se ky veprim i vajzës së re s'është «*turp e çnderim*», por «*nder me shokë e me shoqe shumë*»; ajo di t'i tregojë vendin edhe zonjës Majnur, që shpif e vjell vrer kundër vajzave partizane. Në këtë plan është kuptimplotë edhe fakti që kjo, Selfixheja plakë, asnjëherë e në asnjë rrethanë nuk e braktis shtëpinë e vet, edhe kur të tjerët, për shkak të rrezikut, strehohen në kubenë e shtëpisë, shkojnë në kalanë e qytetit apo fshatrave, kur qyteti evakuohet i tëri. Me këto tipare morale që fiton në vepër, gjyshja Selfixhe nuk mbetet thjesht një gjyshe e dashur, e ngrohtë dhe e dhembshur si gjithë gjyshet, por në një farë kuptimi ajo përfaqëson urtësinë, qëndrimin dhe gjykimin e popullit.

I. Kadare në romanin «Kronikë në gur» synon të vizatojë para lexuesit një etapë të caktuar të realitetit tonë historik, duke zgjedhur si mënyrë të vetën, si kënd vështrimi, botën naive dhe plot drita të forta të fëmijnisë së tij. Kjo s'e ka penguar autorin që të japë gjykime të thella për kohën e ngjarjet, ta vështrojë drejt atë kohë, ato ngjarje, ata njerëz. Dhe pikërisht këtu, në ndërthurjen mjeshtërore të këtyre dy anëve në pasqyrimin e realitetit, qëndron një nga vlerat kryesore të veprës.

Kundrimi i realitetit me sytë e fëmijës dhe zberthimi i psikologjisë së fëmijës është një nga elementët zotëruese në roman. Por autori i kalon caqet e një konstatimi të zakonshëm fëmijnor të realitetit, ai, pa u shkëputur nga fëmijnia, nga tiparet e moshës së heroit, ka mundur të meditojë thellë.

Është interesant të vërehet se në shtrirjen e krejt subjektit të romanit, megjithëse ndjek një ecuri të natyrme, pa as më të voglin sforcim, autori ka mundur mjeshtërisht që, në mënyrën si i ka renditur episodet dhe faktet, në mënyrën se si i ka ndriçuar, ato, të na trasmetojë qëndrimin e tij të përcaktuar ndaj ngjarjeve dhe njerëzve, ndaj vetë jetës së kohës dhe ka arritur të na e japë gjithshka të vështruar me syrin e kohës sonë. Me një nëntekst të pasur artistik ne thithim në vepër jo vetëm kohën e ngjareve, që na përshkruhen, por edhe mendimin e autorit për to.

Me vërtetësi na janë dhënë në vepër ndjenjat e fëmijës, emocionet e tij, që pjesërisht janë të qarta dhe të pranueshme për vetë cilësitë dhe zhvillimin fiziologjik të tij, dhe pjesërisht mbeten të mjegullta e të pashpjegueshme deri në fund për të, për arësyen e pranueshme se janë ndjenja dhe emocione të parakohshme. Në këtë aspekt romani s'ka dalë për asnjë çast nga e vërteta. Për heroin janë të natyrshme pasionet e fëmijnisë, lodrat me shokët, gëzimet familjare, ngrohtë-

sia e gjyshes, dëshira e tij për t'u bërë si babazoti, krenaria për kubënë e fortë të shtëpisë së tij, dhe, mbi të gjitha, etja e pafund për të njohur të renë, për ta përqafuar atë. Kjo e fundit e shtyn heroin të njohë sa më parë aeroplanin e Dino Çiços dhe vetë autorin e shpikjes, që ka mrekulluar fantazinë e fëmijës; po kjo ndjenjë e nxit të jepet pas leximit të «Makbethit» me aq pasion, saqë më vonë mëse një herë njerëzit, që njuh dhe ndodhitë në familjen e tyre t'i krahasojë me heronjtë e tragjedisë së Shekspirit. Dhe përsëri është ky, pasioni fëmijnor për të renë, për shkencën dhe teknikën, që e shtyn heroin e vogël të dashurohet pas aeroportit dhe aeroplanit bombardues deri në atë masë, saqë të mos kuptojë të keqen e pushtimit, të mos bindet për këtë as nga mendimi e ndjenjat e kundërta, që kanë të rriturit për avionet, që ai i adhuron, derisa ngjarjet, konkretisht bombardimet, e bëjnë të kuptojë se këta avionë të armikut mbjellin vetëm vdekjen në në qytetin e tij dhe ai të zhgënjehet në ndjenjat, që kishte ushqyer më parë. Zhgënjime të tilla ka disa në lirin e heroit të veprës, ato tregojnë se për brezin e ri duhej kohë e re. Duke i mbetur besnik kornizës historike ku ai ka vendosur ngjarjet e veprës, autori motivon plotësisht këto iluzione dhe zhgënjime në ndjenjat e heroit.

Bota mendore e shpirtërore e heroit të romanit, sado naive dhe e paformuar, nuhati dhe kuptoi qoftë dhe intuitivisht të bukurën, të mirën, përparimtarin në atë periudhë të zymtë e të rëndë. Është ky element i pranishëm, që na bën të besojmë si krejt të natyrshëm afrimin e fëmijës me lëvizjen ilegale të porsanisur, afrim shpirtëror ky dhe jo aktiv, por sidoqoftë afrim plotësisht i pranueshëm. Heroi i simpatizon dy ilegalët e lagjes së tij, Javerin dhe Isain, ai krenohet me aktin e tezes së vogël, që doli partizane, ai entuziazmohet me kolonat partizane, që hyjnë në qytet.

Romani «Kronikë në gur» shquhet edhe për gjerësinë e mbresave, që ka arritur të na transemtojë. Në vështrimin e veprës zë një vend të dukshëm dhe shtrihet në krejt brendinë e saj, e bashkërenduar me aspekte të tjera jetësore, edhe rruga që ndoqi lufta jonë, që në protestën e heshtur nismëtare e deri në shpërthimin e armatosur. Linja e luftës është trupëzuar në dy prej personazheve të romanit, të Isai dhe Javeri. Këta të rinj ilegalë në diskutimet e tyre për jetën e qytetit dhe armikun okupator, përfaqësojnë qëndrimin e rinisë sonë heroike, fillimet e luftës së saj, së pari në ilegalitet e në format e luftës individuale, e, më pas, gjithmonë e më hapur deri në luftën e armatosur të organizuar nga Partia. Fundi heroik i Isait dhe mënyra si Javeri hakmerret kundër të ungjit ballist, janë pikat më të mprehta të kësaj faze të luftës. Por autori s'ka mbetur në një vështrim kaq të ngushtë. Romani në shtrirjen e vet ka përfshirë në pasqyrim edhe një varg episodesh të tjera, që flasin për shtrirjen e menjëhershme, që mori lufta jonë. Kështu ne ndeshim mëse një herë lajme për nxënës, që përjashtohen nga shkolla e burgosen për veprimtari antifashiste, apo grupe të burgosurish, që internohen nga fashizmi. Po kështu djegja e bashkisë, vrasja e tradhëtarit Gjergj Pula dhe e komandantit të qytetit Bruno Arxhivokale pohojnë të njëjtin realitet, që vjen e arrin kulmin me daljen e të rinjve të qytetit në mal dhe me hyrjen e kolonave partizane triumfalisht në qytet pas shpartallimit të Italisë fashiste. Në këto skena, që përbëjnë kapitujt e fundit të romanit, ndonëse shkurt, autori hedh dritë mbi moralin e lartë të partizanëve dhe mbi principialitetin e luftës sonë. Në funksion të kësaj ideje është edhe ekzekutimi i partizanit Tare Bonjaku, që ka një domethënje të lartë. Por mënyra si është dhënë ky episod, fakti që autori vetëm sa e ka pohuar këtë aspekt të moralit të luftëtarëve tanë, ka bërë që episodi të ketë shumë efekt,

por të mos arrijë të zërthehet në tërë domethënjen e tij, duke lënë përshtypjen ireale sikur me këtë episod synohet më tepër për efekt të jashtëm, të bujshëm.

Një vërejtje pak a shumë të kësaj natyre do të kishim edhe për skenën e bisedës së dy të panjohurve në kala, bisedë që e dëgjojnë të dy fëmijët, heroi me Ilirin, shokun e tij të ngushtë, e cila qëndron krejt më vete me kuriozitetin për kokat e prera, që vendoseshin në një kamare në Stamboll, dhe që kemi përshtypjen se në mënyrë të panevojshme e ndërpret rrjedhën realiste të krejt romanit.

Siç mund të vërehet lehtë në vepër, në plan të parë është vendosur konflikti i thellë antagonist midis popullit dhe okupatorit, por kjo s'e ka zbehur, as minimizuar, edhe aspektin tjetër të konflikteve të brendshme të shoqërisë shqiptare të asaj kohe. Siç vumë në dukje edhe më sipër në këtë analizë të shkurtër të romanit, autori e ka vështruar realitetin dhe njerëzit në mënyrë të diferencuar, duke u nisur nga një pikë vështrimi e përcaktuar ideologjike për të bërë zërthimin e asaj kohe, sigurisht me mjetet dhe mënyrat specifike të artit letrar. Ne i shohim qartë në roman, të dalluar e me kufi të përcaktuar, tërë përfaqësuesit e klasave të pasura, llumin e shoqërisë shqiptare të kohës, tërë ata që tradhëtuan e u bënë spiunë e bashkëpunëtorë të armikut, duke nisur me më të pasurit si Mak Karllashi e deri tek agjentët ordinerë si Maksuti i Nazos. Edhe nëpërmjet mënyrës së veçantë të botës fëmijore, autori ka mundur të gjejë mjetet për ta bërë këtë diferencim, bile me shumë sukses.



Në këtë vepër, sikurse në romanet e mëparshme, I. Kadare ka mundur të ndjekë shtigje të reja forme, që i shkojnë mirë për shtat brendisë dhe ideve të veprës. Dinamika e ngjarjeve, që rrjeshtohen njëra pas tjetrës, moria e mendimeve të derdhura, kërkoi që të

përdorej një formë, e cila t'i jepte dorë autorit që imazhi i kohës të arrihej sa më i plotë në vepër. Përdorimi dhe vendosja ndërmjet kapitujve e copëzave të shkëputura nga kronikat e kohës, është formë e përshtatshme, e gjetur dhe e përdorur me sukses nga autori në këtë roman. Me ato lajme të shkurtra tabloja e jetës së qytetit jepet e plotë, kështu që në vepër s'kemi të bëjmë më me një grusht njerëzish, por me mbarë popullsinë e qytetit, me ngjarjet dhe jetën e masës. Kjo i ka dhënë shumë jetë e frymëmarrje romanit. Kjo mënyrë kompozicionale e ka rreshtur edhe atë të metë, që do të kishim ndjerë në rast të kundërt — përqëndrimin pak si tepër në jetën e vogël të qytetit, në jetën e meskiniteve e thashethemeve. Jo! Te «Kronikë në gur» aspektet e mikrojetës nuk predominojnë dhe nuk janë pa funksion; përkundrazi ato janë në harmoni e në raport të drejtë me krejt imazhin e fuqishëm të realitetit, që na ka dhënë romani, ato i shërbejnë këtij imazhi të veprës.

Edhe ky roman i ri i I. Kadaresë, ndonëse krejt i ndryshëm nga të mëparshmit, është një vepër me vlerë për autorin dhe letërsinë tonë për pasuritë ideore, për densitetin e jashtëzakonshëm jetësor, për humorin e hollë, që e përshkon tej e mbanë dhe për novitetin artistik, që sjell në prozën tonë të gjatë.

1971

ROMANI «STUHIA» I RAMIZ LIKAJ

Pasqyrimi i gjallë dhe bindës i jetës dhe në mënyrë të veçantë i aspekteve më të fundit të saj, është padyshim një kërkesë imperative, që vetë realiteti ynë e shtroi para njerëzve tanë të penës.

Koha kur jeton dhe krijon artisti doemos do të gjejë vend në krijimtarinë e tij, ca më tepër koha jonë me tërë heroizmin e ditëve tona, që gërshetohet në mënyrë harmonioze me romantikën e së ardhmes, me luftën dhe përpjekjet në emër të idealeve të larta të Partisë dhe të popullit.

Ndër veprat e kësaj natyre, krahas tregimeve të shumta, krahas romaneve si «Ara në mal», «Vlaga e dheut», mund të përmendim romanin e parë «Stuhia» të prozatorit të ri Ramiz Likaj, i cili pas novelës «Dallgët e detit», që ishte debuti i tij i parë, iu vu punës dhe realizoi një krijim me shumë kërkesa ideo-artistike siç është romani. Në mos për tjetër, edhe për këtë fakt, autori duhet përshëndetur.

Sikurse dy romanet e botuara kohët e fundit, edhe «Stuhia» qëndron në problematikën e jetës së fshatit, por jo gjithaq të një fshati të prapambetur e të largët malor, se sa më tepër të një fshati që është futur prej kohësh në rrugën kooperativiste, madje e ka të konsoli-

duar këtë rrugë, sigurisht, brenda mundësive reale. Dhe kjo del e qartë në roman. Fizionomia sociale e kësaj kooperative, siç na e ka dhënë autori, ka në vetëvete ata elemente apo ato shtresa, që realisht i gjejmë në kooperativat tona: krahas masës së fshatarëve të bashkuar në kooperativë egzistojnë edhe ekonomitë e vogla individuale, që, si çibanë, molepsin ndërgjegjen e re socialiste, ndikojnë për të keq duke kultivuar te kooperativistët ndjenjën e pronësisë së vogël, të interesimit dhe përkujdesjes për të.

Përpjekja për zhdukjen e kësaj pengese të fundit, përbën një nga problemet në roman, që, për mendimin tonë autori e ka kaluar dhe e ka zgjidhur mjaft lehtësisht. Nëse ky problem do të ishte trangu ideor i veprës, me siguri gjithshka tjetër nga ato probleme që vijëzohen në të, do të gjente rrugë dhe ecuni më të natyrshme. Problem tjetër që ngre vepra dhe që shtjellohet, për mendimin tonë, jo në përmasat e nevojshme, është puna e gjallë produktive e njerëzve në fshat, pasqyrimi i përpjekjeve dhe i luftës për të ecur përpara, qoftë edhe me zigzake, drejt formimit të ndërgjegjshëm, deri në atë masë, sa që njerëzit tanë ta kuptojnë punën si domosdoshmëri, si nder, si forcë reale për të ecur përpara, apo për të zhdukur qëndrimin përbuzës ndaj punës, që shfaqet nëpër individë si trashëgim i moralit feudo-borgjez të dikurshëm.

Duke qenë njohës përsëafërmi i jetës së fshatit, autorit nuk i mbeten jashtë vështrimit artistik edhe problemet etikomorale, të cilat i trajton në raport me qëndrimin moral socialist të shoqërisë sonë dhe kështu, i jep mundësi vetes të dënojë apo përkrahë fenomenet e kësaj natyre, i nisur nga një qëllim i drejtë dhe i shëndoshë. Pavarësisht se sa ia ka arritur kësaj, gjë për të cilën do të flasim më poshtë, në këto shënime, themi se ky fakt duhet parë si qëndrim serioz i autorit në krijimin e vet. Ajo që do të theksojmë që tani, është e keqja që edhe këto probleme delikate dhe pikante në jetën tonë të sotme, nuk zënë vend të dukshëm në rrjedhën

e ngjarjeve në vepër, por janë dhënë në një vështrim tangencial dhe janë zgjidhur, po ashtu, pak si nxitimthi dhe pa forcë bindëse.

Atëhere të lind pyetja: Ç'gjë e ka preokupuar autorin? Cilën nga këto shumë e shumë shfaqje jetësore të realitetit tonë ka vendosur ai në boshtin e subjektit të veprës së vet? Duke i dhënë përgjegje kësaj pyetjeje, të lind mendimi se pikërisht këtu qëndron dhe shkakku apo burimi i dobësive kryesore të veprës. Kryesisht vëmendjen e autorit e ka thëthitur konflikti midis një kryetari kooperative, si Osman Haxhia, njeri i poshtër dhe i pesëqind maskarallëqeve dhe një të riu, që vjen nga radhët e flotës, Besim Jonuzi, i cili pas Letrës së hapur kthehet në fshat të japë kontributin e vet në mbarëvajtjen e kooperativës. Të gjitha të tjerat, ngjarje qofshin apo njerëz, heronj që lëvizin dhe bartin ngjarjet, janë të ndara edhe ato, bile me vijë demarkacioni pro Besimit dhe kundër Osmanit ose pro Osmanit dhe kundër Besimit.

Të kthehemi për një çast te jeta, te ky libër i madh i pashkruar, që është burimi i pashtershëm i frymëzimit për veprat tona. Evenimentet e rëndësishme të këtyre viteve të fundit në jetën tonë synuan në një thellim të mëtejshëm të asaj vije ideologjike dhe politike, që Partia e ndoqi besnikërisht dhe e përpunoi gjatë viteve. Pra nuk ishte fjala për ndonjë përmbysje në këto vitet e fundit, por për një thellim të frymës revolucionare.

Edhe në aspektin e jetës së fshatit, thellimi i revolucionit tonë ideologjik dhe kultural synoi në këtë, që të përmirësohet niveli i jetës së tij, të korigjohen gabimet e vërtetuara në praktikën e veprimtarisë së kooperativave dhe të vihen në vend drejtuesit, të kritikohen ata në gabimet e tyre për hir të së drejtës, sepse edhe ata janë njerëzit tanë, që kanë shkarë, dhe s'janë armiqtë tanë. Kjo që e përgjithshmeja në jetën tonë, ajo që në radhë të parë meriton vendin kryesor në pasqyrimin artistik-emocional në faqet e veprave tona.

A është i kësaj natyre konflikti, që ngrihet në romanin «Stuhia»? A mund ta futim Osman Haxhinë në këtë kategori njerëzish të gabuar? Ashtu si është konceptuar në roman, Osmani është armiku i klasës, njeriu që është futur kontrabandë në radhët e partisë dhe që lufton për qëllimet e veta në mënyrë të fshehtë, por, jo me shumë dinakëri dhe zgjuarësi. Ky tip shoqëror, me të tilla tipare dhe me të tillë synim, ndofta edhe egziston në ndonjë kooperativë; ndofta edhe është i mundshëm, por me siguri s'është tipik, s'përgjithëson. Ai që përgjithëson në këtë kategori njerëzish, është shumë më i ndryshëm. Osman Haxhia është armik klase që ka fshehur kthetrat e tij, se kështu ja ka dashur puna. Këtë autori na e ka dhënë që kur na jep justifikimin «teorik» të veprimeve të personazhit: i ati, njeri dinak dhe i fshehtë, largpamës në veprimet e tij, e këshillon, të birin, Osmanin, të dalë partizan që të mund të sigurojë mallin, se e sheh, aty nga fundi i luftës, që fitorja është e partizanëve. Pra këto janë motivet, që e hedhin Osmanin në lëvizje.

Fshati ku zhvillohen ngjarjet e romanit nuk është nga ata që mbajnë peshën kryesore të Luftës sonë nacionalçlirimtare, por në gjirin e familjeve fshatare pati edhe të tilla, të varfëra, që e përkrahën lëvizjen dhe i strehuan njerëzit e partisë. Pra diferencimi klasor që i qartë dhe i dukshëm edhe në këtë fshat dhe është po aq e qartë se Osman Haxhia me shokë, sado të shtihehin, nuk mund të verbonin njerëzit që me të vërtetë luftuan dhe sakrifikuan për të sotmen. Në këtë vështrim, të duket e pabesueshme që me krijimin e kooperativës, ky Osman të zgjidhet kryetar i saj, madje të jetë njeri me peshë në rreth dhe me besim në parti. Një armik është plotësisht e mundshme që në rrethana të caktuara, të favorshme për të, të veshë «lëkurë qengji», por po në atë fshat, ku Osmanit i njohin dhëmbë e dhëmballë, sikur s'na besohet, dhe autori s'ka mundur ta motivojë se si u bë i mundur një fakt i tillë, që një maskara, të cilin e njeh shumëkush, të vihet në krye të

kooperativës. Për më tepër, ajo që e bën më të pabesueshëm personazhin, është vetë linja e zhvillimit, që ndjek ai në subjektin e romanit. Osmani, pasi është bërë kryetar, për vite me radhë ka abuzuar, bile shumë haptazi. Ai mban një numër të madh bagëtish jashtë sasisë, që i lejon statuti, ka qindra metra tokë më shumë dhe askush s'ia ndal dorën: as organizata e partisë, as udhëheqja e rrethit, madje, edhe kur i zbulohen këto shkelje, ai s'pëson gjë, opinionin për të pothuaj nuk ndryshon dhe kjo të habit, apo më mirë të themi, kjo s'është e vërtetë. Nga ana tjetër Osmani është tip i ulët, imoral, gojëndyrë, e megjithëkëtë, megjithëse disa fshatarë ia dinë këto fëlliqësi, ai s'do t'ia dijë. Për të gjitha këto që renditëm, mendojmë se Osmani nuk është një figurë e krijuar me vërtetësi logjike. Një armik që ka hyrë dinakërisht në parti, s'mund të jetë kaq i pakujdesshëm për sjelljet e veprimet e tij, ndryshe do të qe nëse Osmani do qe një njeri sinqerisht i lidhur me luftën, që më vonë shkau, megjithëse një shkarje kaq të madhe, zor se mund ta besonim te një luftëtar partizan, sado që të qe degraduar ai, apo sado i futur thellë në llumin e poshtërsive të egoizmit mikroborgjez të ishte zhytur ai. Kur rrethi i hekurt i demaskimit vjen duke u ngushtuar dhe e kërcënon serozisht pozitën e tij, Osmani hidhet në veprime të dëshpëruara, që shërbejnë, ashtu si na janë dhënë, për ta shpejtuar fundin e tij. Osmani, para mbledhjes së asamblesë thërret gjithë llumin e fshatit, ata që kanë shpëtuar nga dënimi për krimet e kryera në saje të përkrashjes së kryetarit, dhe kërkon që ata ta mbrojnë dhe, siç merret me mend, njëri pas tjetrit, plehrat e fshatit, i japin besën, por ky komplot bëhet qesharak dhe i pabesueshëm kur Osmani thërret edhe Fitoren, agronomen komuniste, që ta futë në këtë grup të miqve të tij, megjithëse e di mirë që ajo është kundërshtarë e rreptë e tij. Kaq naiv të jetë ky Osman! Inkoseguente është figura e këtij personazhi edhe në shumë raste të tjera: kujtojmë këtu fundin e romanit, kur në fshat vjen kryetari i komitetit ekzekutiv të rre-

thit dhe, në mënyrë aq të pavend, atij i dalin përpara fshatarët e përpunuar nga Osmani. Edhe ky episod është një veprim, që s'tregon një njeri të zgjuar dhe ca më pak një dinak.

Përballë këtij personazhi, që tipizon anë kaq të errëta karakteri, autori ka vendosur dy figura pozitive: Besim Jonuzin, një bashkëfshatar të Osmanit, oficer marine, që vullnetarisht vjen në fshat dhe Veronikën, instruktore e komitetit të partisë së rrethit për zonën ku bën pjesë edhe fshati, ku zhvillohen ngjarjet e romanit.

Si ide, ashtu siç nis dhe me ato qëllime që ka Besimi, autori pasqyron me vërtetësi dhe drejt realitetin tonë të sotëm. Esenca e parullës së Partisë që të shkojmë te masa, të mësojmë prej saj dhe t'i mësojmë asaj, presupozon ndihmën, që duhet të japin kuadrot edhe ndikimin e tyre pozitiv në mënyrë që edhe fshatrat e prapambetura ta kuptojnë drejt dhe shpejt atë që thotë Partia, të renë, dhe ta përkrahin atë. Ky fenomen nuk është diçka e trilluar nga autori. Shumëkush nga ne ka parë dhe ka marrë pjesë në ekipe për në zona malore, apo të prapambetura, me qëllim që të tërhiqet edhe fshati në rrugën e gjerë të jetës socialiste. Por ky fakt nuk injoron të vërtetën e madhe, se vetë në ambientet e fshatrave tona egziston fryma e shëndoshë, dëshira për të ecur përpara, sigurisht këtë frymë mund ta ndeshim jo në gjithë masën e fshatarëve, por së paku në një pjesë të shëndoshë të saj. Dhe kjo pjesë s'duhet harruar.

Thamë se, si nisje, ideja e autorit për të na dhënë një Besim, luftëtar të së resë, s'ka asgjë të keqe. E keqja qëndron në përmasat, që ka marrë ky funksion te Besimi, i cili arrin gati-gati në një hero shpëtimtar, që rivendos normat e shkelura të marrëdhënjeve sociale në fshat, në të gjitha planet e jetës së kooperativistëve. Besimi është filiz i dalë nga një familje e shëndoshë, e lidhur me lëvizjen, pra përfaqësues i asaj shtrese fshatarësh, që u bë forcë aktive e revolucionit tonë popullor. Në këtë të kaluar të tij, ka nisur edhe njohja me Vero-

nikën, dikur partizane. Shkëputja e Besimit për një kohë të gjatë nga jeta e fshatit ka bërë që ai të mos e njohë realisht jetën e sotme të kooperativës, prandaj është e natyrshme që atij t'i bien më tepër në sy anët e meta të jetës, dhe së dyti, duke qenë i edukuar në një ambient të shëndoshë, siç, është jeta në marinën luftarake, ai s'mund të pajtohet me shumë neglizhenca të jetës në kooperativë, apo me shumë shfaqje të qëndrimit indiferent. Por edhe këto motive nuk japin arsye që autori të krijojë me Besimin dhe Veronikën një forcë kaq të ndryshme nga jeta e fshatit, apo, më mirë të themi, të krijojë një fshat, që është kaq larg frymës së re, kaq shumë inaktiv dhe indiferent për çka ndodhin aty. Në këtë situatë Besimi del shpëtimtar i gjendjes së krijuar, vishet me vetija e tipare, që përmbledhin gjithë anët e mira e pozitive të heroit ideal, dhe kështu autori, dashur, padashur, kapet pas skemës në skalitjen e personazhit dhe na e jep atë larg heroit të gjallë, real e të besueshëm, ashtu siç e ka jeta. Në shumicën e episodeve, që vargëzohen në roman, ku luftohet e vjetra, doemos do të ndeshim Besimin: qoftë në verifikimin e pronës së tepërt, që mbajnë disa fshatarë, qoftë në gjallërimin e jetës kulturele në fshat, qoftë në marrëdhënjet familjare të atyre familjeve me një natyrë patriarkale, që e kanë këtë ndjenjë ende mjaft të fortë e të rrënjosur, qoftë në frymën e re ndaj punës, e cila konsiston në ndërgjegjësimin e kooperativistëve, pra është ky, Besimi, që i mëson fshatarët të punojnë për prodhim me cilësi, të mos gënjajnë sa për të realizuar normën, etj. Pikërisht kjo tendencë, që ka ndjekur autori në mpiksjen e personazhit, përbën tendencën shematike, që s'i përgjigjet së vërtetës.

Në raport me antipodin e vet, Besimi është ekuivalent i Osmanit në sens të kundërt me të. Por në këtë përjasje të Besimit me Osmanin të bie në sy një mungesë vijushmërie logjike. Edhe Besimi s'e njeh sa duhet kryetarin e kooperativës, madje në ndonjë rast, ai i shpreh edhe konsideratën Osmanit, për të cilën s'ka

asnjë dyshim dhe, tërë mllefi i mëvonshëm i tij vjen në formë impulsesh, pa ndonjë shkak, apo fërkim të dukshëm. Kjo mënyrë procedimi nëpërmjet shmangjes së konfliktit, që do të lindte nga acarimi i pikëpamjeve të të dy antipodeve, e ka zbutur ashpërsinë e vërtetë të fërkimit real të dy koncepteve diametralisht të kundërta, që përfaqësojnë dy botë. Si rrjedhim, demaskimi final, që i bëhet Osman Haxhisë mbetet pa forcë, kalohet nëpërmjet fjalëve të kryetarit të komitetit ekzekutiv të rrethit, gjë që ka shkaktuar që zgjidhja e konfliktit të mos ketë ashpërsinë e mprehjen e nevojshme. Kjo dobësi pohohet edhe me një fakt tjetër kuptimplotë: shkëndijën e zjarrit kundër Osman Haxhisë e nis një korrespondent vullnetar i gazetës, që na qenka kooperativist, por që deri në këtë moment, ka mbetur krejt i panjohur për ne, bile i paemërtuar. Kjo artificë e panevojshme, ka rrjedhur, mendojmë ne, ngaqë autori s'ka ditur të gjejë e të kundërverë forcat, që realisht ai do t'i gjente në gjirin e masës së fshatarëve kooperativistë.

Ndërsa te Besimi gjejmë disa tipare, që e bëjnë atë një figurë të stisur më tepër se sa reale, Veronika mendojmë se është konceptuar tërësisht si një skemë, që pothuaj s'ka asgjë të natyrshme; që më tepër është e futur nga autori në ngjarjet e veprës. Veronika pothuaj s'ka fare pika takimi shpirtëror me personazhet e tjera, edhe me ndonjë si Marija, ajo nuk arrin të shkrihet, të krijojë afri motre, por mbetet gjithmonë diçka si drejtuese, udhërefyese. Bile, padashur, ajo në ndonjë episod, ka dalë si figurë që s'gëzon simpatinë e të tjerëve, ndonëse autori është munduar të na e japë si grua të lidhur me jetën e fshatarëve, nëpërmjet ndonjë heroizmi të kryer dikur në vitet e luftës (ajo ka vrarë në kohën e luftës Gjeto Mirin, një armik i urryer ky për gjithë fshatin). Pra që të dyja këto figura, Besimi dhe Veronika s'janë të realizuara, kanë shumë mungesa, janë më tepër të krijuara nga autori se sa të qena. Kjo e ka dëmtuar shumë idenë e autorit, që është munduar të përçojë të renë, nëpërmjet tipash të realizuar me doza të shumta skematizmi.

Një vend të rëndësishëm në roman zë edhe pasqyrimi i një ane kryesore në jetën e fshatit tonë sot, që shprehet në aspektin e luftës për emancipimin e gruas. Nëpër skenat dhe ngjarjet e shumta në vepër lëvrijnë tipa të ndryshëm grash dhe vajzash, që nga Maria e deri te Fitorja, të cilat kanë një diçka të përbashkët: luftën kundër trajtimit të diferencuar, pothuaj skllavërues në krahasim me burrin. Ndonëse në shumë raste kjo linjë problemore, e veçantë për nga natyra e vet, është e kapur dhe e vështruar drejt, prapë të bie në sy se edhe në këtë front të luftës sonë ideologjike sot, autori i ka dhënë shumë vend ndërhyrjes dhe ndikimit apo pranisë së Besimit. Ai, që porsa mbërrin në fshat, shkakton shqetësim ndërmjet shumë grave dhe vajzave, madje ndonjëra, që dikur e paska dashur, pendohet për jetën e saj dhe për lumturinë e humbur, fakt ky që në vepër i jep një interpretim të padrejtë problemit. Po kështu deri edhe në luftën për veshjen e lehtë të grave, ai që jo vetëm e nis, por edhe që lufton me qëllim që çdo grua ta ruajë këtë veshje, është Besimi, ndërsa forcën, sado të pakët, por reale, të gruas që lufton për veten e saj, s'e shohim gjëkund. Më sakt është zgjidhur lufta për emancipimin në fatin e Marijes, ndonëse, edhe këtu cedimi i të shoqit është dhënë pak si lehtë dhe jo me forcën e vërtetë të regresit, që i reziston me egërsi moralit të ri.

Në bashkëveprimin e forcave të errësirës, të atyre që përpëliten bashkërisht t'i kundërvihen së resë, autori nuk ka harruar të evidencojë edhe një nga komponentet kryesore të saj, fenë të mishëruar te hoxha i fshatit, mulla Deliu. Në gjithë historinë e veprimtarisë së tij është synuar dhe është arritur portretizimi i një kleriku armik, i cili jo vetëm ka rrjepur dhe mashtruar, por tinëzisht ka luftuar dhe lufton rendin tonë nëpërmjet helmit të ideologjisë «së shenjtë», që ua servir tradhëtarëve e të mykurve. Ne e urrejmë hoxhën, kur mësojmë krimin e tij të shëmtuar vite më parë, sepse e njohim atë si armik pa skrupull, që s'ndalet përpara asnjë mjeti

për të realizuar qëllimin e tij, por e urrejmë ca më tepër, kur njohim vazhden e sotme të veprimeve të tij të fëlliqura në dëm të ideve dhe frymës së re. Hoxha mundohet si e si që të pengojë idetë dhe veprimet e Besimit, madje ai synon deri aty sa të diskreditojë apo të zhdukë Besimin. Por mbetet e pamotivuar akti i tij i fundit, vrasja e Qamiles, akt i cili e çon atë në demaskimin e plotë, themi i pamotivuar, se s'na duket bindëse që një hoxhë i tillë, i rrahur me vaj e me uthull, mjaft dinak, të pranojë të japë doza të forta helmi sa ta helmtojë Qamilen pa pasur ndonjë shtyrje të fortë, apo arësye bindëse. Edhe në këtë rast kemi një «deus eks machina», që përdor autori për të larë hesapet me hoxhën.

Autori i romanit «Stuhia» në krijimin e veprës ka përdorur një material të pasur jetësor dhe për këtë na bind larmia e problemeve, galeria e madhe e personazheve, duke nënkuptuar këtu edhe ata që sapo janë skicuar aty-këtu nëpër episode etj. Vetëm se atij i duhej një punë e madhe dhe më e kujdesshme për t'u ngritur mbi faktet konkrete jetësore, për të përgjithësuar ato fenomene e shfaqje, që ka ndeshur në realitetin rrethues në mënyrë që vepra të dilte nga caqet e kornizës së ngushtë të fenomeneve, që mund të ndodhin në një fshat iks, që njeh për së afërmi autori. Kështu personazhet, fenomenet do të merrnin një shtrirje më të gjerë dhe do të fitonin mjaft në vërtetësinë e tyre.

Është anë inkurajuese, pozitive fakti që vepra ka një arkitekturë relativisht të saktë. Autori i ri, Ramiz Likaj, e ka manovruar me shkathësi bagazhin e pasur të episodeve, që ka derdhur në vepër. Nga kapitulli në kapitull kalohet natyrshëm dhe tërë episodet, që vijjnë njëri pas tjetrit nuk humbin vijueshmërinë në kujtesën e lexuesit.

Ndonëse në këto mendime të hedhura për këtë roman, ne u ndalëm kryesisht në anët e porealizuara, nuk duam të injorojmë meritat dhe vlerat, që objektivisht i ndeshim në vepër, sado modeste qofshin ato. Për mendimin tonë kjo sprovë e parë e këtij autori të ri në gjininë

e vështirë të romanit, tregon në mënyrë elokumente se forcat tona krijuese janë të pashtershme, nga ana tjetër romani «Stuhia» duhet t'i shërbejë si Ramizit, ashtu edhe shumë penave të tjera të reja premtuese për letërsinë tonë, që të kuptojnë se kërkesat e artit tonë letrar të realizmit socialist janë të tilla që shtrojnë përpara shkrimtarëve tanë, e veçanërisht përpara talentëve të reja, nevojën për një punë të madhe këmbëngulëse me qëllim që të njohin gjithmonë e më thellë filozofinë e klasës punëtore, marksizëm-leninizmin, materialet e Partisë sonë si dhe veprat e shokut Enver Hoxha, pa nënvleftësuar punën për përvetësimin dhe perfeksionimin e mjeshtërisë së shkrimtarit, në mënyrë që veprat tona letrare të jenë të denja për t'i bërë jehonë heroizmit të ditëve tona, të jenë të atilla që të komunikojnë me lexuesin, të përçojnë të renë tek ai dhe ta edukojnë atë duke i ngjallur emocione estetike.

1969

MBRESA DHE MENDIME PËR NJË VËLLIM ME TREGIME

Ndër tregimet me temë aktuale, që përfshihen në vëllimin e Sotir Antonit «Kur merrnim fluturim», është pozitiv fakti që autorin e preokupojnë probleme të jetës së fshatit tonë sot, të cilat ai i njeh dhe i vështron duke u nisur nga një kënd i shëndoshë. Ai dënon kështu ato dobësi e të meta, që pengojnë ecjen e së resë, triumfin e saj. Kjo mënyrë e të vështruarit të realitetit i ka dhënë dorë autorit të kapë të tilla probleme të rëndësishme si: luftën në ndërgjegjen e njerëzve, të cilët ambientin, shoqëria jonë me frymën e re morale i detyron të heqin dorë nga rruga e tyre; konservatorizmin, lidhjen me të vjetrën në emër të «zakonit e nderit», lidhjen me të vjetrën në emër të ambicjes, dembelizmin e vetëkënaqjen, lakminë për pasuri e fitim me rrugë sa më të lehtë, pa mundim e në dëm të kolektivit dhe të pronës së përbashkët etj. Krahas një problematike të tillë, gjejmë në vëllim edhe tregime ku të bie në sy që autori ngre lart njeriun e ri me ideale të mëdha, i cili, të gjitha fuqitë e veta ja kushton një qëllimi fisnik: mirëqenjes dhe jetës së lumtur të popullit. Këto tregime, ndonëse më të pakëta në vëllim (ato janë vetëm dy: «Kam të bëj me tokën, me bukën e njerëzve» dhe «Legjenda e ujit»), ngërthejnë aspekte më tipike e më të përha-

pura sot ndër ne, përfaqësojnë më me vërtetësi ritmikën e jetës sonë aq sa të vjen keq që ata janë vetëm dy.

Në jetë ka gjithmonë vend për vepra të denja, mjafton që të egzistojë dëshira për të qenë i dobishëm, i nevojshëm për popullin tënd, pa s'ka rëndësi se ku e ke frontin e luftës. Të tilla përfaqësojnë janë mendimet e Xhako Xhaferrit, heroit të tregimit «Kam të bëj me tokën, me bukën e njerëzve», i cili kthehet në fshatin e tij të varfër malor me mendimin që forcat dhe dijet e tij t'i përdorë për të mirën e bashkëfshatarëve. Këtë ide autori e realizon në tregim në mënyrë të natyrshme, duke derdhur me vërtetësi skena jete e duke ravijëzuar me pak penelata tipa të ndryshëm, që mbartin e japin qëndrime të ndryshme ideo-emocionale, të cilat autori i gërsheton në funksion të qëllimit kryesor për të nxjerrë në pah luftën ndërmjet së resë, që po flakëron më me shkëlqim dhe së vjetrës që, ndonëse vetëm po regëtin, prapë duhet goditur derisa të shuhet fare. Pas një ekspozicioni relativisht të gjatë, autori shtron problemin, që përfshin në fakt konfliktin e tregimit. Ky konflikt gjen shprehjen në përplasjen e dy koncepteve të kundërta rreth mundësisë për të hapur toka buke në fshat. Siç është e logjikshme, të renë, revolucionaren, pra, iniciativën për të hapur këto toka, e përfaqëson Xhakua, por autori nuk e lë gjithshka në duart e heroit. Xhakua është, si të thuash, vetëm si shkëndija e parë, që ndez atë atmosferë të përgatitur për të shpërthyer. Fshatarët, sidomos të rinjtë, kanë po ato qëllime dhe dëshira sikurse Xhakua. Ky fakt shpreh një mendim shumë të rëndësishëm të kohës dhe pikërisht mendimin që tanimë iniciativat revolucionare për të ecur përpara ziejnë në gjirin e vetë masës, që fshatarësia jonë kooperativiste e ka bërë të sajën parullën e partisë për të siguruar bukën në vend, për të ndërtuar socializmin me forcat tona.

Konflikti i tregimit mprihet sidomos në mbledhjen e fshatit, ku ndeshim edhe përfaqësues të brezit të vjetër, që ruajnë konservatorizmin dhe frymën patriarkale apo

që mbartin një mentalitet të kalbur e nihilist. Xha Resuli, përfaqësuesi i kësaj rryme regresive, është vizatuar realisht jo vetëm si personazh, por edhe si mishërim i asaj ideologjie, që çdo ditë po humb terren. Në tregim tipat na duken të realizuar në detajet psikologjike, që shkrimtari ka ditur të përdorë për secilin; ai futet në shpirtin e tyre duke zbërthyer mendime e dëshira, që na i zbulojnë ata. Ndërsa Xhakua po kthehet pas studimeve në fshat, ai mendon: «S'është zotësi të ngresh folenë në majën e një lisi, jo. Më mirë shko në vatrën tënde, atje zërë vend, puno, nguliti rrënjët thellë në tokën, që të njeh e bëhu lis ti vetë. A mund të bëhesh lis? ... Po, mundesh, sepse në fund të fundit lisi mbin nga një lende fare e vogël.» Nga ana tjetër, jo rastësisht, autori, gjatë diskutimit të xha Resulit, na e jep këtë në tre pozicione: së pari, ai sheh përtokë, pastaj vështron në kurrizin e shokëve, që ka përpara e, së treti, hedh sytë që ta shohë ballazi Xhakon, po në këtë gradacion rritet edhe respekti dhe konsiderata për djaloshin «... Por xha Resuli tashti e ngriti kryet mirë, tashti iu duk Xhakua më i rritur, iu bë se me të mund të matej pa u turpëruar në sy të shokëve.»

Mbi një bazë kontradiktash të tilla jo antagonistike po triumfon e reja sot në jetën tonë. Dhe është kjo veti e kohës, të cilën autori, si themel, e vendos edhe në ndonjë tregim tjetër të vëllimit, p.sh. te «Legjenda e ujit» ku, megjithëse subjektin interesant, fabula e tregimit është e zbetë dhe personazhet nuk rilevohen aq sa duhet. Kur lexon këtë tregim të dytë, të krijohet përshtypja se autori është kënaqur me idenë, që ka mundur të kapë dhe s'është shqetësuar shumë për situatat, episodet, karakteret, të cilat na duket se do ta kishin ngulitur më mirë idenë te lexuesit.

Na bie në sy se në disa tregime të këtij vëllimi, gjithmonë me temë aktuale, Sotir Andoni vë në qendër të subjektit jo fenomenin pozitiv; por negativin. Kjo mënyrë të proceduari në vepër letrare (pa marrë parasysh faktin se sa ka arritur autori ta realizojë nga ana artis-

tike, gjë për të cilën do të flasim më poshtë) mendojmë se nuk është një rrugë e gjetur drejt. Megjithatë, autori e pasqyron realitetin në mënyrë dialektike, e, bashkë me shtjellimin e subjektit, zhvillohen, rriten, pësojnë ndryshime edhe heronjtë e veprës letrare, rrjedhimisht pra edhe ata ndërrojnë botëkuptimin, mentalitetet e tyre, si dhe zhvishen nga veset apo të metat e tjera në karakterin e tyre.

Ndër tregimet e kësaj natyre, më i realizuari na duket «Para burimit, kundrejt fshatit». Ky tregim, jo vetëm për afërinë problematike, por edhe për procedimin e ngjajshëm kompozicional paraqet analogji me tregimet «Pendimi» dhe «Shtërgjet». Në qendër të tregimit është figura e Çote Larjes, që dikur ka vjedhur në mallin e kooperativës. Për këtë faj është kapur dhe është dënuar me gjashtë vjet burg. Kur nis tregimi, Çotja, që është falur pasi ka krye tre vjet nga dënimi, ka ardhur fshehurazi me vendimin e prerë që të largohet nga fshati, (të cilin ai edhe tashti e do shumë) nga miqtë e shokët dhe nga vajza e tij e vogël treveçare, që e pat lënë foshnje dhe që tashti s'e njeh fare. Në fshat Çotja vjen vetëm të marrë një certifikatë, por ja do puna, megjithëse ka ardhur fshehurazi, t'i shfaqet xha Manos dhe bashkëmoshatarit të tij, Lilos. Janë këta të dy që, më në fund, ja mbushin mendjen që të qëndrojnë. Edhe nga kjo paraqitje shumë e zbetë dhe e përgjithshme e subjektit, mund të kuptojmë se strumbullarin ideor të tregimit e përbën kundërvënja e ambientit tonë shoqëror, e anëve të shëndosha të jetës së fshatit kooperativist, ndaj elementit negativ, duke nxjerrë në pah se realiteti ynë nuk i pranon shëmtimet morale, se ai ka forcë të plotë për t'i mposhtur ato.

Mendojmë se do të qe me vend të dinim pse Çote Larja, dikur ka shkarë dhe është bërë vjedhës. Në ç'rrethana është ndodhur? Çfarë e ka shtyrë të vërë dorë në pasurinë e përbashkët?

Në një plan të tillë ideor është shtruar edhe tregimi tjetër «Pendimi», ndonëse shtjellimi i subjektit dhe që-

ndrimi i autorit nuk është dhënë në po atë mënyrë njeri nga matike, por më tepër në një frymë humoristike për së Nagallja, heroi i tregimit, që është edhe dembeli tipik-është një figurë e gjallë, konkrete dhe e besueshme. Ai ka tipare, që e individualizojnë, që i japin mish dhe gjak. Këtë autori ka mundur ta realizojë nëpërmjet shumë detajeve të gjetura dhe individualizuese. Panua ka qejf gjumin, muhabetin, ai i shmanget çdo pune, s'do ta lodhë trupin dhe kokën për asgjë. Pra, mund të themi, se ky lloj njeriu, edhe pse jeton në një kohë tjetër, në rrethana dhe ambiente fare të ndryshme me ato që kultivonin dikur njerëz të tillë, prapë ruan mentalitetin e kënaqësitë e pronarit të vogël, e mikroborgjezit. Autori, për ta stigmatizuar këtë tip negativ, jo vetëm e vë në lojë sidomos nëpërmjet personazheve të tjera, por gjatë gjithë tregimit nënvizon mendimin se gjithmonë e më shumë bëhet e vështirë që tipa të tillë të mund të veçtojnë lirshëm te ne, në jetën tonë. Pikërisht ky konkluzion është edhe dënimi më i ashpër, që u jep koha jonë njerëzve të kallëpit të Pano Nagalles. Fundi i tregimit na duket i shpejtuar dhe naiv, s'e kemi fjalën që t'i kërkojmë autorit të na shpjegojë se ç'rugë do të marrë Panua më pas, nëse do të bëjë kthesë apo jo, por do të qe më me përfitim për tregimin që Panua të fshikullohej më ashpër, këtë e kërkon bile edhe vetë linja, që ndjek personazhi.

Lufta kundër së vjetrës, që materializohet, në formën e lakmisë për fitim, si te tregimi «Shtërgjet», apo në formën e bindjeve e koncepteve të mykura patriarkale, si te tregimi «Nënkryetar Nexhipi» është një shprehje reale, që i përgjegjet asaj që në të vërtetë po zhvillohet sot në shoqërinë tonë. Por me gjithë këtë meritë, e cila, sigurisht, është e dorës së parë dhe u jep vlerën tregimeve, ne do të kishim ndonjë vërejtje për realizimin artistik të të dy tregimeve.

«Shtërgjet» është një tregim ku autori ka për qëllim të na kallëzojë se në fshatin tonë po luftohet kundër ndjenjës së pasurimit nëpërmjet rrugësh të lehta

e të pandershme. Dhe konkretisht në tregim luftohet kundër dëshirës, që kanë disa fshatarë, të cilët, për t'u pasuruar, dimrit, lënë fshatin dhe shtegtojnë deri në malësinë e Krrabës për të bërë qymyr. Ndër ta është dhe heroi i tregimit, Palua i Kiço Brojës, i cili, në fund të tregimit, kur është në Krrabë bashkë me të atin dhe nja dy pleq të tjerë, merr një letër nga e dashura dhe braktis të atin e kthehet në fshat. Pikërisht këtë kthesë autori s'ka mundur ta përlligjë plotësisht. Palua, i cili në fillim të tregimit është i vendosur dhe s'tundet nga e tija, megjithëse atij i flet vëllai, Vasili dhe vajza që e do, ai prapë s'heq dorë. Por ja, papritmas, mjafton vetëm letra, që i ngjall kujtime, për ta bërë Palon që të largohet nga shtërgjet (pleqtë) e të shkojë në fshat. Pse ndodhi kjo? Për lexuesin nuk del shumë e qartë.

Ndërsa te «Nënkryetar Nexhipi», figura e Zenit, njërit prej personazheve kryesore, na duket se s'është e realizuar në atë masë sa që t'i kundërvihet denjësisht Nexhipit, që është shumë më i skalitur si karakter. I vetmi moment, ku autori na ka dhënë një Zen, që vepron në atë masë sa t'i përgjegjet misionit, që ka në tregim, është në fund kur ndeshen në pyll ungj e nip në episodin kuptimplotë të shkulljes së koshit. Ndërsa gjetkë më tepër kemi të bëjmë me një personazh që, për hir të dëshirës së autorit e jo të logjikës së jetës, në rrethana e për arsye që ne s'i lexojmë e s'i ndeshim gjëkund, arrin të bëhet kryetar i kooperativës së bashkuar! Po kështu, ndonëse Zeni përfaqëson të renë, ai nuk ndeshet asnjëherë, bile dhe kur takohet me të gjyshin, nuk ka atë forcë bindëse argumentacioni për të luftuar konceptet e gabuara patriarkale të plakut. Pra, të krijohet përshtypja se ky më tepër është një hije pa shumë vërtetësi jetësore, që autori e përdor simbas interesit të vet.

Sikurse edhe në vëllimet e mëparshme, edhe te ky, në një masë më të vogël, është trajtuar tema e Luftës nacionalçlirimtare. Nëpërmjet kësaj teme autori ka dhënë heroizmin e luftëtarëve partizanë, shpirtin e lartë të sakrificës, që gërshëtohen bukur me ndjenjat e holla

shpirtërore. «Kur merrnim fluturim» është njeri nga këta. Kur shfleton faqet e këtij tregimi, njeh për së afërmi njerëz dhe ngjarje, që të ngjallin admirim, kupton më mirë se sa e vështirë dhe heroike ka qenë rruga nga kaluan prindërit tanë për të sjellë këto ditë. Me vërtetësi në tregim gjen vend mendimi se lufta e partizanëve tanë për liri pati gjithmonë përkrahjen e pakursyer të popullit që e strehoi, e ushqeu, e mbathi luftëtarin e tij kur mundi e sa mundi. Heroi i tregimit, që autori e ka shtjelluar duke e vendosur krejt kallëzimin në vetën e parë, e kryen me sukses detyrën; mban e ushqen tre shokë të plagosur me ushqimet, ilaçet dhe veshjet, që i japin në fshat. Përveç kësaj ideje, te ky partizan është skalitur komunisti, luftëtari i gatshëm për të qenë gjithmonë në vijën e parë. Tregimi, që kryesisht mbështetet mbi ngjarjet, që përshkruhen, ka tërësi organike dhe koherencë, me përjashtim të atij çasti kur partizani lë shokët dhe vendos të kthehet prapsht në mal. Ç'e shtyn partizanin të marrë këtë vendim? Cilat janë motivet, që e bëjnë atë të mos i bindet urdhërit? Nëse do të mendonim që për këtë kthesë që shkak dashuria për vajzën ilegale, kjo do të na dukej jo e drejtë për mënyrën si i ka konceptuar e shtjelluar këto linja autori. Arësye tjetër nuk mund të gjesh, se dëshira e heroit për të luftuar nuk kishte përse të pengohej në qytet. Aso kohe lufta kundër okupatorit zhvillohej si në fshat, edhe në qytet.

Idenë e fuqishme se Lufta nacionalçlirimtare që në të njëjtën kohë edhe një lëvizje gjigante, që hoqi nga sytë e njerëzve të mashtruar perden e demagogjisë së tradhëtarëve, e gjejmë të plazmuar mjeshtërisht te tregimi «Shtëpia e Sherifit në majë të gërxxhit». Ndryshe nga sa pamë te të tjerët, ky tregim mbahet kryesisht në karakterin e heroit, që ka gdhendur autori. Sherifi është malësori trim dhe i besës, megjithëse i varfër, ai ka rënë në rjetën e demagogjisë së tradhëtarëve dhe është bashkuar me ta. Se sa i pathemeltë është ky bashkim, kuptohet lehtë nga fakti që vetëm një takim me parti-

zanët i mjafton atij për t'iu shembur bindjet dhe mendimet e vjetra. Ai sheh se ndryshe nga ç'i kishin thënë, partizanët s'janë të huaj, por shqiptarë e madje po aq të varfër sa ai vetë. Atë e mahnit trimëria dhe guximi i tyre, dashuria dhe shpirti i pastër i partizanëve, karakteristika këto që autori na i jep nëpër një sërë episodesh, që rrjedhin në mënyrë të natyrshme në tregim. Të gjitha këto e bëjnë të mendojë Sherifin, e bëjnë të bluajë në kokë shumë gjëra, që deri dje i shihte dhe i kuptonte ndryshe, andaj ai, si malësor me karakter, ndonëse deri në takimin me partizanët i konsideronte si armiq, tashti që po i udhëheq nëpër terr e tufan, u shërben besnikërisht «... Hej, dreq! Po sikur t'i zvarris poshtë e lart? Jo, jo, atë s'e bëj, është pabesi. Jo, jo! Më mirë ngordh si qen.» Edhe kthesa shpirtërore e Sherifit është diçka e logjikshme, që vjen në mënyrë graduale, që vjen si rrjedhim logjik dhe jo artificialisht si një dëshirë e autorit.

Kurse te tregimi «Mulliri i trimave» për mendimin, tonë autori nuk ja ka qëlluar idesë, që do të shprehë. Te ky tregim, që më drejt do të qe të quhej një përshkrim letrar, nuk gjejmë asnjë episod, që të ngjallë interes, as edhe ndonjë personazh, i cili qoftë dhe pak, të ketë një individualitet, të përgjithësojë apo të tipizojë diçka nga ajo kohë heroike, ku e ka marrë subjektin autori. Tregimi do të flasë për trimërinë e dy luftëtarëve, të cilët në fakt nuk kryejnë ndonjë akt që t'i dallojë, përveçse qëndrojnë të fshehur nën gërmadhat e mullirit, që rrëzohet nga bombardimi, por, që lumtërisht, nuk i vret luftëtarët. Këta, në fund të tregimit, shpëtohen nga shokët. Ky tregim është vetëm një ndodhi, që, po të inkuadrohej me episode të tjera, mund të kishte një farë funksioni, por kështu më vete domethënjën e ka shumë të zbetë. Do të qe më mirë që të mos përfshihej fare në vëllim.

Në disa tregime të tjera të vëllimit autorit i ka ngjallur interes e kaluara, koha kur populli ynë, i shtypur e i mjerë nga sundimi i egër feudal, vuante dhe revoltohej

kundër sundimtarëve të egër feudo-borgjezë. Duke kapur e pasqyruar copëza nga ajo jetë e rëndë, shkrimtari, përpiket të vërë gishtin mbi plagët e së kaluarës gjithmonë në funksion të edukimit klasor të lexuesit e veçanërisht të rinisë.

Në tregimin «Kur hynte drapëri në ara», duke ironizuar me figurën e një feudali tipik të kohës, autori është munduar të dënojë në plan humoristik gjithë atë skotë parazitësh, xhahilash, injorantësh, që i shtrydhnin kripë mbi kokë popullit. Këta sundimtarë të urryer ishin të etur për të rrëmbyer gjithshka, bile edhe nderin e njerëzve të varfër. Ndonëse Myftar aga Pollonica, heroi i tregimit, pëson një fund tragjikomik, që na bën të vëmë buzën në gaz kur e lexojmë tregimin, kjo s'e zbut aspak urrejtjen tonë, por thëthnin prej nesh, bashkë me urrejtjen, edhe përbuzjen tonë, neverinë tonë. Vështrimit të autorit në këto lloj tregimesh nuk i shpëton as aspekti tjetër i rëndësishëm i atij realiteti, që ishte protesta kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, protestë që manifestohet në forma e shkallë të ndryshme. Sulmi i grave të fshatit kundër Myftar agait nuk është një shpërthim i çastit për gënjeshtëri, që u kurdisi agai fshatarkave, por është rezultat i vuajtjeve dhe dhembjeve të shumta, që njerëz të atij kallëpi i shkaktonin popullit, është shfryrja e gjithë helmit të grumbulluar.

Të bie në sy se si në këtë, ashtu edhe në tregimin «Te shkronja K e alfabetit» tipat negativë të shoqërisë së atëhershme, autori i sheh kryesisht si njerëz, te të cilët e keqja më e madhe është imoraliteti. Qoftë Myftar Pollonica, qoftë Frrok Çali i tregimit të dytë, lëpihen dhe jargosen kur shohin gratë e botës dhe madje janë gati që çdo gjë: pasurinë, pozitën etj. t'i flakin tej për të arritur qëllimet e tyre të ulëta. Natyrisht, kjo që një e vërtetë e shëmtuar e kohës; degjenerimi i klasave të pasura dihet që s'kishte anë e udhë. Por të shohësh vetëm këtë aspekt nga ai realitet, na duket një minimizim i padrejtë i kontradiktave antagonistike klasore, që e brennin së brendshmi shoqërinë shqiptare të asaj kohe.

Edhe te tregimi «Intervistë me një turist», ndonëse pak më ndryshe, po të njëjtën plagë ka prekur autori. Urrejtjen klasore dhe antagonizmin klasor midis të pasurve e të varfërve këtu e shohim më gjerësisht. Feudali, Bezat beu, nuk është një donzhuan, por një gjakpirës i pashpirt, që të kujton feudalët e mesjetës. Ai nuk lë njeri të kalojë i qetë rrugës për në punë të vet, ai ka lëshuar «qentë dhe zagarët» e tij që të mos lërë shqiptar të mësojë gjuhën amtare. Kështu, me këto tipare, që i janë veshur personazhit, ne formojmë një ide më të qartë për figurën e urryer të feudalit shqiptar. Pjesa e dytë e këtij tregimi, që zgjatet në përshkrime të udhëtimit nëpër Greqi, ku heroi kërkon mikun e rinisë së vet, e sidomos disa episode, sikur e rëndojnë më kot tregimin dhe i japin një karakter aventuroz. Ideja do të dilte e plotë, na duket neve, edhe sikur tregimi të mbyllej me arratisjen e të dy shokëve.

Edhe te ky vëllim vërehen tiparet dalluese të krijimtarisë letrare të këtij prozatori të talentuar, tregimet e të cilit janë të pasura në detaje e plot kolorit. Në to zënë vend edhe probleme e aspekte të jetës së sotme të fshatit, të cilën e njeh mirë autori, apo mbresa të gjalla të epopesë së lavdishme të Luftës nacionalçlirimtare dhe të së kaluarës historike. Pa dyshim thellimi në jetë, pasqyrimi sa më besnik i transformimeve revolucionare, të ndërgjegjes së njerëzve tanë, i revolucionarizimit të jetës sonë, do të bëjnë që edhe në të ardhmen autori të na japë vepra gjithnjë e më dinjitoze, më të bukura.

1967

NOVELA «PATAT E EGRA» E FATOS ARAPIT

Poeti Fatos Arapi edhe më parë e ka provuar penën e tij në prozë dhe na ka dhënë ndonjë tregim të goditur, që ka dëshmuar për aftësitë e këtij autori për të lëvruar me sukses edhe ndonjë gjini të rëndësishme dhe të dashur të prozës për lexuesin, siç është tregimi. Kohët e fundit ai e ka shpeshuar këtë lloj krijimtarie duke na dhënë të parën novelë të tij, gjë që dëshmon për mundësitë e këtij autori në këtë drejtim të ri letrar për të.

Tema e patriarkalizmit, e vështruar në një nga aspektet e saj me të përhapura e me të mprehta, në aspektin e luftës së femrës për emancipimin e saj në ditët tona, e ka preokupuar edhe Fatos Arapin. I nisur direkt nga ajo që i sugjeron jeta, shkrimtari, si vërejtës i hollë i realitetit, e vështron fenomenin pikërisht në gjirin e kësaj jete dhe nepërmjet tij, ai përgjithëson duke zbuluar forcat e kundërta, që në ndeshjen midis tyre, vënë në pah dy anët e kundërta: të vjetrën dhe të renë, patriarkalen dhe revolucionaren.

Konfliktin autori e ka vështruar dhe e ka trajtuar si konflikt familjar, por kjo s'e ka penguar që t'i japë këtij një shtrirje jashtë suazës së ngushtë të familjes, duke e vënë në shumë pika takimi me ambientin shoqëror,

me forcat jashtë familjes, që ndikojnë drejtëpërsëdrejti në jetën e brendshme e intime të vetë familjes apo konkretisht në fatin e heronjve.

Meritë e autorit është se në novelë, në qendër ka vendosur të renë, gruan e ditëve tona, e cila vetë lufton për të kapërcyer vështirësi e pengesa të ndryshme në rrugën e saj për të qenë e pavarur, e lirë në jetë, pra ai si të thuash, nuk ka parë përparimin e së resë vetëm nëpërmjet të dekompozimit të së vjetrës, e cila kalbëzohet dhe detyrohet nga realiteti ynë të leshojë terren, por e sheh procesin duke pasur në qendër progresin e së resë, përpjekjen dhe luftën e saj që e detyron të vjetrën të tërhiqet.

Drita, heroina e novelës, është mishërim e tipizim i forcës së të resë, ajo ecën dhe rritet në protestën e vet duke u pasuruar si tip para syve të lexuesit. Këtë qëllim që ka ndjekur, autori mundohet ta realizojë në tërë lindjen e heroinës, por kemi përshtypjen se kjo herë-herë nuk është motivuar dhe si rrjedhim ka mbetur e zbetë dhe jo bindëse vende-vende. Drita është një vajzë shtëpiake, e mbyllur brenda mureve të shtëpisë, nga presioni i të atit, Vangjelit, që tipizon apo përfaqëson të vjetrën. Duke na dhënë në mjaft raste botën e brendshme të heroinës, autori na ka dhënë mundësinë që ta njohim për së afërmi personazhin në mendimet, ndjenjat dhe dëshirat e saj dhe pikërisht këtu ne njohim Dritën si një vajzë të pakënaqur nga jeta përreth, të irituar në shpirt, ndonëse këto dallgë shpirtërore të saj vajza mundohet t'i ndryjë në vetëvete për të mos u sjellë pakënaqësi prindërve. Iritimi i Dritës do shteg, që të shpërthejë, kjo është e kuptueshme, megjithëse ajo e ndryn dhe mundohet ta frenojë në shpirtin e saj revoltën, sepse të tilla janë rrethanat dhe i tillë është ambienti familjar, që i imponohet.

Por autori, duke e zbërthyer në psikologjinë e vet personazhin, ka rast e mundësi të na bëjë të njohur neve hovet e brendshme të Dritës, që hëpërhë nuk manifestohen në veprimet e saj. Këtu na duket se i është

mëshuar më tepër se sa do të që e natyrshme për një vajzë, (ndonëse është e mbyllur brenda mureve të shtëpisë, ajo është rritur në ditët tona, në gjirin e shoqërisë e të rinisë sonë, pra me idealet e mëdha të epokës sonë) paraqitjes së dëshirave dhe ëndrrës së saj për një të dashur, përfytyrimeve të saj se si do të jetë ky i dashur, madje që në bangat e shkollës Drita na paskësh qenë e preokupuar vetëm me këtë «hall», se si do të jetë burri i saj i ardhshëm. Këtë ajo e kërkon midis shoqëve të klasës dhe s'e gjen, midis mësuesve të saj e kudo. Ndërsa tashti pas shkollës, kur ajo po merret me pajën, gjithë shqetësimi i saj është vetëm për burrin. Është e kuptueshme dhe e besueshme që për vajzën, ashtu sikurse për djalin, çështja e ndjenjës, e dashurisë midis tyre, përbën një preokupim shpirtëror për ta, por ta bësh këtë sot të vetmin qëllim të heroinës, na duket se egzagjerohet e tejkalohet kufiri i masës. Aspekti i dytë i jetës së heroinës në novelë është përpjekja e saj për t'u futur në punë, për të thyer konceptet e prindërve, të ambientit mikroborgjez familjar, për të filluar një jetë të denjë në radhët e klasës punëtore. Kjo përbën anën më kryesore, më thelbësoren të linjës së personazhit në novelë. Këtu autori e lë mënjanë fare ndjenjën e dashurisë së heroinës, me të cilën u mor aq gjatë në pjesën e parë dhe merret vetëm me luftën e saj kundër edhe të shoqit të ardhshëm, i cili edhe ky manifeston një qëndrim mikroborgjez, megjithëse më të moderuar se ai i Vangjelit. Iliri s'është kundër që Drita të hyjë në punë, po do një punë intelektuale për të fejuarën. Sido që të jetë, ai ka pika takimi në botëkuptim, me të vjehrrin. Atë ndjenjë dashurie të përfytyruar, tani e gjejmë të topitur te Drita, kurse tek Iliri ajo ka marrë më shumë nuanca sensualizmi, si një llojë marrëdhënesh ku ndjenja pothuaj është vyshkur plotësisht. Ky kapërcim i pamotivuar në vizatimin, që u bën autori linjave dhe karaktereve, na duket pak i shpejtuar dhe pa forcë bindëse realiste.

Në momentin e dytë, siç thamë edhe më sipër, në

përpjekjet e Dritës për t'u shkëputur nga bota e ngushtë, autori e ka lënë vetëm heroinën në përpjekjet e saj, këtë ndoshta e ka bërë për të nënvizuar se ajo vetë, gruaja dhe vajza jonë, pra, duhet të jetë luftëtare e të drejtave të saj, dhe ka vepruar drejt. Por s'e gjejmë me vend dhe të mjaftueshëm për të na bindur, ndikimin e ambientit punëtor të Drita, që e bëri atë aq të guximshme e të vendosur, saqë të ngrihet jo vetëm kundër të atit, të cilit është drojtur dhe e ka kursyer deri në atë moment, si njeri të sëmurë, por edhe kundër të fejuarit, edhe kundër dashurisë. Që të arrinte këtu, Drita s'duhej të qe ajo që na është dhënë në pjesën e parë të novelës, por duhej të qe një tip tjetër, më i hedhur, më luftarak i vajzave tona.

Ndikimin e ambientit punëtor në ndryshimet e qëndrimit të heroinës, forcën që e armatos atë me kurajën dhe guximin e klasës në luftën e saj, autori e ka përçuar deri të heroina nëpërmjet të shoqes së fëmijnisë së Dritës, nëpërmjet të Laureshës, që tani punon në kombinatin e tekstitit. Po për këtë qëllim ai e shpie edhe heroinën një herë në kombinat, ku ajo e udhëhequr nga Lauresha njih procesin e punës dhe ambientin punëtor. Kjo na duket shumë pak për të ndikuar aq rrënjësisht në bindjet e heroinës, e cila në luftën e saj pas këtij çasti, fiton një vendosmëri e qëndrim këmbëngulës, të pakrahueshëm **me atë të mëparshmin**. Ndofta do të duhejshin mjete dhe rrugë të tjera për ta motivuar më plotësisht këtë gjë, që autori s'arrin ta bëjë brenda caqeve të ngushta të novelës, por që mendojmë se do të kishte interes për procesin jetësor të përshkruar në novelë, sepse realisht në jetën tonë është një aspekt, që ndikon shumë në jetën e rinisë sonë. Drita do të fitonte vërtet aq shumë sa fitoi, po jo vetëm me një vizitë turisteje e me një qëndrim gjysmë ore në klubin e kombinatit, por me kontakte më të gjata e më të shpeshta me ambientin e vërtetë punëtor, me botën shpirtërore, ndjenjat dhe dëshirat e kësaj klase, me ideologjinë e saj. Kjo mënyrë, po, do të qe reale dhe bindëse për ne që ta prananim

kthesën e vendosmërinë e heroinës në luftën e saj, dhe jo vetëm takimi i saj tancegjial me botën punëtore. Realizimi më i kujdesëshëm e me i motivuar i këtij momenti do t'i kishte dhënë shumë pluse personazhit, idesë e krejt novelës.

Megjithëse, siç e vumë re, fakti qe autori e ka përqëndruar më shumë vështrimin e tij tek e reja, është shumë pozitiv, prapë mendojmë se më të realizuar artistikisht në novelë janë ata që përfaqësojnë të vjetrën, botën që po shembet. Vangjeli i novelës së Fatos Arapit, ndonëse në proporcione më të vogla, mbetet pothuaj i një shkalle realizimi me shumë tipa të tjerë të skalitur nëpër veprat e tjera të autorëve tanë, të botuara këto vitet e fundit. Vangjeli dhe e shoqja, Efigjeni, denjësisht e përfaqësojnë botën e tyre, ata të bindin për çdo veprim dhe mendim që shfaqin, ata janë dhënë po kaq të vërtetë edhe në detajet e pasura artistike, që ka gjetur autori, apo në ambientin ku ai i vendos, shkurt, në gjithshka që i rrethon e që ka të bëjë me të djeshmen apo me të sotmen e tyre.

Tek Iliri autori ka dashur të na japë një tip apo karakter më kompleks se të tjerët, por kemi përshtypjen, se ai mbetet i paplotë në novelë. Kjo mungesë të bie në sy veçanërisht në pjesën e fundit të novelës e sidomos pas acarimit të tij me të fejuarën, Dritën.

Tema që ka trajtuar autori është shumë e rëndësishme dhe interesante, por problemi shtytës, ai që e vë në lëvizje subjektin, na duket jo aq tipik dhe i përgjithshëm për realitetin tonë, që e ka kaluar prej vitesh edhe atë ngurim të pakët të familjeve patriarkale për të mos lejuar vajzat në punë, veçanërisht i dobët dhe i pafuqishëm ka qenë ky konflikt në familjet qytetare mikroborgjeze, siç është familja, që ka vendosur në qendër të novelës së vet Fatos Arapi. Një gjetje më e qëlluar do t'i kishte dhënë më shumë gjallëri subjektit, konfliktit të veprës dhe do ta kishte evidencuar me me sukses temën. Është karakteristike pozitive për novelën stili i dukshëm poetik i autorit, i cili vende-vende i ka

dhënë ngjyra shumë të ngrohta dhe lirike asaj. Kjo veçori stili nuk e ka dëmtuar aspak karakterin realist të saj dhe s'e ka penguar autorin në mendimet apo në analizat shoqërore e psikologjike, që u bën ngjarjeve, veprimeve dhe karaktereve të personazheve në novelë.

1970

PËR PJEKJE PËR TË HYRË NË PSIKOLOGJINË E NJERËZVE

Jeta jonë e re ka mijëra shfaqje të larme e plot dritë ku shkrimtari, si zhbirues i thellë i realitetit, mund të thithë subjektin për veprën e tij. Njerëzit tanë, të zhveshur nga meskiniteti, egoizmi dhe ambicja, njerëzit tanë, pjesëtarë të denjë të shoqërisë sonë socialiste me tiparet e tyre të larta morale me shpirtin revolucionar, janë shëmbëlltyra të gjalla të karaktereve, që do të skalisë në vepër dora e shkathët e prozatorit. Pikërisht për këtë pasuri e larmi të pafund shfaqjesh, me të cilat rrjedh jeta jonë, ne mendojmë se shkrimtarët kanë në duart e tyre një gurrë ujëplotë, që doemos ndikon dhe u jep dorë krimjimeve të tyre. Kjo pandehmë nuk është një hamendje jona, por është vetë e vërteta ndër ne, ndër ditët tona, e cila për secilin nga ne është e ndijshme, e prekshme, konkrete.

Pikërisht kjo, mendojmë ne, është themeli dhe burimi apo shkaku, që shpjegon këtë vitalitet e lulëzim të paparë të letërsisë sonë në këto vitet e fundit, ndoshta si asnjëherë më parë.

Është bërë tashmë traditë që ne të kemi shumë shpesh ndër duart tona libra të rinj dhe jo vetëm kaq, por edhe firma të reja, të panjohura më parë, të cilat dëshmojnë për aftësi e zotësi në kapjen me guxim të pro-

blemeve të jetës deri në shfaqjet e tyre më të ndërlikuara e më delikate si dhe në trajtimin origjinal dhe me art të tyre.

Ndër vëllimet me tregime të prozatorëve të rinj, që me sukses kanë debutuar vitet e fundit, është edhe «Mrekullia e diellit» i Shefqet Tiganit, për të cilin do të thoshim fjalë të ngrohta si për një të ri, i cili në fushën e tregimit qysh në këtë vëllim të parë jep mjaft shpresa se do të ecë përpara.

Që në një vështrim të parë «Mrekullia e diellit» të bën përshtypje për larminë dhe gjerësinë tematike, për aspekte shumë të ndryshme jete, që ka derdhur në të autori, si dhe për ambientet e krijuara me vërtetësi e me sigurinë e një prozatori me përvojë. Kjo dëshmon për atë që Sh. Tigani jo vetëm e vëren me kujdes jetën rreth tij, mendon për të dhe për njerëzit, mundohet t'u hyjë thellë fenomeneve të jetës dhe karaktereve por dhe që jo vetëm një herë ai ja ka arritur që me forcë e vërtetësi të na i rikrijojë në vepër. Kjo anë e punës së tij si shkrimtar është pa dyshim një nga anët më të shëndosha, së cilës ai s'duhet t'i ndahet gjatë gjithë krijimtarisë së vet, se kjo ka bërë që prozatori të jetë gjithmonë realist e si rrjedhim, i besueshëm e bindës në krijimet e veta, dhe nga ana tjetër, kjo cilësi prej observuesi, ka bërë që ai të mos jetë pa masë mbas fantazisë së vetë krijuese, të mos i besojë vetëm asaj, por atë, fantazinë krijuese, ta ketë kurdoherë nën kontrollin e rreptë të realitetit, i cili s'i honeps dot trillimet dhe fantazimet boshe.

Duke lexuar tregimet e këtij vëllimi, na ra në sy, si vegori e përbashkët në krejt vëllimin, aftësia e autorit për t'u futur në botën e brendshme të heronjve të tregimeve të tij; pra përpjekja e tij për t'i njohur këta heronj në mendimet e ndjenjat e tyre apo më mirë për të na dhënë neve ata heronj duke zbërthyer tiparet më kryesore të tyre, botën e tyre shpirtërore, forcën e vërtetë lëvizëse, atë që i shtyn njerëzit në këtë apo atë veprim. Ky synim i autorit na duket se është një nga cilësitë e tij më me vlerë, nga e cila ai s'duhet të heqë

dorë, por ta thellojë e ta pasurojë në të ardhmen. Kjo cilësi e prozës së këtij autori të ri ka zënë vend nëpër tregime duke qenë e kontrolluar nga ndjenja e masës pra pa tepërime, pa u kthyer në një mani stili, pa rënë në psikologjizëm dhe së fundi, pa prishur proporcionin e elementeve të tjera të tregimit sidomos zhvillimin e aksionit, thellimin e konfliktit apo skalitjen e karaktereve.

Zbërthimi psikologjik i personazhit si element, që motivon veprimet e tij, kemi përshtypjen se është dhënë në mënyrë më të qëlluar në tregimet «Mrekullia e Diellit», dhe «Revole me tapë». Në secilën prej këtyre tregimeve autori është përqëndruar kryesisht në spikatjen e lëkundjeve të brendshme të personazhit duke u munduar të kapë edhe dridhjet e tyre më të padukshme me qëllim që të na i komunikojë ato neve. Dhe kësaj ai ia ka arritur.

Ne lexojmë «Mrekullinë e diellit» dhe bashkë me Petritin, heroin e tregimit, jetojmë emocionet e tij, ndjejmë këmbënguljen dhe vullnetin e tij për ta mposhtur vdekjen, që i kërcënohet, dashurojmë jetën, dritën e thyer të diellit, që shkëlqen edhe aty nën ujë, ndjejmë rrahjet e ngadalësuara të zemrës së tij, shijojmë athtësinë e ujit të detit dhe të gjitha këto në saje të forcës komunikuese të tregimit. Në të gjithë komponentet e veta tregimi është shtruar drejt dhe me përmasa të sakta, vetëm se motivi që ka zgjedhur autori për ta përligjur dëshirën për jetë të heroit na duket se s'duhej absolutizuar në atë mënyrë, sikurse e gjejmë në tregim, ku Rabi, vajza që dashuron Petritin, është e vetmja forcë që e lidh atë me jetën dhe që e shtyn të luftojë për jetën. Mendojmë se interesat e tij, si dhe pasionet e tij, pra interesat dhe pasionet e të riut tonë sot janë shumë më të gjera se sa vetëm dashuria për vajzën.

Ndërsa te «Revole me tapë» Koçua është, për mendimin tonë, një tip punëtori i realizuar e i skalitur plotësisht, ndonëse nëpërmjet pak penelash dhe me kursim detajesh si rrallë në ndonjë tregim tjetër. Këtë njeri

të thjeshtë, punëtor të palodhur, që jeta e vrullshme qysh në vitet e para pas çlirimit e kaliti me ndërgjegjen e njeriut të lirë e shqetëson dhe e djek përbrenda ajo frazë «Revolet me tapë të Koços», që e tha drejtori kur kritikoi punën e dobët në gurorë. Kjo frazë që shkaktoi të qeshura iu ngul si gozhdë në tru e në zemër Koços dhe e ndjek atë deri në fund të tregimit. Pse vallë? Se për Koçon uzina, gurorja apo gjithshka tjetër është e tij. Sukseset e tyre janë të tijat, ai s'arrin ta kuptojë se si atë mund ta kritikojnë për diçka që s'është në dorë të tij. Të gjithë këtë tronditje të brendshme, autori e ka zberthyer drejt, nëpërmjet situatash të besueshme shpirtërore.

Por në këtë tipar stili ka edhe ndonjë tregim ku zberthimi psikologjik del si qëllim në vete dhe në tërësinë e tregimit mbetet si diçka e pajustificuar. Biem si shembull tregimin «Rrapua» ku heroi i tregimit brehet me vetëveten. Të krijohet përshtypja se diçka e pengon Rrapon që të martohet, ai bile ankohet për këtë dhe turfullon me vete, por, gjatë tregimit e sidomos në fund në, jo vetëm nuk hasim ndonjë pengesë reale, por përkundrazi ndodhemi përpara një drejtori popullor dhe të gatshëm jo vetëm që të lehtësojë martesën e Rrapos, por që ka edhe dëshirë të marrë pjesë në dasmë. Pra pse gjithë ajo brejtje në ndërgjegjen e Rrapos. Në të tilla raste, kur analiza psikologjike e personazhit nuk është në funksion të ndonjë ideje, ajo bëhet e panevojshme dhe shndërrohet në mani stili.

Krejt ndryshe ndodh me tregimin «Ti je kapedan». Plaku Refat brehet në mendimet e veta, atë e shqetëson qortimi i sekretarit, ndonëse ky i ka folur ngrohtë dhe me besim. Në tërë shtrirjen e subjektit, përçamja e brendshme shpirtërore e personazhit është dhënë në një moment kthese në fatin e heroit, prandaj ajo është e domosdoshme, sepse, në radhë të parë, motivon veprimin e mëpasëm dhe shpjegon pse dhe si ndodh ndryshimi në fatin e ngjarjes apo personazhit në tregim. Autori me zberthimin psikologjik e ndjek personazhin në disa mo-

mente. Refatin ne e shohim të tronditur thellë që kur niset për shtëpi, ai e ka humbur fare kur hipën në autobus dhe po kështu i çoroditur shpirtërisht është edhe me të shogen në shtëpi. Në tërë këto momente jo rastësisht është shtrirë analiza, që i bëhet personazhit dhe kjo është plotësisht funksionale, sepse shpjegon ndryshimin e qëndrimit të Refatit me ekuipazhin, ai bëhet më i kujdesshëm e më kërkuar, si edhe ndryshimin e rezultatit të punës së anijes peshkatare.

Sigurisht për realizime të tilla funksionale dhe të arrira të zbërthimit të botës së brendshme të personazhit e kemi fjalën ne kur çmojmë këtë tipar të prozës së Sh. Tiganit.

Ana tjetër, që vlerësojmë në këtë vëllim, është lar-mia e ambienteve, që ka mundur të na realizojë autori nga tregimi në tregim. Ajo që është më pozitive në këtë drejtim, mendojmë se është fakti që këto ambiente në shumicën e tregimeve janë dhënë me vërtetësi, gjë që dëshmon se autori e ka njohur mirë atë që na përshkruan.

Kështu ne futemi në thellësitë e tunelit ku njihemi me punëtorë me shpirt të madh si Fiqiriu, të cilët edhe në raste të rënda fatkeqësish gjejnë forca morale për të luftuar në emër të jetës (tregimi «Rreze drite në errësirë»), apo jetojmë në mes të peshkatarëve duke njohur jo vetëm preokupacionet e tyre, por edhe gazin, gjallërinë dhe humorin e tyre (tregimet «Ti je kapedan», «Unë, Leni dhe babai i saj»), apo njihemi me punëtorë të thjeshtë, me njerëz që luftojnë çdo lloj pengese dhe vështirësie për të realizuar detyrat dhe planet (tregimi «Revole me tapë») si dhe shumë ambiente të tjera ku ndihet shkathhtësia e autorit dhe detajet mjeshtrorë, që ka ditur ai të japë e të plazmojë në vizatimin e këtyre ambienteve.

Mendojmë se një anë ende e porealizuar sa duhet në tregimet e këtij vëllimi përbën kapja dhe evidencimi i konflikteve, që rreh të na japë në themel të tregimeve të veta autori. Në disa tregime, që për mënyrën e tyre, e kërkojnë konfliktin, ky s'është theksuar

sa duhet dhe ka mbetur i porealizuar. Kështu tregimi «Rrapua» të përgatit për konflikt dhe më pas e humb fare atë; tregimi «Ne jemi bashkë, baba» preston në shumë momente për konflikte të natyrave të ndryshme, por s'i trajton asnjëherë ato, kjo ka bërë që disa situata të kalojnë të zbeta në tregim e të mos marrin shpjegim, si është rasti në raport me robin gjerman, sjellja ndaj të cilit nuk është e kuptueshme për lexuesin në ndonjë moment. Apo heroizmi i babait që qëndron i vetëm dhe u bën ballë gjermanëve të armatosur pohohet si fakt që të duket si diçka gati-gati e zakonshme etj.

Në tregimin «Alo, alo!» ku në objektivin e vet autori ka vendosur konfliktin e madh midis së resë e së vjetrës në moral, është kaluar lehtë e cekët kjo ndeshje konceptesh. Ai ndoshta e ka bërë këtë gjë për të theksuar se e vjetra, megjithëqë na kërcënon, është krejt e pafuqishme dhe rezistenca e saj është qesharake. Por kjo na duket se nuk mjafton për të përligjur zbehjen e konfliktit. Në çdo lloj shfaqje të saj e vjetra nuk dorëzohet aq lehtë, ajo lufton dhe detyra e letrarit është jo që ta mohojë, por të dijë si ta japë të tërë mprehtësinë e saj në mënyrë që të dalë po aq edhe superioriteti i së resë, forca e saj. Në këtë mënyrë është vepruar me tregimin «Unë, Leni dhe babai i saj», që ka të njëjtën problematikë ku konflikti është vënë në qendër dhe ka dalë me tërë forcën dhe mprehtësinë e tij, dhe na duket se është vepruar më drejt. Pra në kapjen e konflikteve të jetës, në paraqitjen e tyre me sa më tepër forcë, me fjalë të tjera, në njohjen e jetës dhe në pasqyrimin realist të saj, autori duhet ende të bëjë një punë të kujdesshme dhe këmbëngulëse, gjë që pa dyshim do t'i rritë vlerat e krijimeve të tij letrare.

Me këto tipare vlera dhe merita, që hasim në vëllimin e parë të Shefqet Tiganit, ne jemi optimistë se ky autor i ri, duke shmangur ndonjë të metë e dobësi, do të arrijë të na japë vepra përherë e më të pjekura, më me vlerë ideo-emocionale.

1970

TREGIME QË U BËJNË JEHONË DITËVE TONA

Ky vëllim i dytë me tregime i Teodor Laços, është një hap i ndijshëm përpara i autorit, që nga vëllimi i tij i parë. Ndër shumë vlera e merita që mund të vëresh, të bie në sy se «Rruga e bardhë» i bën jehonë me forcë realitetit tonë të sotëm; në të autori ka derdhur mbresa të freskëta jete, të cilat si vëzhgues jo i zakonshëm, ka ditur t'i mbledhë e të na i paraqitë të ngritura në art.

Një tipar i rëndësishëm dallues në tërësi i tregimeve të vëllimit është aktualiteti i temës, që ka trajtuar në to autori. Subjektet e tregimeve vërtiten kryesisht rreth problemeve më të fundit të revolucionarizimit të jetës, kanë në epiqendër njeriun e ri dhe luftën e shoqërisë e të individit për të përmbysur mentalitetet e vjetra reaksionare, që bëhen pengesë në ecjen përpara. Në secilin tregim në veçanti është skicuar me vërtetësi jeta e ditëve tona, është kapur karakteristika më e qenësishme e kësaj jete, ndeshja midis dy koncepteve të kundërta, triumfi i së resë, revolucionares, mbi të vjetrën, reaksionaren.

Kjo kontraditë thelbësore që shfaqet në forma të ndryshme: herë më e dukshme dhe e acaruar, herë më pak e dukshme, vërehet në të gjithë tregimet dhe për-

bën themelin e tyre. Në funksion të kësaj kontradikte karakterizohen edhe personazhet, që pikërisht për hir të kësaj vetije, janë të gjallë, bindës dhe realë.

Autori e njeh jetën e fshatit tonë sot dhe e ka pasqyruar këtë duke kapur atë më kryesore: përpjekjen që bëhet për ta transformuar fshatin dhe ndërgjegjen e fshatarit tonë në mënyrë që edhe kjo klasë e shoqërisë sonë të ecë me të njëjtin hap si klasa jonë punëtore drejt socializmit, drejt jetës së re. Pikërisht këtë problem trajton tregimi «Brezat e gurtë». Krahas Xhezos, fshatarit që mbart pikëpamje të vjetëruara tashmë te ne, për pronën kolektive e personale; krahas njeriut që priret nga kjo e dyta, ne njohim edhe Rinushin, përfaqësuesin e së resë në fshat. Rinushi është i vendosur në qëllimin e vet për ta bërë të pjellshme çdo pëllëmbë tokë në fshat dhe ai ja arrin kësaj me gjithë vështirësitë, që i dalin me njerëz si Xhezua, sepse ai ka përkrahjen e plotë të partisë në fshat.

Akoma më gjerë e më me forcë kjo ide është dhënë te tregimi tjetër «Në lëndinat e pashkelura», ku lufta për të çuar fjalën e partisë në vend që, bukën ta sigurojmë vetë, është vështuar si një përpjekje e përbashkët e fshatarësisë sonë kooperativiste dhe e klasës punëtore. Për traktoristë si Arifi s'ka asnjë pengesë, kur është fjala për të ndihmuar në hapjen e tokave të reja, ai me shokë nuk ngurojnë ta ngjisin traktorin edhe në rrugë të rrezikshme, nuk ngurojnë të punojnë në kondita të vështira pa asnjë komoditet.

Këto tipare të larta morale nuk lindën rastësisht në shoqërinë tonë, ato u rritën dhe lulëzuan në saje të kujdesit të Partisë, ato u manifestuan së pari te komunistët e vërtetë, që në atë kohë, kur ata, ndonëse ende kishin plagët nga lufta për liri të pashëruara, u vërsulën pa rezerva në luftën e re për rindërtimin e atdheut të shkatërruar. Ky mendim spikat në tregimin «Në tufan». Megjithëse në këtë tregim përshkruhet një ngjarje e viteve të para mbas çlirimit, ajo tingëlloq mjaft aktuale dhe kjo, sepse autori ka kapur fillimin e

asaj vazhde heroizmesh, që sot çdo ditë e më tepër po bëhet karakteristikë për bashkëkohësit tanë. Po këtë ide, të vështruar në shfaqje të tjera, që janë përshkruar bukur, me realizëm e forcë emocionale, autori e ka plazmuar edhe në disa tregime të tjera si «Dritë rrëzë pyllit», «Zjarret e natës», «Mullarët e kripur» etj.

Një karakteristikë e dytë e vëllimit, që ka tërhequr kujdesin e autorit, është përpunimi dhe skalitja e karaktereve apo personazheve nëpër tregime. Heronjt e tregimeve janë të zbërthyer edhe në botën e tyre të brendshme; në këtë mënyrë ata janë të motivuar plotësisht, dhe i shpëtojnë paraqitjes shabllone. Te secili prej tyre është dhënë individualja, e veçanta, por njëkohësisht ata edhe përgjithësojnë vetija të përbashkëta të moralit të ri të njerëzit tanë. Heronjt e tregimeve kanë të zhvilluar shpirtin e sakrificës, janë këmbëngulës në idetë e tyre, janë luftëtarë të paepur për triumfin e së resë, të cilën e mbartin dhe e përfaqësojnë në vepër.

Lexojmë vëllimin dhe na mbeten të gjallë në kujtesë heronj të tillë si Malai i tregimit me të njëjtin titull, me dëshirën e madhe për të mos u ndarë nga puna edhe pse është plak. Për të s'ka kuptim jeta e kotë, pa aktivitet, ai s'mund ta kuptojë se si mund të rrijë vite të tëra si pensionist pa u marrë me asgjë; «*aty ku mbaron puna, mbaron jeta*», kështu mendon Malai. I kësaj natyre shpirtërore është edhe Andoni i tregimit «Rruga e bardhë». Ky i ri, mësues fshati, e ka thellë në ndërgjegje ndjenjën e dashurisë për profesonin, për fëmijët, dhe është pikërisht kjo ndjenjë, që i jep forcë të mos ndalet e të mos friksohet as nga tufani, as nga dëbora, as nga ujëqerit, por të çajë përpara derisa arrin në fshat.

Është shumë afër nga ndërtimi moral e bindja politike ky personazh me sekretarin, ish-partizan, të tregimit «Në tufan». Te ky i fundit autori ka mishëruar atë forcë shpirtërore të komunistit, që është i ndërgjegjshëm se historia i ka ngarkuar një mision të ri brezit të tij: të hapë gjithmonë rrugë të reja në jetë.

Krahas heroit pozitiv, që e hasim me ato tipare që

përmendëm më sipër, në shumicën e tregimeve, autorin e kanë shqetësuar edhe ato shfaqje negative, sado të rralla qofshin, që lulëzojnë te njerëzit e dobët si reflektim i egoizmit, dëshirës për mirëqenje vetiake, mbylljes në grackën e interesave të vogla etj. I tillë është personazhi i tregimit «Një njeri i vogël» Tafili. Të tillë njerëz janë si një çiban në trupin e shëndoshë të shoqërisë sonë, janë si një notë fallco në simfoninë heroike të ditëve tona, të jetës sonë dhe këta vetë jeta i flak tej si plehra. Kurse në tregimin «Shtigjet humbasin pyjeve» autori ka nënvizuar, nëpërmjet personazhit, Bidos, mendimin se ndjenja mikroborgjeze e pronës private është përherë një rrezik, një grackë, që mund të molepsë njerëzit e dobët, që mund t'i joshë ata në rrugën e degjenerimit apo të degradimit moral, kundër të cilit duhet luftuar vazhdimisht. Bidua është zbërthyer bukur në luftën e vet shpirtërore ndaj ndjenjës së pronësisë për një kohë por, pas kësaj, Bidua arrin të shkëputet e këtu ndikon ambienti shoqëror, i yni, pra evidencohet kjo e vërtetë e madhe, që te ne s'ka rrethana, që ta favorizojnë mikroborgjezimin e njeriut dhe të shoqërisë. Do të qe më mirë, për mendimin tonë, që autori të mos linte pas dore pa na e pasqyruar më hapur faktorin e rëndësishëm shoqëror, që ndikoi në kthesën shpirtërore të heroit.

Në shumë tregime Teodor Laçua ka kapur një aspekt shumë të rëndësishëm të ditëve tona, që është jeta aktive e masës, pjesëmarrja e saj në të gjitha problemet ekonomike e politike, ngritja e saj në një forcë të vërtetë vendimtare për gjithë jetën tonë. Në shumë probleme të koklavitura gjatë punës dhe veprimtarisë, që u dalin heronjve, pjesëmarrja e njerëzve të thjeshtë, mendimi i tyre është vendimtar, pra masa e njerëzve të popullit nuk është një masë inerte e pa funksion në tregim. Kujtojmë për shembull tregimin «Mullarët e kripur» ku problemi i ruajtjes së mishit gjen zgjidhje nga një njeri krejt i zakonshëm, nga kasapi Jorgo Bucoi ose (Capi). Ai në mbledhjen e kolektivit jep mendimin se si

mund të ruhet mishi i therur pa pasur frigoriferë. Apo në tregimin «Zjarret e natës» ku shohim qëndrimin aktiv, që fshatarët mbajnë ndaj burokratëve parazitë dhe sidomos vrullin e rinisë për të lulëzuar jetën e fshatit.

Ka nëpër tregime shumë mendime, figura, probleme për të cilat s'mund të flasim hollësisht në këto shënime të shkurtra, por e përbashkët për to është se janë pasqyrë e gjallë e jetës sonë të sotme.

Autori e ka derdhur këtë material të pasur në një formë të zgjedhur e të bukur letrare. Proza e tregimeve jo vetëm që është e rrjedhshme dhe e këndshme, por edhe e pasur me përshkrime të bukura, që fiksojnë në përfytyrimin tonë tablo të gjalla. Po kështu, heronjt e vëllimit janë të detajuar edhe në botën e tyre të brendshme, veçori kjo që u jep më shumë «gjak e mish» atyre, i bën më të gjallë e më bindës.

1967

VLERA IDEO-ARTISTIKE E DRAMËS «TOKA JONË»

Ndër dramat e bukura që ka trajtuar me realizëm dhe forcë emocionale temën e jetës së re, që lindi në fshatin tonë fill pas çlirimit, është dhe drama «Toka jonë» e Kolë Jakovës. Kjo vepër ngre dhe pasqyron drejt një sërë problemesh të ndryshme, në themel të të cilave qëndron reforma agrare, e cila realizoi një nga ëndrrat më të mëdha shekullore të fshatarësisë sonë.

Kuadri historik, ku autori ka vendosur subjektin e dramës, është ai i periudhës më të parë, kur atdheu ynë i porsadalë nga përleshja legjendare e bijve të tij partizanë me bishën nazifashiste, po niste një epokë të re, një faqe të re në historinë e vet, e prirë, sikurse gjatë luftës për çlirim, nga Partia Komuniste Shqiptare. Prapambetja historike shumëshekullore e Shqipërisë, e rënduar me plagët dhe shkatërrimet e mëdha, që i shkakton okupatorët nazifashistë dhe tradhëtarët e çdo marke gjatë luftës së fundit, shtronte si detyrë imperative përpara Partisë dhe popullit, jo vetëm zhdukjen e prapambetjes, por edhe hedhjen e themeleve të shëndosha, mbi të cilat do të bëhej i mundur ndërtimi i një jete të re.

Partia dhe pushteti ynë popullor ndërmoren një sërë masash revolucionare me karakter politik, ekonomik e shoqëror, të cilat kishin për qëllim jo vetëm t'i prisnin rrugët çdo mundësie të restaurimit të kapitalizmit,

por edhe të çelnin shtegun e rrugës së re socialiste, që do të ndiqte paskëtaj atdheu ynë. Ndër këto masa që edhe shpronësimi i plotë i tokave, pronë e ish-feudalëve vendas dhe e shfrytëzuesve të tjerë, apo e shoqërive të huaja (të cilave ua kishte shitur regjimi antipopullor i satrapit Zog) dhe dhënja e tyre falas fshatarësisë punonjëse të patokë ose me tokë të pamjaftueshme, duke ndjekur parimin «toka i përket atij që e punon».

Por realizimi i kësaj reforme të madhe nuk u krye lehtë, ai u bë nëpërmjet një lufte të egër, të përgjakshme me armiqtë e brendshëm e të jashtëm, nëpërmjet një lufte me kulakët dhe borgjezinë e feudalët e përmbysur, të cilët, megjithëse e kishin humbur gjithë pushtetin politik, mbaheshin akoma të fortë në pushtetin ekonomik; pra, reforma u zbatua nëpërmjet një lufte të ashpër klasash.

Paraqitjen e kësaj lufte ka arritur ta përgjithësojë Kolë Jakova në dramën e vet, në themelin e së cilës ka vendosur kontradiktën e madhe midis dy botëve: së resë e së vjetrës, socialistes dhe feudo-kapitalistes, duke e gërshetuar këtë konflikt edhe me konflikte më të dyta, që synojnë dhe e japin të plotë tablonë reale të fshatit shqiptar në atë periudhë.

Ngjarja, që shtjellohet në dramën «Toka jonë», zhvillohet diku në një fshat të bregut të Matit, pra krahinat e Veriut, ku varfëria dhe diferencimi ekonomik që i theksuar. Në qendër të subjektit autori ka vendosur fatin e një familjeje të varfër malësore, familjes së Gjokajve, që varfëria dhe sidomos lakmia e pangopur e pasanikut, e kulakut më të urryer të fshatit, Tuç Makut, e kishte hedhur në mjerim.

Gjokën, të shoqin e Lokes, heroinës kryesore të dramës, e pat bërë «mik e vëllam me gjak» Tuçi. Arësyeja e vërtetë e kësaj «miqësie» që se Tuçi i kish vënë syrin arës së Gjokës, që shtrihej në kufi të pronave të tij dhe Lokes, gruas së bukur të Gjokës. Meqë s'ja doli dot me dredhi për të shtënë në dorën arën e Gjokës, Tuçi vuri dhe pagoi me para Gjin Keçin që të vriste «vëllamin»

dhe, për të mbuluar gjurmët, shtiu njerëz të tjerë për të vrarë Gjin Keçin. Por kjo poshtërsi nuk mbeti pa u marrë vesh nga të tjerë, vetëm se ata, nga frika, se Tuçi aso kohe qe zot e padron, që mund t'u bënte çdo të keqe, heshtën. Pasi qëroi nga rruga Gjokën, Tuçi u mundua të shtinte në dorë Loken, por kësaj s'ja arriti dot. Atëhere kulaku shpirtzi përhapri fjalë se Lokja gjoja qenkësh grua pa nder e për të «mbrojtur» fëmijët e «mikut» të tij, Gjokës, «se nëna e tyre mund t'i mësonte si veten e saj», i ndau nga Lokja. Lokja u detyrua të mernte rrugën e maleve, pa bukë, pa mbrojtje, duke i lënë jetimët në dorë të gjakësit të babait të tyre. Kështu Tuçi realizoi qëllimin e tij: i rrëmbeu atë rrip të vogël toke kësaj familjeje të varfër.

E gjitha kjo që përshkruam më sipër, ndodh përpara ngjarjeve, që autori vendos në dramë dhe ne e mësojmë këtë nëpërmjet fjalëve të personazheve të ndryshëm e sidomos nga goja e Lokes.

Me t'u hapur sipari, ne kemi përpara fshatarin tonë malësor, përpara të cilit po shtrihet një rrugë e re, e ndritshme jete. Ai po merr tokë e këtë tokë Partia, pushteti popullor, po ja jep falas, ëndërr kjo që ai s'kishte guxuar ta sillte nëpër mend. Por jo vetëm kaq: këta malësorë janë të rilindur shpirtërisht. Në mendimet e tyre, në fjalët e tyre ata janë të guximshëm. Ka ikur prej tyre frika nga i pasuri, nga bajraktari apo kulakët si Tuç Maku. Fshatarët bisedojnë për tokën, që po marrin, por janë të pakënaqur nga komiteti i fshatarëve të varfër e sidomos nga Gjergj Bardhi, kryetari, njeri me karakter të dobët, i cili, duke qenë në krye të komisionit të reformës, i ndan tokat padrejtësisht e në favor të Tuçit, me të cilin dikur ka qenë mik. Ai e ruan akoma këtë miqësi fshehurazi. Fshatarëve u del krah Meti, një komunist i vendosur, dikur punëtor në punishten e sapunit në Shkodër, që është ngarkuar nga partia për të kontrolluar zbatimin e reformës. Meti i ka kuptuar hilet e Tuçit e të Gjergjit, ashtu sikurse i kanë kuptuar edhe vetë fshatarët, prandaj bashkë me ta, kërkon që të demaskojë

gjithë veprimtarinë e Gjergj Bardhit me shokë si vegla të Tuçit. Po në këtë akt ne njihemi me Vatën, të fejuarin e Files, vajzës së Lokes, që është komandant vendi në fshat. Edhe ky ka pasur një të kaluar jo të pastër, ai ka mundur me marifet t'i fshehtë gjurmët, por jo aq sa të mos e njohë edhe Tuçi, i cili ka ndërhyrë për fejesën e tij me Filen, me qëllim që ta ketë si vegël të vet. Tuçi i kujton të kaluarën Vatës dhe e vë në shërbim të tij. Ndërkaq vjen Lokja prej malësie e fshatrave ku ka qenë endur për vite të tëra si argate. Ajo ka qenë më parë te Murrashi, i cili e ka përkahur nënën, se e ka kuptuar që ajo është e pafajshme dhe viktimë e Tuçit. Lokja ndeshet me Tuçin te shtëpia e djalit të saj të madh Lekës dhe ja përplas në fytyrë atij gjithë ligësitë, që i ka punuar.

Tuçi, pasi e ka mashtruar, e tërheq për hunde Lekën dhe e ndërson kundër së ëmës. Megjithëse Leka s'e qas dhe e dëbon në fillim, detyrohet më pas ta futë në shtëpi Loken vetëm për hatër të letrës së Murrashit, të cilën Lokja e ka prurë me vete. Në atë letër vëllai i vogël i tragon të vërtetën për nënën e tyre.

Në aktin e dytë, ku konflikti ashpërsohet në mënyrë më të mprehtë, kryesisht subjekti përqëndrohet në demaskimin e fytyrës së urryer të Tuç Makut. Në shtëpi shpërthen stuhia, që aq shumë e priste Lokja. Murrashi, djali i vogël i Lokes, kthehet më në fund nga ushtria në fshat dhe përveç njerëzve të tij, ai gjen edhe Tuçin e Vatën, që kanë ardhur «të çmallen» me të. Krejt ndryshe nga Leka, Murrashi mban një qëndrim të prerë ndaj Tuçit. Duke qenë komunist, Murrashi nuk është naiv si Leka; ai e njeh armikun e klasës, e njeh rrezikun e tij, ai s'bën asnjë kompromis, nuk i fërkon shpatullat atij, por e godet ashpër, e demaskon pa mëshirë. Në gjithë dialogët e këtij akti e veçanërisht në bisedën Murrash-Tuç, ndihet në gjithë ashpërsinë e saj, përlëshja e dy botëve të kundërta, që luftojnë për jetë o vdekje, demaskohet figura e armikut të klasës, e kulakut Tuç Maku. Po në këtë akt, në saje të Murrashit, Lokja gjen vendin

e saj si nënë në familje pas shumë vuajtjesh e mjerimësh, që ka kaluar.

Shtjellimi i veprimit të subjektit vazhdon në aktin e tretë të dramës, që njëherazi është një nga aktet më dramatike, më emocionale. Murrashi me Metin, të pasuar nga bujqit e varfër të fshatit, i janë përveshur punës për të mëkëmbur plotësisht jetën e re në fshat. Mbasi ka demaskuar Tuçin e Vatën, Murrashi ia përplas të vërtetën në sy edhe veglës së Tuçit, Gjergj Bardhit. Tuçi e sheh se po i prishen të gjitha planet, që me aq mundim e mjeshtëri mezi i kishte kurdisur, ai e kupton që armiku më i rrezikshëm për të është Murrashi dhe vendos që ta heqë atë nga rruga. Po në këtë akt të dramës Tuçi vë Vatën dhe e vret Murrashin. Por fshatarët ngrihen në këmbë për të ndjekur gjakësin. Vata, mbasi ka kryer krimin, vjen në shtëpi të Lekës për të rrëmbver apo për të vrarë Filen; aty ndeshet me Loken e Marën dhe bie në duart e tyre. Akti mbyllet me lajmin e vrasjes së Murrashit, që vjen t'ia thotë Lokes Meti. Me gjithë dhembjen e thellë, Lokja qëndron si burrneshë, si nënë e vërtetë malësie.

Në fund, në aktin e katërt, drama mbyllet me kapjen e Tuçit, i cili i ndjekur nga të gjithë, bie padashur, në duart e Lokes dhe gjen atë që meritonte. Jo pa qëllim autori vë Loken që ta kapë Tuçin. Me këtë ai i jep asaj të drejtën për t'u hakmarrë për gjithë të zezat në jetë, burim i të cilave ka qenë Tuçi e klasa e tij. Drama mbyllet me një frymë të thellë optimiste. Me gjithë hidhërimin për Murrashin që iu vra, Lokja, si dhe gjithë fshatarët, është e lumtur se më në fund po realizohet ëndrra për tokë, që ishte dhe dëshira dhe qëllimi i lartë i Murrashit të saj.

Sikurse thamë më sipër drama ka në themelin e vet konfliktin e fuqishëm shoqëror, përpjekjen antagonistike midis dy sistemeve të shprehur në luftën klasore. Rezistenca e njerëzve si Tuçi është tamam si përpëlitja e egër e bishës së qëlluar për vdekje, që herë tërhiqet për të mbledhur fuqi, herë vërsulet me tërbimin e dëshpërimit. Klasat e përmbysura, që kanë humbur gjithë pushtetin,

politik, të cilin ua përmbysi revolucioni, mundohen të mbahen me çdo mjet pas asaj që u ka mbetur si e vetmja mbështetje, pas pasurisë, pas ndikimit ideologjik. Tuç Maku me qëndrimin e tij e përfaqëson plotësisht këtë në dramë; ai s'lë mjet pa përdorur për të ruajtur tokën e pasurinë dhe, kur e sheh se po i rrezikon edhe ato, nxjerr dhembët e tij prej gjaksori, vret Murrashin.

Krahas këtij konflikti të madh, që përbën kolizionin në vepër, janë vendosur edhe konflikte të tjera, që harmonizohen në unitet me të. I tillë është ai që mbart Lokja në dramë. Tragjedia e saj nuk është thjesht një çështje fati të keq në jetë, që lidhet vetëm me Loken; përkundrazi, ajo është një përgjithësim i fuqishëm i mjerimit të masës së popullit tonë në regjimet e së kaluarës. Linja e Lokes ka një nëntekst të fuqishëm demaskues, autori me të ngrihet në një aktakuzë të fortë në emër të femrës fshatare shqiptare, që koha e kishte shndërruar gati në një kafshë pune pa personalitet dhe së cilës lehtë mund t'i merrej nëpër këmbë edhe ndjenja më njerëzore e dashurisë për fëmijët e saj. Përpos këtyre, në dramë vërejmë edhe konflikte më të dyta, që shërbejnë për të evidencuar mendimin kryesor të dramës, apo që shërbejnë për të theksuar e për të vënë më në pah tipare të karaktereve njerëzore.

Karakteret më të realizuar në dramë, ata që mbajnë peshën kryesore të veprimit të saj, janë Tuç Maku dhe Lokja.

Lokja përfaqëson gruan shqiptare nga fshatarësia e varfër dhe gjithë vazhda e saj përgjithëson fatin e mjerë të gruas fshatare. Në vizatimin e këtij personazhi autori ka hedhur shumë hije dhe dritë. Si të thuash, Lokja po hyn në jetën e re plot dritë, pasi ka dalë nga bota e erët, por asaj, si gjithë popullit tonë, i duhet të luftojë ende kundër mbeturinave të errësirës. Lokja është gruaja mallësore, burrneshë, që ka luftuar me guxim gjithë jetën e saj me valët e tërbuara të egërsisë së sundimtarëve për të mbrojtur nderin e saj. Ajo duroi edhe dhembjen më të egër, asaj iu mohua e drejta të përkëdhelte fëmijët, u

përzu nga vatra, u rropat maleve por nuk u përul. Lokja, edhe në vitet e vështira të jetës së saj, bashkë me urrëjtjen kundër Tuçit, grumbulloi ato pak lekë që mundi t'i fitonte me punë të rëndë, vetëm e vetëm që t'u blinte një rrip tokë fëmijëve të saj, t'u krijonte atyre lumturinë e mohuar padrejhtësisht. Por triumfi i revolucionit tonë popullor e zgjidhi përfundimisht fatin e të gjitha lokeve shqiptare.

Edhe pse i biri e përze e s'e qas në shtëpi, Lokja e ndjen se e ardhmja po punonte për të, se Tuç Makut me shokë i kishte ardhur fundi. Ajo është e etur, e dëshiruar për t'u hakmarrë për jetën e humbur, për hidhërimet e saj e të fëmijëve të saj, Lokes s'i durohet sa t'ia përplasë në fytyrë gjithë mllëfin e saj Tuçit. Ja si i thotë ajo Files: *«Edhe ma mirë, moj bijë, le të krisë e le të bumbullojë. Këtë stuhi e ka pritë Lokja tash sa mot. Vetëm mbas kësaj stuhie mund ta shoh unë kjartë dritën e diellit.»*

Lokja është kaq e vendosur në luftën e vet, sa edhe grushti i rëndë e dhembja e madhe për vdekjen e Murrashit nuk e thyejnë, ajo bëhet më e vendosur për luftë, më e ashpër me Tuçin, armikun e saj. Me gjithë këto anë pozitive që vërejtëm në skalitjen e figurës së Lokes, herë-herë na bie në sy edhe një farë melodramatizmi, që e dobëson disi karakterin e Lokes.

Antipodi i saj, përfaqësuesi i errësirës, i botës së urreyer shfrytëzuese, që po perëndonte, është Tuç Maku. Në të gjitha tiparet, që autori i ka veshur kësaj fytyrë të urreyer, është përfaqësuar armiku i betuar i së resë, i popullit. Tuçi jo vetëm që është shfrytëzues i egër, i pashpirt, lakmitar, i pamoralshëm, por është dhe dinak e hipokrit. Ai e sheh se koha e tij po perëndon por, ashtu si klasa e vet, ai s'do ta besojë këtë realitet, s'do të pajtohet me të dhe jo vetëm kaq, por lufton me se të mundet që të rikthejë «parajsën e humbur».

Me këtë fakt Kolë Jakova nxjerr në pah një të vërtetë të pamohueshme që armiku i klasës edhe i përmbysur. e vazhdon luftën e vet. Ai mundohet të tërheqë sa

më shumë pas vetes, ai lidhet me armikun e jashtëm dhe merr çdo fytyrë e përdor çdo mjet për t'ia arritur qëllimit.

Si armik i zgjuar e dinak Tuçi punon mjeshtërisht për të gjetur shteg e mënyrë që të mos humbë pasurinë; me dinakëri ai ka verbuar Lekën, ka bërë vegël Gjergj Bardhin dhe sidomos Vatën. Por planet e tij i shemb Murrashi e Lokja, që ia zbulojnë fytyrën e tij prej egërsire. Shpesh Tuçi mbulohet me hipokrizi e kjo e bën atë të neveritshëm; ai hiqet si baba i dhembshur për Lekën, Filen e Murrashin. Sa e pështirë tingëllon hipokrizia e tij kur thotë: «Më pëlqen (Murrashi — 0.0) se ka krejt tiparet e mia. Është pak çapkën, por kështu kam qenë edhe unë kur isha i ri. Sidoqoftë ty të ka baba shtyllën e shtëpisë (është fjala për Lekën — 0.0) Ti më ke dalë djalë e përmbi djalë». Ai e ndërson Lekën kundër së ëmës dhe ia arrin qëllimit, por në disa raste, sidomos kur është me njerëzit «e vet», p.sh. me Vatën, e zbulon fytyrën e tij të vërtetë si armik i betuar i dritës, i së resë. Tuçi dhe njerëzit si ai s'e kanë të gjatë, sado të përpiqen; jeta socialiste atyre ua çjerr maskën dhe i flak pa mëshirë ashtu si klasat, që ata përfaqësojnë. Kështu ndodh në dramë. Pas vrasjes së Murrashit, Tuçi kapet dhe i dorëzohet gjyqit të popullit për t'u dënuar. Ky fund i Tuçit është fundi i logjikshëm i çdo armiku, që ngre dorë kundër popullit dhe atdheut tonë. (Por në dramë rëzimi i Tuçit është pak i shpejtuar, e veçanërisht, për një njeri aq dinak e të zgjuar siç e njohëm Tuçin gjatë gjithë dramës, nuk justifikohet ngutja e tij për të zhdukur Murrashin, sepse ky akt doemos do të shpejtonte fundin e tij në çdo formë që të ishte, sikurse ndodh në fakt.)

Leka është personazh tipik për të përfaqësuar atë pjesë të malësorëve tanë, të cilët trashëgojnë tipare të rralla si burrërinë, nderin, krenarinë dhe mikpritjen tradicionale tonën, por dhe paragjykimet patriarkale.

Leka ka dramën më të fortë shpirtërore ndër gjithë personazhet. Si malësor ai nuk mund të pajtohet me mendimin që e ëma e tij është grua e pandershme; ve-

tëm për këtë ai s'e fut në shtëpi Loken. Nga ana tjetër, në ndërgjegjen e tij bën majë ndjenja e dashurisë dhe e respektit për nënën; sidomos pas letrës së Murrashit kjo ndjenjë bëhet më e mprehtë. Si rrjedhim pra edhe lufta e tij shpirtërore bëhet më e ashpër. Në skenën e bisedës së Murrashit me Tuçin ky dualizëm shpirtëror shprehet qartë kur Leka thotë: «Rri, Tuç Maku, e përgjigju Murrashit. *Sonte do të bindet Lekë Gjoka, ose ka nanë Loken, ose ka babë Tuç Makun. Këtu ndahet shapi prej sheqeri. Për at qiell nuk po del nga dera sonë sa të jem gjallë unë, për pa u skjarue këto punë*».

Përpos të tjerëve, Leka është edhe naiv. Ai beson lehtë në sjelljet «dashamirëse» të Tuçit. Për të njohur fytyrën e vërtetë të këtij armiku, Lekës i duhej një shkundje e fortë, që ia jep Murrashi pas ardhjes së tij. Leka e kupton cili është Tuçi, por e kupton vonë, dhe e urren atë, e urren me forcën e urrejtjes së njeriut të drejtë e të ndershëm, që e kanë gënjyer poshtërsisht duke shfrytëzuar pikërisht karakterin e tij. Kjo urrejtje shpërthen në fjalët e Lekës: «*Të vras Tuç Makun; ta hudh në hendek ashtu si ai babën tonë; pastaj më shërohet zemra.*»

Murrashi ndryshon nga Leka, përpos vetijave burrërore të malësorit, është i pajisur edhe me ndërgjegjen e lartë komuniste. Si i tillë, ai e njuh mirë armikun e klasës dhe mban një qëndrim të papajtueshëm me të. Murrashi e godet që në fillim Tuç Makun dhe i shkatërron çdo iluzion për pajtim dhe afrim me të. Murrashi e lufton Tuçin jo vetëm e jo aq për motive personale, lidhur me Loken, por sidomos si armik të popullit, si përfaqësues të klasave shfrytëzuese të përmbysura. Murrashi është i gjallë, aktiv, plot jetë dhe dashuri për jetën e njerëzimit, ai e do jetën, dritën po aq sa urren errësirën dhe krimbat e saj.

Personazhet e tjera në dramë në përgjithësi janë të realizuara. Me gjithë ndonjë të metë, që mund të kenë, ata janë të profilizuara dhe secili ka individualitetin e vet, që e dallon nga të tjerët.

Drama «Toka jonë» shquhet për një ndërtim apo

kompozicion të bukur, veprimi në të ecën natyrshëm e pa sforcim. Konflikti, që vjen duke u rritur, arrin kulmin e mprehjes së vet në aktin e dytë, kur Murrashi e demaskon dhe e vë me shpatulla pas murit Tuçin. Pas kësaj vjen zgjidhja, që nis me vrasjen e Murrashit. Fundi i dramës, siç thamë më sipër, është pak i nxituar.

Kolë Jakova është njohës i mirë jo vetëm i jetës, i zakoneve e i karakterit të malësorit, por edhe i gjuhës së tij, të cilën e përdor me mjeshtëri në gojën e personazheve për t'i individualizuar ata, për t'u dhënë kolorit atyre.

Për këto vlera dhe merita ideo-artistike drama «Toka jonë» është njëra nga më të realizuara në dramaturgjinë tonë të re.

1967

FAMILJA E PESHKATARIT

Letërsia jonë e re, që lindi qysh në vitet e Luftës nacionalçlirimtare dhe që u zhvillua e lulëzoi gjerësisht si letërsi e realizmit socialist, ka ndër shumë karakteristika të tjera edhe këtë tipar thelbësor dallues: ajo i lëvroi të gjitha gjinitë letrare, ndonëse, siç është e natyrshme, në raporte jo të barabarta.

Krahazi me poezinë dhe prozën që, siç dihet, kanë bërë hapa të mëdhenj duke e çuar më tej atë që trashëguam nga e kaluara, po njih një lëvrim e zhvillim të kënaqshëm edhe dramaturgjia.

Drama jonë e sotme fillimet e saj i ka që në ato inskenimet e thjeshta teatrale, që bëheshin gjatë kohës së luftës. Në ato vite u shkruan mjaft pjesë teatrale nga autorë të panjohur, të cilat, ndonëse modeste dhe pa pretendime artistike, e luajtën fare mirë rolin e tyre ideo-politik e mobilizues.

Menjëherë mbas çlirimit, me lindjen e trupave teatraleë profesionistë, me rritjen e kërkesës për pjesë nacionale në skenat tona diletante apo profesioniste, lindi si nevojë e ngutshme përpara shkrimtarëve tanë, që ta trajtonin me më shumë seriozitet edhe këtë gjini. Hapi i parë serioz dhe i suksesshëm në këtë drejtim, pa marrë në konsideratë ndonjë tentativë diletanteske të më parshme, u krye në vitet pesëdhjetë me vënjen në skenë të dramave dinjitoze si «Toka jonë» dhe «Familja e peshkatarit».

Drama jonë trajtoi tematikë të shumëllojshme dhe dramaturgët tanë u përpoqën që me veprat e tyre të kapnin një problematikë sa më të gjerë.

E vështruar në këtë prizëm, tematika e dramës, ashtu sikurse e gjinive të tjera të letërsisë sonë, ndahet në tri grupe të mëdha:

a) Tema e së kaluarës së lavdishme historike, e luftërave të popullit tonë nëpër shekuj kundër shfrytëzimit e shtypjes, për pavarësi e tokë, kundër pushtuesve të huaj e veçanërisht, kundër sundimit të egër turk (si të «Halili dhe Hajria» e K. Jakovës, «Shtatë shaljanët» e N. Lucës, «Trim i mirë me shokë shumë» e S. Pitarkës).

b) Tema e Luftës nacionalçlirimtare, e heroizmit të popullit tonë në këtë luftë për shpartallimin e bishave nazi-fashiste, për përmbysjen e botës së vjetër feudo-borgjeze dhe për triumfin e lirisë, demokracisë e socializmit (si të dramat: «Janë plagët që flasin» e B. Levonjës, «Familja e peshkatarit» e S. Pitarkës, «Në tufan» dhe «Njëzet ditë» të F. Paçramit, «Hijet e natës» e V. Kokonës, «Tri të shtëna pushke» e I. Uruçit etj.).

c) Tema e marrë nga realiteti i ditëve tona, i vështruar ky realitet në shumë aspekte: puna për ndërtimin e jetës së re, lufta dhe përpjekjet për tejkalimin e pesëvjeçarëve; heroizmi i njerëzve të thjeshtë të frymëzuar nga idetë e mëdha të partisë; lufta kundër armiqve të jashtëm imperialisto-revizionistë dhe lufta kundër armiqve të klasës, kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, kundër zakoneve prapanike etj. (P.sh. «Toka jonë» dhe «Përkolgjinajt» të K. Jakovës, «Votra e huaj» e N. Lucës, «Shtëpia në bulevard» dhe «Ngjarje në fabrikë» të F. Paçramit, «Doktor Aleks» dhe «Studentja e vitit të fundit» të I. Uruçit, «Cuca e maleve» e Loni Papës, «Fisheku në pajë» i F. Krajës dhe shumë të tjera).

Tema e Luftës nacionalçlirimtare, siç thamë dhe më sipër, është pasqyruar gjerë në dramaturgjinë tonë të re, por prapë u mbetet shumë për të bërë dramaturgëve tanë në këtë fushë, sikurse u theksua edhe në plenumin XV të K.Q. të P.P.SH. Letërsia jonë, pra edhe dramaturgjia,

i janë borxhli kësaj periudhe historike të lavdishme dhe u takon ta pasqyrojnë drejt dhe thellë për t'i treguar kështu brezit të ri rrugën e vështirë, që u desh të kalonin prindërit e tyre derisa e prunë atdheun tonë, Shqipërinë, në ditët e sotme të lira e të lumtura.

Me këtë tematikë, ndër dramat më të realizuara është edhe «Familja e peshkatarit» e Sulejman Pitarkës.

Drama «Familja e peshkatarit» e merr subjektin nga ajo fazë e rëndë, por heroike e historisë sonë, kur Shqipëria vuante nën thundrën e egër të pushtimit fashist dhe pikëzohet në fatin, luftën dhe rrugët, që ndjek familja e peshkatarit plak, Jonuzit, për të përgjithësuar, nëpërmjet kësaj familje, me realizëm dhe forcë dramatike, qëndrimin heroik dhe luftën e popullit tonë të udhëhequr nga Partia.

Drama ka në thelb të saj luftën kundër sundimtarit të huaj, me të cilin është bashkuar dhe armiku i klasës, shfrytëzuesi i brendshëm. Këtë luftë në dramë e mbart brezi i ri (Dini, Petriti, Mira dhe Vehipi etj.) Kështu autori pasqyron të vërtetën historike të rolit të madh të rinisë nga shtresat popullore në Luftën tonë nacionalçlirimtare.

Ky konflikt, që është qëndrori në dramë, do ta përshkojë atë tej e mbanë dhe do të përbëjë kolizionin, për të cilin do të ndalemi hollësisht më poshtë.

Pjesëmarrja e Dinit me anëtarët e tjerë të familjes në luftë kundër fashistëve ngjall grindjen në shtëpinë e Jonuzit. Djali i madh i Jonuzit, Selimi, ndryshe nga të vëllezërit dhe e motra, është njeri i ulët; i prishur, i rënë moralisht, një parazit e përtac, që kërkon shtigje të lehta në jetë dhe, si rrjedhim, bie në prehër të agjentëve të armikut, rekrutohet prej tyre dhe bëhet spiun kundër të vëllezërve dhe atdheut të tij. Ky konflikt, ndonëse i dytë, ndeshet në të gjithë dramën dhe është rrjedhim direkt i të parit.

Në aktin e parë të dramës autori na njeh me personazhet dhe arrin të na japë zanafillën e aksionit të dramës dhe të konflikteve të saj.

Që në krye të dramës lexuesi njihet menjëherë me thjeshtësinë dhe varfërinë e një familjeje peshkatarësh. Brenda në shtëpi Jonuzi u tregon fëmijëve të vet një ngjarje heroike, kurse jashtë ndihen krisma pushke. Kjo ngjarje ë vënë në fillim, bëhet shkak për nisjen e aksionit dhe ka një farë kuptimi simbolik. Jonuzi u tregon të bijve mbi qëndrimin patriotik të një shqiptari në të kaluarën. Po ishte koha kur këto ngjarje heroike duhej të ndodhnin me të vërtetë në jetë e çdo ditë, sepse At-dheu përsëri kishte rënë nën sundimin e huaj. Dhe krismat e pushkëve jashtë janë pasqyrë e heroizmit të ri të Luftës nacionalçlirimtare, që zhvilloi më tej traditat e heroizmit të së kaluarës së lavdishme; ato shënojnë lindjen e kolizionit. Tregimi i Jonuzit bëhet shkak për të lindur edhe konflikti i dytë, që shtjellohet në marrëdhënjet kontradiktore midis djemve të këtij peshkatarit të ndershëm dhe patriot. Në grindjen që lind midis djemve të Jonuzit, autori jep diferencimin, që bëhet në këtë familje midis asaj vetë dhe një anëtari të padenjë të saj, Selimit. Kjo grindje fjalësh, që pasqyron karakteret e kundërta të Petritit dhe të Selimit, motivon, i bën të kuptueshme dy qëndrimet e kundërta të dy djemve. Petriti aktivizohet nga i vëllai komunist dhe ndihmon me përhapjen e trakteve, kurse Selimi, ndonëse në fillim lëkundet, hyn në marrëdhënje me Sadikun, një agjent i degjeneruar i fashizmit.

Në aktin e dytë aksioni vjen e rritet. Petriti është aktivizuar edhe më thellë në lëvizjen, kjo e shqetëson nënën plakë, gëzon Mirën, por e zemëron Selimin, që është gati të përfytet me vëllain e vogël. Por në këtë akt, ne njohim edhe Shejen, një fqinjë e familjes së Jonuzit, vajzë e mbetur jetime, të cilën Selimi e ka gënjyer dhe braktisur. Ashtu si rritet figura e Petritit me zgjerimin e aktivitetit të tij revolucionar, ashtu madje dhe më shumë, vjen duke u degraduar figura e Selimit, që, si zgjedh rrugën e tradhëtisë, futet në veprime armiqësore. I tillë është plani, që ky bën për të kapur ilegalët, të cilët atë natë do të zhvillonin një mbledhje të fshehtë.

Në mbledhje do të jetë edhe Dini. Këtë bisedë e dëgjon pa u pikasur Vehipi dhe menjëherë njofton Dinin, por është vonë. Dini s'arrin të lajmërojë të gjithë shokët. Te vendi ku do të bëhej mbledhja ndodh një përleshje, fashistët mundën të plagosnin Maliqin, njërin prej ilegaleve, i cili vjen e strehohet në kasollen e Jonuzit. Xhandarët me togerin rrethojnë shtëpinë. Petriti, që është infermier në spital, i mjekon plagën Maliqit dhe e fsheh në bodrum, por fashistët fillojnë kontrollin, dhe, kur duan të futen në bodrum, u del përpara Petriti me kokë të lidhur. Fashistët, duke kujtuar se ai ishte komunisti i plagosur, e arrestojnë dhe më vonë e internojnë në Prishtinë. Krahas rritjes së Petritit si figurë heroike, që arrin deri në vetëmohim, në këtë akt zhvillohet dhe Vehipi, që edhe ai merr rrugën e popullit, të klasës, së cilës i përket.

Në aktin e tretë rrjedha e ngjarjeve na çon drejt zgjidhjes. Sheja, si vajzë e braktisur, ka marrë emër të keq. Ajo përbuzet nga Jonuzi dhe hyn në shtëpinë e tij vetëm fshehurazi. Ajo s'ja ka hapur zemrën askujt. Të fshehtën e saj e di vetëm Vehipi, i cili nga dhimbësia, që ndjen për të, më në fund e shfaqëson para prindërve të tij. Jonuzi atëherë e fal Shejën dhe zë e urren ca më tepër Selimin. Selimi vjen në shtëpi për të marrë plaçkat e tij, ai tashmë është agjent i deklaruar. Dini dhe Mira kanë dalë ilegalë, krse Petriti s'dihet se ç'ka pësuar në internim. Para se të vijë Selimi, në shtëpi ka ardhur Dini fshehurazi vetëm sa për t'u takuar me nënën e babain. Ai përgatitet të dalë në mal. Në kohën kur largohet, Selimi me xhandarët përleshën me ilegalët dhe mbeten të vrrarë. Këtë fat, i vrrarë si tradhëtar, pësoi ai që u nda nga populli, nga klasa, nga familja e tij.

Në aktin e katërt jemi në prak të çlirimit, partizanët pothuaj i kanë dëbuar nazistët. Papritmas në shtëpi kthehet Petriti, që është arratisur nga kampi i Prishtinës e ka dalë malit partizan. Figura e tij është rritur dhe më. Ai ka marrë pamjen e luftëtarit, e njeriut të qëndrueshëm, të guximshëm dhe trim. Është gjithmonë i dashur, i gëzuar e plot humor. Edhe Dini, si ka luftuar për çliri-

min e atdheut, kthehet në familje, dhe drama mbyllet me gëzimin e madh të takimit në liri pas kaq vuajtjesh, përpjekjesh e sakrificash.

* * *

Sulejman Pitarka në dramën «Familja e peshkatarit» ka arritur të skalisë bukur e me realizëm një varg personazhesh. Nëpërmjet tyre ai ka hedhur dritë në njerëz të ndryshëm, heronj të gjallë të kësaj kohe, të cilët kanë një vetijë të përbashkët: e urrejnë dhe i lufojnë pushtuesit e huaj dhe tradhëtarët e vendit.

Jonuzi plak është i shtresës së varfër qytetare. Brezi i tij, ndonëse për të jetuar iu desh të luftonte shumë, nuk u tërhoq e nuk u mund prej vështirësive. Për të siguruar bukën, Jonuzi u bë marinar dhe u rropat vite të tëra nëpër detra larg vatrës dhe familjes, i malluar për fëmijët. Vetëm në pleqëri ai i njohu fëmijët e tij dhe vuri re, siç thotë vetë, se «vetëm një ferrë lindi në këtë shtëpi» (Selimi). Sjellja dhe qëndrimi i Selimit atë e brengos. Ai me dhembje sheh se i biri i është prishur, se ai s'ka asgjë të bukur në shpirt, ai është i huaj për të, për të vëllëzërit, për Atdheun. Jonuzi përpiqet, mesa ka në dorë, që i biri të kthejë udhë, por që të gjitha mundimet i shkojnë kot. Jonuzi, si përfaqësues i masave të varfra të qytetit, është patriot; ai e urren padrejtësinë dhe shtypjen shoqërore. Këto ndjenja ai ua transmeton fëmijëve të vet (këtë e shohim qoftë edhe nëpërmjet tregimit për atë plakun, që vdiq buzëqeshur e pa iu trembur pashait e xhelatit turk). Në dramë del më së miri se si heroizmi, ndjenja e sakrificës, hovi revolucionar, që pushtoi masat tona të udhëhequra nga partia, u mbështet në traditat e formuara në luftërat shekullore të popullit tonë për liri dhe pavarësi. Ajo i zhvilloi dhe i fuqizoi këto tradita mbi një bazë të re. Të huajin Jonuzi e urren. Ai nuk shfaqet haptaz në sy të fëmijëve, por në të vërtetë e miraton në heshtje luftën e tyre antifashiste.

Ndonëse i ashpër në dukje (Jonuzi shpesh bëhet ner-

voz kur sheh grindje në shtëpi), në thelb ka shpirt të butë e të dhembshur. Ai është njeri i ndershëm, që s'e honeps dot tjetrin kur ky s'është i tillë.

Nëna, Balja, është një grua e urtë, pak e drojtur dhe e heshtur. Ajo ka mbajtur mbi shpinë pa u ndjerë halle të mëdha. Ajo s'ka ashpërsinë e të shoqit, por ka një shpirt të butë, plot dashuri dhe ngrohtësi. Drama e djemve të saj është njëherazi edhe një dramë e thellë e brendshme shpirtërore e saj. Ajo thotë diku: «*T'u bëftë nëna, Dini! ç'janë këto që bëni? . . . Të gjallë në dhe do më futni mua nënën.*» Ajo vuan e ka vuajtur gjithë jetën pa iu ndjerë zëri, por tani përherë e më shumë simpatizon luftën çlirimtare.

Ndër personazhet më të realizuara në dramë është Petriti. Te ky autori ka dhënë realisht të riun e gjallë, gazmor, por dhe plot ndjenja atdhedashurie e gatishmërie për t'u sakrifikuar. Në fillim të krijohet përshtypja se Petriti di vetëm të qeshë e të bredhë, por shpejt tek ai dallon dhe vetija të rralla; ai është trim, i guximshëm, i gatshëm për çdo sakrificë, ai të mahnit me pjekurinë dhe vendosmërinë e tij, kur, duke sakrifikuar veten, shpëton Maliqin e plagosur. Plot burrëri ai thotë në sy të armiqve: «*Po, kapedan. Nuk e harroj kurrë kokën e prerë të plakut, që vdiq buzagaz. . . im atë ma ka treguar. Të rrojë populli e të rrojë Partia! Edhe unë do të rroj, se ka shumë djem Partia*». Në sjelljet e veta Petriti është i çiltër, i thjeshtë dhe real, tek ai s'ka asgjë të sforcuar, artificiale, bile të krijohet përshtypja, pasi e lexon dramën, se atë heroizëm që kreu, vetëm njerëz si Petriti mund ta kryenin.

Figurë interesante është edhe ajo e Vehipit; ai është viktimë e kohës, e regjimit dhe e varfërisë. Vehipi ka një shpirt të butë dhe të dhembshur. Ai është i drojtur për shkak të sakatllëkut, që prindërit s'kanë mundur t'ia kurojnë, por ka një botë të pasur e të gjerë, ndoshta më shumë se të gjithë të tjerët në shtëpi. Vehipi është i drejtë, ashtu siç ia thotë këtë gjë i ati në fund të dramës. Ai s'pajtohet asnjëherë me punët e fëlliqura të të vëllait; Se-

limit, e sidomos i vjen keq për Shejen, kur merr vesh se kjo është viktimë e Selimit.

Sheja për mendimin tonë, është një figurë krejt e parealizuar, apo më mirë e trilluar, ajo ka nota të theksuara sentimentalizmi; ajo s'gjen asnjë forcë në shpirtin e vet dhe autori me të më tepër ka dashur të na zbulojë karakterin e ulët të Selimit, se sa të krijojë një tip apo personazh më vete. **Zhdukja e saj në fund nga bajonetat e nazistëve është pak si një «deus eks makina»,** që i shërben autorit për të mos patur telashe.

Personazhi më negativ në dramë është pa dyshim Selimi. Autori te kjo figurë ka mishëruar atë pakicë të fëlliqur njerëzish të degjeneruar, që për interesat e tyre egoiste, shkelën e pështynë mbi çdo gjë të shtrenjtë dhe të dashur. Ata mohuan atdheun, klasën, familjen, nderin dhe dinjitetin si njerëz, për hir të pak të hollave, që morën nga padronët e tyre. Selimi është aq i ulët, saqë arrin të vjedhë edhe në xhepin e të atit; ai është pijanec, kumarxhi dhe i të gjitha veseve të tjera. Kalbëzimi shpirtëror i Selimit i ka rrënjët të thella. Me gjithë presionin e të atit dhe të Dinit, ai nuk heq dorë nga rruga e tij. Kulmin e fëlliqësisë së karakterit ai e manifeston aty nga fundi i dramës, kur është gati të vrasë dhe të atin e i drejton grykën e revolverit: «*Qëlllo, katil, qëlllo! Vraje dhe tët atë*», i thotë Jonuzi me urrejtje këtij përbindshi, që është djali i tij.

Selimi në fakt është një njeri i degjeneruar, është një lumpen proletar tipik; për të tillë tipa fashizmi u interesua në mënyrë të veçantë, se nga këta njerëz të degjeneruar do të dilnin agjentë dhe spiunë.

Shturja morale e Selimit ka arësytet e veta dhe autori e ka motivuar mirë këtë fenomen shoqëror në gjirin e familjes së varfër qytetare në atë kohë në Shqipëri. Pra nuk mbetet i pashpjeguar ky fakt, në dukje paradoksal, që në të njëjtën familje, në të njëjtat kushte ekonomike e moralo-sociale, Selimi merr një rrugë të ndryshme, diametralisht të kundërt me atë të vëllezërve të tjerë.

Selimi që në moshën më të re filloi të merrte vese të këqija; u bë alkoolist dhe i pamoralshëm. Mungesa e Jonuzit që largohej vazhdimisht si marinar, shoqërimi i tij me njerëz të shturur, ndikuan në formimin e karakterit të Selimit. Mbi këtë bazë do të zhvillohej edhe degjenerimi ideologjik, kthimi i tij në një vegël të pushtuesve fashistë.

Ndërsa te Dini, që duhej të ishte figura më e realizuar, si heroi më pozitiv, autori s'ka mundur t'i shpëtojë plotësisht skematizmit. Dini është figura më e ngritur politike, si të thuash udhëheqësi i vëllezërve, ai herë-herë i imponohet edhe Selimit, por prapë në pikëpamje të realizimit artistik ky personazh s'ka aq mish e gjak sa Petriti për shembull. Si personazh ai nuk rritet, mbetet po ai i pari, i formuar një herë e mirë që në fillim.

* * *

Në dramën «Familja e peshkatarit», siç theksuam edhe në fillim, është kapur e pasqyruar lufta e popullit tonë për liri kundër okupatorëve nazi-fashistë, e parë kjo nëpërmjet rrugës dhe luftës së një familjeje të varfër peshkatori.

Autori ka vënë në themel të dramës konfliktin e madh klasor të luftës së masës, duke kapur kështu atë më të qenësishmen veçori të Luftës nacionalçlirimtare: kjo s'mbeti një luftë e një grupi apo shtrese shoqërore, por u bë lufta e masave popullore, e gjithë vegjëlisë. Këtë konflikt kryesor autori e ndërthur me konfliktin brenda familjes, duke nënvizuar mendimin se revolucioni ynë popullor që edhe një shoshitje e madhe social-politike e morale, që i flaku tej plehrat e shoqërisë shqiptare, të cilat vepronin haptazi ose të maskuara.

Drama është thurur mirë. Në aktin e parë autori lidh nyjen e konfliktit dhe zë e shtjellon subjektin. Kjo nyje është kontradikta midis Selimit dhe anëtarëve të tjerë në familjen e Jonuzit, që kushtëzohet nga kontradikta e madhe shoqërore-politike e asaj kohe: lufta midis dy botëve:

të resë që po lind dhe së vjetrës që po vdes, lirisë dhe robërisë. Pika kulminante arrin kur Petriti sakrifkohet për të shpëtuar shokun, por pas kësaj, pra, në dy aktet e fundit, veprimi sikur bie, veget dhe drama s'e ka atë gjallëri. Në aktin e tretë ka episode, që edhe mund të mos ishin p.sh. dialogu Shazo-Jonuz, që s'jep ndonjë gjë të re, por e zbeh aksionin, është si një stacion. Në këtë akt ka vetëm një moment ngritjeje kur Selimi ndeshet me të atin. Akti i katërt mund të shkrihej fare mirë në të tretin dhe do të përbënin kështu së bashku një akt të vetëm shumë më të fortë e më tingëllues si finale.

Por, edhe pse vumë re disa të meta, që, po të ishin ndrequr nga autori, do t'ia kishin shtuar vlerën dramës, prapë «Familja e peshkatarit» mbetet një dramë e bukur e dramaturgjisë sonë të re me temë nga Lufta nacionalçlirimtare, që të emocionon dhe që flet me vërtetësi për atë periudhë të lavdishme të historisë sonë. Drama ka lojtur dhe lot një rol të madh në edukimin klasor revolucionar të brezit të ri, i cili duhet të njohë atë epokë të madhërishme në historinë e lavdishme të popullit shqiptar.

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

A) PROBLEME TË LETËRSISE SONE KONTEMPORANE

Jeta e sotme revolucionare në romanin tonë	5
Për heroin pozitiv të romanit tonë	16
Raporti midis individit, familjes dhe shoqërisë në disa romane	23
Për një letërsi me forcë më të madhe ideore	33
Kundër një psikologjizmi të tepëruar, për një hero të lidhur me punën	38

B) VEPRA

Pjekuria e një talenti	45
Një lindje e vështirë	67
Një roman i bukur për Luftën nacionalçlirimtare	75
Vendi i së resë dhe i së vjetrës në një roman	95
Si lindi për popullin tonë një agim i ri	101
Vërtetësi dhe forcë emocionale	122
Romani «Stuhia» i Ramiz Likajt	132
Mbresa dhe mendime për një vëllim me tregime	143
Novela «Patat e egra» e Fatos Arapit	153
Përpjekje për të hyrë në psikologjinë e njerëzve	159
Tregime që u bëjnë jehonë ditëve tona	165
Vlera ideo-artistike e dramës «Toka jonë»	170
Familja e peshkatarit	180

Tirazhi 4.06v kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1972